

# **Fëmijët dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut**

Vështrim mbi jurisprudencën

## **Redakotorë**

Biljana Braithwaite, Menaxhere Programi për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE  
Catharina Harby, Konsulente Ligjore Senior, Qendra AIRE  
Goran Miletić, Drejtor për Evropën, Civil Rights Defenders

## **Kontribuesit kryesorë**

Ishaani Shrivastava, Avokate, Devereux Chambers, Londër  
Nuala Mole, Themeluese dhe Avokate Senior, Qendra AIRE

## **Falenderime të veçanta për**

Ledi Bianku, ish-gjyqtar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

I jemi gjithashtu mirënjohës Beatrice Blois, William Ferris, Ralitsa Peykova dhe Bianca Valperga për kontributin e tyre për këtë publikim.

© 2019 Qendra AIRE

Printuar  
250

Versioni origjinal i këtij botimi u përgatit në anglisht. Ai u përkthye në gjuhën boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedonase.

## **Dizajni nga**

Kliker Dizajn

## **Printuar**

ALFA-2 d.o.o.

## Hyrje

Forum i Gjashtë i Përvitshëm Rajonal i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore është pjesë e një serie eventesh, që kanë si qëllim promovimin e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, inkurajimin e bashkëpunimit rajonal dhe asistencën në procesin e integritimit evropian. Forumi do t'i dedikohet çështjes delikate të të drejtave të fëmijës, në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky Forum do të fokusohet në trajtimin që Gjykata e Strasburgut i ka bërë parimeve kryesore të: prevalimit të interesit më të lartë të fëmijës, duke përfshirë rëndësinë e dëgjimit të fëmijës dhe zbatimin e këtyre interesave në detyrimet e shtetit ndaj fëmijëve, në raste të ndryshme.

Një sistem i fuqishëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është një tipar thelbësor i çdo shteti, që pretendon të jetë demokratik. Pa të, një shoqëri nuk mund të konsiderohet se respekton shtetin e së drejtës. Fëmijët janë ndër anëtarët më vulnerabël të shoqërisë dhe si të tillë, kanë nevojë për mbrojtje dhe konsideratë të veçantë në ligj dhe praktikë.

2019 është 30 vjetori i miratimit të Konventës së OKB për të Drejtat e Fëmijëve (KDF). Neni 53 i KEDNJ sjell standardet e KDF-së në çdo vendim të marrë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjatë konsultimit me anëtarë të gjyqësorit në rajon dhe në Strasburg, janë evidentuar aspekte të KEDNJ-së që kanë një rëndësi të veçantë për fëmijët: njohje praktike dhe efektive e prevalimit të interesit më të lartë të fëmijës, së bashku me kërkesën që fëmija duhet të dëgjohet; sigurimi i mbrojtjes nga dëmtimi (së bashku me hetimin e duhur dhe masat korrigjuese, nëse kanë ndodhur); respektimi i jetës private dhe familjare të fëmijës; akses në gjykatë dhe zbatim i vendimeve gjyqësore; vendosja në strehim të sigurt dhe të drejtat e fëmijëve lidhur me sistemin e drejtësisë penale; zhvendosja dhe rrëmbimi; fëmijët azilkërkues dhe fëmijët që rrezikojnë ose janë viktimat e trafikimit; si edhe e drejta për arsimim.


Duke identifikuar jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane dhe duke ofruar një përmbledhje të jurisprudencës së përzgjedhur, shpresojmë që ky botim, së bashku me burimet e tjera që u ofrojmë pjesëmarrësve në Forum, do të ndihmojnë më tej në kuptimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës – si të drejtave substanciale, ashtu edhe atyre procedurale.

Ne shpresojmë që në përfundim të këtij eventi, të gjithë ata që kanë marrë pjesë në Forum dhe në diskutime, të ndihen më të aftë për të hulumtuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane me ndihmën e të gjitha materialeve të ofruara duke tejkalluar kështu sfidat me të cilat përballet aktualisht zbatimi i Konventës në rajon, në lidhje

me fëmijët. Ju urojmë të gjithëve një Forum të suksesshëm dhe mirëpresim të gjitha diskutimet tuaja!

**Biljana Braithwaite**

Qendra AIRE



**Goran Miletić**

Civil Rights Defenders



Dubrovnik, mars 2019

## Përmbajtja

(1) HYRJE.....	13
(2) PARIMET E PËRGJITHSHME .....	15
(a) Përkufizimi i fëmijës.....	14
(b) Interesi më i lartë i fëmijës .....	14
(c) Të dëgjosh fëmijën.....	17
(d) Shmangia e vonesave dhe marrja e masave për ekzekutimin e vendimeve .....	18
(e) Përgjegjësia e shtetit për mbrojtje.....	18
(3) FËMIJËT DHE FAMILJA.....	20
(a) Kujdestaria dhe familjet atipike .....	20
(b) Vizita, kujdestaria, rezidenca, birësimi, familjet kujdestare .....	24
(c) E drejta e prindërve për të njohur fatin e fëmijëve të tyre .....	29
(4) FËMIJËT DHE KUJDESI SOCIAL.....	30
(a) Marrja e fëmijëve nën kujdes .....	30
(b) Fëmijët në edukim të mbikëqyrur .....	31
(c) Ribashkimi i fëmijëve me familjet e tyre.....	32
(5) FËMIJËT DHE SISTEMI I DREJTËSISË PENALE .....	32
(6) FËMIJËT NË KUFIJ: MIGRACIONI, AZILI, TRAFIKIMI.....	35
(a) Fëmijët që kërkojnë azil (të shoqëruar, të ndarë, të pashoqëruar) .....	35
(b) Ndalimi i fëmijëve migrantë .....	37
(c) Eksludimi i fëmijëve migrantë .....	39
(d) Dëbimet e fëmijëve .....	39
(e) Rrëmbimi.....	43
(f) Zhvendosja.....	45
(g) Trafikimi dhe puna e fëmijëve.....	47
(h) Vlerësimi i moshës dhe procedurat e verifikimit.....	49
(7) E DREJTA PËR ARSIM .....	52
(8) KËRKUESIT QË JANË FËMIJË.....	53
(9) KONKLUZIONE .....	54

**Përmbledhje vendimesh..... 55**

*Autoritetet kroate nuk arritën të mbronin kërkuesen kundër dhunës në familje nga ish-bashkëshorti që kishte probleme të shëndetit mendor*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN A. k. KROACISË..... 55**

*Mosdhënia e kujdesit të përshtatshëm mjekësor ose mbikëqyrja arsimore e një të mituri në një qendër të përkohshme ndalimi, përbënte shkelje të nenit 3 dhe 5, ndërsa marrja në pyetje dhe proceset përbënin shkelje të nenit 6*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BLOKHIN k. RUSISË .....58**

*Dështimi i autoriteteve në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive për të mbrojtur jetën e nënës dhe fëmijës së varë nga ish-partneri përbënin shkelje të nenit 2*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BRANKO TOMAŠIĆ DHË TË TJERËT k. KROACISË .....63**

*Gjykata lejoi një OJF të paraqesë një çështje në emër të një të riu me aftësi të kufizuara mendore i cili udiq në një spital psikiatrik*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN QENDRA PËR BURIME LIGJORE NË EMËR TË VALENTIN CAMPEANU k. RUMANISË ..... 66**

*Mungesa e rishikimit gjyqësor dhe mbikëqyrja e thirrjeve telefonike të një të miture të ndaluar në një qendër edukimi përbënte shkelje të nenit 5 (4) dhe nenit 8 të Konventës*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN D.L. k. BULLGARISË.....70**

*Dështimi i Kroacisë për të mbrojtur një person vulnerabël nga ngacmimet e dhunshme dhe të vazhdueshme, përbënë shkelje të nenit 3 dhe 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ĐORĐEVIĆ k. KROACISË ..... 74**

*Dështimi i autoriteteve sllovene për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 për të lehtësuar të drejtën për takim të babait me vajzën e tij - megjithëse ai nuk mund të parashtronte përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kërkesën në emër të vajzës së tij për sa kohë që nëna kishte kujdestarinë e plotë*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN EBERHARD DHE M. k. SLLOVENISË..... 77**

*Koracia duhej të siguronte të drejtën e takimit midis babait të divorcuar dhe vajzës së tij në përputhje me programin e punës dhe në ambiente të përshtatshme*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GLUHAKOVIC k. KROACISË ..... 81**

*Nuk kishte shkelje të nenit 8 të Konventës në kuadër të rrethanave të veçanta të rastit, pasi autoritetet vendase morën të gjitha masat e arsyeshme për të ekzekutuar të drejtat prindërore të kërkuarit*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GRUJIĆ K. SERBIË .....84**

*Urdhri për kujdestari urgjente për fëmijën e sapo lindur përbënte shkelje të së drejtës së kërkuarve për respektimin e jetës familjare sipas nenit 8*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN K. DHE T. K. FINLANDËS ..... 88**

*Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore nuk garantoj të drejtën e takimeve të rregullta mes një nëne dhe djalit të saj duke shkelur të drejtën për respektimin e jetës familjare*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN K.B. DHE TË TJERËT K. KROACISË.....93**

*Dështimi i autoriteteve për të marrë hapat e nevojshme për të lehtësuar kontaktin mes babit dhe të birit, të dy me aftësi të kufizuar, përbënin shkelje të nenit 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KACPER NOWAKOWSKI K. PLONISË .....97**

*Dështimi për t'i garantuar kërkuarit, të cilit i ishte hequr zotësia për të vepruar, një bazë për njohjen e atësisë e tij ligjore mbi fëmijën e tij, përbënte mospërbushje të detyrimeve të shtetit sipas nenit 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KRUŠKOVIĆ K. KROACISË.....100**

*Mungesa e qartësisë në rregulloret lidhur me vizitat familjare në paraburgim dhe arbitrariteti në kufizimin e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet kërkuarit dhe të afërmeve të tij përbënte shkelje të nenit 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KURKOWSKI K. POLONISË ..... 104**

*Kohëzgjatja e tepërt e proceseve të kujdestarisë dhe dështimi i shtetit për të hetuar në mënyrë efektive mbi abuzimin e dyshuar ndaj fëmijëve përbënte shkelje të neneve 3 dhe 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE M. K. KROACISË..... 107**

*Dëbimi i një çifti afgan me dy fëmijë të mitur përbënte shkelje të së drejtës së tyre për të respektuar jetën familjare garantuar nga neni 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE TË TJERËT K. BULLGARISË ..... 111**

*Refuzimi për të njohur ligjërisht marrëdhëniet prind-fëmijë kur fëmijët lindën si pasojë e surrogacisë në një vend ku ky proces ishte i ligjshëm, përbënte shkelje të nenit 8 lidhur me të drejtën e fëmijëve për respektimin e jetës së tyre private*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MENNESSON K. FRANCËS ..... 115**

- Vonesa e tepruar në transferimin e dy fëmijëve nga ish-bashkëshorti tek kërkuesja, pasi asaj i ishte dhënë kujdestaria nga një gjykatë vendase përbënte shkelje të nenit 8*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MIJUŠKOVIĆ k. MALIT TË ZI .....119**
- Shteti zgjati periudhën e pasigurisë juridike të kërkuesve në lidhje me identitetin e tyre në shkelje të neneve 6 dhe 8*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MIKULIĆ k. KROACISË .....122**
- Dështimi i shtetit për të lehtësuar takimin midis një fëmije me babain e saj dhe gjyshërit nga i ati, si dhe mungesës së mjeteve efektive juridike përbënte shkelje të neneve 8 dhe 13*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MITOVI k. ISH REBUPLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË .....125**
- Dhënia e dënimit me burg ndaj një nëne për mospërbushje të urdhrit për të drejtën e takimit nuk përbënte shkelje të nenit 8*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MITROVA DHE SAVIK k. ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË ..... 129**
- Ndalimi i paligjshëm i të miturit azilkërkues, përbënte shkelje të nenit 3 dhe 5*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MUSKHAZHIVËVA DHE TË TJERËT k. BELGJIKËS .....133**
- Vendimet e gjykatave vendase për rikthimin e tre fëmijëve tek babi i tyre kundër vullnetit të tyre dhe pa bërë ulësimin e duhur mbi interesin e tyre më të lartë përbënte shkelje të nenit 8*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN N.TS. DHE TË TJERËT k. GJEOGJISË .....137**
- Urdhri i dhënë nga gjykatat zvicerane për kthimin në Izrael të një fëmije, i cili ishte rrëmbyer nga nëna e tij nuk ishte në interesin e tij më të lartë dhe për rrjedhojë cenonte nenin 8*  
**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN NEULINGER DHE SHURUK k. ZVICRËS.....141**
- Dështimi i autoriteteve polake për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive dhe për të ekzekutuar një urdhrë gjykatë pas një rrëmbimi ndërkombëtar të një fëmije, rezultoi në shkelje të nenit 8*  
**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN OLLER KAMINSKA k. POLONISË ..... 146**



*Segregimi i fëmijëve Rom në një shkollë fillore kroate përbënte diskriminim dhe shkelte nenin 14 marrë së bashku me nenin 2 të Protokollit nr. 1*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN ORSUS DHE TË TJERËT K. KROACISË ..... 149**

*Vdekja e një studenti në duart e mësuesit të tij derivoi krijimin e detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën sipas nenit 2 dhe e shkelit këtë nen*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN OSMAN K. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....152**

*Ndalimi administrativ i të miturve së bashku me familjen e tyre në një qendër ndalimi të papajisur për nevojat e fëmijëve në i veçanti përbënte shkelje të neneve, 3, 5 dhe 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN POPOV K. FRANCËS ..... 158**

*Kujdesi i pamjaftueshëm dhe ndalim i paligjshëm i një azilkërkuesi të mitur të pashoqëruar përbënte shkelje të neneve 3, 5 dhe 13*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RAHIMI K. GREQISË ..... 163**

*Dështimi i autoriteteve për të hetuar me shpejtësi dhe efektivitet vdekjen ose zhdukjen e një grup Romësh, varka e të cilëve u mbyt në bregdetin malazes përbënte shkelje të nenit 2 të Konventës*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RANDELOVIC DHE TË TJERËT K. MALIT TË ZI ..... 167**

*Vdekja e një personi i cili ishte trafikuar në Qipro, përfshinte përgjegjësinë e autoriteteve për të mbrojtur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, duke derivuar në shkelje të neneve 2, 4 dhe 5*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RANTSEV K. QIPROS DHE RUSISË..... 170**

*Vonesat dhe mungesa e përpjekjeve në proceset e brendshme në lidhje me një sulm fizik ndaj një fëmije i cili derivoi në pamundësinë për të shqyrtuar çështjen, përbënte shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit sipas nenit 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN REMETIN K. KROACISË .....173**

*Hetimi i autoriteteve kroate për sa i përket ankimit të kërkuësës se ajo ishte detyruar të prostituonte nuk ishte i përshtatshëm dhe shkelte aspektin e detyrimeve procedurale të shtetit sipas nenit 4*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN S.M. K. KROACISË ..... 177**

*Trajtimi i ndryshëm midis babait fëmija i të cilit kishte lindur gjatë martesës dhe një babai fëmija i të cilit kishte lindur jashtë martesë përbënte shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 8*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN SAHIN k. GJERMANISË.....181**

*Vendosja e fëmijëve të kërkuësës së parë në komunitetin "Il Forteto" dhe mungesa e kontaktit përbënin shkelje të nenit 8, ku kërkuësja që kishte mundësi të vepronte në emër të fëmijëve nuk kishte më përgjegjësi prindërore*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN**

**SCOZZARI DHE GIUNTA k. ITALISË ..... 184**

*Pretendimi i kërkuësit për shkelje të së drejtës garantuar nga neni 8 i Konventës në lidhje me refuzimin e autoriteteve për ta transferuar atë më pranë familjes u deklarua e papranueshme, ndërkohë kushtet në të cilat ai mbahej në paraburgim u gjetën në shkelje të nenit 3*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SERCE k. RUMANISË..... 189**

*Vendimi i gjykatës për të kthyer fëmijën tek i ati i cili jetonte në një tjetër shtet përbënte shkelje të nenit 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠNEERSONE DHE KAMPANELLA k. ITALISË ..... 192**

*Dështimi i autoriteteve vendase në marrjen e të gjitha masave të arsyeshme për të lehtësuar bashkimin mes kërkuësës dhe të birit pavarësisht vendimeve gjyqësore që ekzistonin në favor të saj sollën shkelje të nenit 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠOBOTA-GAJIĆ k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS ..... 196**

*Gjykimi dhe dënimi i dy kërkuësve të mitur, të dënuar për vrasje nga një gjykatë për të rritur, përbënte shkelje të nenit 5 dhe 6*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJET T. k. MBRETËRISË SË BASHKUAR dhe V. k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....200**

*Kthimi i një familje afgane azilkërkuësish në Itali sipas Rregullores së "Dublin" pa garanci individuale në lidhje me kujdesin ndaj tyre përbënte shkelje të nenit 3*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN TARAKHEL k. ZVICRËS..... 205**

*Kohëzgjatja e panevojshme e procesit gjyqësor familjar dhe mungesa e ekzekutimit të vendimit të së drejtës së takimit përbën shkelje të neneve 6 dhe 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN V.A.M. k. SERBISË..... 208**

*Heqja e të drejtës së aksesit të babait ndaj fëmijës për shkak të besimit fetar ishte diskriminuese dhe përbënte shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 8*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN VOJNITY K. HUNGARISË.....212**

*Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve – dështim i autoriteteve për të shqyrtuar ankimin e “rrezikut të lartë” ndaj një fëmije*

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN X K. LETONISË .....215**

*Dështimi i autoriteteve shtetërore për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga neglizhenca duke shkelur kështu nenin 3*

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Z. DHE TË TJERËT K. MBRETËRISË SË BASHKUAR .... 218**

*Foshnjat e humbura në spitale: Serbia duhet të japë shpjegime të besueshme në lidhje me fatin e secilit prej fëmijëve dhe të vendosë në vend të drejtat e shkelura të prindërve*

**ZORICA JOVANOVIĆ K. SERBISË.....222**



## (1) HYRJE

Fëmijët, për shkak të moshës dhe pamundësisë së tyre për të mbrojtur veten, janë veçanërisht anëtarë vulnerabël në çdo shoqëri.

Megjithëse, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) ka vetëm disa dispozita, që i referohen në mënyrë të drejtpërdrejt fëmijëve, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Gjykata”) që mbron fëmijët është e gjerë.

Përpara Gjykatës shumë çështje paraqiten nga prindërit. Rrjedhimisht, jurisprudenca e Gjykatës shpesh mund të përqendrohet në të drejtat e të rriturve në lidhje me fëmijët e tyre dhe jo mbi të drejtat e vetë fëmijëve. Kjo përmbledhje ka për qëllim të ndalet më tepër aspektin e dytë.

Në veçanti nenet e mëposhtme invokohen rregullisht në çështje që kanë të bëjnë me fëmijët, të cilat do të përfshihen në këtë përmbledhje. Të gjitha referencat për nenet dhe protokollet i referohen KEDNJ-së, nëse në tekst nuk parashikohet ndryshe.

- Neni 1: Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut
- Neni 2: E drejta për jetën
- Neni 3: Ndalimi i torturës
- Neni 4: Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar
- Neni 5: E drejta për liri dhe siguri, veçanërisht -
  - ◊ Neni 5 § 1 (d): Edukimi i mbikëqyrur dhe ndalimi i ligjshëm i fëmijës me qëllim paraqitjen përpara autoritetit kompetent ligjor
- Neni 6: E drejta për një proces të rregullt
- Neni 8: E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare
- Neni 13: E drejta për zgjidhje efektive
- Neni 53: Mbrojtja e të drejtave ekzistuese të njeriut
- Neni 2 i Protokollit Nr. 1: E drejta për arsim

Dy janë parashikime tepër thelbësore: neni 1 dhe neni 53.

Neni 1 parashikon se Palët e Larta Kontraktuese në KEDNJ duhet t'i sigurojnë çdo individ brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Seksionin 1 të KEDNJ-së. Një shtet është përgjegjës për të gjitha veprimet dhe mosveprimet e organeve të tij. Gjithashtu, shtetet kanë detyrime të qarta pozitive dhe negative ndaj fëmijëve.

Neni 53 parashikon:

“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose cenon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo Pale të Lartë Kontraktuese ose nga çdo marrëveshje tjetër në të cilën kjo Palë e Lartë Kontraktuese është palë.”

Si e tillë, KEDNJ duhet të interpretohet në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Në vëmendje duhet të mbahet “çdo rregullim relevant i së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme ndërmjet palëve” dhe veçanërisht rregullat që lidhen me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>1</sup>

## (2) PARIMET E PËRGJITHSHME

### (a) Përkufizimi i fëmijës

KEDNJ nuk përmban një përkufizim të “fëmijës”. Gjykata ka pranuar përkufizimin e përcaktuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve 1989 (“KDF”). KDF është instrumenti kryesor ndërkombëtar, që rregullon të drejtat e fëmijëve. Ajo është ratifikuar pothuajse në mënyrë universale nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Gjykata ka deklaruar se KDF ka fuqi detyruese sipas ligjit ndërkombëtar mbi Shtetet Kontraktuese të KEDNJ.<sup>2</sup>

Neni 1 i KDF përkufizon një fëmijë si:

“Çdo qenie njerëzore **nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare** përveç rasteve nëse, sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijët, pjekuria arrihet më herët».

*(theksi i shtuar)*

Fëmijët më të rritur, si ata që i përkasin moshës 16 ose 17 vjeçare, janë gjithsesi fëmijë dhe duhet të trajtohen si të tillë.

### (b) Interesi më i lartë i fëmijës

Gjykata gjithmonë do të marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet lidhur me ta. Rëndësia e këtij elementi rrjedh nga parimi i dytë i Deklaratës së të Drejtave të Fëmijëve, miratuar nga Kombet e Bashkuara më 1959.

---

1 *Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 6 korrikut 2010, nr. 41615/07, (përfshirë në këtë publikim).

2 *Çoselau k. Turqisë*, vendim i 9 tetorit 2012, nr. 1413/07, § 36.

Interesat më të larta të fëmijës konsiderohen të jenë:

- (a) “konsiderata prevalueuse” (Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve 1959, Parimi 2; KDF neni 21, në lidhje me birësimin);
- (b) “të një rëndësie të lartë” (Konventa e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës 1980);
- (c) “konsiderata primare” (për shembull, KDF neni 3 § 1, në lidhje me çështje të ndryshme nga birësimi; Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 i KDF (2013) mbi të drejtën e fëmijës për të marrë fillimisht në konsideratë interesin e tij më të lartë; Komenti i Përgjithshëm Nr. 5 i KDF (2003) Masat e përgjithshme në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës; Konventa e Hagës e 1996 mbi Përgjegjësinë Prindërore dhe masat për Mbrojtjen e Fëmijëve).

Domethënia praktike e këtyre dallimeve në formulim është diskutuar së tepërmi. Kur Gjykata shqyrton dispozitat e KEDNJ së bashku me ato të një traktati tjetër ndërkombëtar, ajo duhet të sigurojë, që nuk interpreton KEDNJ në mënyrë të tillë që të kufizojë ose të shmangë formulimin e gjendur në cilindo traktat tjetër ndërkombëtar të zbatueshëm në çështjen objekt gjykimi. Nëse formulimi është “konsideratë primare” që duhet të respektohet, kjo nuk do të thotë që KEDNJ-ja nuk mund të ngrejë nivelin e mbrojtjes së ofruar, duke trajtuar interesat në shqyrtim si të dorës së parë. Megjithatë, kur instrumenti tjetër parashikon shprehimisht termin “konsideratë prevalueuse”, ky do të jetë standardi që Gjykata duhet të zbatojë.

Komenti i Përgjithshëm Nr. 5 i KDF përcakton se neni 3 § 1 i KDF (i cili kërkon që interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsiderata primare në të gjitha veprimet lidhur me të) kërkon marrjen e masa aktive nga ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori. Çdo organ apo institucion legjislativ, administrativ dhe gjyqësor kërkohet që të zbatojë parimin e interesit më të lartë, duke marrë në konsideratë në mënyrë sistematike faktin se si interesat e fëmijëve janë ndikuar, ose do të ndikohen nga vendimet dhe veprimet e tyre - për shembull, një ligj, projektligj apo politikë, ose një veprim administrativ apo vendim gjyqësor, duke përfshirë ato që nuk lidhen drejtpërdrejt me fëmijët, por ndikojnë tek ta në mënyrë indirekte.

Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 i KDF përcakton se interesi më i lartë i fëmijës është një koncept i trefishtë:

- (a) **Një e drejtë thelbësore:** e drejta e fëmijës për t'i garantuar se interesi më i lartë i tij/saj do të vlerësohet dhe merret si një konsideratë primare në kohën kur do të vlerësohen interesa të ndryshme me qëllim marrjen e një vendim për çështjen në fjalë, si edhe garancinë se kjo e drejtë të zbatohet sa herë që

duhet të merret një vendim në lidhje me një fëmijë, një grup fëmijësh të identifikuar ose të paidentifikuar, ose në përgjithësi. Neni 3 § 1 i KDF krijon një detyrim në nivel të brendshëm për shtetet, është drejtpërdrejt i zbatueshëm (i vetë-zbatueshëm) dhe mund të invokohet përpara një gjykate.

- (b) **Një parim ligjor thelbësor dhe imperativ:** Nëse një dispozitë ligjore është e hapur dhe pranon më shumë se një interpretim, duhet të zgjidhet interpretimi që në mënyrë më efektive i shërben interesit më të lartë të fëmijës. Të drejtat e mishëruara në KDF dhe Protokollet e saj Fakultative sigurojnë kuadrin e nevojshëm për interpretim.
- (c) **Një rregull procedural:** sa herë duhet të merret një vendim, i cili do të ndikojë mbi një fëmijë të caktuar, një grup të identifikuar fëmijësh, ose fëmijët në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv ose negativ) të vendimit për fëmijën ose fëmijët në fjalë. Vlerësimi dhe përcaktimi i interesave më të larta të fëmijës kërkon garanci procedurale. Arsyetimi i një vendimi duhet të tregojë se kjo e drejtë është vlerësuar në mënyrë eksplicite. Shtetet Palë do të shpjegojnë se si është respektuar kjo e drejtë në vendimmarrje: cili është konsideruar si interesi më i lartë i fëmijës; në cilin kriter është bazuar ky vlerësim; dhe se si janë balancuar interesat e fëmijës kundrejt interesave të tjera, qofshin këto çështje të politikave të përgjithshme apo rasteve individuale.

Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 § 39 e bën të qartë se duke qenë se interesi i fëmijës përbën “konsideratën primare”, ky interes ka një prioritet shumë më të lartë dhe nuk është thjesht një ndër interesat që duhet të shqyrtohen. Një peshë më e madhe i duhet dhënë asaj që i shërben interesit më të lartë të fëmijës nëse këto interesa nuk janë “prevaluese”.

Gjykata ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm në lidhje me kuptimin e “interesit më të lartë” të fëmijës:

- (a) Interesi më i lartë i fëmijës duhet të vlerësohet në çdo çështje individuale.<sup>3</sup>
- (b) Interesat më të larta të fëmijës nuk përputhen as me ato të babait ose nënës, përveç faktit se ato mund të kenë të përbashkët disa kriterë vlerësimi që lidhen me personalitetin, mjedisin dhe situatën specifike të fëmijës.<sup>4</sup>
- (c) Lidhjet e fëmijës me anëtarët e familjes së tij/saj duhet të mbahen parasysh, përveç nëse familja ka dëshmuar se është veçanërisht e papërshtatshme, pasi

---

3 *Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 6 korrikut 2010, nr. 41615/07, §§ 138, 146, (përfshirë në këtë publikim).

4 *X k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 26 nëntorit 2013, nr. 27853/09, §§ 100, (përfshirë në këtë publikim).



ndërprerja e këtyre lidhjeve do të thotë shkëputja e fëmijës nga rrënjët e tij/saj. Lidhjet familjare mund të ndërpriten vetëm në rrethana shumë të jashtëzakonshme dhe gjithçka duhet bërë për të ruajtur marrëdhëniet personale, si edhe kur është e përshtatshme, për të rindërtuar familjen.<sup>5</sup>

- (d) Gjykata ka vlerësuar, si një konsideratë primare, se “rëndësia thelbësore” dhe “rëndësia e veçantë” duhet t’i bashkëngjiten interesave më të larta të fëmijës, të cilat, në varësi të natyrës dhe seriozitetit të tyre, mund të anashkalojnë ato të prindërve.<sup>6</sup>
- (e) Sipas nenit 8, një prind nuk mund të ketë kurrë të drejtë të marrë masa, të cilat do të dëmtonin shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.<sup>7</sup>
- (f) Autoritetet vendase kanë kryesisht për detyrë të vlerësojnë interesat më të larta të fëmijës. Këto autoritete kanë mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë me personat në fjalë. Ato gëzojnë një hapësirë vlerësimi, e cila mbetet subjekt i mbikëqyrjes evropiane kur Gjykata shqyrton, sipas KEDNJ, vendimet që këto autoritete kanë marrë.<sup>8</sup>
- (g) Mund të jetë e nevojshme bërja e një ekspertize psikologjike me qëllim vlerësimin e thënieve të bëra nga një fëmijë.<sup>9</sup>

## (c) Të dëgjosh fëmijën

Fëmijët kanë të drejtën për t’u dëgjuar nga organet gjyqësore dhe administrative:

Në çdo proces gjyqësor ose administrativ, që prek të drejtat e fëmijëve sipas nenit 8, fëmijët e aftë për të pasur pikëpamjet e tyre duhet të përfshihen mjaftueshëm në procesin vendimmarrës dhe t’u jepet mundësia për t’u dëgjuar dhe për të shprehur lirisht pikëpamjet e tyre në lidhje me të gjitha çështjet që i prekin (neni 12 i KDF dhe Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 i KDF, § 32; shih gjithashtu Komentin e Përgjithshëm Nr. 14, §§ 53 - 54; Guida e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore për Fëmijët).<sup>10</sup>

---

5 *Gnahoré k. Francës*, vendim i 19 shtatorit 2000, nr. 40031/98, § 59.

6 *Sahin k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, nr. 30943/96, § 64 dhe 66, (përfshirë në këtë publikim).

7 *Sahin k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, nr. 30943/96, § 66 (përfshirë në këtë publikim); *Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, nr. 31871/96, § 64; *Elsholz k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 korrikut 2000, nr. 25735/94, § 50).

8 *Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 6 korrikut 2010, nr. 41615/07, §§ 137 -138. (përfshirë në këtë publikim).

9 *Elsholz k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 korrikut 2000, nr. 25735/94, § 52.

10 *N. TS. dhe Të Tjerët k. Gjeorgjisë*, vendim i 2 shkurtit 2016, nr. 71776/12, § 78, (përfshirë në këtë publikim); *M. dhe M.*

Pikëpamjet e fëmijëve nuk kanë domosdoshmërisht imunitet.<sup>11</sup> Një fëmijë mund të mos jetë mjaftueshmërisht i pjekur, ose mund të ketë probleme besimi me prindërit, aq sa opinioni i tij/saj mund të mos jetë mjaftueshmërisht i pavarur.<sup>12</sup> Për më tepër, e drejta e fëmijës për të shprehur pikëpamjet e tij/saj nuk duhet të interpretohet si një mundësi që u jep atyre një fuqi të pakushtëzuar vetoje, madje edhe kur ata janë 12 vjeç ose më shumë, pa konsideruar ndonjë faktor tjetër dhe pa kryer një vlerësim për të përcaktuar interesin e tyre më të lartë.<sup>13</sup>

#### **(d) Shmangia e vonesave dhe marrja e masave për ekzekutimin e vendimeve**

Koha merr një rëndësi të veçantë në rastet, që kanë të bëjnë me fëmijët pasi ekziston gjithmonë rreziku, që çdo vonesë procedurale të rezultojë në një përcaktimin *de facto* të çështjes përpara gjykatave.<sup>14</sup> Situatat në të cilat vonesa shkaktohet nga rezistenca e një prindi, ose vërtet nga vetë fëmija janë trajtuar në vazhdim.

#### **(e) Përgjegjësia e shtetit për mbrojtje**

KEDNJ u vendos shteteve detyrime pozitive në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të neneve 2, 3 dhe 8, marrë së bashku me nenin 1.

- (a) Në rrethana në të cilat autoritetet kanë pasur ose duhet të kishin pasur dijeni për ekzistencën e një rreziku të vërtetë dhe të menjëhershëm për jetën e një ose disa individëve të dëmtuar nga veprat penale kryer nga një palë e tretë, por nuk kanë pasur mundësi të marrin masa brenda kompetencave të tyre, që duke gjykuar në mënyrë të arsyeshme mund të kishin shmangur rrezikun në fjalë, do të evidentohet një shkelje e nenit 2.<sup>15</sup>
- (b) Në mënyrë të ngjashme, kur Shteti dështon në marrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar një keqtrajtim, për të cilin autoritetet kishin ose duhet të kishin dijeni do të evidentohet shkelje e nenit 3.<sup>16</sup>

---

*k. Kroacisë*, vendim i 3 shtatorit 2015, nr. 10161/13, §§ 180-181, (përfshirë në këtë publikim).

11 *Raw dhe Të Tjerët k. Francës*, vendim i 7 marsit 2013, nr. 10131/11, § 94.

12 *Gajtani k. Zvicrës*, vendim i 9 shtatorit 2014, nr. 43730/07, §§ 107 dhe 111.

13 *C. k. Finlandës*, vendim i 9 majit 2006, nr. 18249/02, § 58.

14 *Plaza k. Polonisë*, vendim i 25 janarit 2011, nr. 18830/07, § 74; *K.A.M. k. Serbisë*, vendim i 13 marsit 2007, nr. 39177/05, (përfshirë në këtë publikim).

15 *Branko Tomašić k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009, nr. 46598/06, § 51, (përfshirë në këtë publikim); *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, nr. 23452/94, § 116, (përfshirë në këtë publikim).

16 *Z. dhe Të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, nr. 29392/95, § 73, (përfshirë

- (c) Detyrimet pozitive, në disa raste sipas neneve 2 ose 3, ose në raste të tjera sipas nenit 8, të marra më vete ose së bashku me nenin 1, mund të përfshijnë detyrimin për të miratuar dhe zbatuar një kuadër ligjor të përshtatshëm, që siguron mbrojtje nga veprimet e dhunës së individëve privatë.<sup>17</sup>
- (d) Detyrimet pozitive sipas neneve 2 dhe 3 kërkojnë që shteti të krijojë një sistem gjyqësor efikas dhe të pavarur, përmes të cilit mund të zbulohet shkak i vdekjes ose i lëndimit të ndodhur dhe të ndëshkohen fajtorët. Ekziston një kërkesë e shpejtësisë dhe efikasitetit të arsyeshëm.<sup>18</sup>
- (e) Neni 8 përfshin detyrimin pozitiv për të miratuar masa të përshtatshme për të siguruar respektimin e jetës private edhe në sferën e marrëdhënieve ndërmjet vetë privatëve.<sup>19</sup>
- (f) Zgjedhja e mjeteve të llogaritura për të siguruar respektimin e nenit 8 në sferën e marrëdhënieve private bie brenda kufijve të hapësirës së vlerësimit të një shteti. Në rastet kur një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i ekzistencës ose identitetit të një individi është në rrezik, ose kur aktivitetet në fjalë përfshijnë një aspekt më intim të jetës private, hapësira e vlerësimit për shtetin ngushtohet.<sup>20</sup>
- (g) Kuadri ligjor i kërkuar sipas nenit 8, mund të konsistojë edhe në mjete ligjore civile.<sup>21</sup>
- (h) Kur në shqyrtim janë vepra serioze si përdhunimi apo ngacmimi seksual ndaj fëmijëve, shtetet duhet të sigurojnë që parashikimet e dhura ligjore janë në fuqi në kuadër të legjislacionit penal.<sup>22</sup>
- (i) Fëmijët duhet të mbrohen jo vetëm në situata që përfshijnë dhunën fizike. Në çështjen *K.U. k. Finlandës*, një fëmijë 12-vjeçar kishte qenë subjekt i një reklame të një natyre seksuale në një faqe njohjesh virtuale në internet. Reklama përmendi vitin e tij të lindjes, karakteristikat fizike, përfshihu një lidhje me një faqe interneti që kishte imazhin dhe numrin e tij të telefonit, i cili ishte i saktë përveç një shifre. U pretendua se fëmija ishte në kërkim të një marrëdhënieje intime. Gjykata vlerësoi se kishte një kërcënim të mundshëm për cenimin e mirëqenies fizike dhe mendore të fëmijës. Ai ishte bërë objekt për pedofilët. Mbrojtja praktike dhe efektive e fëmijës kërkonte disponueshmërinë

---

në këtë publikim).

17 *Talpis k. Italisë*, vendim i 2 marsit 2017, nr. 41237/14, § 100.

18 *Talpis k. Italisë*, vendim i 2 marsit 2017, nr. 41237/14, § 99; *Söderman k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08, § 83.

19 *Söderman k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08, § 78.

20 *Söderman k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08, § 79.

21 *Söderman k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08, § 85.

22 *M.C. k. Bullgarisë*, vendim i 04 dhjetorit 2003, nr. 39272/08.

e një mjeti korrektues, që mundësonte identifikimin e shkelësit dhe sjelljen e tij përpara drejtësisë.<sup>23</sup>

- (j) Gjithashtu, fëmijët duhet të mbrohen nga dhuna e ushtruar nga fëmijë të tjerë. Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i KDF-së (2011) trajton të drejtën e fëmijës për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës duke përfshirë dhunën psikologjike (§ 21) dhe dhunën mes vetë fëmijëve (§ 27). Dhuna e kryer nga fëmijët mund të angazhojë detyrimin pozitiv për të mbrojtur viktimën. Në *Dordević k. Kroacisë*,<sup>24</sup>, ku kërkuesi ishte një i rritur vulnerabël, i cili kishte qenë subjekt i dhunës ushtruar nga fëmijët, është konstatuar shkelje e nenit 3. Ky standard mund të zbatohet *mutatis mutandis* për situatat kur një fëmijë është viktimë e dhunës nga fëmijë të tjerë.

### (3) FËMIJËT DHE FAMILJA

#### (a) Kujdestaria dhe familjet atipike

Neni 8 garanton respektin për jetën familjare. Gëzimi i ndërsjellë nga prindërit dhe fëmijët i shoqërisë së njëri-tjetrit përbën një element thelbësor të jetës familjare. Në çështjet e kujdestarisë zbatohet një hapësirë e gjerë vlerësimi.

Dhoma e Madhe ka dhënë udhëzime mbi llojet e marrëdhënieve që përfshihen brenda konceptit të jetës “private” dhe “familjare”, në çështjen *Paradiso dhe Campanelli k. Italisë*<sup>25</sup>, ne cila lidhet me një fëmijë, të sjellë nga kërkuesit nga Rusia në Itali. Kërkuesit nuk kishin lidhje biologjike me fëmijën. Fëmija kishte lindur përmes vezëve dhe spermës së dhuruar, nga një nënë surrogato, nëpërmjet teknikave të riprodhimit që ishin të jashtëligjshme në Itali. Fëmija i ishte marrë kërkuesve dhe ishte vendosur nën kujdesin e shërbimeve sociale, me qëllim birësimin. Në përfundim, nuk kishte pasur shkelje të nenit 8.

Shqyrtimi i jurisprudencës dhe i parimeve përkatëse është tepër i dobishëm. Dhoma e Madhe në çështjen *Paradiso dhe Campanelli k. Italisë*, dha këto përfundime në lidhje me marrëdhëniet që përbëjnë “jetë familjare”, duke gjetur si përfundim se nuk ekzistonte një e tillë:

---

23 *K.U. k. Finlandës*, vendim i 2 dhjetorit 2008, nr. 2872/02, §§ 41 to 49; *Söderman k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08, § 84. Shih gjithashtu Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, “Konventa e Stambollit”, neni 2 § 2, 3 § f, 13, dhe 56.

24 *Dordević k. Kroacisë*, vendim i 24 korrikut 2012, nr. 41526/10, §§ 146 to 148, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

25 *Paradiso dhe Campanelli k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, nr. 25358/12.

- (a) Ekzistenca ose mos ekzistenca e “jetës familjare” është një çështje faktike, që lidhet me ekzistencën e lidhjeve të ngushta personale.
- (b) Nocioni i “familjes” në nenin 8 lidhet me marrëdhënie martesore dhe lidhje të tjera familjare *de facto*, ku personat jetojnë së bashku jashtë martese, ose ku ka faktorë të tjerë që tregojnë se një marrëdhënie është e qëndrueshme.
- (c) Neni 8 nuk garanton të drejtën për të gjetur një familje ose të drejtën për të birësuar. Ky nen presupozon ekzistencën e familjes, ose të paktën, marrëdhënien e mundshme midis, për shembull, një fëmije të lindur jashtë martese me babanë e tij/saj biologjik, ose marrëdhënien që lind nga një martesë e mirëfilltë, edhe nëse jeta familjare nuk është vendosur ende plotësisht; ose marrëdhënien midis një babai dhe fëmijës së tij të ligjshëm, edhe nëse provohet, vite më vonë, se nuk ka pasur lidhje biologjike; ose marrëdhënien që lind nga një birësim i ligjshëm.
- (d) Mund të ketë *de facto* jetë familjare midis të rriturve dhe fëmijëve, në mungesë të lidhjeve biologjike ose ligjore, me kusht që të ketë lidhje të vërteta personale.
- (e) Mund të ketë jetë familjare midis fëmijës dhe prindërve kujdestarë që janë kujdesur për të përkohësisht, për shkak të lidhjeve të ngushta personale, rolit të luajtur nga të rriturit dhe kohës së kaluar së bashku (shih p.sh. *Moretti dhe Benedetti k. Italisë*<sup>26</sup>, në të cilën një foshnjë 1 muajshe kishte ardhur në familje dhe për 19 muaj kërkuesit i ishin gjendur pranë në fazat më të rëndësishme të jetës së fëmijës. Fëmija ishte integruar në familje dhe ishte shumë i lidhur me kërkuesit. Kërkuesit ishin kujdesur për zhvillimin social të fëmijës. Shih gjithashtu *Kopf dhe Liberda k. Austrisë*<sup>27</sup>, çështje në të cilën një familje kujdestare ishte kujdesur për 46 muaj për një fëmijë, që ishte dërguar në shtëpinë e tyre në moshën 2 vjeçare. Kërkuesit ishin të shqetësuar për mirëqenien e fëmijës dhe lidhjen emocionale që kishin krijuar mes tyre).
- (f) Në shqyrtimin e faktit nëse ekziston “jetë familjare”, është e nevojshme të konsiderohet cilësia e lidhjeve, roli i luajtur nga kërkuesit vis-à-vis fëmijës dhe kohëzgjatja e bashkëjetesës mes tyre dhe fëmijës.

Dhoma e Madhe, në çështjen *Paradiso dhe Campanelli k. Italisë*<sup>28</sup>, gjithashtu ka konsideruar se cila marrëdhënie përfshihet në konceptin e “jetës private”, duke konstatuar se faktet e kësaj çështje bënë pjesë në jetën private të kërkuesve:

- (a) “Jeta private” është një koncept i gjerë, i cili nuk i jep vetes një përkufizim të plotë. Ai mbulon integritetin fizik dhe psikologjik të një personi dhe, deri në

---

<sup>26</sup> *Moretti dhe Benedetti k. Italisë*, vendim i 27 prillit 2010, nr. 16318/07, § 48.

<sup>27</sup> *Kopf dhe Liberda k. Austrisë*, vendim i 17 janarit 2012, nr. 1598/06, § 37.

<sup>28</sup> *Paradiso dhe Campanelli k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, nr. 25358/12.

një pikë, të drejtën për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me persona të tjerë. Ndonjëherë ky koncept merr edhe aspekte të identitetit fizik dhe social të një individi. Ai përfshin edhe të drejtën për “zhvillim personal” ose të drejtën për vetëvendosje.

- (b) Nuk ka arsye të vlefshme për të kuptuar konceptin e “jetës private” duke përfshirë lidhjet emocionale të krijuara dhe zhvilluara mes një të rrituri dhe një fëmijë, në situata të ndryshme nga lidhjet e zakonshme të farefisnisë. Kjo lloj lidhje gjithashtu ka të bëjë me jetën dhe identitetin social të individëve. Në disa raste të caktuara, që përfshijnë një marrëdhënie midis të rriturve dhe një fëmije kur nuk ka lidhje biologjike ose ligjore, faktet mund të përfshihen në fushën e “jetës private”.

Gjykata gjithashtu u shpreh se, kur merret në konsideratë koncepti i familjes, prindërve dhe fëmijëve:

- (a) Neni 8 zbatohet për një familje “të ligjshme” në të njëjtën mënyrë si për një “familje të jashtëligjshme”. Çdo dallim mes dy koncepteve nuk do të ishte në përputhje me fjalën “çdokush” në nenin 8. Kjo konfirmohet nga neni 14 dhe ndalimi i diskriminimit bazuar në “lindjen”, (shembujt përfshijnë: *Sahin k. Gjermanisë*,<sup>29</sup> që kishte të bënte me një baba të pamartuar; *Marckx k. Belgjikës*,<sup>30</sup> që kishte të bënte me një nënë beqare me fëmijë).
- (b) Kontaktet sporadike dhe lidhjet biologjike të dyshuara, por edhe lidhjet biologjike të vërtetuara, nuk japin një të drejtë absolute për të pasur të drejta prindërore. Në këto raste prevalon interesi më i lartë i fëmijës<sup>31</sup>.
- (c) Birësimet e ligjshme prodhojnë jetë familjare edhe kur prindërit adoptues kanë pasur kontakt minimal me fëmijën<sup>32</sup>.
- (d) Marrëdhëniet midis prindërve birësues dhe një fëmije të birësuar gëzojnë mbrojtje të njëjtë për familjet ku nuk ka ndodhur birësimi<sup>33</sup>.
- (e) Birësimi “Kafala”, një praktikë islamike e ngjashme me adoptimin por që nuk kërkon domosdoshmërisht shkëputjen e lidhjeve me familjen e origjinës, është marrë në konsideratë nga Gjykata. Gjykata u shpreh se, refuzimi nga gjykatat franceze për të lejuar birësimin nga kërkuesi të një fëmije algjerian, që kishte qenë nën kujdestarinë e saj sipas Kafala-s, nuk përbënte shkelje të nenit 8. Ky

---

29 *Sahin k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 08 korrikut 2003, nr. 30943/96, (included as a summary in this publication).

30 *Marckx k. Belgjikës*, vendim i 13 qershorit 1979, no. 6833/74.

31 *Yousef k. Holandës*, vendim i 5 nëntorit 2002, nr. 33711/96.

32 *Pini dhe Tërjet k. Rumanisë*, vendim i 22 qershorit 2004, nr. 78028/01 78030/01.

33 *Kurochkin k. Ukrainës*, vendim i 20 majit 2010, nr. 42276/08.

vendim kishte marrë parasysh faktin se ligji në vendin e origjinës nuk e lejonte adoptimin dhe faktin se Kafala njihej në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhënie e statusit dhe mbrojtjes së njëjtë. Të drejtat e fëmijës për integrim dhe jetë familjare nuk ishin paragjykuar nga mungesa e birësimit<sup>34</sup>.

- (f) Në lidhje me surrogacinë, një refuzim i gjykatave franceze për të urdhëruar njohjen e marrëdhënies prind-fëmijë, ku marrëveshjet për surrogacinë ishin të jashtëligjshme dhe çifti kërkues kishte kryer surrogacinë në SHBA, u konsiderua si një ruajtje e balancave në lidhje me të drejtat për jetë familjare të çiftit. Nga ana tjetër, sa i takon vetë fëmijës, Gjykata u shpreh ndryshe. Aspekte kyçe të identitetit të fëmijës ishin të lidhura me refuzimin e autoriteteve franceze për të njohur lidhjen e fëmijës me babanë biologjik, ose për t'i atribuar fëmijës shtetësinë ose të drejtat e trashëgimisë<sup>35</sup>.
- (g) Në 16 tetor 2018, Gjykata mori kërkesën e saj të parë për një mendim këshillues, që nga hyrja në fuqi e Protokollit nr. 16 më 1 gusht 2018. Pyetja e Gjykatës franceze të Kasacionit ishte në lidhje me surrogacinë dhe faktin nëse Francës i lejohej të refuzonte regjistrimin në regjistrat civilë të lindjes, në lidhje me lindjen e një fëmije nga një nënë surrogato jashtë vendit, në rrethana të caktuara. Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga Dhoma e Madhe<sup>36</sup>.

E drejta e regjistrimit të lindjes së një fëmije mbrohet nga neni 7 i KDF. Regjistrimi i lindjes përmban informacionin thelbësor që kërkohet për të përcaktuar shtetësinë e një fëmije, vendin, datën e lindjes dhe identitetin e prindërve. Dështimi për të regjistruar lindjen rrit rrezikun e pa shtetësisë. Fëmijët romë, në veçanti, janë prekur negativisht nga kjo çështje<sup>37</sup>. Refuzimi i regjistrimit të lindjes së fëmijëve do të ngrejë çështje në kuadër të nenit 8.

---

34 *Harroudj k. Francës*, vendim i 4 tetorit 2012, nr. 43631/09.

35 *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11; shih edhe *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, §§ 78 - 79, (përfshirë në këtë publikim).

36 <https://hudoc.echr.coe.int/fre-press#%7B%22itemid%22:%5B%22003-6269064-8165703%22%5D%7D>

37 Roma Belong – Statelessness, Discrimination and Marginalisation of Roma in the Western Balkans and Ukraine, raport i the European Roma Rights Centre in 2017, f. 34.

## **(b) Vizita, kujdestaria, rezidenca, birësimi, familjet kujdestare<sup>38</sup>**

### **Vizita, kujdestaria, rezidenca**

Gëzimi i ndërsjellë nga prindërit dhe fëmijët i shoqërisë së njëri-tjetrit, përbën një element thelbësor të jetës familjare edhe kur marrëdhënia midis prindërve është prishur<sup>39</sup>.

Hapat që rregullojnë kontaktin midis prindërve dhe fëmijëve, heqja e kujdestarisë dhe vendimet për rezidencë, përbëjnë të gjitha *prima facie* një ndërhyrje në jetën familjare dhe kërkojnë justifikim sipas nenit 8<sup>40</sup>.

Neni 8 përfshin të drejtën e prindërve dhe fëmijëve që të ribashkohen dhe detyrimin e autoriteteve kombëtare për të lehtësuar këto ribashkime. Kjo vlen jo vetëm për rastet që kanë të bëjnë me marrjen e detyrueshme të fëmijëve në kujdes publik, por edhe me rastet kur mes prindërve ose pjesëtarëve të tjerë të familjes lindin mosmarrëveshje lidhur me kontaktin dhe rezidencën e fëmijëve. Shteti mund të jetë i detyruar të marrë masa për të siguruar këtë të drejtë, duke përfshirë si parashikimin e një kuadri rregullator të makinerisë gjyqësore dhe të ekzekutimit, ashtu edhe zbatimin e masave specifike<sup>41</sup>.

Detyrimi i autoriteteve vendase për të lehtësuar kontaktin me, ose ribashkimin me, një prind që nuk ka kujdestarinë, e fëmijëve pas divorcit, nuk është absolut. Ky detyrim do të varet nga shumë faktorë, përfshirë dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Kur masa në fjalë ka të bëjë me një mosmarrëveshje mes prindërve për fëmijën e tyre, nuk i takon Gjykatës të zëvendësojë autoritetet vendase që rregullojnë pyetjet në lidhje me të drejtën e takimit. Përkundrazi, Gjykata do të rishikojë sipas KEDNJ vendimet që kanë marrë këto autoritete në ushtrimin e hapësirës së tyre të vlerësimit<sup>42</sup>.

---

38 Vërehet se termi «rezidencë» përdoret gjithnjë e më shumë sesa «kujdestari». Pjesa më e madhe e jurisprudencës relevante përdor termin kujdestari dhe si i tillë, ky term do të përdoret edhe këtu.

39 *K. dhe T. k. Finlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 korrikut 2001, nr. 25702/94; *R.I. dhe Të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 53.

40 *K.T. k. Norvegjisë*, vendim i 25 shtatorit 2008, nr. 26664/03.

41 *Ignacolo-Zenide k. Rumanisë*, vendim i 25 janarit 2000, nr. 31679/96 § 94; *M. dhe M. k. Kroacisë*, vendim i 03 shtatorit 2015, nr. 10161/13, § 177, (përfshirë në këtë publikim); *R.I. dhe Të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 54.

42 *R.I. dhe Të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 55.



Hapësira e vlerësimit që i jepet autoriteteve kompetente vendase do të variojë në lidhje me natyrën e çështjeve dhe rëndësinë e interesave për të cilat bëhet fjalë. Gjykata ka njohur faktin se autoritetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi, veçanërisht kur vendosin mbi kujdestarinë.<sup>43</sup>

Një shqyrtim më i rreptë kërkohet kur bëhet fjalë për kufizime të mëtejshme, siç janë kufizimet që vendosen nga autoritetet mbi të drejtat prindërore të aksesit dhe lidhur me çdo mbrojtje ligjore që siguron një mbrojtje efektive të të drejtës së prindërve dhe fëmijëve, për të respektuar jetën e tyre familjare. Kufizime të tilla të mëtejshme përmbajnë rrezikun se marrëdhëniet familjare midis një fëmije të vogël dhe një ose të dy prindërve të tij, mund të cungohen së tepërmi<sup>44</sup>.

Drejtësia procedurale është çelësi. Neni 6, e drejta për një proces të rregullt do të zbatohet në rastet kur ngrihen pyetje që kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave civile. Neni 8 nuk përmban kërkesa procedurale. Megjithatë, vihet theksi në drejtësinë dhe respektimin e interesave që duhen mbrojtur.<sup>45</sup> Faktorët relevantë do të përfshijnë<sup>46</sup>:

- (a) Mundësinë për të parashtruar kërkesa personalisht, ose në formë të shkruar, përpara marrjes së vendimeve;
- (b) Aksesin në raporte dhe dokumente në të cilat mbështetet vendimmarrja;
- (c) Sigurimin e përfaqësimit ligjor;
- (d) Raportet e ekspertëve, duke përfshirë raporte psikiatrike të pavarura.

Ankesat për mosekzekutimin e vendimeve të tilla do të bien gjithashtu brenda fushës së nenit 8.<sup>47</sup> Procedimi i vonuar dhe joefektiv i procedurave të kujdestarisë mund të përbëjë shkelje.<sup>48</sup>

Mjaftueshmëria e një mase duhet të vlerësohet nga shpejtësia e zbatimit të saj. Harku kohor mund të ketë pasoja të pakthyeshme për marrëdhëniet midis një fëmije dhe një prindi që nuk bashkëjeton me të. Kohëzgjatja e proceseve lidhur me fëmijët është

---

<sup>43</sup> *Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, nr. 31871/96, § 63.

<sup>44</sup> *Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 Korrikut 2003, nr. 31871/96, § 63.

<sup>45</sup> *McMichael k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 shkurtit 1995, nr. 16424/90, § 87.

<sup>46</sup> *P., C. dhe S. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 16 korrikut 2002, nr. 56547/00; *Elsholz k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 Korrikut 2000, nr. 25735/94; *A.K. dhe L. k. Kroacisë*, vendim i 8 janarit 2013, nr. 37956/11.

<sup>47</sup> *Grujic k. Serbia*, vendim i 28 gushtit 2018, nr. 203/07, (përfshirë në këtë publikim).

<sup>48</sup> *Eberhard dhe M. k. Sllovenisë*, vendim i 01 dhjetorit 2009, nr. 8673/05 9733/05, § 127, (përfshirë në këtë publikim); *R.I. dhe Të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 56.

shumë e rëndësishme, sepse ekziston gjithmonë rreziku se një vonesë procedurale mund të çojë në përcaktimin de facto të çështjeve.<sup>49</sup>

Vendimtar është fakti nëse autoritetet vendase kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar kontaktin, siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme në rrethanat specifike të çdo rasti.<sup>50</sup>

Kur fëmijët refuzojnë takimin me një prind, neni 8 përcakton se shtetet kanë detyrimin të identifikojnë shkakun e një refuzimi të tillë dhe ta adresojnë atë, sipas rastit. Është detyrim sa i takon mjeteve e jo rezultatit dhe mund të kërkojë masa përgatitore ose të përshtatura në kohë. Autoritetet duhet të marrin masa për rregullimin e konfliktit të interesit, duke pasur parasysh gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës. Vetëm pasi masa të tilla të jenë marrë, autoritetet vendase mund të konsiderohen se kanë përbushur detyrimet e tyre pozitive, sipas nenit 8.<sup>51</sup>

Në çështjen *K.B dhe të Tjerët k. Kroacisë*<sup>52</sup>, Gjykata adresoi situatën në të cilën kërkuesi nuk kishte mundësi të shihte rregullisht fëmijët e tij, si pasojë e refuzimit të fëmijëve. Gjykata theksoi se:

- (a) Teksa pikëpamjet e fëmijëve duhet të merren parasysh, ato nuk janë detyruesisht të pandryshueshme dhe kundërshtimet e tyre, të cilave duhet t'u jepet pesha e duhur, nuk janë detyruesisht të mjaftueshme për të anashkuar interesat e prindërve, veçanërisht në pasjen e një kontakti të rregullt me fëmijën e tyre.
- (b) E drejta e fëmijës për të shprehur pikëpamjet e veta nuk duhet të interpretohet si dhënie efektive e një vetoje, pa konsideruar faktorë të tjerë dhe pa kryer një ekzaminim që do të përcaktojë interesin më të lartë të fëmijës.
- (c) Interesat më të lartë të fëmijës normalisht diktojnë faktin se, lidhjet e fëmijës me familjen duhen ruajtur, përveç rasteve kur kjo do të dëmtojte shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.<sup>53</sup>
- (d) Fëmijët mund të jenë në gjendje të formojnë dhe artikulojnë opinione lidhur me dëshirat e tyre. Kjo mund të ndodhë, për shembull, për shkak të një konflikti

---

49 *Mitrova dhe Savik k. 'ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë'*, vendim i 11 shkurtit 2016, nr. 42534/09, § 77, (përfshirë në këtë publikim); *R.I. dhe të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 56.

50 *Grujic k. Serbia*, vendim i 28 gushtit 2018, nr. 203/07, §§ 60 - 65, (përfshirë në këtë publikim).

51 *K.B. dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 14 marsit 2017, nr. 36216/13, § 143 - 144 është gjetur shkëlqej (përfshirë në këtë publikim); *Nuutinen k. Finlandës*, vendim i 27 qershorit 2000, nr. 32842/96, § 128.

52 *K.B. dhe të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 14 marsit 2017, nr. 36216/13, (përfshirë në këtë publikim).

53 *Shih edhe Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 06 korrikut 2010, nr. 41615/07, § 136, (përfshirë në këtë publikim).

besnikërie ose ekspozimi ndaj sjelljes armiqësore të një prej prindërve. Nëse gjykatat do të bazonin vendimet e tyre në pikëpamjet e fëmijëve në rrethana të tilla, këto vendime do të binin ndesh me nenin 8.

- (e) Bashkimi i një prindi me fëmijën, i cili ka jetuar për disa kohë me prindin tjetër, mund të mos ndodhë direkt dhe mund të kërkojë marrjen e masave përgatitore. Natyra dhe zgjatja e këtyre përgatitjeve do të varet nga rrethanat e secilit rast, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i të gjithë palëve të interesuara do të jetë një përbërës i rëndësishëm.<sup>54</sup>

Masat shtrënguese për të zbatuar kthimin e fëmijëve tek prindërit që kanë marrë kujdestarinë përgjithësisht nuk janë të dëshirueshme, pasi kjo është një zonë e ndjeshme. Sidoqoftë, përdorimi i sanksioneve nuk duhet të përjashtohet në rast të sjelljes së paligjshme të prindit me të cilin jetojnë fëmijët<sup>55</sup>. Edhe nëse është e mundur që sanksionet më të rënda nuk do të kishin ndryshuar qëndrimin e përgjithshëm të prindërve, kjo nuk i përjashton autoritetet vendase nga detyrimet e tyre për të ndërmarrë të gjitha hapat e duhur për të lehtësuar kontaktin.<sup>56</sup>

### **Birësimi dhe kujdestaria**

Gjykata ka adresuar kujdestarinë dhe birësimin në çështjen *Strand Lobben dhe Të Tjerët k. Norvegjisë*<sup>57</sup> (kjo çështje është në pritje të gjykimin nga Dhoma e Madhe). Kërkuesit u ankuan se vendimi i autoriteteve vendase për të lejuar familjen kujdestare të birëson-te fëmijën e tyre cenoi të drejtën për një jetë të qetë familjare në kuadër të nenit 8.

Gjykata theksoi se vendimet e marra nga gjykatat vendase në lidhje me mirëqenien e fëmijëve janë shpesh të pakthyeshme, veçanërisht në rastet kur është autorizuar një birësim. Si të tilla për këto raste duhet të kushtohet një mbrojtje e shtuar me qëllim shmangien e ndërhyrjeve arbitrare.<sup>58</sup>

---

54 Shih edhe *R.I. dhe Të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 57; *Kuppinger k. Gjermanisë*, vendim i 15 janarit 2015, nr. 62198/11, §§ 103, 107.

55 *Hokkanen k. Finlandës*, vendim i 23 shtatorit 1994, nr. 19823/92; *Mitroua dhe Savik k. 'Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë'*, vendim i 11 shkurtit 2016, nr. 42534/09, § 77. (përfshirë në këtë publikim).

56 *R.I. dhe Të Tjerët k. Rumanisë*, vendim i Komitetit i 4 dhjetorit 2018, nr. 57077/16, § 57; *Kuppinger k. Gjermanisë*, vendim i 15 janarit 2015, nr. 62198/11, §§ 103, 107.

57 *Strand Lobben dhe Të Tjerët k. Norvegjisë*, vendim i 30 nëntorit 2017, nr. 37283/13, (pritet vendimi i Dhomës së Madhe).

58 *Strand Lobben dhe Të Tjerët k. Norvegjisë*, vendim i 30 nëntorit 2017, nr. 37283/13, (pritet vendimi i Dhomës së Madhe), § 102.

Megjithëse, sikurse u përmend më lart autoritetet vendase gëzojnë një hapësirë të madhe vlerësimi në lidhje me vlerësimin e nevojës nëse një fëmijë duhet marrë apo jo në mbrojtje, një vlerësim tepër strikt nevojitet të bëhet në lidhje me kufizimet, që vendosen veçanërisht mbi të drejtën e prindërve për të takuar fëmijët e tyre, si edhe mbi garantitë ligjore të miratuara për të siguruar mbrojtje efektive të së drejtës së prindërve dhe fëmijëve për respektimin e së drejtës për jetë të qetë familjare. Kjo situatë duhet trajtuar me shumë rigorozitet pasi këto kufizime rrezikojnë thelbin e marrëdhënieve familjare mes prindërve dhe fëmijëve të tyre.<sup>59</sup>

Në rastet kur ka kaluar një kohë e gjatë nga periudha kur fëmija është marrë në mbrojtje, interesi i tij/saj në lidhje me ndryshimin *de facto* të situatës familjare mund të prevalojë mbi interesin e prindërve për ta pasur serish të bashkuar familjen e tyre.

Qëndrimi i Gjykatës, në lidhje me pyetjen nëse zëvendësimi i marrëveshjes së kujdestarisë me birësimin, e cila do të sillte si pasojë humbjen e përgjegjësive dhe lidhjeve prindërore mes fëmijëve dhe prindërve të tyre, është se “masa të tilla duhet të zbatohen vetëm në raste përjashtimore dhe [mund] të justifikohen vetëm [nëse janë] të motivuara nga qëllimi për të ruajtur interesin më të lartë të fëmijës”.<sup>60</sup>

Ajo çfarë duhet të përcaktohet në lidhje me vendimmarrjen në kuadër të nenit 8 është përfshirja e prindërve gjatë gjithë procesit në atë shkallë sa t'u sigurohet mbrojtja e duhur e interesave të tyre, duke pasur në vëmendje rrethanat e veçanta të secilit rast dhe rëndësinë e vendimeve.

Gjykata duhet të konstatojë nëse gjykatat vendase kanë kryer një shqyrtim të thellë të të gjithë gjendjes familjare, në veçanti, duke mbajtur në vëmendje aspektet faktike emocionale, psikologjike, materiale dhe shëndetësore. Gjithashtu, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse gjykatat vendase kanë bërë një vlerësim të balancuar dhe të arsyeshëm të interesave konkurruese duke mbajtur në vëmendje kryesore interesin më të lartë të fëmijës. Në praktikë, ka gjasa që të ketë mbivendosje në këtë drejtim në lidhje me nevojën për arsye relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar marrjen e masave të tilla për kujdesin ndaj një fëmije.<sup>61</sup>

---

59 *K. dhe T. k. Finlandës*, vendim i 12 korrikut 2001, nr. 25702/94, § 155; *Strand Lobben dhe Të Tjerët k. Norvegjisë*, vendim i 30 nëntorit 2017, nr. 37283/13, (pritet vendimi i Dhomës së Madhe), § 104.

60 *Strand Lobben dhe Të Tjerët k. Norvegjisë*, vendim i 30 nëntorit 2017, nr. 37283/13, (pritet vendimi i Dhomës së Madhe), § 106.

61 *Strand Lobben dhe Të Tjerët k. Norvegjisë*, vendim i 30 nëntorit 2017, nr. 37283/13, (pritet vendimi i Dhomës së Madhe), § 107.

Në vendimin *X k. Kroacisë*<sup>62</sup> është theksuar se ndarja e një familjeje është një ndërhyrje tepër serioze. Gjykata është shprehur se autoriteteve vendase nuk duhet të ndjekin procedura të ngurta, por u duhet njohur një masë diskrecioni në lidhje me to. Sidoqoftë, në çdo rast duhet të mbahet në vëmendje fakti se çdo vendim i marrë mund të jetë i pakthyesëm (p.sh., kur një fëmijë është marrë nga prindërit dhe do të birësohet nga persona të tretë). Në këto raste do të ketë një vëmendje të shtuar në lidhje me mbrojtjen nga ndërhyrjet arbitrare.<sup>63</sup>

Procesi vendimmarrës i autoriteteve vendase duhet të jetë i tillë, që të sigurojë njohjen dhe marrjen parasysh të pikëpamjeve dhe interesave të prindërve natyrorë të një fëmije. Ata duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë në kohën e duhur çdo mjet juridik në dispozicion të tyre. Prindërit duhet të përfshihen në procesin e vendimmarrjes në një shkallë të mjaftueshme sa t'i sigurohet mbrojtja e nevojshme e interesave të tyre. Nëse ky standard nuk respektohet do të ndeshemi me një shkelje të së drejtës së tyre për të respektuar jetën familjare, e tillë që nuk do të mund të konsiderohet e nevojshme në kuptim të nenit 8.<sup>64</sup>

Natyrisht, prindërit kanë të drejtë të dëgjohen dhe të jenë plotësisht të informuar, megjithëse kufizimet në lidhje me këtë të drejtë mund të justifikohen sipas nenit 8 § 2 në rrethana të caktuara. Gjykata ka të drejtë të marrë parasysh nëse proceset janë kryer në mënyrë të drejtë duke siguruar respektin e duhur për interesat e mbrojtura nga neni 8 në çdo rrethanë.<sup>65</sup> Gjithashtu në këto raste do të zbatohet edhe neni 6.

### **(c) E drejta e prindërve për të njohur fatin e fëmijëve të tyre**

E drejta e prindërve për të njohur fatin e fëmijëve të tyre është ngritur në kontekst të nenit 2. Neni 2 vendos një detyrim procedural ndaj shtetit për të hetuar zhdukjen e anëtarëve të familjes, nëse mendohet se kjo ka ndodhur kur ata kanë qenë në duart e autoriteteve shtetërore, ose për shkak të veprimeve të individëve privatë, qofshin ata të identifikuar ose jo.<sup>66</sup>

---

62 *X k. Kroacisë*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 11223/04.

63 *X k. Kroacisë*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 11223/04, § 47.

64 *X k. Kroacisë*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 11223/04, § 48.

65 *X k. Kroacisë*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 11223/04, § 49.

66 *Randelovic dhe Të Tjerët k. Malit të Zi*, vendim i 19 shtatorit 2017, nr. 66641/10, § 122, (përfshirë në këtë publikim); *Varnava dhe Të Tjerët k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 18 shtatorit 2009, nr. 16064/90 16065/90 16066/90 16068/90 16069/90 16070/90 16071/90 16072/90 16073/90, § 200, (jo specifikisht mbi fëmijët por përmban orientim mbi rastet e zhdukjes); *Zorica Jovanovic k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013, nr. 21794/08, § 70, (përfshirë në këtë publikim).

## (4) FËMIJËT DHE KUJDESI SOCIAL

### (a) Marrja e fëmijëve nën kujdes

Në lidhje me pyetjen nëse është e nevojshme për të marrë një fëmijë nën kujdes, siç u përmend më lart, shtetit i është dhënë një hapësirë e gjerë vlerësimi. Autoritetet shtetërore kanë avantazhin e kontaktit të drejtpërdrejtë me të gjithë personat e interesuar, në fazën kur masat e kujdesit janë duke u parashikuar ose menjëherë pas zbatimit të tyre.<sup>67</sup>

Detyra e Gjykatës nuk është të zëvendësojë autoritetet shtetërore. Gjykata do të shqyrtojë në dritën e parashikimeve të KEDNJ-së vendimet, që këto autoritete kanë marrë në ushtrimin e kompetencave të tyre. Gjykata nuk e kufizon shqyrtimin e saj vetëm në lidhje me hapat proceduralë të ndërmarrë nga autoritetet, por gjithashtu do të shqyrtojë nëse arsyet e parashtruara nga autoritetet për veprimet e marra prej tyre janë “relevante dhe të mjaftueshme”

Kur një fëmijë merret nën kujdes, mund të lindin probleme në lidhje me të gjitha të drejtat garantuar sipas neneve të përmendura në fillim të kësaj përmbledhjeje, por edhe të drejta të tjera, p.sh., mos respektimi i përkatësisë fetare të një fëmije (neni 9).

Mbrojtja efektive e fëmijëve mund të kërkojë marrjen e masave urgjente, për t'i mbrojtur ata nga dëmtimi.<sup>68</sup> Megjithatë, edhe në këto raste Gjykata do të shqyrtojë me kujdes nëse është e nevojshme vërtet zhvendosja e menjëhershme e tyre, si edhe nëse autoritetet kanë kryer një vlerësim të duhur të ndikimit që këto masa do të kenë dhe ekzistencën e masave alternativave.<sup>69</sup>

Vendimet ose vlerësimet e gabuara në lidhje me faktin nëse një fëmijë duhet të ishte marrë nën kujdes nuk e shkelin *per se* Konventën. Çështja kryesore në këto raste është fakti nëse autoritetet shtetërore - të cilat mund të përfshijnë institucione mjekësore dhe sociale - kanë pasur shqetësime të arsyeshme dhe reale për sigurinë e fëmijës.<sup>70</sup>

Përsëri, kërkohet një shqyrtim tepër rigoroz në lidhje me kufizimet e mëtejshme, të tilla si kufizimet në të drejtat e prindërve për të takuar fëmijët e tyre, ose masat

---

67 *Johansen k. Norvegjisë*, vendim i 7 gushtit 1996, nr. 17383/90, § 64.

68 *Clemeno dhe Të Tjerët k. Italisë*, vendim i 21 tetorit 2008, nr. 19537/03, §§ 51 to 52.

69 *K. dhe T. k. Finlandës*, vendim i 12 korrikut 2001, nr. 25702/94, § 166.

70 *A.D. dhe O.D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 16 marsit 2010, nr. 28680/06 § 84; *M.A.K. dhe R.K. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 23 marsit 2010, nr. 45901/05 40146/06, § 35.

e marra me qëllim që fëmija të birësohet, sepse këto kufizime derivojnë rrezikun e kufizimit efektiv të marrëdhënieve familjare midis prindërve dhe fëmijës.<sup>71</sup>

## **(b) Fëmijët në edukim të mbikëqyrur**

Neni 5 § 1 (d) parashikon një përjashtim në lidhje me të drejtën e garantuar nga neni 5 § 1 se “gjithkush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë”.

Konsiderohen përjashtimore rastet kur<sup>72</sup>: “një i mitur ndalohet në bazë të ligjit, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij, për t’u dërguar përpara autoritetit kompetent ligjor.”

Edukimi i mbikëqyrur nuk mund të jetë i njëjtë i me mësimin e ofruar nga shkollat, por mund të përfshijë shumë aspekte të ushtrimit të të drejtave prindërore për të mirën dhe mbrojtjen e fëmijës<sup>73</sup>.

Shtetet duhet të sigurojnë që mbikëqyrja arsimore është arsyeja e vërtetë për paraburgimin e fëmijës dhe se fëmija po mbikëqyret realisht. Kur paraburgimi i caktohet një fëmije, një kriter thelbësor që duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e proporcionalitetit është nëse paraburgimi i urdhëruar si mjet i fundit i aplikueshëm, ishte në interesin më të lartë të fëmijës dhe kishte për qëllim parandalimin e rreziqeve serioze për zhvillimin e tij. Kur kriteret nuk plotësohen, bie arsyeja për heqjen e lirisë:

- (a) Kur një fëmijë 16 vjeçar u mbajt në paraburgim, Gjykata hodhi poshtë pohimin e Shtetit se masa ishte pjesë e një programi arsimor. U konstatua se në burg nuk kishte staf ose pajisje për të kryer aktivitete edukuese.<sup>74</sup>
- (b) Rasti i dy fëmijëve të cilët pasi kishin pranuar kryerjen e vjedhjes, shpenzuan një muaj në një qendër për të mitur për qëllime të paspecifikuara dhe nuk morën pjesë në ndonjë program arsimor, u konsiderua jashtë kuptimit të nenit 5 § 1 (d). Procedimi penal i tyre filloi pas lirimit të tyre nga qendra për të rinj.<sup>75</sup>

---

71 *T.P. dhe K.M. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, nr. 28945/95, § 71; *Johansen k. Norvegjisë*, vendim i 7 gushtit 1996, nr. 17383/90.

72 *Blokhin k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, nr. 47152/06, § 166; *P. dhe S. k. Polonisë*, vendim i 30 tetorit 2012, nr. 57375/08, § 147.

73 *D.L. k. Bullgarisë*, vendim i 19 majit 2016, nr. 7472/14, § 74, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

74 *Bouamar k. Belgjikës*, vendim i 29 shkurtit 1988, nr. 9106/80.

75 *Ichin dhe Të Tjerët k. Ukrainës*, vendim i 21 dhjetorit 2010, nr. 28189/04 28192/04, §§ 37 to 39.

- (c) Vendosja e një të reje shtatzënë në një qendër me qëllim për të mitur për ta ndarë atë nga nëna e saj dhe për të parandaluar abortin, bie në kundërshtim me nenin 5 § 1 (d).<sup>76</sup>
- (d) Paraburgimi i një fëmije 12 vjeçar në një qendër paraburgimi të të miturve për të parandaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme kriminale u konsiderua jashtë nenit 5 § 1 (d).<sup>77</sup>

### **(c) Ribashkimi i fëmijëve me familjet e tyre**

Marrja e fëmijës nën kujdestari duhet të konsiderohet si një masë e përkohshme. Qëllimi përfundimtar duhet të jetë ribashkimi i fëmijës me prindërit e tij/saj. Kjo vlen jo vetëm për rastet që kanë të bëjnë me fëmijët e marrë në kujdes publik, por edhe për rastet kur ka pasur mosmarrëveshje për vendbanim midis prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes.<sup>78</sup>

Siç u tha më lart, detyrimi për të marrë masa për bashkimin e prindërve dhe fëmijëve nuk është absolut. Shteti duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të lehtësuar ribashkimin në mënyrë të arsyeshme në rrethanat e veçanta sipas rastit.

## **(5) FËMIJËT DHE SISTEMI I DREJTËSISË PENALE**

Përkufizimi i fëmijës është “çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, përveç rasteve kur sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën moshë madhore arrihet më herët” (KDF, neni 1). Edhe adoleshentët më të vjetër konsiderohen ende fëmijë. Ata duhet të mbrohen (Shih Komentarin e Përgjithshëm të KDF-së nr. 20 (2016) mbi zbatimin e të drejtave të fëmijës gjatë adoleshencës dhe gjithashtu Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (“Rregullat e Pekinit”).

Mosha e përgjegjësisë penale në Evropë varion, ndonëse ekziston një konsensus i gjerë se mosha 14-vjeçare është kufiri më i ulët. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve po rishikon aktualisht Projektligjin e Përgjithshëm Nr. 10 (2007) mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur. Drafti i Komitetit të Përgjithshëm të Rishikuar, § 33, aktualisht është duke i inkurajuar shtetet që të rrisin moshën minimale dhe i përgëzon shtetet që kanë një moshë më të lart minimale. Komiteti rekomandon që palët

---

<sup>76</sup> *P. dhe S. k. Polonisë*, vendim i 30 tetorit 2012, nr. 57375/08, § 148.

<sup>77</sup> *Blokhin k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, nr. 47152/06, § 171.

<sup>78</sup> *N.T.S. dhe Të Tjerët k. Gjeorgjisë*, vendim i 02 shkurtit 2016, nr. 71776/12, § 70, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Mihailova k. Bullgarisë*, vendim i 12 janarit 2006, nr. 35978/02, § 80.



shtetërore në asnjë rrethanë të mos e zvogëlojnë moshën minimale të përgjegjësisë penale nëse ligji përcakton moshën minimale më të lartë se 14 vjeç.

Gjatë një çështjeje në të cilën kërkuesi në kohën e incidenteve në fjalë ishte 17 vjeç dhe ishte hetuar sipas ligjit penal, Dhoma e Madhe citoi dispozitat e mëposhtme të instrumenteve ndërkombëtare<sup>79</sup>:

- (a) Kur të miturit mbahen në paraburgim, duhet të merret parasysh statusi i tyre si fëmijë, moshë, cenueshmëria e tyre dhe niveli i maturitetit. Ata duhet të informohen menjëherë për të drejtat dhe masat mbrojtëse të tyre në një mënyrë që të jetë sa më kuptueshme për ta. Ndërsa gjatë marrjes në pyetje nga policia ata duhet, në parim, të shoqërohen nga prindi, kujdestari i tyre ligjor ose një i rritur tjetër i përshtatshëm. Ata gjithashtu duhet të kenë të drejtën e pasjes së një avokati dhe një mjeku. (Rekomandimi i Komitetit të Ministrave në lidhje me mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit të të miturve dhe rolin e drejtësisë për të miturit 2003).
- (b) Shtetet Anëtare duhet të rishikojnë, nëse është e nevojshme, legjisllacionin dhe praktikën e tyre me qëllim përforcimin e pozitës ligjore të fëmijëve gjatë gjithë procedurës (duke përfshirë marrjen në pyetje të policisë), duke njohur ndër të tjera të drejtën e ndihmës së avokatit që mund, nëse është e nevojshme, të emërohet zyrtarisht dhe të paguhet nga shteti (*Rekomandimi i Komitetit të Ministrave mbi reagimet sociale ndaj delikuentëve të miturve 1987*).
- (c) Çdo fëmijë i privuar nga liria e tij ka të drejtë të ketë akses të shpejtë në ndihmë juridike përshtatshme, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e heqjes së lirisë së tij para një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent. (*KDF, neni 37*).
- (d) Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve rekomandon që palët shtetërore të vendosin dhe zbatojnë afate kohore për periudhën ndërmjet komunikimit të veprës penale dhe përfundimit të hetimit të policisë, vendimit të prokurorit ose organit tjetër kompetent për të ngritur padi kundër fëmijës, dhe vendimit të formës së prerë të gjykatës ose të një organi tjetër gjyqësor kompetent. Këto afate kohore duhet të jenë shumë më të shkurtra se ato të vendosura për të rriturit. Por në të njëjtën kohë, vendimet pa vonesë duhet të jenë rezultat i një procesi në të cilin respektohen plotësisht të drejtat e fëmijës dhe masat mbrojtëse ligjore (*Komenti i Përgjithshëm i KDF-së nr. 10 (2007)*).
- (e) Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve, Turqi, 2001, theksuan se shkelësit e mitur duhet të trajtohen pa vonesë, me qëllim që të shmangen periudhat e paraburgimit të pa komunikuar dhe se paraburgimi

---

79 *Salduz k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 nëntorit 2008, nr. 36391/02.

duhet të përdoret vetëm si një masë e fundit, pasi të jenë ezauruar të gjitha masat e tjera, duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur dhe nuk duhet të jetë më shumë se afati i përcaktuar me ligj. Masat alternative të paraburgimit duhet të përdoren sa herë që të jetë e mundur.

Gjykata ka adresuar parimet e mëposhtme, në lidhje me fëmijët në sistemin e drejtësisë penale, në praktikën e saj gjyqësore:

- (a) **E drejta për të pasur një avokat** - Ekziston një rëndësi themelore në sigurimin e të drejtës për të pasur avokat kur personi në paraburgim është fëmijë (shih *Salduz k. Turqisë*,<sup>80</sup> një rast lidhur me një fëmijë 17 vjeçar dhe *Blokhin k. Ruisë*,<sup>81</sup> lidhur me një fëmijë 12-vjeçar).
- (b) **Drejtësia e procesit gjyqësor** – aftësia për të kuptuar procedurën: Fakti që një fëmijë është palë në një gjykatë nuk është në vetvete shkelje e nenit 6, por fëmija në fjalë duhet të jetë në gjendje të kuptojë procesin, shkakun dhe pasojat e tij. Gjatë procesit duhet marrë parasysh mosha, niveli i pjekurisë, aftësitë intelektuale dhe emocionale. Gjithashtu, procesi duhet të përshtatet në mënyrë që të lehtësojë kuptueshmërinë e fëmijës për atë që po ndodh. Fakti i thjeshtë se ai ose ajo mund të përfaqësohet nga një avokat nuk është i mjaftueshëm.<sup>82</sup>
- (c) **Përfshirja e publikut**: Ekzistojnë përjashtime të caktuara nga kërkesa e nenit 6 që procedurat penale duhet të jenë të hapura për publikun. Këto përjashtime përfshijnë interesat e të miturve, mbrojtjen e jetës private të palëve dhe rastet kur seancat e hapura për publikun do të dëmtonin interesat e drejtësisë.
- (d) **Publikimi i emrave të fëmijëve të akuzuar**: Sipas nenit 40 § 2 (b) të KDF është garanci minimale për fëmijët e akuzuar për krime, respektimi i plotë të privatësisë së tyre në të gjitha fazat e procedimit. Rregullat e Pekinit gjithashtu deklarojnë se “privatësia e të miturve do të respektohet në të gjitha fazat” dhe “në parim nuk do të publikohen informacione që mund të çojnë në identifikimin e një të akuzuari të mitur”.

---

80 *Salduz k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 nëntorit 2008, nr. 36391/02, § 62.

81 *Blokhin k. Ruisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, nr. 47152/06 § 199.

82 *Adamkiewicz k. Polonisë*, vendim i 2 marsit 2010, nr. 54728/00 § 70; *Blokhin k. Ruisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, nr. 47152/06, § 195.

## (6) FËMIJËT NË KUFIJ: MIGRACIONI, AZILI, TRAFIKIMI

### (a) Fëmijët që kërkojnë azil (të shoqëruar, të ndarë, të pashoqëruar)

Fëmijët kanë nevoja specifike sipas moshës së tyre dhe aftësisë së tyre për të qenë të pavarur. Këto nevoja do të vlerësohen në rast se fëmija kërkon azil.

Termi “i mitur i pashoqëruar” përshkruan personat nën moshën 18 vjeç që hyjnë në territorin evropian pa pasur një të rritur përgjegjës për ta në shtetin pritës. KEDNJ nuk përmban shprehimisht dispozita për të miturit e pashoqëruar. Megjithatë, trajtimi i tyre mund të konsiderohet sipas dispozitave të nenit 5 § 1 (f), neni 8 ose neni 2 i Protokollit nr. 1. Karta Sociale Evropiane i referohet fëmijëve të privuar nga mbështetja e familjes së tyre në nenin 17 § 1).

Gjykata ka vërejtur se KDF inkurajon shtetet të marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë që kërkon të marrë statusin e refugjatit gëzon mbrojtje dhe ndihmë humanitare qoftë vetëm ose i shoqëruar nga prindërit e tij<sup>83</sup>. Shtetet kanë përgjegjësinë të kujdesen për të miturit e pashoqëruar dhe jo t'i braktisin kur lirohen nga paraburgimi.<sup>84</sup>

Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale, ashtu sikurse dhe Gjykata, ka theksuar se shtetet të cilat kanë politika për të të ndaluar shkeljet e rregullave të emigracionit nuk duhet t'i privojnë fëmijët e huaj, veçanërisht nëse janë të pashoqëruar, nga mbrojtja që ju jep statusi i tyre. Mbrojtja e të drejtave themelore dhe çdo kufizim i imponuar nga politika e emigracionit të Shtetit duhet të jene në harmoni.<sup>85</sup>

Duke pasur parasysh natyrën absolute mbrojtëse të nenit 3, Gjykata ka theksuar se për një fëmijë të pashoqëruar faktori vendimtar që përcakton rrjedhën e veprimit që duhet të merret më tej është vulnerabiliteti i tij. Shteti duhet të marrë masat e duhura për të ofruar kujdes dhe mbrojtje si pjesë e detyrimeve të tij pozitive.<sup>86</sup>

---

83 *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Maltës*, vendim i 22 nëntorit 2016, nr. 25794/13 28151/13, § 103; *Popov k. Francës*, vendim i 19 janarit 2012, nr. 39472/07 39474/07, § 91, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *S.F dhe Të Tjerët k. Bullgarisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017, nr. 8138/16, §§ 84- 92.

84 *Rahimi k. Creqisë*, vendim i 5 prillit 2011, nr. 8687/08, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

85 *ECSR, Defence for Children International (DCI) k. Holandës*, vendim i 20 tetorit 2009, Ankesa nr. 47/2008.

86 *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03, § 55.

Sipas ligjit të Bashkimit Evropian (BE), dispozitat specifike për të miturit e pashoqëruar janë të përfshira në disa instrumente ligjorë që rregullojnë procedurat e azilit, si dhe në Direktivën e Kthimit. Sipas Rregullores së Dublinit, Nr. 604/2013:

- (a) Aplikimet nga të miturit e pashoqëruar duhet të shqyrtohen nga Shteti Anëtar në të cilin anëtarët e familjes, vëllezërit e motrat ose të afërmit janë ligjërisht të pranishëm (neni 8 i Rregullores);
- (b) fëmija duhet të pajiset me një përfaqësues (neni 6 i Rregullores);
- (c) duhet të vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës (neni 6 § 3 i Rregullores);
- (d) ka rregulla për të shmangur ndarjen në rast se anëtarët e familjes paraqesin kërkesa të ndara në një Shtet Anëtar (neni 11 i Rregullores);
- (e) Në mungesë të një anëtari të familjes, i vëllezërve ose i afërmeve, Shteti Anëtar përgjegjës është shteti ku fëmija ka parashtruar kërkesën për azil, me kusht që ai të jetë në interesin më të lartë të fëmijës (neni 8 i Rregullores).

Të miturive të pashoqëruar që kërkojnë azil duhet t'ju caktohet një përfaqësues sapo të aplikojnë për azil. Përfaqësuesit duhet t'i jepet mundësia për të diskutuar çështjet me fëmijën para intervistës së azilit dhe për ta shoqëruar fëmijën tek intervista. Në rastin kur një fëmijë ishte i regjistruar si i mitur i pashoqëruar dhe nuk kishte një kujdestar që mund të veprojë si përfaqësues ligjor është konsideruar si shkelje e nenit 5 § 4 të Konventës. Edhe duke supozuar se mjetet juridike do të kishin qenë efektive, Gjykata nuk arriti në konkluzionin se fëmija mund t'i ushtronte ato. Fëmija nuk ishte në gjendje që të kontaktonte një avokat dhe broshura informative që përshkruante mjetet juridike ishte shkruar në një gjuhë që ai nuk mund ta kuptonte, edhe pse intervista e tij ishte në gjuhën e tij amtare.<sup>87</sup>

Shtetet janë të detyruara të lehtësojnë bashkimin familjar të të miturve të pashoqëruar.<sup>88</sup> Rëndësia e gjurmimit të shpejtë të anëtarëve të familjes dhe ribashkimit familjar është nënvizuar në nenin 22, paragrafi 2, 9, paragrafi 3 dhe 10, paragrafi 2, si dhe Komenti i Përgjithshëm Nr. 6, § 31. Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët rekomandoi se ribashkimi i fëmijës me një prind të bëhet në një fazë të hershme, përpara përcaktimit të statusit (UNHCR, Udhëzimet mbi Politikat dhe Procedurat në trajtimin e Fëmijëve të Pashoqëruar që kërkojnë azil, §§ 5 dhe 7).

Familjet me fëmijë që kërkojnë azil nuk mund të dëbohen në një Shtet tjetër Kontraktues në qoftë se ata rrezikojnë rrethana të pasigurta, përveç nëse Shteti

---

<sup>87</sup> *Rahimi k. Greqisë*, vendim i 5 prillit 2011, nr. 8687/08, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>88</sup> *Mublanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03, § 85; *Johansen k. Norvegjisë*, vendim i 7 gushtit 1996, nr. 17383/90, § 78.

përkatës ofron garanci specifike dhe konkrete për pranimin në përputhje me moshën e tyre.<sup>89</sup>

## **(b) Ndalimi i fëmijëve migrantë**

Në rastet e ndalimit të fëmijëve emigrantë cenueshmëria ekstreme e një tyre është faktori vendimtar. Ajo ka përparësi ndaj vlerësimeve të tjera, që një shtet mund të aplikojë për trajtimin e njerëzve që klasifikohen si emigrantë jo të ligjshëm.<sup>90</sup>

Detyrimet e një shteti lidhur me mbrojtjen e fëmijëve të emigrantëve do të jenë të ndryshme në varësi të faktit nëse ato janë të shoqëruara ose jo.<sup>91</sup> Megjithatë, edhe aty ku fëmijët janë mbajtur në paraburgim me prindërit, në pritje të masave të emigracionit është shkelur neni 3.<sup>92</sup>

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përfshin mbajtjen e familjes të bashkuar sa më shumë që të jetë e mundur dhe shqyrtimin e të gjitha alternativave në mënyrë që ndalimi i fëmijëve të jetë opsioni i fundit.<sup>93</sup>

Sipas nenit 8, një masë izolimi duhet të jetë proporcionale me qëllimin e ndërmarrë nga shteti. Në rastet e emigracionit, qëllimi i autoriteteve është zakonisht zbatimi i një vendimi dëbimi. Kur përfshihen familje, autoritetet duhet që gjatë testit të proporcionalitetit, të marrin parasysh interesin më të lartë të çdo fëmije.

Dhoma e Madhe konsideroi pranueshmërinë e kushteve të jetesës së atyre që kërkonin azil në çështjen *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>94</sup> (ky rast nuk kishte të bënte me kërkues fëmijë, por ofroi udhëzime të dobishme për këtë çështje). Dhoma e Madhe konsideroi se Shtetet janë përgjegjëse për qëndrimin e azilkërkuesve të cilët nuk ishin mbajtur në paraburgim. Ajo theksoi vulnerabilitetin e njerëzve që kërkojnë azil, të cilët shpesh nuk mund ta kuptojnë gjuhën lokale dhe janë pa mjete financiare. Në

---

89 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, § 121 deri në 122, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

90 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, § 99, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

91 *Rahimi k. Greqisë*, vendim i 5 prillit 2011, nr. 8687/08, § 63, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

92 *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03, § 55; *Popov k. Francës*, vendim i 19 janarit 2012, nr. 39472/07 39474/07, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

93 *Popov k. Francës*, vendim i 19 janarit 2012, nr. 39472/07 39474/07, §§ 140 deri në 141, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Rahimi k. Greqisë*, vendim i 5 prillit 2011, nr. 8687/08, § 108, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

94 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim i 21 janarit 2011, nr. 30696/09.

shumë raste, ata kanë përjetuar përvoja traumatike. Është e nevojshme që shteti të marrë masa aktive për të informuar azilkërkuesit me infrastrukturën ose institucionet ndihmëse që janë në dispozicion të tyre dhe për të lehtësuar asistencën dhe përpunimin e shpejtë të kërkesave të tyre.<sup>95</sup>

Në rastet kur fëmijët ndalohen duhet të mbahen në kushte të përshtatshme për nevojat e tyre. Efektet, që paraburgimi mund të ketë ndaj fëmijëve dhe kushtet në të cilat ata mbahen, mund të përbëjnë shkelje të nenit 3, edhe nëse kjo nuk do të konsiderohej shkelje në qoftë se është një i rritur. <sup>96</sup> Kushtet e pritjes për fëmijët që kërkojnë azil duhet të përshtaten me moshën e tyre, për të siguruar që ato kushte të mos “krijojnë ... për ta një situatë stresi dhe ankthi, me pasoja veçanërisht traumatike”.<sup>97</sup>

Shkelje të nenit 3 janë gjetur në:

- (a) *Popov k. Francës*, në të cilën fëmijët ishin të moshës 5 muaj dhe tre vjeç dhe pasi ishin ndaluar ishin mbyllur për 15 ditë në një qendër paraburgimi në të cilën nuk kishte shtretër për fëmijë ose objekte për lojë, mobilitet ishin metalike dhe gjithashtu kishte dyer që mbyllen automatikisht të cilat paraqesin rrezik të lartë lëndimit. Gjithashtu u gjetën shkeljet e neneve 5 dhe 8.<sup>98</sup>
- (b) *Muskhadzhiyeva dhe Të Tjerët k. Belgjikës*, në këtë çështje, katër fëmijë të vegjël të shoqëruar nga nëna e tyre, ishin mbajtur për një muaj në pritje të largimit. Gjykata mori parasysh moshën e tyre të re (shtatë muaj deri në shtatë vjeç), kohëzgjatjen e ndalimit të tyre dhe statusin shëndetësor.<sup>99</sup>
- (c) *Rahimi k. Greqisë*, në të cilën kushtet e paraburgimit të një fëmije të pashoqëruar të moshës 15 vjeçare ishin aq të këqija, saqë cenuan thelbin e dinjitetit njerëzor dhe mund të konsideroheshin në vetvete, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e paraburgimit (disa ditë) si trajtim degradues.<sup>100</sup>

---

95 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, §§ 249 to 263.

96 *Muskhadzhiyeva dhe Të Tjerët k. Belgjikës*, vendim i 19 janarit 2010, nr. 41442/07, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

97 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, § 119, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

98 *Popov k. Francës*, vendim i 19 janarit 2012, nr. 39472/07 39474/07, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); shiko gjithashtu *S.F dhe Të Tjerët k. Bullgarisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017, nr. 8138/16.

99 *Muskhadzhiyeva dhe Të Tjerët k. Belgjikës*, vendim i 19 janarit 2010, nr. 41442/07, § 63, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

100 *Rahimi k. Greqisë*, vendim i 5 April 2011, nr. 8687/08, § 108, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); Shiko gjithashtu *S.F dhe Të Tjerët k. Bullgarisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017, nr. 8138/16.

### **(c) Ekskludimi i fëmijëve migrantë**

Kur një fëmije që ka jetuar më parë larg një prindi, jashtë një Shteti Kontraktues, i refuzohet hyrja për t'u bashkuar me familjen, mund të konsiderohet shkelje.

Në rastet kur fëmija ka jetuar në distancë me familjen për periudhë të gjatë kohe është e vështirë të provohet lidhja e mjaftueshme familjare. Në çështjen *Ahmut k. Holandës*,<sup>101</sup> një djalë 15-vjeçar u largua nga Maroku, ku ishte rritur nga të afërmit, për t'u bashkuar me babanë e tij i cili jetonte në Holandë. Djali kishte jetuar shumicën e jetës së tij në Marok dhe kishte lidhje të forta gjuhësore dhe kulturore me këtë shtet. Ndarja me djalin, ishte rezultat i një vendimi të vetëdijshëm të babait për të lëvizur dhe ai nuk kishte asnjë arsye që i ndalonte të jetonin së bashku. Fakti se i ati i djalit kishte preferuar të bashkohej me djalin dhe të jetonin së bashku në Holandë nuk u konsiderua nga gjykata si arsye e mjaftueshme për t'i garantuar të drejtën për të zgjedhur vendin më të përshtatshëm për të zhvilluar jetën familjare me djalin.

Situata mund të ndryshojë nëse një prind ka arritur të fitojë statusin e refugjatit. Dhënia e statusit të refugjatit duhet të konsiderohet si një njohje nga shteti se prindërit nuk mund të kthehen.

Faktor vendimtar mund të jetë në rast se prindërit arrijnë të tregojnë një shkallë të lartë integrimi në vend. Në *Sen k. Holandës*,<sup>102</sup> prindërit kishin marrë leje qëndrimi dhe rezidence në Holandë dhe dy prej fëmijëve të tyre kishin lindur në atë vend. Gjykata i dha rëndësi faktit se fëmijët nuk kishin lidhje me Turqinë dhe thanë se zgjedhja e lirë e prindërve për t'u larguar nga fëmija i tyre më i madh në Turqi nuk mund të konsiderohej si një vendim i pakthyeshem që ai të qëndronte jashtë familjes.

### **(d) Dëbimet e fëmijëve**

Në rastet kur përfshihen fëmijë, Shteti duhet të marrë parasysh interesat e tyre më të larta. Dëbimi i një fëmije nga vendi në të cilin ata kanë jetuar pjesën më të madhe të jetës dhe ku jeton familja e tyre, rrallë herë mund të përshtatet me interesin më të lartë të tyre.

Kur një fëmijë ka kryer një vepër penale të rëndë, shteti ka detyrimin të vazhdojë të shqyrtojë interesat më të larta të fëmijës. Në rastin e një 13-vjeçari i cili kishte kryer përdhunim dhe u dënua me katër vjet burg, Gjykata u shpreh se shteti nuk kishte

---

<sup>101</sup> *Ahmut k. Holandës*, vendim i 28 nëntorit 1996, nr. 21702/93.

<sup>102</sup> *Sen k. Holandës*, vendim i 21 dhjetorit 2001, nr. 31465/96.

provuar se kishte arsye të bazuara dhe objektive që fëmija mund të kryente sërish një krim të tillë. Gjykata e konsideroi dëbimin e fëmijës të panevojshëm.<sup>103</sup> Në *Lak-upovic k. Austrisë*,<sup>104</sup> Gjykata theksoi se duhet të ekzistojnë arsye shumë të rënda për të justifikuar dëbimin e një 16-vjeçari, veçanërisht duke pasur parasysh historinë e konfliktit në vendin e origjinës dhe duke pasur parasysh se nuk kishte prova që djali kishte të afërm që jetonin atje. Gjykata vendosi se shteti kishte bërë një ndërhyrje jo proporcionale në jetën e tij private dhe familjare.

Për të justifikuar dëbimin për një emigrant që ka jetuar të gjithë ose pjesën më të madhe të fëmijërisë së tij në vendin pritës konform rregullave të atij vendi, në rastet kur ai ka kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm, duhet të vlerësohen një sërë kritere.<sup>105</sup> Elementet kryesore, që shteti duhet të vlerësojë janë shtrirja e lidhjeve të individit me shtetin e origjinës dhe shtetin pritës. Kjo shtrirje duhet të balancohet më pas me vlerësimin nëse efektet e parandalimit të krimit janë më pozitive se efektet e largimit të kërkuesit.

Në rastet kur një kërkues i gjeneratës së dytë kalon pjesën më të madhe të jetës së tij në një Shtet Anëtar dhe i refuzohet ripërtëritja e lejes së qëndrimit për arsye teknike, konsiderohet shkelje. Një vajzë 15-vjeçare e lindur nga prindër somalezë me vendqëndrim në Danimarkë shkoi në Kenia për t'u kujdesur për gjyshen e saj. Leja daneze e qëndrimit i kishte skaduar për shkak të mosplotësisimit brenda afatit, dhe nuk i lejohej të kthehej në Danimarkë. Gjykata gjeti se nuk ishte bërë një balancim të drejtë midis interesave të saj dhe kontrollit të imigracionit.<sup>106</sup>

Edhe kur dëbimi i kërkuesve të gjeneratës së dytë është i justifikuar, Gjykata ka përjashtuar vendosjen e një mase të tillë në rast kur shumica e lidhjeve familjare ekzistojnë ende.<sup>107</sup>

Dëbimi i fëmijës ose efektet e tij, mund të jenë kaq traumatike sa që mund të sjellin shkelje të nenit 3.

---

<sup>103</sup> *A.A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 20 shtatorit 2011, nr. 8000/08, §§ 53 deri në 77.

<sup>104</sup> *Jakupovic k. Austrisë*, vendim i 06 shkurtit 2003, nr. 36757/97.

<sup>105</sup> *Maslov k. Austrisë*, vendim i 23 qershorit 2008, nr. 1638/03.

<sup>106</sup> *Osman k. Danimarkës*, vendim i 14 qershorit 2011, nr. 38058/09, §§ 53 - 77.

<sup>107</sup> *Yilmaz k. Gjermanisë*, vendim i 17 prillit 2003, nr. 52853/99, § 48; *Keles k. Gjermanisë*, vendim i 27 tetorit 2005, nr. 32231/02, § 66.



- (a) Vendosja e një fëmije kongolez pesë vjeçar në një qendër të mbyllur për të rritur, pa pajisje, këshillim apo asistencë edukative është konsideruar si trajtim jo human, që përbën trajtim çnjerëzor.<sup>108</sup>
- (b) Shtetet duhet të marrin masa për ofrimin e mbrojtjes adekuate dhe të sigurojnë që kur dëbojnë një fëmijë, ka anëtarë ose struktura të përshtatshme të familjes për t'u kujdesur për ta pas mbërritjes. Kur Belgjika dërgoi një fëmijë kongolez pesë vjeçar në Kanada, Gjykata konstatoi mungesë të përgatitjes dhe mbikëqyrjes adekuate të rastit. Autoritetet belge nuk kishin marrë masa që fëmija të shoqërohej gjatë fluturimit dhe nuk ishin siguruar që një anëtar i familjes do të vinte për ta takuar në aeroport. Gjykata u shpreh se autoritetet belge kishin detyrimin të lehtësonin ribashkimin e vajzës me nënën e saj në Kanada, por kishin dështuar. Autoritetet nuk kishin ndjekur interesin më të lartë të fëmijës, veçanërisht duke e mbajtur atë në një qendër të papërshtatshme për të rritur, në vend që t'a akomodonin në një strukturë më të përshtatshme.<sup>109</sup>
- (c) Lejimi i një fëmije për të qëndruar vetëm për 10 ditë pa mbikëqyrje dhe kujdesi të duhur është konsideruar shkelje e nenit 3.<sup>110</sup>
- (d) Në rrethana të jashtëzakonshme, kushtet që përballen fëmijët me dëbim në një vend tjetër mund të shkaktojnë trajtime çnjerëzore dhe degraduese në kundërshtim me nenin 3. Që një trajtim të konsiderohet se ka shkelur nenin 3 duhet të kalojë pragun minimal të ashpërsisë. Një ndryshim i thjeshtë i mjedisit dhe standardeve të jetesës është i pamjaftueshëm për t'u konsideruar si trajtim çnjerëzor dhe degradues.<sup>111</sup>

Një fëmijë nuk mund të fajësohet për sjelljen e të afërmeve të tij.<sup>112</sup> Dëbimi i një prindi nga një Shtet Kontraktues mund të jetë i papajtueshëm me kërkesat e nenit 8 kur ka një fëmijë i cili gjithashtu ka vendbanimin në atë Shtet.

Faktorët që do të merren në konsideratë janë:

- (a) shkallën në të cilën jeta familjare është shkelur;
- (b) natyrën dhe fuqinë e lidhjeve të prindërve me fëmijën;
- (c) nëse familja ose një anëtar i familjes jeton në vështirësi të mëdha në vendin e origjinës;

---

<sup>108</sup> *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03.

<sup>109</sup> *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03.

<sup>110</sup> *Rahimi k. Greqisë*, vendim i 5 prillit 2011, nr. 8687/08, §§ 81 deri në 94, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>111</sup> *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03.

<sup>112</sup> *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03.

- (d) nëse ka faktorë të kontrollit të emigracionit;
- (e) në qoftë se cenohet rendi publik;
- (f) mosha dhe aftësia e fëmijëve për t'u përshtatur.

Kur një prind jo-shtetas është duke u dëbuar dhe fëmijët janë në kujdestari të prindit tjetër pas ndarjes ose divorcit, lidhjet familjare ndoshta mund të prishen midis prindit jo-shtetas dhe fëmijës, meqë fëmija nuk do të shoqërojë atë prind. Kjo mund të krijojë një paradoks, ku një prind që ka qenë i divorcuar mund të përfitojë të drejtën për të qëndruar në atë shtet në mënyrë që të ketë mundësi të takohet me fëmijën e tyre, ndërsa ata që janë në një marrëdhënie të martuar të vazhdueshme mund të presin marrëdhëniet me çdo anëtar të familjes dhe të largohen.

- (a) *Në Berrehab k. Holandës*,<sup>113</sup> kërkesa ishte sjellë nga një baba, ish-grua dhe fëmijë në lidhje me kërkesën për dëbim të babait pas divorcit. Ky dëbim mund të bëhej shkak për të ndërprerë lidhjet ndërmjet tij dhe fëmijës. Fakti që prindërit nuk jetonin më bashkë nuk ishte fakt vendimtar për ekzistencën ose jo të jetës familjare. Marrëdhëniet mes babait dhe djalit lindën nga një martesë e ligjshme dhe vazhduan edhe pas divorcit. Babai e takonte fëmijën katër herë në javë dhe kishte kontakt të rregullt dhe të shpeshtë. Gjykata vlerësoi me rëndësi faktin që babai kishte qëndruar në mënyrë të ligjshme në Holandë për shumë vite, kishte një shtëpi, punë dhe shteti nuk kishte asnjë arsye për ta larguar atë. Në këtë rast shteti nuk ishte arritur një ekuilibër të drejtë mes interesit të kontrollit të emigracionit dhe interesit të ndërsjellë të kërkuesve për lidhjet e vazhdueshme familjare.
- (b) Në *Ciliz k. Holandës*,<sup>114</sup> procedura e vendimmarrjes në lidhje me dëbimin e babait zbuloi një shkelje të nenit 8, ku autoritetet paragjyquan rezultatin e procesit gjyqësor duke e dëbuar atë gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore dhe ai nuk ishte dënua për një vepër penale që do të justifikon largimin e tij.
- (c) Vendimet që kanë të bëjnë me dëbimin e një prindi jo-shtetas duhet t'i japin kujdesin e duhur interesit më të lartë të fëmijëve. Kur një nënë, e cila ishte prindi kujdestar i dy vajzave, u vu nën urdhër të dëbimit dhe ndalimit të rihyrjes për dy vjet, Gjykata konstatoi se shkeljet e saj të rënda të ligjit të emigracionit nuk justifikonin ndikimin traumatik të ndarjes nga dy fëmijët të cilët ishin vendosur me urdhër të gjykatës nën kujdesin e babait të tyre për shkak të urdhrit të dëbimit.<sup>115</sup>

---

<sup>113</sup> *Berrehab k. Holandës*, vendim i 21 qershorit 1988, nr. 10730/84.

<sup>114</sup> *Ciliz k. Holandës*, vendim i 11 korrikut 2000, nr. 29192/95.

<sup>115</sup> *Nunez k. Norvegjisë*, vendim i 28 qershorit 2011, nr. 55597/09.

Kur fëmijët, gjatë rikthimit, vihen para rrezikut të ndarjes ndaheshin nga prindërit e tyre ose mbaheshin në strehim të papërshtatshëm, kjo ishte e mjaftueshme për të konstatuar një shkelje të mundshme të nenit 3.<sup>116</sup>

Siç u tha më lart, familjet me fëmijë që kërkojnë azil nuk mund të dëbohen në një Shtet tjetër Kontraktues ku ata rezikojnë të gjenden në rrethana të pasigurta, përveç nëse shteti në fjalë siguron garanci konkrete.<sup>117</sup>

## (e) Rrëmbimi

Ashtu siç parashtrohet në fillim të kësaj përmbledhje, nenit 53 i KEDNJ-së duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që nuk kufizon ose derogon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në instrumentet relevante të Hagës, OKB-së dhe BE-së në të cilat shtetet janë palë.

Kjo ka një rëndësi të veçantë në trajtimin e fushës së rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve. Detyrimet që neni 6, 8 dhe 13 i akordojnë Shteteve Kontraktuese duhet të interpretohen duke marrë parasysh, në veçanti, Konventën e Hagës të 1980 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës<sup>118</sup>, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>119</sup> dhe, sipas rastit, Rregulloren e BE-së 2201/2003 ("Brukseli II bis") që zbatohet në rastet e rrëmbimeve brenda BE.<sup>120</sup>

Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private<sup>121</sup>, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Bashkimi Evropian kanë bërë dhe vijojnë të bëjnë një punë të rëndësishme për çështjen e rrëmbimit të fëmijëve.

Çështja kyçe që ngrihet në rastet që kanë të bëjnë me rrëmbimin është nëse ekziston një ekuilibër i drejtë midis interesave konkurruese në rrezik siç janë interesat

---

116 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

117 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, § 121 deri në 122, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

118 *Iglesias Gil dhe A.U.I. k. Spanjës*, vendim i 29 prillit 2003, nr. 56673/00, § 51; *Ignaccolo-Zenide k. Rumanisë*, vendim i 25 janarit 2000, nr. 31679/96, § 95.

119 *Maire k. Portugalisë*, vendim i 26 qershorit 2003, nr. 48206/99, § 72.

120 *Sneerson dhe Kampanella k. Italisë*, vendim i 12 korrikut 2011, nr. 14737/09, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

121 [www.hcch.net](http://www.hcch.net).

e fëmijës, të prindërve dhe të rendit publik,<sup>122</sup> ku interesi më i lartë i fëmijës duhet prevalojë. Tek *X k. Letonisë*,<sup>123</sup> Gjykata shkoi më tej dhe konstatoi se ekziston një konsensus i gjerë - përfshi këtu edhe në të drejtën ndërkombëtare - në mbështetje të idesë se të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, duhet të prevalojë interesi më i lartë i tyre.<sup>124</sup> Gjykata konsideroi se, në mungesë të çfarëdo rrethanash të cilat mund të përjashtonin gjykatat vendase nga detyra për të respektuar në mënyrë strikte afatin, sipas Konventës të Hagës, nuk ishim në kushte pajtueshmërie me detyrimin pozitiv për të vepruar me shpejtësi në proceset lidhur me kthimin e fëmijëve.

Gjykata ka dhënë një shpjegim veçanërisht të vlefshëm në dy raste të shqyrtuara prej saj. Rasti i parë, *Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*,<sup>125</sup> ka të bëjë me një situatë ku një fëmijë u mor nga nëna e tij nga Izraeli në Zvicër, pasi ajo kishte frikë se babai i tij do ta çonte fëmijën në një kamp për indoktrinimin fetar. Gjykata deklaroi se nuk ishte e bindur se kthimi i fëmijës në Izrael do të ishte në interesin e tij më të lartë. Për sa i takon nënës, nëse ajo do të detyrohej për t'u kthyer në Izrael kjo mund të përbente një ndërhyrje jo proporcionale në të drejtën e saj për respektimin e jetës familjare. Rrjedhimisht, do të kishte pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me të dy kërkuesit nëse vendimi që urdhëronte kthimin e kërkuesit të dytë në Izrael do të ishte ekzekutuar. Për këto arsye Gjykata konstatoi shkelje me kusht të nenit 8 – e cila do të konsiderohej e tillë vetëm nëse autoritetet zvicerane do të ekzekutonin vendimin për kthimin e fëmijës. Faktet u shqyrtuan përmes prizmit të interesit më të lartë të fëmijën.

Në rastin e dytë, *Oller Kaminska k. Polonisë*<sup>126</sup>, Gjykata konfirmoi nevojën për njohjen dhe ekzekutimin e shpejtë lidhur me vendimin e rrëmbimit të fëmijës dhe vendimin e kujdestarisë. Kjo çështje ka të bëjë me një kërkesë të parashtruar nga një shtetase polake, e cila pretendonte se i ishin shkelur e drejta e saj për një jetë të qetë familjare, për shkak të pamundësisë së autoriteteve polake për ta bashkuar atë me vajzën e saj, pavarësisht lëshimit të një sërë urdhrash kthimi. Shteti Polak nuk kishte vepruar menjëherë, dhe Gjykata shqyrtoi nëse kjo përbente shkelje të të drejtave të nenit 8. Gjykimi i tej zgjatur lidhur me rrëmbimin e fëmijës krijoi një vakum të kërkesave, urdhrave dhe apelimeve konkurruese, si në Poloni ashtu dhe në Irlandë.

122 *Maumousseau dhe Washington k. Francës*, vendim i 06 dhjetorit 2007, nr. 39388/05; *Rouiller k. Zvicrës*, vendim i 22 korrikut 2014, nr. 3592/08.

123 *X k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 26 nëntorit 2013, nr. 27853/09, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

124 *X k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 26 nëntorit 2013, nr. 27853/09, § 96, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

125 *Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 6 korrikut 2010, nr. 41615/07, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

126 *Oller Kaminska k. Polonisë*, vendim i 18 janarit 2018, nr. 28481/12, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

Gjykata vuri në dukje se nëna e fëmijës kishte iniciuar procese duke u bazuar në Konventën e Hagës, se ajo kishte kërkuar të ekzekutoheshin urdhrat e gjykatës irlandeze, se kishte mbajtur kontakt të vazhdueshëm me autoritetet qendrore irlandeze dhe polake dhe se ajo kishte kërkuar vazhdimisht që proceset të përshpejtoheshin dhe të apelohej aty ku kërkohej. Gjykata riafirmoi se normat e përcaktuara në “Bruksel II bis” dhe në Konventën e Hagës bazohen në filozofinë se në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, duhet të prevalojë interesi më i lartë i tyre. Në lidhje me rastin nëse autoritetet shtetërore kishin marrë të gjitha masat e arsyeshme që pritej të merreshim në mënyrë që të siguronin njohjen e të drejtave familjare, Gjykata arriti në përfundimin se Polonia i kishte përmbushur detyrimet e saj në kuadër të Konventës. Gjatë periudhës së tej zgjatur të proceseve, nëna nuk kishte pasur kontakt me fëmijën. Ndonëse njëhej kompleksiteti i kësaj çështje, Gjykata nuk u kënaq nga prapësimet e bëra nga shteti se tej zgjatja e procesit kishte ardhur si pasojë e kompleksitetit të rastit.

## **(f) Zhvendosja**

Zakonisht, rastet e zhvendosjes janë mosmarrëveshje që lidhen me faktin nëse një prind apo kujdestar duhet të lejohet të marrë fëmijën e tij/saj për të jetuar në një vend të ri si banesa e tij apo e saj kryesore. “Zhvendosja e fëmijëve” i referohet ndryshimit të vendbanimit të fëmijës. Këto mosmarrëveshje janë ndër më të tensionuarat, të cilat përbëjnë rrezik të lartë për të dyja palët dhe lënë pak hapësira për kompromis.

Deklarata e Uashingtonit e vitit 2010 mbi Zhvendosjen Ndërkombëtare të Familjes ka qenë produkt i diskutimeve për të harmonizuar ligjin ndërkombëtar të zhvendosjes, i cili përbën një dokument paraprak dhe përmban një sërë faktorësh që duhet të merren në shqyrtim për një aplikim për zhvendosje. Kohët e fundit, Këshilli i Evropës ka publikuar Rekomandimin 2015 (4), i cili vlen për situata ku ka ose mund të ketë mosmarrëveshje për zhvendosjen e një fëmijë, si brenda juridiksionit të një shteti anëtar<sup>127</sup>ashtu edhe jashtë tij. Ky rekomandim zbatohet në veçanti për situatat ku, si rezultat i zhvendosjes së tij ose të saj, një fëmijë do rrezikonte të humbiste lidhjet ose se ndërprerja e marrëdhënies do të ishte e tillë, e cila do të ndikonte në humbjen e lidhjeve me një nga prindërit e tij ose personat e tjerë që iu ishte dhënë përgjegjësia prindërore.

Ajo përcakton tre parime të përgjithshme duke nënvizuar se ligjet kombëtare duhet të:

---

127 Në varësi të parimit 7, shiko Rekomandimin 2015 (4) për informacion të mëtejshëm.

- (a) ofrojnë siguri të mjaftueshme për të parandaluar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet e zhvendosjes;
- (b) sigurojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të kënaqshme; dhe
- (c) inkurajojnë zgjidhjen e rasteve me marrëveshje.<sup>128</sup>

Zhvendosja e fëmijës mund të përfshijë një ndryshim të detyruar në gjuhën e folur, praktikimin e fesë ose ndryshimin e rrethit të miqve dhe marrëdhënieve të ngushta me ta. Të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë në mirëqenien fizike dhe psikologjike të fëmijës, të mbrojtur sipas nenit 8. Deri më sot, Gjykata nuk ka shpallur si të pranueshme ndonjë kërkesë mbi refuzimin e zhvendosjes ose lejen për t'u zhvendosur me kërkesën e një prindi. Megjithatë, ajo ka trajtuar ndikimin që ka zhvendosja tek fëmijët e prekur në kontekste të tjera, kryesisht në lidhje me zhvendosjen e detyruar nga ana e shtetit në rastet e emigracionit dhe dëbimit si dhe rastet e dëbimit konstruktiv dhe zbatimit të parimit të "moshës së përshtatshme".<sup>129</sup>

Gjykata ka shqyrtuar ndikimin që ka njohja e dokumentacionit për rastet e fëmijëve të cilët kanë ardhur në jetë nga një marrëveshje me lindje surrugato e njohur me vendim gjyqësor jashtë shtetit, ku prindërit socio-ligjorë i zhvendosin ata në vendin e tyre dhe kërkojnë ti regjistrojnë sipas shtetësisë së tyre. Gjykata vendosi se neni 8 gjente zbatim në aspektin e jetës familjare si tek *Mennesson k. Francës*<sup>130</sup> dhe tek *Labassée k. Francës*<sup>131</sup>, sepse prindërit që ishin pretendentë ligjorë vepronin si prindër të fëmijëve që nga lindja e tyre dhe jetonin së bashku në një mënyrë që bie në kuptimin e jetës familjare.<sup>132</sup> Ka pasur një lidhje të drejtpërdrejtë, mes jetës private të fëmijëve të lindur me marrëveshje "surrogacie" dhe njohjes së tyre me ligj. Duke qenë se në rrezik ishte dhe identiteti i individit dhe si pjesë thelbësore e tij, neni 8 gjente zbatim edhe në aspektin e respektimit të jetës së tij private.<sup>133</sup>

---

128 Rekomandimi CM/Rec (2014) i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare në parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi zhvendosjen e fëmijës, miratuar nga Komiteti i Ministrave në 11 shkurt 2015 në takimin e 1219 të zëvendësministrave.

129 Shiko p.sh. *Jeunesse k. Holandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 3 tetorit 2014, nr. 12738/10; *Biao k. Danimarkës*, vendim i Dhomës së Madhe i 24 majit 2016, nr. 38590/10.

130 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

131 *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11.

132 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, § 45, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11, § 37.

133 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, § 46, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11, § 38.

Mosnjohja ligjërisht e fëmijëve të lindur nga nëna surrugato, ka për qëllim dekrualimin e shtetasve francezë për kryerjen e teknikave riprodhuese jashtë Francës, pasi kjo ishte e ndaluar në vend. Qëllimi i pretenduar ishte mbrojtja e fëmijëve dhe nënës surrugato.<sup>134</sup> Gjykata konstatoi se Franca kishte një hapësirë të gjerë vlerësimi, sepse në sferën e vendimeve në lidhje me marrëveshjen surrugato nuk kishte konsensus evropian dhe për shkak të përfshirjes së çështjeve etike. Nga ana tjetër, hapësira e vlerësimit ishte e ngushtë për shkak se kishte të bënte me prindin, një aspekt kyç i ekzistencës ose identitetit të një personi.<sup>135</sup>

Në lidhje me të drejtën për respektimin e jetës private të fëmijëve, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8. Këta të fundit u ballafaquan me pasiguri ligjore për shkak të mosnjohjes sipas rendit ligjor francez të lidhjes *de facto* midis tyre dhe prindërve socialë/pretendentë ligjorë. Kjo kontradiktë mes realitetit ligjor dhe atij social dëmtoi rëndë identitetin e fëmijëve brenda shoqërisë franceze. Rrjedhimisht, ishte e paqartë nëse fëmijët do të merrnin shtetësinë franceze.<sup>136</sup> Përveç kësaj, mosnjohja kishte pasoja negative lidhur me të drejtat e trashëgimisë për fëmijët. Në përfundim, Gjykata konstatoi se mohimi i njohjes së realitetit biologjik përmes ligjit, (babai që pretendonte atësinë ligjore ishte babai i tyre gjenetik), ishte kundër interesave më të larta të fëmijëve.<sup>137</sup> (Siç u tha më sipër, çështja e njohjes ligjore të nënës është aktualisht në pritje përpara Dhomës së Madhe në rastin e parë të ngritur në kuadër të Protokollit 16.)

Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private është duke zbatuar aktualisht një projekt që synon të përgatisë një instrument që do të adresojë njohjen e prindërve në një hapësirë ndërkufitare.

## **(g) Trafikimi dhe puna e fëmijëve**

Neni 4 ndalon shprehimisht skllavërinë, robërinë, punën e detyruar ose me dhunë. Është një ndalim absolut. Gjithashtu, trafikimi i qenieve njerëzore bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 4 dhe është pa dyshim një fenomen që bie ndesh me frymën

---

134 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, § 62, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11, § 54.

135 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, § 77-80, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11, § 56-59.

136 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, § 96-97, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11, § 75-76.

137 *Menesson k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65192/11, § 99, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Labassée k. Francës*, vendim i 26 qershorit 2014, nr. 65941/11, § 78.

dhe qëllimin e kësaj dispozite ku një rast i rëndësishëm për trafikim është ai i *Rantsev k. Qipros dhe Ruisë*,<sup>138</sup>, megjithëse nuk përfshin fëmijët.

**Skllavëria** është statusi ose gjendja e një personi mbi të cilin ushtrohet ndonjë ose të gjitha tagrat që lidhen me të drejtën e pronësisë.<sup>139</sup>

**Robëria** është një formë veçanërisht e rëndë e mohimit të lirisë. Ajo përfshin detyrimin për t'i shërbyer dikujt nën efektin e shtrëngimit, e cila duhet të lidhet me konceptin e "skllavërisë". Përveç detyrimit për të kryer shërbime për të tjerët, nocioni i robërisë përfshin detyrimin që ka "robi" për të jetuar në pronën e një personi tjetër dhe pamundësinë për të ndryshuar gjendjen në të cilën ai ose ajo ndodhet.<sup>140</sup> Robëria konsiston në kryerjen e një pune të detyruar ose me dhunë, ku faktori dallues është ndjenja e viktimave se gjendja e tyre është e përhershme dhe situata e tyre nuk mund të ndryshojë. Mjafton që kjo ndjenjë të mbështetet në kriteret objektive të sipërpërmendura, ose të jetë e nxitur ose të mbahej e gjallë nga personat përgjegjës për situatën e viktimës.

**Puna me dhunë ose e detyruar** do të thotë "punë ose shërbim që kërkohet nga çdo person nën kërcënimin e çdo ndëshkimi, kundër vullnetit të personit në fjalë dhe për të cilin personi nuk është ofruar vullnetarisht".<sup>141</sup>

**Trafikimi** është përkufizuar nga Gjykata në rastin *Rantsev k. Qipros dhe Ruisë* si trajtimi i qenieve njerëzore si mallra, me mbikëqyrje nga afër, kufizime të lëvizjes, përdorimi i dhunës dhe kërcënimeve, kushteve të këqija të jetesës dhe punës, dhe dhënia e një pagese të ulët ose mosdhënia e asnjë pagese.<sup>142</sup> Përderisa nuk ka një referencë të shprehur lidhur me trafikimin në KEDNJ, në vlerësimin e fushëveprimit të nenit 4, Gjykata ka theksuar se duhet të kihet parasysh që KEDNJ është një instrument jetësor e cila duhet interpretuar në bazë të kushteve aktuale. Gjykata ka vërejtur se, trafikimi i qenieve njerëzore është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Konkluzionet e Protokollit të Palermos në vitin 2000 dhe Konventa Kundër Trafikimit në vitin 2005 paraqesin njohjen në rritje në nivel ndërkombëtar të përhapjes së trafikimit dhe nevojës për marrjen e masave për ta luftuar atë.<sup>143</sup>

---

<sup>138</sup> *Rantsev k. Qipros dhe Ruisë*, vendim i 07 janarit 2010, nr. 25965/04, §§ 279 deri në 282, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>139</sup> *Siliadin k. Francës*, vendim i 26 korrikut 2005, nr. 73316/01, § 122.

<sup>140</sup> *C.N. dhe V. k. Francës*, vendim i 11 tetorit 2012, nr. 67724/09, §§ 89 deri në 90; *Siliadin k. Francës*, vendim i 26 korrikut 2005, nr. 73316/01, § 123.

<sup>141</sup> *C.N. dhe V. k. Francës*, vendim i 11 tetorit 2012, nr. 67724/09, § 71.

<sup>142</sup> *Rantsev k. Qipros dhe Ruisë*, vendim i 07 janarit 2010, nr. 25965/04, §§ 279 deri në 282, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>143</sup> Gjithashtu, BE-ja ka vendosur një kuadër ligjor dhe politik gjithëpërfshirës dhe të fokusuar tek viktimat, Direktiva



Neni 4 parashikon detyrime pozitive që lindin sipas neneve 2 dhe 3 (siç janë përcaktuar në pjesët e mësipërme), si dhe në vijim:<sup>144</sup>

- (a) Shtetet duhet të marrin masat e duhura për të parandaluar që bizneset të përdoren si një maskim për trafikimin;
- (b) Shtetet duhet të sigurojnë që rregullat e emigracionit nuk mund të nënvlerësohen në një mënyrë të tillë që të inkurajojnë, lehtësojnë ose tolerojnë trafikimin;
- (c) Shtetet duhet të vendosin një kuadër legjislativ dhe administrativ për të ndaluar dhe dënua trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat;
- (d) Konventa Kundër Trafikimit kërkon në mënyrë eksplicite që secili shtet anëtar të ketë juridiksion lidhur me veprat penale të trafikimit që ndodhin në territorin e tij;
- (e) Shtetet duhet të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me autoritetet përkatëse të shteteve të tjera në hetimin e veprimtarive ndërkufitare të trafikimit. Kjo detyrë është në përputhje me objektivat e shteteve anëtare, siç shprehet në preambulën e Protokollit të Palermos, për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse ndërkombëtare për trafikimin nga vendet e origjinës, transitit dhe destinacionit.

## (h) Vlerësimi i moshës dhe procedurat e verifikimit

Vlerësimi i moshës në proceset e kërkesave për azil i referohet procedurave përmes të cilave autoritetet kërkojnë të përcaktojnë probabilitetin e moshës së një personi që pretendon se është fëmijë, në mënyrë që të përcaktohet se cilat janë procedurat e emigracionit që duhet të ndiqen.

Vlerësimi i moshës është një hap paraprak për marrjen në shqyrtim të kërkesës për azil. Kjo ndodh pasi një sërë masash mbrojtëse procedurale i bashkëngjiten kërkesave për azil të paraqitura nga fëmijët<sup>145</sup> të cilët duhet të prezumohen si të tillë edhe pse fillimisht rasti i tyre nuk është provuar. Është e thelbësore që procedura të tilla të përfundojnë shpejt me qëllim që ata që e kanë paraqitur kërkesën për azil si fëmijë, por nuk janë trajtuar si të tillë, nuk mund ta përfundojnë atë në rast se kalojnë në moshë madhore në kohën që vlerësimi i moshës ka përfunduar.<sup>146</sup>

---

2011/36/KE për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj.

<sup>144</sup> *Siliadin k. Francës*, vendim i 26 korrikut 2005, nr. 73316/01; *C.N. dhe V. k. Francës*, vendim i 11 tetorit 2012, nr. 67724/09; *Rantsev k. Qipros dhe Rusisë*, vendim i 07 janarit 2010, nr. 25965/04, § 288, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>145</sup> *Mahamed Jama k. Maltës*, 26 nëntor 2015, nr. 10290/13, § 150.

<sup>146</sup> Shiko <https://rm.coe.int/age-assessment-council-of-europe-member-states-policies-procedures-and/168074b723>

Gjykata nuk ka dhënë ende një udhëzim lidhur me kriteret e një procesi për vlerësimin e moshës në përputhje me standardet e KEDNJ-së, edhe pse rastet janë komunikuar aktualisht, të tilla si *Darboe dhe Camara k. Italisë*.<sup>147</sup>

Nuk ekziston asnjë mënyrë e sigurt për vlerësimin dhe përcaktimin e moshës. Një sërë metodash që përdoren për të bërë vlerësimin e moshës janë të dëmshme dhe mund të shkaktojnë dëme fizike ose mendore për personat që ju nënshtrohen atyre. UNHCR-ja ka rekomanduar shtetet për të treguar kujdes në rastet e vlerësimeve të moshës në kontekstin e azilit. Para Komitetit të UNCRC-së janë në pritje më shumë se 20 raste shkeljesh, të cilat kanë të bëjnë me procedurat për vlerësimin e moshës.

Udhëzimet e UNHCR-së për Mbrojtjen Ndërkombëtare: Kërkesat për Azil për Fëmijët sipas neneve 1 (A) (2) dhe 1 (F) të Konventës për Refugjatët të 1951 dhe/ose të Protokolli të 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve, § 75, theksojnë se është e rëndësishme që vlerësimet e moshës të jenë kryer në një mënyrë të sigurt, të kujdesshme për shkak të ndjeshmërisë ndaj fëmijës dhe gjinisë së tij/saj, dhe respektimi i duhur i dinjitetit njerëzor.

Hapësira e vlerësimit lidhur me të gjitha metodat e vlerësimit të moshës duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që në rast pasigurie, individi do të konsiderohet fëmijë. Duke qenë se moshja nuk llogaritet njëjloj në mënyrë universale ose duke pasur parasysh rëndësinë e njëjtë që ka, duhet të tregohet kujdes në marrjen e vendimeve të pafavorshme mbi besueshmërinë, ku standardet e kulturës vendase mund të ulin ose të rrisin moshën e fëmijës. Fëmijëve duhet t'u jepet informacion i qartë lidhur me qëllimin dhe procesin e procedurës së vlerësimit të moshës në një gjuhë që ata e kuptojnë. Më e rëndësishmja, para se të kryhet një procedurë për vlerësimin e moshës, duhet të caktohet një kujdestar i pavarur, i kualifikuar për të këshilluar fëmijën dhe këshillat duhet të jepen në praktikë.

Pasojat, e konstatimit të gabuar të moshës së një fëmije si i rritur, janë të rënda. Në këtë rast gjejmë zbatim nënet 3 dhe 8 të Konventës. Fëmijës do t'i mohohen të drejtat materiale dhe procedurale, të cila iu njihen si të drejta sipas ligjit ndërkombëtar dhe evropian, si dhe humbasin përfitimet e duhura sociale. Kjo mund të ndikojë në vendimin e kërkesës për azil të fëmijës. Një rrezik i qartë dhe i rëndë është vendosja në një strehim të papërshtatshëm të fëmijëve me persona të rritur me të cilët nuk kanë lidhje. Kjo mund t'i ekspozojë ata ndaj rrezikut për t'u abuzuar, si dhe në rrezikun të trafikimit (shih seksionin e mësipërm).

---

<sup>147</sup> *Darboe dhe Camara k. Italisë*, kërkesa nr. 5797/17, e komunikuar më 14 shkurt 2017.

Në kontekstin e procedurave të verifikimit për gjetjen e lidhjeve familjare, fëmijët që kërkojnë leje të nisin këto procese mund të kenë barrën e provës për të vërtetuar marrëdhëniet e pretenduara me personat që tashmë janë në atë vend. Për parashkrimin e pretendimeve duhet t'u jepet një mundësi e drejtë dhe për këtë kërkohej që të ekzistojë mirëbesimi nga ana e Shtetit.

Tek *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Maltës*,<sup>148</sup> ankesa e fëmijës kërkuar kishte të bënte me faktin se ata ishin të ndaluar pavarësisht pretendimit se ishin të mitur. Më pas kërkesa e tyre u gjet e bazuar. Gjykata përsëriti se në kontekstin e emigracionit duhet bërë një shqyrtim mjaft i kujdesshëm lidhur me domosdoshmërinë e ndalimit të fëmijëve. Në Maltë, ishte mjaft pozitiv fakti se kur një individ i ndaluar konstatohet të ishte fëmijë ai nuk arrestohej por vendosej në një qendër kujdesi.

Megjithatë, në lidhje me mirëbesimin e shtetit mund të ngrihej çështja kur vlerësimi për përcaktimin e moshës e tejkalon afatin e arsyeshëm. Tejkalimi i afatit mund të ndikojë në krijimin e një pritshmërie nga ana e fëmijës deri në marrjen e vendimit zyrtar.<sup>149</sup>

Tek *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Maltës*, Gjykata vlerësoi se pavarësisht faktit se rastet “kufitare” mund të kërkojnë vlerësim të mëtejshëm dhe faktit se një numër i madh personash që kalonin kufijtë në vit nuk ishin fëmijë, gjithsesi kjo nuk mund të justifikonte kohëzgjatjen e procesit për më shumë se shtatë muaj për të vendosur mbi pretendimet e kërkuar. Shteti nuk kishte dhënë shpjegime se pse ishte e nevojshme që kërkuar i parë duhej të priste pesë muaj për të bërë testin dhe tjetri për dy muaj e gjysmë për një vendim të tillë, dhe më tej pushimin e efekteve të urdhrit.<sup>150</sup>

Madje duke pranuar se ndalimi ishte ngushtësisht i lidhur me qëllimin e ndalimit për shkak të hyrjes së paautorizuar, në praktikë, për t'u lejuar që të bëhej një kërkesë për azil duke e lidhur me vlerësimin e moshës, vonesat, veçanërisht ato pas përcaktimit të moshës së fëmijës, ngrinin dyshime serioze në mirëbesimin e autoriteteve. Situata u bë edhe më e rëndë nisur nga fakti se kërkuar nuk kishin ndonjë garanci procedurale, si dhe faktin se në asnjë fazë të procesit nuk pati konstatime nga ana e autoriteteve nëse vendosja në qendrën e ndalimit të fëmijëve emigrantë ishte masa e fundit dhe nuk kishte alternativa të tjera në dispozicion.<sup>151</sup>

---

148 *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Maltës*, vendim i 22 nëntorit 2016, nr. 25794/13 28151/13.

149 *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Malta*, vendim i 22 nëntorit 2016, nr. 25794/13 28151/13, § 145.

150 *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Maltës*, vendim i 22 nëntorit 2016, nr. 25794/13 28151/13, § 145.

151 *Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k. Maltës*, vendim i 22 nëntorit 2016, nr. 25794/13 28151/13, § 145 deri në 148.

## (7) E DREJTA PËR ARSIM

Neni 2 i Protokollit nr. 1, garanton të drejtën për arsim. Arsimi është një koncept i gjerë. Arsimi fillestar në veçanti, luan një rol mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës. Neni 2 i Protokollit nr. 1 nuk përcakton asnjë standard të veçantë për arsimin.

Një çështje që ngrihet zakonisht është paragjykimi i fëmijëve që i përkasin pakicave etnike. Dhoma e Madhe ka shqyrtuar të drejtën për arsim, marrë së bashku me nenin 14, ndalimi i diskriminimit, tek rasti i *Oršuš k. Kroacisë*.<sup>152</sup> Ky rast ka të bëjë me fëmijët romë që pretendonin se gjatë arsimit të tyre fillor ata ishin caktuar në klasa që përbëheshin vetëm me persona që i përkisnin komunitetit rom, çka shkelte të drejtën e tyre për t'u arsimuar dhe të drejtën e tyre për të mos u diskriminuar.

Dhoma e Madhe konstatoi si më poshtë vijon:

- (a) Që e drejta për arsimim të jetë efektive, individi që është përfitues duhet të ketë mundësinë të përfitojë nga arsimi i marrë, domethënë, e drejta për të marrë në përputhje me rregullat në fuqi në secilin shtet dhe në një formë ose një tjetër, t'i njihen zyrtarisht studimet që ai ka përfunduar;
- (b) Romët janë një nga grupet e veçanta të pakicave të pa avantazhuara dhe kërkojnë mbrojtje të veçantë. Kërkesit ishin fëmijë për të cilët e drejta për arsim ishte mjaft e rëndësishme.
- (c) Pozita vulnerabël e romëve/egjiptianëve do të thotë se këtyre grupeve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë lidhur me nevojat e tyre dhe mënyrën e ndryshme të jetesës së tyre si në miratimin e kuadrit rregullator përkatës ashtu edhe në marrjen e vendimeve për raste specifike;
- (d) Marrëveshjet e shkollimit për fëmijët romë nuk ishin mjaftueshëm të mbështetur me masa mbrojtëse që do të siguronin se, në ushtrimin e hapësirës së vlerësimit të shtetit në fushën e arsimit, shteti kishte në vëmendje të veçantë nevojat e tyre specifike si anëtarë të një grupi të pa avantazhuar. Si rezultat i marrëveshjeve, kërkesit u vendosën në klasa të veçanta në të cilat u ndoq një kurrikulum i përshtatur, pavarësisht se përmbajtja e tij e saktë mbeti e paqartë.
- (e) Për shkak të mungesës së transparencës dhe mungesës së kritereve të qarta për transferim, kërkesit u vendosën në klasa që kishin vetëm fëmijë romë për periudha të konsiderueshme kohore, ndonjëherë edhe gjatë gjithë arsimit fillor.
- (f) Nuk u morën masat e duhura mbrojtëse, me qëllim garantimin e proporcionalitetit mes mjeteve të përdorura dhe arritjes dhe realizimit të qëllimit legjitim

---

<sup>152</sup> *Oršuš dhe Të Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 16 marsit 2010, nr. 15766/03, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

që thuhej se ishte ndjekur. Vendosja e kërkuesve në klasat vetëm me romë në kohën e arsimit fillor nuk përbënte justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

## (8) KËRKUESIT QË JANË FËMIJË

Neni 34 i KEDNJ, përcakton se kush legjitimohet për të paraqitur kërkesë: ata që kanë “statusin e viktimës”. Fëmijët, mund të parashtrojnë një kërkesë lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre sipas KEDNJ-së nëpërmjet një përfaqësuesi të përshtatshëm.

Gjithashtu, prindërit mund të paraqesin kërkesa në emër të fëmijëve të tyre. Nëse një prind biologjik ka tagër për të vepruar në emër të fëmijës së tij apo saj, varet nëse pala që kundërshton prindin biologjik, dhe ka të drejtë ta përfaqësojë fëmijën sipas ligjit të brendshëm, dhe mund të konsiderohet se mbron në mënyrë efektive të drejtat e fëmijës sipas KEDNJ-së.<sup>153</sup>

Ekziston një rrezik në rastet kur mes prindërve ka konflikte pasi disa nga interesat e fëmijës nuk mund të sillen kurrë në vëmendjen e Gjykatës, duke i privuar kështu mbrojtjen efektive të fëmijës. Edhe pse një prindi i është mohuar përgjegjësia prindërore, fakti i të qenit prind biologjik është i mjaftueshëm për t'i dhënë atij ose asaj tagrin e nevojshëm për të paraqitur kërkesë në Gjykatë në emër të fëmijës si dhe, për të mbrojtur interesat e tij/saj.<sup>154</sup>

Gjykata ka dalë në një përfundim tjetër lidhur me mosmarrëveshjet midis një nëne që ka kujdestarinë dhe babait biologjik të fëmijës mbi të drejtën e këtij të fundit për t'u takuar me fëmijën. Në rastet që ka mosmarrëveshje midis prindërve, prindi që ka të drejtën e kujdestarisë është ai të cilit i është besuar mbrojtja e interesave më të larta të fëmijës. Në situata të tilla, pozita si prind biologjik nuk mund të jetë një arsye e mjaftueshme për të sjellë një kërkesë në emër të një fëmije.<sup>155</sup>

---

<sup>153</sup> *Eberhard dhe M. k. Sllovenisë*, 1 dhjetor 2009, nr. 8673/05 9733/05, § 86, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>154</sup> *Scozzari dhe Giunta k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 korrikut 2000, nr. 39221/98 41963/98, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Eberhard dhe M. k. Sllovenisë*, 1 dhjetor 2009, nr. 8673/05 9733/05, § 87, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

<sup>155</sup> *K.B. dhe Tjerët k. Kroacisë*, vendim i 14 marsit 2017, nr. 36216/13, § 109, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim); *Eberhard dhe M. k. Sllovenisë*, 1 dhjetor 2009, nr. 8673/05 9733/05, §88, (e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

## (9) KONKLUZIONE

Në të gjitha vendet e botës, duke përfshirë edhe Evropën sot, ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira. Ata janë duke u rritur pa kujdes dhe ndihmë, pa atmosferën e lumturisë, dashurisë dhe mirëkuptimit dhe pa gëzuar paqen, dinjitetin dhe lirinë të cilat duhet të konsiderohen të mirëqena për të gjithë fëmijët. Është e domosdoshme që Shteti të mbrojë të drejtat e atyre që janë më vulnerabël në shoqërinë tonë: pasi ata nuk mund ta mbrojnë veten.

Hyrja e mësipërme e ka vënë theksin në disa nga çështjet më kyçe lidhur me detyrimin e shtetit për të mbrojtur fëmijët, duke filluar nga e drejta për respektimin e jetës familjare, respektimin e të drejtave të fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale dhe të drejtën për arsim. Fokusi ka qenë i bazuar në veçanti në fushat relevante për vendet e Ballkanit Perëndimor. Një përzgjedhje e përmbledhjeve të rasteve nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të vijojë për të ilustruar dhe përpunuar më tej çështjet e diskutuara në këtë hyrje.

## Përmbledhje vendimesh

*Autoritetet kroate nuk arritën të mbronin kërkuesen kundër dhunës në familje nga ish-bashkëshorti që kishte probleme të shëndetit mendor*

### **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN A. k. KROACISË**

(Kërkesa nr. 55164/08)

**14 tetor 2010**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja A, shtetase kroate e lindur në vitin 1979, në kohën e gjykimit të rastit të saj në Gjykatën Evropiane jetonte në Z., duke u fshehur nga ish-bashkëshorti i saj B. Në vitin 2001 ata patën një vajzë, dhe në nëntor të 2006 i dhanë fund martesës së tyre.

Referuar dy raporteve psikiatrike të dhjetorit 2004 dhe janarit 2008, B., i cili u kap gjatë Luftës Kombëtare të vitit 1992 dhe u dërgua në një kamp përqendrimi ku u torturua dhe pësoi çrregullime të rënda të shëndetit mendor. Raportet theksonin tendencën e tij si person i dhunshëm dhe sjelljen impulsive, duke rekomanduar nevojën e tij për trajtim të detyrueshëm psikiatrik.

Midis nëntorit 2003 dhe qershorit 2006, ish-bashkëshorti i kërkueses ushtroi dhunë të përsëritur ndaj saj. Dhuna ishte si verbale, përfshi këtu kërcënime serioze me vdekje dhe lëndime fizike. B., e ka dhunuar shpesh kërkuesen përpara vajzës së tyre, dhe në disa raste ka ushtruar dhunë dhe ndaj asaj. Midis 2004 dhe 2009 në gjykatat vendase janë iniciuar një sërë procesesh të ndara kundër B (tri grupe procesesh penale dhe katër grupe procesesh për kundërvajtje), në kuadër të së cilave ato urdhëruan një sërë masash mbrojtëse, të tilla si periudha e paraburgimit, trajtim psikiatrik ose psiko-social, urdhra mbrojtje dhe madje edhe një mandat ndalimi. Disa masa mbrojtëse u vunë në zbatim, të tilla si paraburgimi ndërkohë që të tjerat si rasti i burgimit nuk u ekzekutua pasi burgu nuk kishte kapacitete. B. nuk ju nënshtrua trajtimit psiko-social të dhënë gjatë proceseve të fundit për shkak të mungesës së individëve ose agjencive të kualifikuara në këtë fushë.

B. u arrestua në shtator të 2009, dhe gjatë periudhës së gjykimit të rastit në Gjykatën Evropiane ai vijonte të ishte ende në burgim, duke ndjekur dënimin e tij në tetor 2009 dhe dënimin me tre vjet burgim për kërcënimet me vdekje të bëra ndaj një gjyqtareje (dhe vajzës së saj të vogël) u përfshi në një nga proceset penale kundër tij për dhunë në familje. Nuk dihej se ku po mbahej z. B apo nëse ishte duke u trajtuar në ndonjë qendër të trajtimit psikiatrik.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja ankohej se autoritetet nuk kishin mundur ta mbronin atë në mënyrë adekuate nga dhuna në familje. Ajo e mbështeste kërkesën e saj në nenet 2, 3, 8 dhe 13. Gjithashtu ajo ankohej se ligjet përkatëse në Kroaci në lidhje me dhunën në familje ishin diskriminuese, çka përbëntë shkelje të nenit 14.

### Neni 8

Fillimisht, Gjykata gjeti se kërkuesja do të kishte qenë më e mbrojtur efektivisht nga dhuna e ish-bashkëshortit të saj nëse autoritetet do të kishin pasur një pasqyrë të situatës në tërësi, sesa proceset e shumta të ndara në grupe.

Edhe pse gjykatat kishin urdhëruar masa mbrojtëse, shumë prej tyre (të tilla si periudhat e paraburgimit, gjobat, trajtimi psiko-social dhe madje edhe burgimi) nuk ishin zbatuar, duke minuar kështu qëllimin me efekt parandalues të sanksioneve të tilla. Në të vërtetë, rekomandimet për trajtimin e vazhdueshëm psikiatrik, të bëra shumë herët, janë përmbushur deri në tetor të vitit 2009 dhe më pas vetëm në kontekstin e proceseve penale që nuk lidhen me dhunën kundër kërkueses. Përveç kësaj, ishte e paqartë nëse B. i ishte nënshtruar ndonjë trajtimi psikiatrik. Në të vërtetë, rekomandimet për trajtimin e vazhdueshëm psikiatrik, të bëra shumë herët, u përmbushën tepër vonë, vetëm në tetor të vitit 2009 dhe më pas vetëm në kontekstin e proceseve penale që nuk lidheshin me rastin e dhunës kundër kërkueses.

Për rrjedhojë, dështimi i autoriteteve për të zbatuar masat e dhëna nga Gjykata, duke synuar që nga njëra anë të adresonte gjendjen psikiatrike të B-së, për shkak të sjelljes së tij haptazi të dhunshme dhe, nga ana tjetër, t'i siguronte kërkueses mbrojtje kundër dhunës së mëtejshme, e kishte vendosur atë për një periudhë të gjatë kohore në një pozitë në të cilën ishte shkelur e drejta e saj për respektimin e jetës private, e cila derivonte në shkelje të nenit 8. Duke pasur parasysh këtë konstatim, Gjykata konsideroi se nuk u ngrit asnjë çështje e veçantë sipas neneve 2, 3 dhe 13.

### Neni 14

Gjykata gjeti se kërkuesi nuk kishte dhënë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se masat ose praktikat e miratuara në Kroaci kundër dhunës në familje ose efektet e këtyre masave ose praktikave ishin diskriminuese. Kërkesa e kërkuesit në lidhje me nenin 14 u shpall e papranueshme.



#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Kroacia duhej t'i paguante kërkuarit 9,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 4,470 euro në lidhje me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Mosdhënia e kujdesit të përshtatshëm mjekësor ose mbikëqyrja arsimore e një të mituri në një qendër të përkohshme ndalimi, përbënte shkelje të nenit 3 dhe 5, ndërsa marrja në pyetje dhe proceset përbënin shkelje të nenit 6*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BLOKHIN k. RUSISË**

(Kërkesa nr. 47152/06)

**23 mars 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Ivan Blokhin, ishte shtetas rus i lindur në vitin 1992 dhe banues në Novosibirsk (Rusi). Ai vuante nga çrregullimi hiperaktiv i deficitit të vëmendjes (ADHD) dhe urinimi i pavullnetshëm. Ai u diagnostikua në dhjetor 2004 dhe janar 2005, pasi u shqyrtua nga dy specialistë të cilët i caktonin ilaçe dhe konsulta të rregullta nga një neurolog dhe psikiatër.

Më 3 janar 2005 kërkuesi, i cili ishte 12 vjeç në atë kohë, u arrestua dhe u dërgua në një komisarjat policie. Atij nuk ia thanë arsyet e arrestimit të tij dhe kërkuesi pretendoi se ishte vënë në një qeli që nuk kishte dritare dhe ku dritat ishin të fikura. Ai deklaroi se kaloi një orë në errësirë, pas së cilës u mor në pyetje nga një oficer policie. Polici i tha atij se S. (fqinji 9 vjeçar i kërkuesit) e kishte akuzuar atë për grabitje. Sipas kërkuesit, oficeri i policisë e detyroi të rrëfehej, duke thënë se nëse ai do të bënte këtë, do të lirohej, por nëse refuzonte, ai do të futej në burg. Kërkuesi nënshkroi një deklaratë me rrëfimin e dhënë. Pasi kujdestari i kërkuesit, gjyshi i tij, u kontaktua dhe erdhi në komisarjatin e policisë, ai tërhoqi rrëfimin e tij.

Duke u bazuar në rrëfimin e kërkuesit së bashku me deklaratat e fqinjtit 9 vjeçar dhe nënës së tij, prokuroria gjeti që veprimet e tij përmbanin elementë të veprës penale të zhatjes. Megjithatë, meqënëse ai nuk kishte arritur moshën e përgjegjësisë penale, autoritetet refuzuan të hapnin procese penale. Më 21 shkurt 2005, Gjykata e Rrethit urdhëroi vendosjen e tij për 30 ditë në një qendër të përkohshme të ndalimit për të mitur, për të mos lejuar kryerjen e veprimeve të mëtejshme kriminale; ai u vendos në qendrën e ndalimit në po të njëjtën ditë me dhënien e vendimit. Pas një apeli të bërë nga gjyshi i kërkuesit, duke deklaruar se ndalimi ishte i jashtëligjshëm dhe i papajtueshëm me shëndetin e nipit të tij dhe se ai ishte kërcënuar dhe marrë në pyetje në mungesë të kujdestarit të tij, gjykata e rrethit anuloi urdhrin e masës me burg në mars 2005. Në maj të vitit 2006 e njëjta gjykatë, pas rishqyrtimit të çështjes, konstatoi se urdhri i mëparshëm i burgimit ishte i ligjshëm.

Pasi u lirua nga qendra e ndalimit më 23 mars 2005, kërkuesi u dërgua në një spital ku mori trajtim për urinimin e pavullnetshëm dhe ADHD deri më 21 prill 2005. Si pas kërkuesit, ai nuk mori kujdesin e duhur mjekësor gjatë kohës së tij në qendrën e ndalimit. Ai pretendonte se aksesin në tualete ishte i kufizuar dhe se ai duhej të duronte dhimbjen e fshikëzës dhe poshtërimin, pasi vuante nga urinimi i pavullnetshëm. Kërkuesi gjithashtu pohoi se ai dhe të miturit e tjerë të ndaluar në qendër, kalonin gjithë ditën në një dhomë të madhe të zbrazët, e cila nuk kishte mobilje. Ata u lejuan të dilnin në oborr vetëm dy herë gjatë qëndrimit 30 ditor të kërkuesit dhe u jepnin mësimet vetëm dy herë në javë për rreth tre orë, ku rreth 20 fëmijë të të gjitha moshave të ndryshme mësonin së bashku në një klasë.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u bazuar në nenin 3, kërkuesi u ankua se kushtet në qendrën e paraburgimit të përkohshëm ishin çnjerëzore dhe se ai nuk kishte marrë kujdesin e duhur mjekësor. Ai gjithashtu u ankua se ndalimi i tij ishte në kundërshtim me nenin 5 (e drejta për liri dhe siguri). Së fundmi, ai pohoi se procedurat lidhur me vendosjen e tij në qendrën e paraburgimit të përkohshëm ishin të padrejta dhe kishin shkelur nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt).

Më 14 nëntor 2013, një Dhomë e Gjykatës dha një vendim, me të cilin në mënyrë unanime konstatoi shkelje të nenit 3, 5 dhe 6. Rasti iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43, me kërkesë të Qeverisë.

### Neni 3

Gjykata përsëriti se, në mënyrë që trajtimi të hyjë në juridiksionin e nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë. Gjykata vuri në dukje se neni 3 imponon një detyrim ndaj Shtetit për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria, duke u ofruar atyre, ndër të tjera, kujdesin e kërkuar mjekësor. Megjithatë, vlerësimi nëse kujdesi mjekësor është i përshtatshëm është një nga elementët më të vështirë për të përcaktuar. Si rezultat, autoritetet duhet të sigurojnë që të mbahen shënime gjithëpërfshirëse lidhur me gjendjen shëndetësore të të ndaluarve dhe trajtimin e tyre gjatë kohës së paraburgimit. Shteti duhet të sigurojë që trajtimi mjekësor i ofruar në mjediset e burgut të jetë në një nivel të krahasueshëm me atë që Shteti i siguron publikut.

Në rastin e fëmijëve, shëndeti i të miturve të privuar nga liria duhet të ruhet sipas standardeve mjekësore të njohura për të miturit në komunitetin e gjerë. Autoritetet gjithmonë duhet të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës dhe duhet të

garantohet mbrojtja dhe kujdesi i duhur i fëmijës. Kjo përfshin një vlerësim mjekësor të gjendjes shëndetësore të fëmijës për të përcaktuar nëse ai/ajo duhet të vendoset në një qendër të paraburgimit për të mitur. Kur ngjarjet qëndrojnë në pjesën më të madhe brenda njohurive ekskluzive të autoriteteve, siç është rasti i personave nën kontrollin ose paraburgimin e tyre, do të lindin prezumime të forta të fakteve në lidhje me dëmtimet, lëndimet ose vdekjen, që kanë ndodhur gjatë paraburgimit. Barra e provës në raste të tilla qëndron tek autoritetet për të dhënë një shpjegim. Në mungesë të ndonjë shpjegimi të mjaftueshëm nga autoritetet, Gjykata mund të nxjerrë konkluzione jo të favorshme.

Në rastin në fjalë, Gjykata vuri në dukje në veçanti moshën e re të kërkuesit dhe gjendjen e tij shëndetësore si rrethana relevante në vlerësimin nëse, niveli minimal i ashpërsisë ishte arritur. Pavarësisht se Qeveria parashtroi dokumente për standardet e qendrës së paraburgimit, Gjykata vuri në dukje se të gjitha dokumentet datonin pas kohës kur kërkuesi ishte vendosur atje. Gjykata gjithashtu u shpreh se, raportet ose certifikatat e paraqitura nga Qeveria ruse kishin nuk kishin vlerë provash pasi nuk i referoheshin dokumentacionit origjinal të mbajtur nga qendra e paraburgimit. Gjykata vuri në dukje se gjyshi i kërkuesit kishte dorëzuar certifikata mjekësore në seancën e vlefshimit të paraburgimit për të treguar se nipi i tij vuante nga ADHD, për të siguruar që autoritetet do të ishin në dijeni të gjendjes së tij. Gjykata i konsideroi këto prova të mjaftueshme për të vërtetuar se autoritetet kishin dijeni për gjendjen shëndetësore të kërkuesit pas pranimit të tij në qendrën e ndalimit të përkohshëm. Për më tepër, fakti që ai duhej të shtrohej në spital pas lirimimit për pothuajse tre javë, tregoi se ai nuk kishte marrë trajtimin e nevojshëm, në kohën kur ishte në qendër.

Gjykata konstatoi se Qeveria nuk kishte arritur të tregonte se kërkuesi kishte marrë trajtim mjekësor të përshtatshëm për gjendjen e tij dhe konstatoi shkelje të nenit 3. Duke dalë në këtë konkluzion, Gjykata e konsideroi të panevojshme shqyrtimin e pjesës së mbetur të ankesave të kërkuesit sipas kësaj dispozite.

## Neni 5

Gjykata konfirmoi se ndalimi i kërkuesit për tridhjetë ditë në qendrën e ndalimit të përkohshëm, përbënte një heqje lirie në kuptimi të nenit 5 (1). Gjykata konstatoi se paraburgimi i kërkuesit nuk i takon juridiksionit të nenit 5 (1) (a), (b), (c), (e) ose (f), por shqyrtoi nëse vendosja e tij në qendrën e përkohshme të ndalimit ishte në përputhje me nenin 5 (1) (d). Paraburgimi për mbikëqyrjen e arsimit, në rastin e të miturve, duhet të bëhet në një strukturë të përshtatshme, me burimet e nevojshme për të përmbushur objektivat arsimore dhe kërkesat e sigurisë. Kjo nuk do të thotë që vendosja në një strukturë të tillë duhet të jetë e menjëhershme, vendosjet e përkohshme

janë të lejuara në objekte që nuk i ofrojnë këto kushte, megjithatë, periodha e kujdestarisë së përkohshme duhet të pasohet në një kohë të shkurtër nga transferimi në një qendër që ofron mbikëqyrje arsimore.

Në rastin konkret, kërkuesi u vendos në qendrën e paraburgimit me qëllim korrigjimin e sjelljes së tij dhe jo për tu mbajtur përkohësisht, përpara se të transferohej në një qendër tjetër. Gjykata konstatoi, në kundërshtim me pretendimet e Qeverisë, që vendosja e kërkuesit në qendrën e ndalimit të përkohshëm nuk mund të krahasohej me një vendosje në një institucion arsimor të mbyllur. Siç u diskutua më sipër, vendosja në një qendër të përkohshme të paraburgimit duhet të jetë një zgjidhje afatshkurtër dhe Gjykata nuk arriti të shohë se si do të mund të sigurohej mbikëqyrja e duhur arsimore, për të ndryshuar sjelljen e një të mituri, gjatë një periudhe maksimale prej tridhjetë ditësh. Gjykata pranoi se ofroheshin disa orë mësimi në qendër, megjithatë, qendra karakterizohej nga një regjim disiplinor. Për më tepër, asnjë nga gjykatat vendase nuk theksoi se vendosja e kërkuesit ishte për qëllime edukimi, por të gjitha ato iu referuan “korrigjimit të sjelljes” ose për të parandaluar atë nga kryerja e veprimeve të mëtejshme kriminale, asnjëra prej të cilave nuk ishin pjesë e juridiksionit të nenit 5 (1) (d).

Gjykata konstatoi se vendosja e kërkuesit në qendrën e ndalimit të përkohshëm nuk ishte bërë sipas parashikimeve të nenit 5 (1) (d), prandaj kemi të bëjmë me shkelje të nenit 5 (1).

## Neni 6

Sa i përket të pandehurve të mitur, Gjykata u shpreh se proceset penale duhet të organizohen për të respektuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe se fëmija i akuzuar për një vepër penale trajtohet në një mënyrë të tillë, që merr parasysh moshën dhe nivelin e pjekurisë të tij dhe se janë ndërmarë hapa për të promovuar aftësinë e tij për të kuptuar dhe marrë pjesë në proces. Fëmija nuk duhet të privohet nga masat mbrojtëse të rëndësishme procedurale, sepse procedimet mund të rezultojnë në heqjen e lirisë së tij. Edhe pse jo absolute, e drejta sipas nenit 6 (3) (c) parashikon që të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale të mbrohen në mënyrë efektive nga një avokat. Gjykata vuri në dukje se vulnerabiliteti i të akuzuarit në fazat fillestare të marrjes në pyetje nga policia mund balancohej vetëm me ndihmën e një avokati. Për një gjykim të drejtë, neni 6 (1) kërkon që caktimi i një avokati duhet të sigurohet sapo një i dyshuar të pyetet së pari nga policia, përveç rastit nëse ekziston një arsye bindëse e bazuar në rrethanat e rastit që kjo e drejtë duhet të kufizohet. Gjykata theksoi në veçanti rëndësinë themelore të ofrimit të një avokati, në rastin kur personi në paraburgim është i mitur, duke pasur parasysh vulnerabilitetin e tyre të

veçantë. Neni 6 (3) (d) ruan parimin se, para se një i akuzuar të mund të dënohet, të gjitha provat kundër tij zakonisht duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë publike. Një të akuzuari duhet t'i jepet një mundësi e përshtatshme për të pyetur dhe për tu përballur me dëshmitarët kundër tij. Kur dënimi bazohet vetëm ose kryesisht në dëshminë e dëshmitarit të munguar, Gjykata duhet të vendosë nëse ka faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues për të lejuar ende një vlerësim të drejtë dhe të duhur të provave. Gjykata më tej vuri në dukje se duhet të ketë arsye të forta për mungesën e një dëshmitari në gjykim, veçanërisht kur dënimi bazohet vetëm në depozitimin e bërë nga një person, me të cilin i akuzuari nuk kishte mundësi të ballafaqohej. Të drejtat e mbrojtjes në këtë rast mund të konsiderohen aq të kufizuara, sa do të kishim të bënim me shkelje të nenit 6.

Në rastin konkret, kërkuesi ishte vetëm dymbëdhjetë vjeç dhe vuante nga ADHD kur policia e mori në pyetje në stacion. Ai ishte gjithashtu nën moshën e përgjegjësisë penale të përcaktuar nga Kodi Penal për veprën penale të zhvatjes, për të cilën ai ishte akuzuar. Megjithatë, ai kishte nevojë për trajtim dhe mbrojtje të veçantë nga autoritetet dhe së paku, duhet t'i ishin garantuar të njëjtat të drejta ligjore dhe masa mbrojtëse si për të rriturit. Gjykata vuri në dukje se nuk kishte asnjë të dhënë se kërkuesit i ishte thënë se kishte të drejtë të thërriste gjyshin e tij, mësuesin, avokatin ose ndonjë person tjetër të afërm, gjatë periudhës që ai ishte mbajtur në stacionin e policisë, për t'i ardhur në ndihmë gjatë marrjes në pyetje. Për më tepër, nuk u ndërmorën masa për të siguruar që atij t'i ishte ofruar ndihmë juridike gjatë marrjes në pyetje. Fakti që ligji i brendshëm nuk kishte ofruar asistencë ligjore për një të mitur nën moshën e përgjegjësisë penale, kur ishte intervistuar nga policia, nuk ishte një arsye e vlefshme për mosrespektimin e këtij detyrimi. Gjykata konstatoi se mungesa e ndihmës juridike gjatë marrjes në pyetje të kërkuesit nga ana e policisë, ndikoi në mbrojtjen e të drejtave të tij dhe dëmtoi procedurën në tërësi. Si rrjedhojë, gjykata konstatoi se kishim të bënim me shkelje të nenit 6 (1) dhe (3) (c). Gjykata vuri në dukje se, Gjykatës së Rrethit iu siguruan rezultatet e hetimit paraprak, i cili përfshinte deklaratat e dëshmitarëve të bëra nga viktima e supozuar dhe nëna e tij. As S., as nëna e tij, nuk ishin thirrur në seancë për të dhënë dëshmi dhe për t'i dhënë kërkuesit një mundësi për t'u përballur me ta, pavarësisht faktit se deklaratat e tyre kishin rëndësi thelbësore për konkluzionin që kishte dalë nga hetimi paraprak, se kërkuesi e kishte kryer aktin. Bazuar në këto fakte, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit nuk iu siguroi e drejta për një proces të rregullt e si rrjedhojë, u konstatua shkelje e nenit 6 (1) dhe (3) (d).

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 7,500 euro në lidhje me dëmin jo material. Gjithashtu, Gjykata i akordoi kërkuesit 1,910 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Dështimi i autoriteteve në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive për të mbrojtur jetën e nënës dhe fëmijës së varë nga ish-partneri përbënin shkelje të nenit 2*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BRANKO TOMAŠIĆ DHË TË TJERËT K. KROACISË**

(Kërkesa nr. 46598/06)

**15 janar 2009**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin Branko Tomašić, gruaja e tij, Đurđa Tomašić, dhe tre fëmijët e tyre, të gjithë shtetas kroatë të cilët jetonin në Čakovec, Kroaci. Kërkuesit ishin të afërmit e M.T. dhe fëmijës së saj, V.T., i lindur në mars të vitit 2005, të cilat u vranë të dyja në gusht të vitit 2006 nga M. M., babai i V.T.

M.T. dhe M.M., deri në korrikun e vitit 2005, jetonin së bashku në shtëpinë e prindërve të M.T., deri kur M.M. u largua pas mosmarrëveshjeve me anëtarët e familjes.

Në janar të 2006, M.T. paraqiti një padi penale kundër M.M. për kërcënimet me vdekje që i kishte bërë si përballë ashtu edhe përmes telefonit. Më 15 mars 2006, gjykata e shkallës së parë e shpalli M.M. fajtor për kërcënim të përsëritur ndaj M.T. se ai do ta vriste atë, veten dhe fëmijën e tyre me një bombë. Ai u dënua me pesë muaj burg dhe, si masë sigurie u vendos që ai t'i nënshtrohej një trajtimi të detyrueshëm psikiatrik gjatë periudhës së burgimit ashtu dhe më pas tij sipas nevojave që do lindin. Më 28 prill 2006, gjykata e apelit e uli periudhën e trajtimit të tij deri në përfundimin e dënimit me burg. M.M. vuajti dënimin e tij dhe u lirua më 3 korrik 2006.

Më 15 gusht 2006 ai qëlloi për vdekje M.T. dhe vajzën e tyre, V.T., përpara se të kryente vetvrasje duke e kthyer armën nga vetja. Përpara se të ndodhnin vrasjet, ai ishte parë nga fqinji i M.T., duke mbajtur një automatik dhe duke lënë biçikletën e tij në drurët aty pranë. Fqinji kishte thirrur menjëherë policinë, por policia mbërriti në vendngjarje njëzet minuta pas ngjarjes tragjike.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan, duke u bazuar në nenin 2 dhe nenin 13, se shteti nuk kishte marrë masat e duhura për mbrojtjen e jetës së M.T. dhe V.T. dhe nuk kishte kryer një hetim efektiv mbi përgjegjësinë e mundshme të Shtetit lidhur me vdekjen e tyre.

## Neni 2

Gjykata përsëriti se neni 2, i urdhëron shtetit të ndër marrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që ndodhen brenda juridiksionit të tij. Kjo përfshin një detyrë parësore të Shtetit për të siguruar të drejtën e jetës duke miratuar dispozita penale efektive për të penguar kryerjen e veprave penale kundër personit, të mbështetur këto nga mekanizmat e zbatimit të ligjit për parandalimin, zbutjen dhe ndëshkimin për shkeljet e këtyre dispozitave. Megjithatë, ai parashikon edhe detyrimin pozitiv të autoriteteve për të marrë masa operative parandaluese për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga aktet kriminale të një individi tjetër. Një detyrim pozitiv lind kur vërtetohet se autoritetet e kanë ditur ose duhet ta kishin ditur se në kohën kur ka ekzistuar një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një individi të identifikuar nga aktet kriminale të një pale të tretë dhe se autoritetet nuk kishin marrë masat brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, të cilat, sipas një arsytimi të bazuar, mund të kishin shmangur këtë rrezik. Në rastin në fjalë, gjetjet e gjykatave të brendshme dhe konkluzionet e ekzaminimit psikiatrik, tregonin padyshim se autoritetet kishin qenë të vetëdijshëm se kërcënimet e bëra kundër jetës së M.T. dhe V.T. kishte qenë serioze dhe se duhej të ishin ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për mbrojtjen e tyre.

Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se nuk ishte kryer asnjë kontroll ndaj ambienteve apo mjeteve të M.M. gjatë procedurave paraprake penale kundër tij, pavarësisht faktit se ai kishte kërcënuar në mënyrë të përsëritur se do të përdorte një bombë. Përveç kësaj, edhe pse raporti psikiatrik i hartuar për qëllimet e këtyre proceseve penale kishte theksuar nevojën për trajtim të vazhdueshëm psikiatrik, faktikisht Qeveria nuk kishte vërtetuar se M. M. ishte trajtuar siç duhet. Në të vërtetë, M.M. nuk kishte ndjekur një program individual gjatë burgimit të tij edhe pse ishte e detyrueshme me ligj. As nuk ishte marrë në shqyrtim dhe vlerësuar nëse, pas lirimit të tij ai mund të përbënte rrezik duke vënë në zbatim kërcënimet e tij për vdekje ndaj M.T. dhe V.T.

Më tej Gjykata konkludoi se autoritetet e brendshme përkatëse nuk kishin marrë masat adekuate për të mbrojtur jetën e M.T. dhe V.T., çka përbënte shkelje të nenit 2 të Konventës.

Gjykata u shpreh se shqyrtimi i kërkesës sipas nenit 2, lidhur me dështimin e Shtetit për kryerjen e një hetimi të plotë mbi përgjegjësinë e mundshme të agjentëve të tij për vdekjen e M.T. dhe V.T, nuk ishte i nevojshëm.



### Neni 13

Më tej Gjykata konkludoi se nuk kishte nevojë të merrte në shqyrtim kërkesat e kërkuësve sipas nenit 13, duke pasur parasysh se ajo kishte përcaktuar përgjegjësinë e shtetit sipas nenit 2.

### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuësve së bashku 40,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 1,300 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Gjykata lejoi një OJF të paraqesë një çështje në emër të një të riu me aftësi të kufizuara mendore i cili vdiq në një spital psikiatrik*

## **QENDRA PËR BURIME LIGJORE NË EMËR TË VALENTIN CAMPEANU k. RUMANISË**

(kërkesa nr. 47848/08)

**17 korrik 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Kjo kërkesë u soll përpara Gjykatës në emër të Valentin Campeanu, një shtetas rumun i cili kishte lindur në vitin 1985 dhe vdiq në vitin 2004. z. Campeanu ishte braktisur nga prindërit që në lindje dhe ishte vendosur në një jetimore. Në vitin 1990, në moshë tepër të re, ai u diagnostikua si HIV-pozitiv dhe se vuante nga një paaftësi të rënda mendore.

Në mars të vitit 1992, ai u transferua në Qendrën për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Craiova dhe më vonë në Qendrën e Kujdesit nr. 7 në Craiova (tani e tutje “Qendra e Kujdesit”).

Në shtator 2003, Këshilli rajonal për Mbrojtjen e Fëmijëve urdhëroi që për z. Campeanu nuk duhet të kujdesej më shteti, për shkak se ai kishte arritur moshën 18 vjeç dhe nuk është regjistruar në ndonjë formë arsimimi.

Në fillim të shkurtit të vitit 2004, pas refuzimeve të njëpasnjëshme nga një sërë institucionesh që ta pranonin z. Campeanu, në fund ai u pranua në një qendër të kujdesit mjekësor dhe social (tani e tutje “QKMS”), personeli i së cilës konstatoi se ai ishte në një gjendje të avancuar degradimi psikiatrik dhe fizik, se nuk kishte marrë ndonjë mjekim antiretroviral dhe se vuante nga kequshqyerja.

Më 9 shkurt, pas një krize të papritur ku dyshohet se z. Campeanu ka reaguar në mënyrë agresive ai u dërgua në Spitalin neuropsikiatrik Poiana Mare (tani e tutje “SPM”) për ekzaminim dhe trajtim. Megjithatë, ai u kthye në Qendrën e Kujdesit në të njëjtën ditë. Më 13 shkurt, z. Campeanu u dërgua përsëri për SPM për trajtim. Ai u mbajt aty një javë dhe u vendos në pavijone të ndryshme psikiatrike.

Më 20 shkurt ai u vu re nga një ekip vëzhguesish të Qendrës për Burime Ligjore (QBL) të cilët raportuan se z. Campeanu mbahej i izoluar në një dhomë pa ngrohje, me një shtrat, por pa shtroje, i veshur në mënyrë të pamjaftueshme vetëm me bluzë pizhamesh dhe pa ndihmën e nevojshme për të ngrënë ose për të përdorur pajisjet sanitare, përderisa punonjësit e spitalit mesa duket refuzonin ta ndihmonin për

shkak të frikës nga HIV. Përfaqësuesit e QBL deklaruan se ata kishin kërkuar që ai të transferohej menjëherë në Spitalin e Sëmundjeve Infektive të Krajovës, ku ai do të mund të merrte trajtimin e duhur. Megjithatë, drejtori i spitalit nuk kishte qenë dakord, duke besuar se pacienti nuk ishte një “rast urgjent, por një rast social”, dhe se në çdo rast ai nuk do të ishte në gjendje të përballonte udhëtimin. Në të njëjtën ditë, më 20 shkurt 2004, z. Campeanu vdiq.

Duke mos pasur dijeni për vdekjen e z. Campeanu, QBL iu dërgoi urgjentisht disa letra një numri zyrtarësh vendorë dhe qendrorë, duke theksuar gjendjen e tij shumë kritike dhe faktin se ai ishte transferuar në një institucion që nuk ishte në gjendje t'i siguronte kujdesin e duhur. QBL kritikoi gjithashtu trajtimin e papërshtatshëm që ai kishte marrë dhe kërkoi marrjen e masave urgjente për të përmirësuar situatën. Ajo theksoi më tej se pranimi i z. Campeanu në QKMS dhe transferimi i tij i mëvonshëm në SPM ishte bërë në shkelje të të drejtave të tij njerëzore, dhe kërkoi që të fillonte një hetim në lidhje me këtë situatë. Më 22 shkurt 2004, QBL dha një deklaratë për shtyp ku nënvizonte kushtet dhe trajtimin e pacientëve në SPM, duke iu referuar të veçantë në rastit të z. Campeanu dhe duke bërë thirrje për masa urgjente.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Pas shumë ankesave nga QBL dhe pas hetimit penal të mëvonshëm mbi vdekjen e z. Campeanu, hetim që nuk dha asnjë rezultat konkret, QBL iu drejta Gjykatës së Strasburgut duke pretenduar se ishin shkelur të drejtat e z. Campeanu sipas neneve 2, 3, 5, 8, 13 dhe 14.

### Mbi pranueshmërinë

6. Qeveria rumune pretendoi se QBL nuk legjitimohej për të paraqitur një kërkesë në emër të Valentin Campeanu, pasi nga njëra anë ajo nuk mund të pretendonte se ishte vetë viktimë e shkeljeve të pretenduara Konventës dhe, nga ana tjetër, nuk mund as të pretendonte se ishte përfaqësuese ligjore e autorizuar e z. Campeanu. Gjykata theksoi se Konventa garanton të drejta që janë praktike dhe efektive, dhe jo teorike dhe iluzive, dhe duke pasur parasysh natyrën serioze të pretendimeve, QBL duhet të kishte mundësi të vepronte si përfaqësuese e z. Campeanu. Rrjedhimisht, kërkesa ishte e pranueshme.

### Neni 2

Gjykata deklaroi se vendimi i autoriteteve rumune për ta vendosur z. Campeanu në QKMS dhe më pas për ta transferuar në SPM u përcaktua kryesisht nga kriteri

se cili institucion ishte i gatshëm për ta pranuar dhe jo aq nga kriteri se ku ai do të ishte në gjendje të merrte kujdesin dhe mbështetjen e duhur mjekësore. Duke pasur parasysh se QKMS nuk ishte e pajisur si duhej për trajtimin e pacientëve të sëmurë mendërisht, ata e transferuan atë në SPM, pavarësisht nga fakti se spitali më parë kishte refuzuar ta pranonte, dhe më pas ishte vendosur në një pavijon pa staf psikiatrik.

Transferimi nga një objekt në një tjetër kishte ndodhur pa ndonjë diagnostikim adekuat dhe përkujdesje e vazhdueshme dhe në mospërfillje të plotë të gjendjes shëndetësore të z. Campeanu dhe të nevojave të tij elementare mjekësore. Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë faktit që autoritetet nuk kishin arritur t'i mundësonin atij një mjekim antiretroviral.

Ajo i kushtoi vëmendje të veçantë gjithashtu gjendjes të brishtë të z. Campeanu, dhe faktit që për të gjithë jetën e tij z. Campeanu kishte qenë në duart e autoriteteve, të cilat për këtë arsye ishin të detyruara të jepnin llogari për trajtimin e tij. Duke vendosur ta shtronin z. Campeanu në spitalin psikiatrik, edhe pse ishin në dijeni të kushteve të tmerrshme në atë spital, autoritetet e kishin vënë në mënyrë të paarsyeshme jetën e tij në rrezik. Dështimi për t'i siguruar atij kujdesin dhe trajtimin e duhur ka qenë një tjetër faktor vendimtar që çoi në vdekjen e tij të parakohshme. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet rumune kanë shkelur nenin 2 duke dështuar të sigurojnë mbrojtjen e nevojshme të jetës së z. Campeanu.

Duke pasur parasysh se autoritetet kishin dështuar të sqaronin rrethanat e vdekjes së z. Campeanu dhe të identifikonin personat përgjegjës për këtë vdekje, Gjykata konstatoi shkelje të aspekteve procedurale të nenit 2 të Konventës.

### Neni 13 marrë së bashku me nenin 2

Gjykata konstatoi gjithashtu, se në Rumani nuk kishte një mekanizëm të përshtatshëm për ndreqjen e situatës ose dëmshpërblimin e personave me aftësi të kufizuara mendore që pretendojnë se janë viktima sipas nenit 2. Për këtë arsye, Gjykata vendosi edhe shkelje të nenit 13 të Konventës të marrë në lidhje me nenin 2.

Sa i takon gjetjeve të nenit 2 dhe 13, Gjykata u shpreh se nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi më vete i pretendimeve në lidhje me nenin 3, i vetëm dhe marrë së bashku me nenin 13, apo nw bazw tw neneve 5, 8 dhe 14.

#### Neni 46

Gjykata u shpreh se shteti i paditur, duhet të marrë masat e përgjithshme të nevojshme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara mendore në situata të ngjashme t'u mundësohet përfaqësim i pavarur, duke u lejuar atyre që ankesat që kanë në bazë të Konventës në lidhje me shëndetin dhe trajtimin e tyre të shqyrtohen nga një gjykatë ose organ tjetër i pavarur.

#### Neni 41

QBL nuk kishte paraqitur ndonjë pretendim në lidhje me dëmin material ose jo material, kështu asnjë shumë nuk u akordua nën këtë zë. Gjykata vendosi që Rumania duhet t'i paguajë 10 000 euro QBL dhe 25 000 euro organizatës Interights, i cili ka vepruar si këshilltare e QBL, për kostot dhe shpenzimet.

*Mungesa e rishikimit gjyqësor dhe mbikqyrja e thirrjeve telefonike të një të miture të ndaluar në një qendër edukimi përbënte shkelje të nenit 5 (4) dhe nenit 8 të Konventës*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN D.L. k. BULLGARISË**

(Kërkesa nr. 7472/14)

**19 maj 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, D.L., ishte shtetase bullgare e lindur në 1999, i cili jetonte në Pleven, Bullgari. Më 2 gusht 2012, në moshën 13 vjeçare, ajo u vendos në një “qendër për fëmijët në krizë” në bazë të vendimit të drejtorit të shërbimeve sociale të bashkisë së Plevenit. Marrja e kësaj mase u kërkuar nga nëna e saj duke u bazuar në faktin se nuk ndjente më se mund të kujdesej në mënyrën e duhur për fëmijën e saj. Më 1 tetor 2012, vendimi u konfirmua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Pleven. Koha e qëndrimit të kërkueses në këtë qendër u zgjat nga gjykata edhe disa raste të tjera.

Më 3 prill 2013, një komitet lokal për luftimin e sjelljeve anti-sociale ndaj të miturve kërkoi që kërkuesja të vendosej një qendër të mbyllur edukimi. Qendra të tilla ishin themeluar si një element i programit të Bullgarisë për të luftuar “sjelljen anti-sociale” dhe ishin të rregulluara sipas Kodit Penal, por jo sipas regjimit të të drejtave të familjes apo të fëmijëve. Megjithatë, ligji nuk parashikonte që ndaj saj të inicioheshin procese penale. Tashmë, skema dhe institucionet ishin kritikuar ashpër, përfshirë këtu Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Avokatin e Popullit të Bullgarisë.

Kërkesa e komitetit u rrëzua nga gjykata për shkak të ndikimit negativ të mundshëm që mund të kishte në zhvillimin psikologjik dhe social të kërkueses, duke pasur parasysh mjedisin e papërshtatshëm të këtyre institucioneve. Më 17 maj 2013, komiteti lokal kërkoi sërish futjen e saj në qendër, me arsyetimin se mungesa e përshtatshme e një ambienti familjar, kishte bërë që kërkuesja të largohej nga shtëpia dhe u përfshi në grupe kriminale të cilët e shtynin atë të ofronte shërbime seksuale. Policia në një sërë rastesh e ktheu atë në qendër, dhe sjellja e saj ishte agresive ndaj stafit.

Më 10 qershor 2013, seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor mbajti një seancë në të cilën nëna e kërkueses e cila ishte e pranishme, kërkoi që kërkuesja të përfaqësohej nga një avokat i caktuar nga gjykata, kërkesë e cila rezultoi e suksesshme. Një sërë deklaratash u dëgjuan nga punonjës socialë dhe persona të tjerë kompetentë. Gjykata urdhëroi që ajo të dërgohej në qendrën e edukimit të sigurt të Podemit. Ajo vlerësoi

se pavarishtë vendimit të mëparshëm, i cili përbënte një zgjidhje më pak të ashpër, d.m.th. zgjatjen e afatit të qëndrimit të saj në “qendrën për fëmijët në krizë”, kjo nuk ishte më e mjaftueshme dhe për rrjedhojë urdhri që ajo të ishte nën mbikëqyrje të mbyllur edukimi përbënte interesin më të lartë për kërkuesen dhe shoqërinë.

Ankimimi i kërkueses lidhur me masën e marrë ndaj saj ishte i pasuksesshëm. Ndërkohë që kërkuesja ishte në qendër, komunikimet e saj me botën e jashtme monitoroheshin.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja ankohej se vendosja e saj në një qendër riedukimi nuk përputhej me nenin 5 (1) të Konventës (e drejta për liri dhe siguri personale) dhe se vendimi nuk u rishqyrtua nga një gjykatë brenda një afati të shkurtër sipas parashikimeve të nenit 5 (4). Gjithashtu, ajo parashitroi se mbikëqyrja automatike dhe pa dallim e e-maileve të saj dhe thirrjeve telefonike vinin në kundërshtim me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

### Neni 5 (1)

Së pari, Gjykata shqyrtoi faktin nëse vendosja e D.L. në qendrën e Podemit ishte në përputhje me parashikimet e nenit 5 (1) (d), e cila autorizon ndalimin e të miturve për qëllim edukimi të mbikëqyrur. Me qëllim për ta bërë këtë gjë, Gjykata duhej të përcaktonte nëse ndalimi i kërkuesit ishte arbitrar, dhe nëse mikëqyrja kishte pasur “për qëllim” edukimin e saj.

Lidhur me faktin nëse vendimi ishte arbitrar ose jo, Gjykata vërejti se ligji bullgar lidhur me sjelljen anti-shoqërore të të miturve nuk llogaritet veprimet që mund të konsiderohen si “anti-shoqërore” për qëllime të legjislacionit. Megjithatë Gjykata iu referua jurisprudencës më të vjetër për të treguar se kishte konsideruar më parë prostitucionin dhe arratisjen si veprime anti-shoqërore të cilat ndikonin në faktin për ta ndaluar për edukim të mbikëqyrur. Më pas, Gjykata vuri në dukje faktin se vendimi u mor nga autoritetet gjyqësore duke marrë për bazë dëshmitë e një sërë personash përgjegjës përfshirë këtu edhe kërkuesen. Autoritetet shqyrtuan në detaje elementet e rastit të kërkueses dhe konkluduan se duke pasur parasysh gjendjen aktuale të jetesës së saj dhe faktin e shterimit të të gjitha masave të tjera, nuk kishte asnjë alternativë për dërgimin e saj në qendrën Podem. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa për të qenë “e parashikuar me ligj” ishte përmbushur dhe vendimi nuk ishte arbitrar. Më pas, Gjykata vijoi me shqyrtimin nëse natyra e privimit të lirisë së saj ishte “për qëllim” të edukimit të mbikëqyrur. Për këtë, Gjykata vuri në

dukje se kërkuesja ishte në gjendje të ndiqte një kurrikul në shkollë, që ajo të arrinte rezultate që i mundësonin progres për të kaluar në një klasë më të lartë dhe që ajo të merrte një kualifikim profesional. Gjykata arriti në përfundimin se vendimi i autoriteteve nuk ishte ndëshkues; ai përcaktonte dërgimin e saj në një mjedis edukativ dhe nuk ishte arbitrar, dhe për rrjedhojë masa ishte në përputhje me nenin 5 (1) (d).

#### Neni 5 (4)

Gjykata rikujtoi se arsyetimi i kërkesës që ndalimi të rishqyrtohet, lidhet me faktin që arsyet fillestare mbi justifikimin e ndalimit mund të pushojnë së ekzistuari; një faktor veçanërisht i rëndësishëm për rastin në fjalë ishte mundësia e sjelljes së kërkueses për tu përmirësuar gjatë periudhës së ndalimit të saj. Gjykata pranoi se palët kishin rënë dakord për mundësië e ankimimit gjyqësor siç parashikohej në vendim. Megjithatë, pyetja për Gjykatën ishte nëse kërkuesja kishte të drejtë të kërkonte një rishikim, dhe nëse po, a ishte ofruar një mundësi e tillë asaj.

Gjykata u shpreh se ajo duhet të kishte përfituar nga kontrolli automatik periodik gjyqësor dhe se ajo duhet të kishte pasur të drejtë të iniciojë, në intervale të arsyeshme, një shqyrtim të tillë. Legjislacioni i zbatueshëm nuk i autorizonte të miturit të kërkonin rishqyrtim lidhur me ndalimin e tyre, por lejonte që kjo të bëhej vetëm nga komiteti lokal. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 5 (4) pasi kërkuesja nuk kishte pasur në dispozicion të drejtën për të bërë ankim.

#### Neni 8

Gjykata deklaroi se ndërhyrja në të drejtën e një individi referuar nenit 8, nuk do të përmbushë standardet e Konventës nëse nuk është “e parashikuar me ligj”, është në ndjekje të një qëllimi legjitim dhe është “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Gjykata vërejti se dy kriteret e para u përmbushën pasi masat ishin parashikuar nga rregullat e brendshme të Podemit dhe për shkak se mbikqyrja e korrespondencës dhe thirrjeve telefonike të të miturve parandalte rrezikun për shëndetin e të miturit dhe mbronte rendin. Megjithatë, nëse kontrolli i korrespondencës ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”, Gjykata vërejti se rregullat e brendshme parashikonin mbikqyrje automatike dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë korrespondencës së të miturve të ndaluar në qendra. Për këtë, edhe korrespondenca e kërkueses me avokatët e saj dhe OJF-të, të cilat në parim duhet të kishin privilegjin e korrespondencës, ju nënshtuan masave të përgjithshme të monitorimit. Për më tepër, autoriteteve nuk u është kërkuar të japin arsye për kontrollin ose të përcaktonin kohëzgjatjen e masës. Gjykata arriti në përfundimin se regjimi i mbikëqyrjes së thirrjeve telefonike që ishin bërë ndaj kërkueses, të cilat nuk bënin përjashtim të kontakteve me familjen



ose OJF-të, dhe që nuk ishin bazuar në një analizë të personalizuar lidhur me rreziqet apo nevojat, nuk ishte e bazuar në arsye objektive dhe të mjaftueshme për të justifikuar një ndërhyrje të tillë. Për këtë, as regjimi nuk mund të konsiderohej se ishte në përputhje me parashikimet e nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Bullgaria duhej t'i paguante kërkuarit 4,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 2,500 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Dështimi i Kroacisë për të mbrojtur një person vulnerabël nga ngacmimet e dhunshme dhe të vazhdueshme, përbënë shkelje të nenit 3 dhe 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ĐORĐEVIĆ k. KROACISË**

(Kërkesa nr. 41526/10)

**24 korrik 2012**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi i parë, Dalibor Đorđević është shtetas kroat lindur në 1977 dhe kërkuesja e dytë Radmila Đorđević është mamaja e tij e lindur në 1956. Kërkuesi i parë vuante nga aftësi të kufizuara fizike dhe mendore dhe jetonte me nënën e tij, e cila kujdesej për të. Mes korrikut 2008 dhe shkurtit 2011 ai ishte ngacmuar vazhdimisht nga nxënësit e një shkolle fillore aty pranë, për shkak të aftësisë së tij të kufizuar dhe origjinës serbe. Ngacmimet ishin të formave të ndryshme: ofendime, të bërtitura, të pështyra dhe shtyrje e goditje, si dhe në një rast, djegie e duarve të tij me cigare. Gjithashtu fëmijët përqeshnin kërkuesin në dialektin serb. Shtëpia e tyre ishte vandalizuar, duke i rënë ziles në orare të papërshtatshme dhe duke pikturuar grafito fyese jashtë saj.

Këto sulme e kishin shqetësuar së tepërmi kërkuesin e parë, duke i shkaktuar frikë dhe ankth, çka vërtetohej nga një numër raportesh mjekësore. Sipas tyre, shpesh kërkuesi kafshonte buzën dhe grushtet, kishte tronditje dhe shenja të psoriazës për shkak të stresit dhe kishte nevojë për një ambient shoqëror. Këto incidente u raportuan në autoritete të ndryshme në disa raste, duke përfshirë shkollën që ndodhej vetëm 70 metra larg, të cilën e ndiqnin shumica e fëmijëve në fjalë, Shërbimet Sociale dhe Avokatin e Popullit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kur policia arrinte, jo gjithmonë në kohë, i shpërndante fëmijët pa i bërë pyetje ose pa i identifikuar. Fëmijët pranuan dhunën ndaj Dalibor në intervistat me policinë, por ishin shumë të rinj për të mbajtur përgjegjësi penale.

Në tetor të vitit 2009 dhe maj 2010, avokatja e kërkuesve i shkroi zyrës së Prokurorisë së Rrethit, lidhur me ngacmimet e shumta dhe të vazhdueshme, duke u ankuar se nuk kishte mjet ligjor efektiv në ligjin kroat për mbrojtjen e personave nga veprimet e dhunshme të kryera nga fëmijët. Ajo gjithashtu u ankua tek Avokatja e Popullit dhe kërkoi këshilla, e cila u përgjigj se nuk kishte juridiksion në këtë çështje. Shërbimet sociale informuan nënën se do të duhej të ndërmerrej një padi civile. Policia u shpreh se një hetim i tillë nuk do të jepte rezultate. Prokuroria e deklaroi se nuk kishte juridiksion në këtë çështje.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan *inter alia* se shteti nuk iu dha atyre mbrojtjen e duhur ndaj ngacmimeve dhe për rrjedhojë u janë shkelur të drejtat e garantuara nga nenet 3, 8, 13 dhe 14 të Konventës.

### Neni 3

Gjykata vendosi t'i konsiderojë incidentet si një situatë e vazhdueshme. Incidentet ishin të mirëregjistruara dhe ndikuan në shëndetin mendor dhe fizik të kërkuesit të parë, të përshkruar si një person paqësor, i paaftë për të mbrojtur veten. Gjykata vlerësoi se efektet e një ngacmimi të vazhdueshëm verbal dhe fizik, i shoqëruar me ndjesi të pafuqisë dhe frikës, i cili ka ndodhur për një periudhë të gjatë kohe, është një fakt mjaftueshmërisht serioz për t'u kualifikuar në fushëveprimin e nenit 3 të Konventës.

Për lindjen e një detyrimi pozitiv për të mbrojtur kërkuesin e parë, autoritetet duhet të kishin qenë ose kishin detyrimin për të qenë në dijeni të ekzistencës së këtij keqtrajtimi nga një palë e tretë dhe kishin dështuar në marrjen e masave për të evituar rrezikun. Akte të tilla të dhunshme që bien ndesh me nenin 3 kërkonin, në parim, masa penale ndaj autorëve. Megjithatë, duke marrë parasysh moshën tepër të re të ngacmuesve të Dalibor, kishte qenë e pamundur që autorët të procedoheshin penalisht. Për më tepër, ka probabilitet, që asnjë nga veprat konkrete të ndërmarra prej tyre nuk përbënte veprë penale në vetvete, por pavarësisht kësaj, marrë në tërësinë e tyre, incidentet dhe ngacmimet janë të papajtueshme me kërkesat e nenit 3 të Konventës.

Megjithatë, që nga korriku i vitit 2008, nëna e Dalibor kishte informuar policinë, Avokaten e Popullit dhe Shërbimet Sociale për këtë ngacmim të vazhdueshëm. Për rrjedhojë, autoritetet kishin qenë të vetëdijshëm për situatën.

Ndërsa policia kishte marrë në pyetje disa fëmijë rreth incidenteve, ata nuk kishin bërë përpjekje serioze për të vlerësuar se çfarë po ndodhte në të vërtetë dhe raportet e hartuara nuk ishin ndjekur nga ndonjë veprim konkret. Gjatë kësaj kohe nuk ishte marrë asnjë vendim për të miratuar ndonjë mekanizëm monitorues me qëllim për të njohur dhe parandaluar ngacmime të mëtejshme. Mungesa e ndonjë përfshirjeje të vërtetë të shërbimeve sociale dhe mungesa e këshillimit për kërkuesin e parë ishte veçanërisht e habitshme. Përveç përgjigjeve ndaj incidenteve specifike, asnjë autoritet nuk kishte ndërmarrë veprime relevante të natyrës së përgjithshme, pavarësisht dijenisë së tyre se kërkuesi i parë ishte vënë në shënjestër në mënyrë sistematike dhe se abuzimi i ardhshëm kishte qenë mjaft i mundshëm.

Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me Dalibor.

#### Neni 8

Në kuadër të nenit 8, shtetet jo vetëm që duhet të mos cenojnë të drejtën e individëve, por kanë detyrimin të marrin masa për t'i mbrojtur ata nga të tjerët. Jeta private dhe familjare e kërkueses së dytë ishte ndikuar negativisht nga këto incidente. Në të njëjtën mënyrë që autoritetet kishin dështuar në marrjen e masave përkatëse për të parandaluar keqtrajtimin e mëtejshëm të djalit të saj, ata nuk kishin mbrojtur kërkuesen e dytë duke shkelur kështu garancitë e nenit 8 të Konventës.

#### Neni 14

Procese të brendshme mund të ishin nisur sipas ligjit kroat për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili kishte dispozita specifike mbi origjinën etnike dhe aftësinë e kufizuar. Kjo mbrojtje garantohej gjithashtu nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane. Kështu këto mjete u konsideruan efektive. Meqenëse këto mjete nuk ishin shteruar, ankimi i kërkuesve në kuadër të nenit 14 u konsiderua i papranueshëm.

#### Neni 13

Meqenëse kishte qenë e pamundur që kërkuesit të ankoheshin për keqtrajtimin, u konkludua se kjo e drejtë ishte shkelur në lidhje me nenet 3 dhe 8 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata iu akordoi kërkuesve 11,500 euro në lidhje me dëmin jo material. Gjithashtu, Gjykata i akordoi 1,200 euro për shpenzimet gjyqësore në procedurat vendase dhe 3,500 euro për procedurat para Gjykatës.

*Dështimi i autoriteteve sllovene për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 për të lehtësuar të drejtën për takim të babait me vajzën e tij - megjithëse ai nuk mund të parashtronte përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kërkesën në emër të vajzës së tij për sa kohë që nëna kishte kujdestarinë e plotë*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN EBERHARD DHE M. k. SLOVENISË**

(Kërkesat nr. 8673/05 dhe 9733/05)

**1 dhjetor 2009**

### **1. Faktet kryesore**

Çështja e ka zanafillën në dy kërkesa nga z. Johann Ivan Eberhard dhe znj. M., vajza e tij. Z. Eberhard ishte i martuar me M.E. dhe ata jetonin së bashku me vajzën e tyre, M., derisa M.E. u largua së bashku me fëmijën dhe paraqiti kërkesën për divorc në prill të vitit 2001. Në shkurt të vitit 2002, ata u divorcuan dhe kujdestaria e fëmijës ju la M.E.

Më 4 maj 2001, z. Eberhard dhe gruaja e tij firmosën një marrëveshje lidhur me të drejtën për takimet me fëmijën. Pasi kishte kaluar një muaj nga momenti që kërkuesi pretendonte se nuk i ishte lejuar të vizitonte vajzën e tij, ai paraqiti një kërkesë në Qendrën për Mirëqenie Sociale të Šentjurit për të përcaktuar zyrtarisht marrëveshjen për të drejtën e takimeve. M.E. vazhdonte të kundërshtonte lejimin e takimeve me vajzën e tyre. Më 1 gusht 2001, Qendra për Mirëqenie Sociale e Šentjurit lëshoi një urdhër që i lejonte atij të takonte fëmijën e tij katër orë në javë, por nuk pranoi t'i jepte mundësinë e marrjes së fëmijës nga çerdhja dhe urdhëroi që M.E. të sillte fëmijën në një pikë takimi të përcaktuar. Vendimi për të drejtën e takimit u bë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm më 16 tetor 2002.

M.E. nuk e zbotoi urdhrin, prandaj kërkuesi në nëntor të vitit 2002 kërkoi ekzekutimin e tij. Më pas, Njësia Administrative e Šentjurit urdhëroi M.E., të lejonte kërkuenin për të vizituar fëmijën dhe në rast se ky urdhër nuk do respektohej ajo do gjobitej. Si rezultat i refuzimit të vazhdueshëm të M.E. për t'i lejuar kërkuenin për të vizituar fëmijën, Njësia lëshoi disa vendime kundër saj për pagimin e gjobave. M.E. i apeloj këto vendime ku u konstatua se M.E. nuk kishte qenë e informuar lidhur me moskryerjen e takimeve të kërkuenin me vajzën e tyre. Vendimi për të drejtën e takimit në vetvete nuk kishte ndryshuar për rrjedhojë ai vijoi të ishte në fuqi.

Më 6 qershor 2003, z. Eberhard parashtroi një kërkesë lidhur me kujdestarinë e fëmijës. Pati një sërë përpjekjesh për të përcaktuar një datë seance, po kjo nuk rezultoi e

suksesshme përfshi këtu edhe refuzimin e M.E. për të bashkëpunuar dhe kërkesën e parë të kërkuarit për të caktuar një psikolog. Në dhjetor 2005, kërkuari i kërkoi gjykatës vendase të nxirrte një vendim të ndërmjetëm për kujdestarinë dhe shtoi një kërkesë alternative për një urdhër të ndërmjetëm lidhur me të drejtën për takim. Gjithashtu, u kërkua caktimi i një eksperti të ri. Më 22 shkurt 2006, z. Eberhard parashtroi ankesë lidhur me rishikimin e mosveprimeve të gjyqtarit.

Në mars 2006, kërkesa e kërkuarit u shqyrtua nga një ekspert kështu që më në fund mund të mbahej një seancë në lidhje me vendimin e ndërmjetëm. Në maj, në të njëjtin vit gjykatat vendase hodhën poshtë kërkesën e kërkuarit lidhur me vendimin e ndërmjetëm mbi kujdestarinë, por lanë në fuqi kërkesën e tij alternative lidhur me vendimin e ndërmjetëm për të drejtën për takim. Z. Eberhard dhe vajzës së tij ju lejua të kalonin kohë së bashku gjatë javës dhe në fundjavë.

Pasi M.E., në raste të caktuara vioji ti mohonte kërkuarit takimet me fëmijën, në gusht të vitit 2006 kërkuari u ankua, duke kërkuar pagimin e gjobave ndëshkuese të dhëna ndaj M.E. Për këtë u caktua një seancë, por më pas u shty dhe kërkuari kërkoi një apel rishikues. Gjatë seancës dëgjimore në shtator të 2007, proceset u bashkuan në një kërkesë të vetme lidhur me të drejtën e takimeve që kërkuari kishte parashtruar në një proces të veçantë në vitin 2004. Gjatë një seance dëgjimore, më 10 janar 2008, palët ranë dakord përfundimisht për marrëveshjet e reja të takimeve dhe z. Eberhard e tërhoqi kërkesën e tij mbi kujdestarinë.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuarit u ankuan lidhur me dështimin e shtetit në mosekzekutimin e rregullimeve të të drejtës për takime të dhënë në proceset administrative si dhe vonesat e hasura në proceset lidhur me kujdestarinë e fëmijës dhe rregullimit të të drejtës së takimeve me fëmijën, në shkelje kjo të neneve 6 dhe 8.

### Pranueshmëria

Fillimisht, Gjykata adresoi prapsimet e Qeverisë së z. Eberhard nuk kishte tagër për të vepruar në emër të vajzës së tij, pasi ishte nëna që kishte kujdestarinë e plotë të fëmijës.

Për këtë qëllim, Gjykata risolli në vëmendje jurisprudencën e kaluar lidhur me rastet që lindin nga mosmarrëveshjet ndërmjet prindërve, ku prindi që kishte të drejtën e kujdestarisë i ishte besuar mbrojtja e interesave të fëmijës. Në situata të tilla, pozita si një prind i njohur ligjshërisht (pa kujdestari) nuk mund të konsiderohej si një kriter

bazë për të sjellë një kërkesë edhe në emër të fëmijës. Në këtë rast, pozita e kërkuesit të parë si baba ishte e pamjaftueshme, dhe rrjedhimisht, kërkuesi i parë nuk kishte asnjë tagër për të vepruar në emër të kërkuesit të dytë.

Për rrjedhojë, Gjykata e kufizoi shqyrtimin e rastit duke e konsideruar si kërkues të vetëm z. Eberhard.

### Neni 8

Fillimisht, Gjykata vuri në dukje se lidhja midis kërkuesit dhe të bijës binte në fushëveprimin e “jetës familjare” brenda kuptimit të nenit 8. Gjykata theksoi se sipas nenit 8, shtetet kanë detyrime pozitive për të lehtësuar bashkimet midis prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe se proceset joefektive dhe me vonesa mund të përbëjnë shkelje të këtij neni. Në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve mbi të drejtën familjare, Gjykata theksoi më tej se si kalimi i kohës mund të ketë një ndikim të fuqishëm negativ në marrëdhënien prind-fëmijë, kështu që zbatimi i menjëhershëm i masës është i domosdoshëm.

Pra, roli i Gjykatës ishte të përcaktonte nëse autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë hapa të domosdoshme, të përshtatshme dhe efektive për të lehtësuar ekzekutimin e vendimit lidhur me të drejtën për vizitë duke marrë parasysh refuzimin për përmbushjen e tij nga ana e nënës. Gjykata vuri në dukje se vendimi për të drejtën për takim nuk ishte ekzekutuar që nga tetori i vitit 2002, momenti kur u bë përfundimtar dhe vendimi i gjykatës vendase për rregullimet e reja në maj të 2006, dhe se asnjë masë nuk u ndërмор nga autoritetet në përgjigje të refuzimit të vazhdueshëm nga M.E. për të lejuar takimet me fëmijën. Gjykata arriti në përfundimin se në lidhje me ekzekutimin e vendimit të së drejtës për takim, shteti nuk kishte krijuar kushtet e nevojshme për ta ekzekutuar atë dhe për të siguruar kontaktin ndërmjet kërkuesit dhe vajzës së tij.

Proceset në lidhje me rregullimet e të drejtës së takimeve dhe kujdestarisë zgjatën më tepër se katër vjet, gjatë së cilës kërkuesi kishte pasur jashtëzakonisht shumë pak kontakte me vajzën e tij. Gjykata pranoi se gjykatat vendase kishin mundësinë të iniciacionin masa të ndërmjetme, por nuk arritën ta bënin këtë. Përveç kësaj, marrëveshja e të drejtës për takim duhet të ishte trajtuar me urgjencë nga autoritetet, por ata nuk kishin bërë përpjekje efektive për ekzekutimin e kësaj mase.

Prandaj, Gjykata pranoi se autoritetet sllovene nuk arritën të siguronin ekzekutimin e marrëveshjeve të të drejtës për takim, duke derivuar në mungesë të kontaktit midis kërkuesit dhe vajzës së tij për më shumë se katër vjet dhe për më tepër nuk arriti të kryejë në mënyrë efektive dhe të menjëhershme proceset, duke shkelur nenin 8.

### Neni 6

Kërkesa e kërkuarit lidhur me nenin 6 për tejzgjatjen e procesit, u hodh poshtë për mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore.

### Neni 41

Gjykata konkludoi se Sllovenia duhej t'i paguarë kërkuarit 7,500 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 3,000 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.



*Koracia duhej të siguronte të drejtën e takimit midis babait të divorcuar dhe vajzës së tij në përputhje me programin e punës dhe në ambiente të përshtatshme*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GLUHAKOVIC K. KROACISË**

(Kërkesa nr. 21188/09)

**12 prill 2011**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Stjepan Gluhaković, ishte shtetas kroat i lindur në 1960 dhe jetonte në Rijeka, Kroaci. Në korrik të 1999, gruaja e z. Gluhaković u nda prej tij; në atë periudhë ajo ishte shtatzanë. Ajo lindi vajzën e tyre në dhjetor të 1999.

Në një sërë procesesh para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Qendrës për Mirëqenie Sociale si dhe para Gjykatës Kushtetuese, z. Gluhaković ju garantua e drejta për të pasur kontakt me vajzën e tij, e cila vazhdoi të jetonte me nënën e saj.

Gjatë këtyre proceseve, z. Gluhaković kërkoi në mënyrë të përsëritur që takimet me vajzën e tij të bëheshin çdo katër ose çdo tetë ditë, përsa kohë që ai punonte në Vicenza të Italisë dhe programi i punës ishte i tillë që ai e kishte pushim një herë në katër ditë. Për këtë arsye, ai shpjegoi se për të ishte shumë e vështirë që të udhëtonte në Rijekë në një ditë të caktuar të javës; ai duhet të ngiste makinën natën dhe ishte i detyruar ti kërkonte kolegëve që ta zëvendësonin, duke i shkaktuar atij vështirësi të mëdha.

Gjykatat kombëtare nuk dhanë asnjë koment në lidhje me orarin e tij të punës dhe vendosën në mënyrë të përsëritur që ai të shihte vajzën e tij në një ditë të caktuar. Fillimisht, deri në tetor 2008, takimet u vendosën të bëhen çdo të martë për dy orë, pastaj nga nëntori i 2008, një herë në javë, dhe, nga nëntori 2009, çdo të enjte.

Së pari, u urdhërua që takimet të mbaheshin në Qendrën e Këshillimit të Rijekës dhe më vonë, nga nëntori i vitit 2008, në Qendrën për Mirëqenie Sociale. Ata duhej të mbikqyreshin nga një person i tretë, siç rekomandohet në një raport të psikiatrit i cili e diagnostikonte z. Gluhaković me psikozë paranojake.

Në mars dhe nëntor 2005, Qendra e Këshillimit, raportoi pranë gjykatave kombëtare se ambientet e tyre nuk ishin të përshtatshme për takimet midis z. Gluhaković dhe vajzës së tij, pasi ata duhej ta shihnin njëri-tjetrin në kuzhinën e Qendrës ose në zyrat e punonjësve të saj. Për këtë arsye, në korrik 2007, Qendra e Këshillimit informoi kërkuesin se nuk mund të takohej më me vajzën e tij në ambientet e tyre.

Në janar 2009 Qendra për Mirqënie Sociale, gjithashtu paraqiti para gjykatave se nuk kishin ambiente të përshtatshme, pasi, për shkak të mungesës së hapësirës, i vetmi vend ku kërkuesi dhe vajza e tij mund të takoheshin do të ishte në korridor.

Në mars 2010 gjykatat urdhëruan që takimet mund të mbaheshin një herë në javë për tre orë sipas orarit të punës së kërkuesit në një vend që të vetë palët do ta rregullonin midis tyre. Sidoqoftë, ky vendim nuk ishte ekzekutuar as në kohën kur çështja ishte për gjykim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut pasi ish-bashkëshortja e kërkuesit refuzoi që ai të takonte vajzën në banesën e tij dhe për këtë nuk u gjet asnjë zgjidhje tjetër e përshtatshme.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Në lidhje me nenin 8 të Konventës, z. Gluhaković u ankua se që nga viti 2000, autoritetet kroate nuk i kishin siguruar kontakt të rregullt me vajzën e tij në ambiente të përshtatshme dhe se në kohën e vendimit të Gjykatës, ai nuk e kishte parë vajzën e tij që nga korriku i 2007.

### Neni 8.

Ishte e qartë se lidhjet mes kërkuesit dhe fëmijës së tij binin brenda fushëveprimit të “jetës familjare” sipas kuptimit të nenit 8. E drejta e kërkuesit për të parë vajzën e tij në intervale të rregullta nuk kishte qenë asnjëherë objekt mosmarrëveshjeje me gjykatat kombëtare pasi ato të gjitha kishin rënë dakord se kërkuesi duhej ta gëzonte këtë të drejtë. Megjithatë, duke pasur parasysh parimin se objekti dhe qëllimi i Konventës, i cili është një instrument për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kërkon që dispozitat e tij të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që të mos jenë thjesht teorike apo iluzionare por praktike dhe efektive, gjykata kombëtare duhet të kishte siguruar gjithashtu që kërkuesi të ishte në gjendje për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e tij për të kontaktuar me vajzën e tij. Gjykata pranoi që vendimi që takimet të mbikëqyreshin nga një person i tretë ishte një masë e arsyeshme referuar problemeve shëndetësore të kërkuesit siç përshkruheshin nga ekspertët e psikologjisë dhe psikiatrisë. Megjithatë, Gjykata pranoi gjithashtu se udhëtimi nga Vicenza në Rijekë në një ditë të caktuar krijonte vështirësi për ushtrimin e të drejtës së kontaktit të z. Gluhaković me vajzën e tij. Nga ana tjetër gjykatat kombëtare, nuk e kishin trajtuar këtë si rast, dhe nuk kishin dhënë asnjë shpjegim se pse nuk ishte e mundur të përshtateshin propozimet alternative të kërkuesit lidhur me të drejtën e pasjes së kontaktit me vajzën e tij. Në të vërtetë, argumentet e tij nuk ishin marrë parasysh në mënyrë të vazhdueshme në çdo nivel gjyqësor.

Gjykatat kombëtare nuk morën parasysh as kundërshtimet në lidhje me vendin e takimeve. Ata nuk morën parasysh si raportet e Qendrës së Këshillimit, ashtu edhe atë të Qendrës për Mirëqenie Sociale. Madje, Gjykatat vendosën që takimet të mbaheshin në Qendrën e Mirëqenies Sociale pa vlerësuar nëse ajo ishte e përshtatshme. Kjo rezultoi në faktin që z. Gluhaković fillimisht duhej të përshkonte një distancë të konsiderueshme për të organizuar zëvendësimin e tij në punë dhe për të takuar vajzën e tij në vende të tilla si një kuzhinë dhe zyrat e Qendrës së Këshillimit, dhe së fundmi duke mos e parë fare atë, sepse i vetmi vend për t'u takuar në Qendrën e Mirëqenies do të ishte në një korridor.

Duke pasur parasysh se z. Gluhaković nuk kishte pasur kontakte me vajzën e tij që nga korriku i vitit 2007, Gjykata u shpreh se autoritetet kroate nuk kishin siguruar të drejtën e tij për të pasur kontakt efektiv me vajzën e tij, e cila përbënte shkelje të nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Kroacia duhej ti paguante z. Gluhaković 15,000 euro në lidhje me dëmin jo material.

#### Neni 46

Përfundimisht, dhe duke pasur parasysh nevojën urgjente për t'i dhënë fund shkeljes së të drejtës së z. Gluhaković për respektimin e jetës së tij familjare, Gjykata vendosi gjithashtu të lëshonte një njoftim formal që Kroacia duhej të siguronte kontakt efektiv ndërmjet kërkuesit dhe vajzës së tij në përputhje me orarin e punës dhe në ambientet të përshtatshme.

*Nuk kishte shkelje të nenit 8 të Konventës në kuadër të rrethanave të veçanta të rastit, pasi autoritetet vendase morën të gjitha masat e arsyeshme për të ekzekutuar të drejtat prindërore të kërkuarit*

## VENDIMI PËR ÇËSHTJEN GRUJIĆ k. SERBISË

(Kërkesa nr. 203/07)

**28 gusht 2018**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuari, z. Boško Grujić, lindi në vitin 1963. Nga viti 1991 deri në vitin 2001 ai jetonte me M.K., dhe së bashku kishin dy fëmijë - J.G. lindur në janar 1992 dhe M.G. i lindur në vitin 1994, i cili kishte një aftësi të kufizuar intelektuale të moderuar. Në janar 2001, pas ndarjes së çiftit, Qendra Lokale e Kujdesit Social vendosi që kujdestaria e fëmijëve i takonte M.K. Ndërkohë, kërkuarit iu dha e drejta të kontaktojë me fëmijët çdo fundjavë, si edhe të shpenzojë me ta gjysmën e parë të pushimeve verore dhe dimërore.

Zbatimi i këtij vendimi u pezullua në qershor të vitit 2005, kur kërkuari njoftoi Qendrën e Kujdesit Social se kishte për qëllim të kërkonte të drejtat e tij prindërore në një proces gjyqësor, me qëllim që të fitonte kujdestarinë e fëmijëve. Ndërsa procesi gjyqësor ishte në vazhdim, gjykata vendase vendosi një urdhër të përkohshëm i kontaktit mes kërkuarit dhe fëmijëve, urdhër i cili kishte kushte të njëjta me vendimin e dhënë nga Qendra e Kujdesit Social. Në shtator 2008 as kërkuari dhe as M.K. nuk morën pjesë në seancën kryesore të vendosjes së kujdestarisë nga Gjykatës Komunalet. Në këto kushte ajo vendosi pushimin e padisë së kërkuarit. Në vitin 2011 urdhri i përkohshëm i kontaktit u revokua në bazë të faktit se procesi gjyqësor kishte përfunduar në vitin 2008.

Gjatë procesit gjyqësor pati shumë problematika në ekzekutimin e urdhërit të përkohshëm të kontaktit dhënë nga gjykata. Në mënyrë të veçantë, J.G. refuzoi të shihte kërkuarin dhe megjithëse M.G. kërkoi të takonte babanë e tij, M.K. refuzoi ta linte atë të shkonte vetëm në takim pa të motrën. Në vitin 2007, pas një viti përpjekjesh të pasuksesshme nga kërkuarit për të parë fëmijët e tij, Gjykata Rrethit Gjyqësor intervistoi fëmijët, të cilët deklaruan se nuk donin ta shihnin babanë e tyre, sepse kishin frikë prej tij. J.G. shpjegoi se ai i kishte bërë titur, i kishte tërhequr telefonin nga dora, si edhe kishte kërcënuar se nuk do ta kthente më M.G. Raportet e hartuara nga autoritetet vendore në lidhje me rastin theksuan se kërkuari dhe M.K. kishin ende një marrëdhënie të vështirë, si edhe se M.K. nuk ishte në gjendje të ndihmonte fëmijët e

saj të kapërcenin kundërshtimin e tyre për të takuar të atin. M.K. u gjet fajtores dhe u gjosit për mos ekzekutim të urdhrit të përkohshëm të kontaktit, duke mos lejuar që M.G. të takonte babanë e tij pa praninë e J.G. Deri në mars të vitit 2009, kërkuesi nuk kishte parë fëmijët e tij për tre vjet dhe kur ai kishte kërkuar ti takonte ata, fëmijët kishin qenë të shqetësuar dhe deklaruan se nuk donin ta shihnin kërkuesin.

Pasi M.G. pësoi një atak ankthi përpara një takimi të planifikuar me kërkuesin në shkurt të vitit 2011 gjykata vendase urdhëroi hartimin e një raporti nga Qendra e Kujdesit Social, në të cilin u paraqit se M.G. kishte një aftësi të kufizuar intelektuale në shkallë të moderuar. Ai ndihej i dashur dhe i pranuar nga nëna dhe motra e tij, ndërkohë nëna e tij besonte se M.G. kishte frikë nga kërkuesi. Megjithatë, raporti theksonte se kishte pasur raste kur kërkuesi ishte takuar me të birin dhe ky i fundit nuk kishte shfaqur ndonjë frikë apo ankth, dhe në të vërtetë takimet kishin qenë të ngrohta dhe të dashura. Në maj 2011 shërbimet sociale organizuan një takim mes M.G. dhe kërkuesit në praninë e punonjësve socialë. Ky takim zgjati një orë dhe kaloi këndshëm, M.G. duke folur dhe duke qeshur me babain e tij. Megjithatë, pas kthimit në shtëpi, M.K. raportoi se M.G. ishte mërziqur qëndrim ky i konfirmuar nga një mjek, që M.K. kishte kërkuar ndihmë.

Takimi i radhës mes kërkuesit dhe të birit i planifikuar në qershor 2011, u anulua sepse M.K. informoi Qendrën e Kujdesit Social se ajo nuk mund të shoqëronte M.G. në takim. Gjyshja e M.G. nga ana e nësës telefoni shërbimet sociale dhe u tregua verbalisht agresive ndaj punonjësit social të caktuar për rastin në fjalë. Pasi u informua se takimi ishte anuluar Z.K.V. dhe J.G. mori M.G. në Qendrën e Kujdesit Social dhe ishin verbalisht agresiv ndaj punëtorëve social atje. Punonjësi social raportoi se M.G. kishte shfaqur shenja frike dhe hutimi. Në vitin 2013, dy vjet më vonë, M.K. dhe Z.K.V. u liruan nga akuza për mos ekzekutim të urdhërit të përkohshëm të gjykatës lidhur me këtë incident.

Pas këtij incidenti, u zhvilluan në Qendrën e Kujdesit Social takime të përjavshme mes M.G. dhe kërkuesit të cilat zgjantën nga një orë dhe nuk patën asnjë problem. Megjithatë, në fund të vitit 2011, procedurat e ekzekutimit të vendimit u ndërpreën pasi procesi gjyqësor kishte përfunduar. Në vitin 2015 M.K. mori një urdhër ekzekutimi të këtij vendimi.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Në bazë të nenit 8 të Konventës, kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut se autoritetet vendase nuk kishin zbatuar ligjin në mënyrë efektive me qëllim që të mund të ishte siguruar e drejta e tij për të takuar fëmijët. Gjithashtu, ai

pretendoj se autoritetet duhet të kishin ndërmarrë më shumë hapa për ta ndihmuar atë të rivendoste kontakt me fëmijët e tij.

### Neni 8

Gjykata nënvizoi se gëzimi i të drejtës së prindërve dhe fëmijëve për të qëndruar bashkë me njëri-tjetrin përbën një element themelor të jetës familjare sipas nenit 8. Shteti ka një detyrim pozitiv për të lehtësuar takimin pas divorcit mes prindit të cilit nuk i është lënë kujdestaria dhe fëmijëve të tij. Megjithatë, ky detyrim nuk është absolut dhe në këtë rast duhet të arrihet një ekuilibër ndërmjet interesave dhe të drejtave të fëmijës, të nënës, të kërkuesit dhe shoqërisë, duke mbajtur gjithmonë në vëmendje që interesi më i lartë i fëmijës të mbizotërojë mbi interesat e palëve të tjera. Në mënyrë domethënëse, çdo shtrëngim i aplikuar nga shteti në këto raste duhet të balancohet me interesat konkurrues të palëve dhe nevojës për të mbajtur në konsideratë gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës sipas nenit 8. Për rrjedhojë, në çështjen objekt gjykimi shteti duhej të lehtësonte kontaktin mes palëve aq sa mund të konsiderohej e arsyeshme në dritën e rrethanave të rastit.

Gjykata vlerësoi se çështja kryesore për t'u shqyrtuar në këtë rast ishte nëse autoritetet serbe i kishin ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të lehtësuar zbatimin e urdhrin të përkohshëm të kontaktit. Pasi kërkuesi kërkoi ekzekutimin e urdhrin të përkohshëm, ishin kryer katërmëdhjetë përpjekje për ekzekutimin e tij nga përmbartuesi gjyqësor vendas në praninë e kërkuesit dhe në njërën nga ato raste ishte prezent dhe një oficer policie. Gjykata vendase kishte pyetur në dy raste vetë fëmijët dhe kishte kërkuar rregullisht rekomandime dhe raporte nga Qendra e Kujdesit Social. Për më tepër, M.K. u ndoq penalisht, dënua dhe u gjobit për mos ekzekutim të urdhrin të ndërmjetëm. Më tej, Gjykata vërejti se autoritetet kishin qenë proaktive në sjelljen e tyre për të zgjidhur situatën, duke organizuar takime të mbikëqyrura midis kërkuesit dhe M.G.

Pavarësisht nga disa periudha pasiviteti, Gjykata vërejti se autoritetet serbe kishin vepruar me zell në këtë rast, edhe pse veprimet e tyre nuk patën shumë ndikim në të drejtën e kërkuesit për të qenë pjesë efektivisht në jetën e fëmijëve të tij, ose për t'i vizituar ata rregullisht. Vështirësitë në këtë drejtim ishin kryesisht për shkak të ngurrimit të vajzës për të takuar babanë e saj, si dhe për refuzimin e M.K.-së për të lejuar M.G. të takonte të atin pa praninë e së motrës. Gjithashtu, fëmijët deklaruan para gjykatës vendase se asnjëri prej tyre nuk dëshironte të takonte të atin. Gjykata vuri në dukje se konfliktet midis prindërve në njërën anë, si edhe midis prindërve dhe fëmijëve në anën tjetër janë jashtëzakonisht të ndjeshme për të gjitha palët dhe se zgjidhja e tyre mund të jetë veçanërisht e vështirë për autoritetet vendase.

Më tej, Gjykata iu referua një raporti të hartuar nga Qendra e Kujdesit Social, i cili pohonte se përpjekjet e vazhdueshme për të zbatuar urdhrin e përkohshëm do të shkaktonin një presion të shtuar mbi fëmijët, si edhe faktin se kërkuesi kishte refuzuar të pranonte zbatimin e metodave të tjera, që mund t'i bënin të mundur ushtrimin e të drejtave të tij. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se takimet e paautorizuara dhe të pa mbikëqyrura të kërkuesit me djalin e tij në shkollë nuk ishin një mënyrë konstruktive për të vendosur kontakt prindëror me një fëmijë veçanërisht vulnerabël. Për rrjedhojë, vetë kërkuesi mund të kontribuonte në një farë mase në vështirësimin e rrethanave të çështjes. Kërkuesi nuk kishte provuar mënyra të tjera alternative për të përmirësuar kontaktin me fëmijët e tij, për shembull duke arritur një marrëveshje me M.K., si edhe as nuk kishte ndjekur në mënyrë aktive përpjekjen për të marrë kujdestarinë e fëmijëve, konkretisht duke mos u paraqitur në procesin gjyqësor, që kishte iniciuar vetë.

Gjykata theksoi se detyrimet e shtetit në kuadër të nenit 8 nuk janë për arritjen e ndonjë rezultati të veçantë, por për mjetet që implikohen. Për rrjedhojë, megjithëse kërkuesi ende nuk ishte në gjendje të ushtronte plotësisht të drejtat e tij prindërore, autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bërë të mundur zbatimin e këtyre të drejtave. Kështu, në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

*Urdhri për kujdestari urgjente për fëmijën e sapo lindur përbënte shkelje të së drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës familjare sipas nenit 8*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN K. DHE T. k. FINLANDËS**

(Kërkesa nr. 25702/94)

**12 korrik 2001**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, një mama dhe bashkëjetuesi i saj T., janë shtetas finlandez. K. ishte nëna e 4 fëmijëve dhe T. është babai i dy prej tyre.

Kërkuesja K. ishte shtruar në spital në disa raste, pasi u diagnostikua si e sëmurë nga skizofrenia. Në maj të vitit 1993, kur ajo ishte duke pritur fëmijën e saj të tretë J., Bordi i Mirëqenies Sociale, duke pasur parasysh se K. nuk ishte në gjendje për t'u kujdesur për fëmijën e saj të dytë M., e vendosi këtë të fundit në shtëpi për fëmijë, si një masë mbështetëse afatshkurtër e marrë me pëlqimin e kërkuesve. Sapo fëmija i tretë lindi në qershor të vitit 1993, J. ishte vendosur në përkujdesje në repartin e fëmijëve të spitalit, në bazë të një urdhri emergjence, dhënë duke pasur parasysh gjendjen e paqëndrueshme mendore K. dhe vështirësitë e familjes. Në një urdhër të mëtejshëm emergjent, i lëshuar disa ditë më vonë, edhe fëmija i dytë M. ishte vendosur në përkujdesje.

Kërkueses K. iu ndalua takimi me fëmijët pa mbikëqyrje. Ajo u shtrua përsëri në spital për shkak të psikozës. Urdhrat për kujdestari urgjente u zëvendësuan me urdhër të kujdesit normal në korrik të vitit 1993. Këto urdhra u konfirmuan nga Gjykata Administrative e Qarkut. Gjykata e Lartë Administrative refuzoi ankimin e kërkuesve.

Në shtator të vitit 1993 kufizimi i aksesit u zgjat dhe në 1994 fëmijët u vendosën në një shtëpi kujdestare rreth 120 kilometra larg kërkuesve. Punonjësit e mirëqenies sociale thuhet se u kanë thënë kërkuesve dhe prindërve birësues se vendosja e fëmijëve aty do të zgjaste me vite. Kërkuesit propozuan, po pa sukses, që marrëveshjet mes tyre dhe prindërve birësues të bëheshin në shtëpinë e të afërmeve dhe se në çdo rast duhet të synonin ribashkimin e familjes. Në maj të vitit 1994 qasja e kërkuesve kundrejt fëmijëve të tyre ishte e kufizuar në një vizitë në muaj, e cila duhet të kryhej nën mbikëqyrje në shtëpinë kujdestare. Në dhjetor të vitit 1994 drejtori i qendrës sociale informoi kërkuesit se nuk kishte më arsye për t'ju kufizuar qasjen me fëmijët. Megjithatë, Bordi i Mirëqenies Sociale autorizoi vetëm takime të mbikëqyrura me fëmijët



të organizuara vetëm një herë në muaj. Bordi e konfirmoi këtë vendim në janar të vitit 1995 dhe ankimi i kërkuesve u rrëzua.

Ndërkohë, në maj 1994, kërkuesit kishin kërkuar revokimin e urdhrave të kujdesit. Kjo kërkesë u refuzua nga Bordi i Mirëqenies Sociale në mars të vitit 1995. Në prill të vitit 1995, K. lindi një fëmijë të katërt, i cili nuk u vendos në kujdes social. Pak kohë më pas K. u mor përsëri në kujdes të detyrueshëm psikiatrik për gjashtë javë, përsëri për shkak të problemeve me skizofreninë.

Plani i kujdesit social u rishikua përsëri në maj 1996 dhe në prill 1997, por kufizimi i qasjes së kërkuesve në raport me fëmijët e tyre u ruajt. Në dhjetor 1998, autoritetet sociale konsideronin se ribashkimi i familjes nuk ishte një opsion i mundshëm. Në nëntor të vitit 2000 kërkuesit dhe fëmijët u lejuan të takoheshin një herë në muaj pa mbikëqyrje. Këto kufizime mbetën në fuqi deri në fund të vitit 2001.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Në vendimin e datës 27 prill 2000 dhënë nga Dhoma, Gjykata vendosi që në çështjen objekt gjykimi nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me vendosjen e fëmijëve në regjimin e kujdesit social dhe refuzimin për ta ndryshuar këtë vendim. Gjithashtu, Dhoma vlerësoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 13. Çështja u referua me kërkesë të qeverisë pranë Dhomës së Madhe në kuadër të nenit 43 të Konventës.

Kërkuesit u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për një jetë të qetë familjare garantuar nga neni 8, në lidhje me faktin se fëmijët e tyre J. dhe M. ishin vendosur në regjimin e kujdesit social. Ata u ankuan gjithashtu se nuk kishin pasur në dispozicion një mjet ligjor efektiv e drejtë e garantuar nga neni 13.

### Neni 8

Së pari, Gjykata konstatoi se ngjarjet përbënin një ndërhyrje në jetën familjare që ekzistonte mes kërkuesve dhe fëmijëve të tyre brenda kuptimit të nenit 8 § 1 të Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar sipas nenit 8 § 2.

### Urdhrat për kujdestari urgjente

Gjykata pranoi se kur nxirret një urdhër urgjent për kujdestari nuk ishte gjithmonë e mundur që, për shkak të karakterit urgjent të situatës, të merrnin pjesë në procesin vendimmarrës edhe personat që kishin kujdestarinë e fëmijës. Kjo nuk ishte as e

dëshirueshme, nga ana tjetër, në qoftë se këta persona shiheshin si burim kërcënimi të menjëhershëm ndaj fëmijës. Gjykata u bind gjithsesi me faktin që autoritetet finlandeze kishin të drejtë të vlerësonin që në lidhje me J. dhe me M. ekzistonin rrethana që justifikonin marrjen e tyre nga kujdestaria e kërkuesve pa një këshillim paraprak. Në mënyrë të veçantë, i takonte autoriteteve finlandeze të vendosnin që, përpara fillimit të zbatimit të çdo mase kujdestarie, ishte ndërmarrë një vlerësim i kujdesshëm i impaktit të masës së kujdestarisë së propozuar kërkuesve dhe fëmijëve si dhe i të gjitha mundësive të tjera për vendosjen e fëmijëve në kujdes publik.

Gjykata e gjeti të arsyeshëm faktin se autoritetet kishin besuar, që paralajmërimi i K. për marrjen e fëmijëve nën kujdes urgjent mund të kishte pasojë të rrezikshme në dëm të vetë kërkueses por eventualisht dhe fëmijëve të saj. Gjithashtu ishte i arsyeshëm vlerësimi i bërë nga ana e autoriteteve se T. nuk do të ishte i aftë të kujdesej njëherazi për K. e cila kishte probleme të shëndetit mendor dhe fëmijëve J. dhe M. As përfshirja vetëm e T. në procesin vendimmarrës nuk ishte një mundësi reale për autoritetet, duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë mes kërkuesve dhe gjasat për shkëmbim informacioni.

Megjithatë, marrja e një fëmije të sapo-lindur në kujdes publik në momentin e lindjes së tij ishte një masë tejet e rëndë. Duhej të ekzistonin arsye tepër të forta që një foshnjë të mund të merret fizikisht nga kujdesi i nënës së tij në kundërshtim me dëshirën e kësaj, menjëherë pas lindjes dhe si pasojë e një procedure në të cilën as ajo dhe as personi që bashkëjetonte me të nuk kishin marrë pjesë. Nuk doli që arsye të tilla të ekzistonin. Autoritetet ishin në dijeni për lindjen e pritshme të J muaj më përpara si dhe për problemet mendore të K.-së, kështu që situata nuk ishte urgjente nga pikëpamja e pa parashikueshmërisë së saj. Qeveria Finlandeze nuk kishte vlerësuar dhe as propozuar mundësi të tjera të mbrojtjes së J. nga rreziku i vuajtjeve fizike nga ana e K.-së. Kur merret një masë e tillë drastike e cila menjëherë e privon një nënë nga fëmija i saj i sapo-lindur, u del për detyrë autoriteteve shtetërore që të shqyrtojnë nëse janë të mundshme ndërhyrje të një shkalle më të lehtë në jetën familjare në një moment kaq kritik të jetës së prindërve me fëmijët e tyre. Arsyet në të cilat u bazuan autoritetet ishin të rëndësishme por jo të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen serioze në jetën familjare të kërkuesve. Edhe duke mbajtur parasysh hapësirën e vlerësimit të autoriteteve shtetërore, Gjykata arriti në përfundimin se urdhrat emergjentë të kujdestarisë në lidhje me J dhe metodat e përdorura në vënien në zbatim të këtij kujdesi nuk ishin në përpjesëtim me qëllimin e ndjekur. Pra, megjithëse kishte pasur një “nevojë” për të marrë disa masa paraprake për të mbrojtur J., ndërhyrja në jetën familjare të kërkuesve nuk mund të shihej sikur kishte qenë “e nevojshme” në një shoqëri demokratike.

Vlerësime të ndryshme u bënë në lidhje me M. Autoritetet kishin të drejtë të ishin të shqetësuara në lidhje me aftësinë e K-së, edhe e ndihmuar nga T., që të vazhdonte të kujdesej për familjen e saj në një mënyrë normale edhe pas lindjes së fëmijës së saj të tretë. M. po tregonte shenja shqetësimi dhe kështu që kishte nevojë për një kujdes të veçantë. Urdhrat emergjentë të kujdesit në lidhje me të nuk mund të kishin të njëjtat pasoja ndaj jetës familjare të kërkuesve si ato të marra në lidhje me J.. M. ishte veçuar fizikisht nga familja e tij si rezultat e vendosjes së tij vullnetare në një shtëpi fëmijësh. Mosmarrja pjesë e T. dhe K. në procesin e vendimmarrjes ishte e kuptueshme në kuadrin e mosprovokimit të një krize në familje përpara ngjarjes stresuese të lindjes së J.. Autoritetet shtetërore kishin të drejtë pra ta konsideronin të nevojshme marrjen e masave të jashtëzakonshme, për një periudhë të kufizuar kohe, në interes të M.

#### *Urdhrat mbi kujdestarinë normale*

Duke pasur parasysh që detyra parësore e autoriteteve ishte mbrojtja e interesave të fëmijës, Gjykata nuk kishte arsye që të dyshonte që autoritetet ishin në gjendje që të mund të vlerësonin se vendosja e fëmijëve në kujdes publik duke filluar nga 15 korriku 1993 dhe në një shtëpi fëmijësh duke që nga fillimi i vitit 1994 ishte më e preferueshme se sa vazhdimi i masave të kujdestarisë normale ose të masave të tjera të ngjashme. Nuk mund as të thuhet, nga ana tjetër, se urdhrat normalë mbi kujdestarinë ishin vënë në zbatim me ndonjë nxitim të veçantë ose në një mënyrë jo të zakonshme. Për më tepër, kërkuesit kishin marrë pjesë në mënyrë të plotë në procesin e vendim-marrjes të urdhrave normalë të kujdestarisë dhe në këtë mënyrë interesat e tyre ishin mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.

#### *Pretendimi për mos marrjen e masave të duhura për bashkimin e familjes*

Gjykata kujtoi parimin themelor se kujdesi publik i fëmijës duhet që në parim të shihet si një masë e përkohshme, që duhet të marrë fund sa më shpejt që këtë ta lejojnë rrethanat. Çdo masë që synon të vërë në zbatim një kujdes të tillë të përkohshëm duhet të jetë në përputhje me qëllimin final të ribashkimit të prindërve natyrorë dhe fëmijës. Detyrimi pozitiv për të marrë masa për të lejuar ribashkimin familjar sa më shpejt që ky të jetë logjikisht i mundur bëhet gjithnjë e më i ndjeshëm me kohëzgjatjen e periudhës së kujdestarisë, me kusht që ky detyrim duhet të jetë në balancë me detyrimin për të vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës.

Gjykata vuri në dukje se nuk ishin bërë disa vlerësime me qëllim që të vlerësohej nëse kërkuesit do të ishin në gjendje të merreshin me J. dhe M.. Ose, gjithsesi mund të thuhet se ato nuk arrinin të përbënin një përpjekje serioze dhe të fortë për të lehtësuar ribashkimin familjar. Minimumi i pritshëm nga ana e autoriteteve ishte ai që ato

të analizonin situatën herë pas here, për të parë nëse ka pasur ndonjë përmirësim në situatën familjare. Mundësitë e ribashkimit do të zvogëloheshin dhe eventualisht do të zhdukeshin në qoftë se prindërit biologjikë dhe fëmijët e tyre nuk do të lejoheshin fare të takonin njëri tjetrin, ose ta takonin aq rrallë sa të mund të krijohej ndërmjet tyre një lidhje e natyrshme. Kufizimet dhe ndalimet e vendosura ndaj kërkuesve në lidhje me mundësinë e tyre për të takuar fëmijët më tepër e penguan sesa e ndihmuan ribashkimin e mundshëm të familjes. Në këtë çështje, ishte vërtet i çuditshëm qëndrimi negativ jashtëzakonisht i vendosur nga ana e autoriteteve. Për këto arsye kishte një shkelje të nenit 8 në këtë kuadër.

#### Kufizimet dhe ndalimet e takimeve

Për aq sa kërkesa në lidhje me kufizimet e takimeve mbulohej nga konstatimi i një shkeljeje të nenit 8 si rezultat i mos marrjes së hapave të mjaftueshëm për ribashkimin e familjes së kërkuesve, nuk ishte e nevojshme për Gjykatën që të shqyrtonte masat e kundërshtuara si një burim i një shkeljeje më vete. Duke pasur parasysh situatën konkrete, përfshirë edhe periudhën pas dhënies së vendimit fillestar të Gjykatës (nga Dhoma), Dhoma e Madhe arriti në të njëjtin përfundim si edhe Dhoma. Duke vlerësuar gjendjen e fëmijëve gjatë periudhës së fundit vlerësimi i autoriteteve në lidhje me nevojën e kufizimit të takimeve nuk përbënte shkelje të nenit 8 § 2.

#### Neni 13

Dhoma e Madhe nuk gjeti arsye të ndryshonte qëndrimin e Dhomës në lidhje me pretendimet për nenin 13.

#### Neni 41

Dhoma e Madhe mbajti të njëjtin qëndrim si Dhoma në lidhje me akordimin e një dëmshpërblimi për dëmin jo material në vlerën 40,000<sup>156</sup> FIM për secilin kërkues. Gjithashtu, Gjykata i akordoi atyre përpos vlerës për shpenzime gjyqësore vendosur nga Dhoma në shumën prej 5,190 FIM edhe 60,000 FIM për procesin përpara Dhomës së Madhe.

---

<sup>156</sup> Vlera e përafërt 1 FIM = 0.17 €.

*Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore nuk garantoi të drejtën e takimeve të rregullta mes një nëne dhe djalit të saj duke shkelur të drejtën për respektimin e jetës familjare*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN K.B. DHE TË TJERËT k. KROACISË**

(Kërkesa nr. 36216/13)

**14 mars 2017**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkesa u paraqit nga K.B. ("kërkuesja") në emër të saj dhe dy fëmijëve të saj të mitur, D.B. dhe P.B. ("fëmijët"). Ata ishin të gjithë shtetas kroatë, të lindur respektivisht në vitet 1968, 2001 dhe 2005. Kërkuesja jetonte në vendin I., ndërsa fëmijët jetonin me babanë e tyre, I.B., në vendin S.

Në mars 2009, marrëdhëniet e kërkueses me babain e fëmijëve, I.B., u prishën. Kërkuesja dhe fëmijët pastaj u zhvendosën nga S., ku familja jetonte së bashku drejt vendbanimit të prindërve të saj në I. Proceset gjyqësore në lidhje me divorcin dhe kujdestarinë e fëmijëve kishin nisur në prill 2009. Në nëntor 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Ivanić-Grad ia dha përkohësisht kujdestarinë e fëmijëve kërkueses dhe i akordoi shtetasit I.B. të drejtën e kontaktit me ta. Në maj të vitit 2010 ekspertët psikiatër rekomanduan që të jepej një urdhër mbrojtjeje për fëmijët për pezullim të ushtrimit të së drejtës së prindërimit, masë e cila u dha në maj 2011.

Në korrik dhe gusht 2010, fëmijët kaluan pushimet e tyre verore me të atin, pas miratimit të një mase të përkohshme dhënë pas kërkesës së I.B., më 18 qershor 2010. Gjatë kësaj periudhe kërkueses iu dha e drejta për tu takuar me fëmijët në banesën e I.B. dhe mbajtja e kontaktit përmes telefonit. Më 28 qershor 2010 kërkuesja apeloi kundër masës së dhënë, duke u ankuar se kjo masë ishte si e papranueshme për arsye psikologjike, si edhe tepër e kushtueshme. Ankimi i saj u refuzua pas majit 2011.

Në fund të gushtit 2010, I.B. nuk i shoqëroi fëmijët tek kërkuesja. Në kohën që çështja gjykohej në pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, fëmijët ende jetonin me të. Në shtator të vitit 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Splitit dha një vendim ekzekutimi, i cili e detyronte I.B. të dorëzonte fëmijët tek kërkuesja. Kjo urdhër u prish nga gjykata e apelit në maj 2011.

Në vendimin mbi divorcin e çiftit dhënë në prill të vitit 2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Splitit i akordoi kujdestarinë e fëmijëve I.B. ndërkohë, kërkueses iu dha e drejta e kontaktit me fëmijët, e drejtë kjo që do të ushtrohej në vendin I. Megjithatë, kjo

e drejtë nuk u ekzekutua asnjë herë. Në qershor 2011 K.B. paraqiti një kërkesë në të njëjtën gjykatë ku pretendoi ekzekutimin e vendimit të mësipërm, por kërkesa e saj u hodh poshtë në dhjetor 2011 me arsyetimin se I.B. nuk e kishte penguar atë në ushtrimin e të drejtave të saj të takimit, të cilat mbetën të pazbatuara vetëm për shkak të rezistencës së fortë të fëmijëve për të takuar nënën e tyre. Në gusht 2012 gjykata urdhëroi që kontakti mes K.B. dhe fëmijëve të bëhej nën mbikëqyrjen e një specialisti nga Qendra e Mirëqenies Sociale të Splitit. Ky vendim nuk u zbatua kurrë.

Në qershor të vitit 2015, raporti i përgatitur nga një ekspert deklaroi se largimi i fëmijëve nga nëna e tyre ishte rezultat i sjelljes negative të babait të tyre ndaj saj. Raporti rekomandoi se babai duhet të ndiqte seanca psikoterapie, rekomandim ky i cili më pas u urdhërua edhe nga gjykata. Në gusht të vitit 2015, kërkesja duke u mbështetur në ekspertizën e lartpërmendur, kërkoi që I.B. t'i hiqej kujdestaria e fëmijëve. Gjykata vendosi që kërkesa e K.B. të shqyrtohej së bashku me kërkesën e saj fillestare për një ndryshim të takimeve me fëmijët. Duket se në kohën kur çështja shqyrtohej në Strasburg ky proces ishin ende në pritje përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Splitit.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesja u ankuar se autoritetet vendase kishin shkelur detyrimin e tyre pozitiv në kuadër të nenit 8 të Konventës, kur nuk kishin siguruar garantimin e të drejtës së saj për t'u takuar me fëmijët

### Neni 8

Gjykata vërejti se shtetet kanë një detyrim pozitiv në kuadër të nenit 8 për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm, që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme në rrethanat specifike të çdo rasti për të lehtësuar kontaktin midis prindërve dhe fëmijëve të tyre. Mjaftueshmëria e masave duhet të gjykohet përmes shpejtësisë së zbatimit të tyre, pasi në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e të drejtave të kontaktit, kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pariparueshme për marrëdhëniet familjare duke rezultuar në një zgjidhje *de facto* të çështjes.

Më tej, Gjykata theksoi se ndonëse opinionet e fëmijëve duhet të merren parasysh, e drejta e një fëmije për të shprehur pikëpamjet e tij nuk duhet të interpretohet si mënyrë efektive duke u dhënë atij një fuqi të pakushtëzuar vetoje. Është gjithmonë nevoja për kryerjen e një ekzaminimi për të përcaktuar interesin më të lartë të fëmijës, interes i cili dikton, që lidhjet e fëmijës me familjen duhet të mbahen, përveç rasteve kur kjo do të dëmtonte seriozisht shëndetin dhe zhvillimin e tij/saj.

Kështu, në raste si çështja objekt gjykimi, ku fëmijët kundërshtuan kontaktin me njërin prind, neni 8 kërkon që shtetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të identifikuar shkaqet e kësaj rezistence dhe t'i adresojnë këto shkaqe në përputhje me rrethanat. Ky detyrim lidhet me mjetet e jo me rezultatet dhe mund të kërkojë masa ose faza përgatitore. Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i të gjithë të interesuarve përbën një element tepër të rëndësishëm. Megjithatë, meqenëse autoritetet duhet të bëjnë maksimumin për të lehtësuar një bashkëpunim të tillë, mungesa e tij nuk ishte një rrethanë e cila në vetvete mund t'i përjashtonte autoritetet kroate nga detyrimet e tyre pozitive në kuadër të nenit 8. Përkundrazi, ishte detyrë e tyre të merrnin masa për të pajtuar interesa konfliktuale, duke mbajtur parasysh si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijëve. Vetëm pas marrjes së masave të tilla, autoritetet vendase mund të konsiderohen se kanë përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8.

Duke u kthyer në rrethanat e veçanta të çështjes, Gjykata ka vërejtur se fëmijët kishin filluar të largoheshin nga nëna e tyre gjatë pushimeve verore në korrik dhe gusht 2010, të cilat i kaluan me babanë e tyre. Në këtë periudhë, kërkuesja nuk i kishte takuar fëmijët për shkak të një vendimi gjyqësor të 18 qershorit 2010, sipas të cilit ajo mund t'i ushtronte të drejtat e saj të takimit në shtëpinë e I.B. Kërkuesja e kishte ankimuar këtë pjesë të vendimit, duke u ankuar se masa ishte e papranueshme për arsye psikologjike dhe kostosh. Megjithatë, vetëm në maj 2011, thuhet se 11 muaj pas përfundimit të afatit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Rrethit të Splitit vendosi mbi ankesën e kërkueses. Në lidhje me këtë, gjykata nuk kishte njohur urgjencën e situatës dhe kishte injoruar ligjet vendase, sipas të cilave, për ankimet në çështjet familjare duhet të merrej vendim brenda gjashtëdhjetë ditëve. Për më tepër, kur hodhi poshtë ankesën e kërkuesit, Gjykata e Rrethit të Splitit nuk i kushtoi vëmendje argumentit të saj lidhur me pazbatueshmërinë e marrëveshjeve të takimit.

Gjykata theksoi më tej se, përveç masave të përkohshme të 18 qershorit 2010, të cilat ishin të zbatueshme vetëm për pushimet verore të 2010-ës, gjykatat vendase nuk e rregulluan në mënyrë të përkohshme çështjen e kujdestarisë dhe të drejtave të takimit në lidhje me fëmijët, në procedurat e zgjidhjes së martesës dhe kujdestarisë. Kjo çështje ishte shqyrtuar gjatë procedurave të njëkohshme në lidhje me rregullimin e të drejtave të takimit të I.B., megjithatë këto procedura përfunduan pa një vendim detyrues në prill të vitit 2010. Si rezultat, urdhri i përbarimit i 13 shtatorit 2010, që urdhëronte I.B. t'i dorëzonte fëmijët kërkueses pas pushimeve verore, nuk mund të kryhej.

Siç është theksuar tashmë, fëmijët filluan të shfaqin shenja të rezistencës ndaj nënës së tyre gjatë qëndrimit me babanë e tyre në verën e vitit 2010. Megjithatë, autoritetet vendase vendosën të siguronin një opinion nga ekspertët e mjekësisë ligjore mbi

shkaqet e rezistencës së fëmijëve në nëntor të vitit 2013 dhe përfundimisht e morën atë në qershor të vitit 2015. Pra, autoriteteve vendase iu deshën pothuajse pesë vite për të siguruar mendimin e nevojshëm nga autoriteti përkatës, në mënyrë që të merinin më pas një vendim të mirëinformuar lidhur me masat që duheshin marrë për të adresuar refuzimin e fëmijëve të kërkueses për ta takuar atë.

Për më tepër, autoritetet u përfshinë në trajtimin e fëmijëve vetëm në prill të vitit 2012, megjithëse nevoja e fëmijëve për t'u trajtuar me qëllim tejkalimin e vështirësive emocionale të shkaktuara nga ndarja e prindërve të tyre, ishte identifikuar nga ekspertët që në korrik dhe më pas tetor 2009. Kurset e ndryshme të trajtimit, të cilëve fëmijët iu nënshtroan gjatë viteve, nuk ishin rregullisht të monitoruara, të rregulluara ose të koordinuara nga autoritetet e mirëqenies apo gjyqësorit.

Së fundmi, Gjykata vuri në dukje se Qendra e Mirëqenies Sociale e Splitit vendosi masën e mbrojtjes së fëmijëve për mbikëqyrjen e ushtrimit të autoritetit prindëror vetëm në maj 2011, pra më shumë se një vit pasi ekspertët e mjekësisë ligjore kishin bërë një rekomandim të tillë dhe tetë muaj pasi fëmijët filluan të shprehnin hezitimin për të pasur kontakt me nënën e tyre. Masat e imponuara nuk kishin mundësuar dërgimin e fëmijëve për një trajtim të rregullt, gjë që do ta bënte këtë trajtim të detyrueshëm dhe autoritetet do të ishin të detyruara ta monitoronin atë.

Duke pasur parasysh vonesat dhe mangësitë e mësipërme, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase nuk i kishin përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 ndaj kërkuesit lidhur me të drejtën e saj për respektimin e jetës familjare. Kështu, kishte pasur shkelje të këtij neni.

#### Neni 41

Kërkueses iu akorduan 12,500 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 3,780 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

#### Neni 46

Kërkuesja kishte kërkuar nga Gjykata të merrej një masë individuale me qëllim që të ndihmonte Shtetin përgjegjës të përmbushte detyrimet e tij për t'i nënshtroar vendimit përfundimtar të Gjykatës, përkatësisht t'i kërkonte shtetit të siguronte një takim të efektshëm ndërmjet saj dhe fëmijëve të saj në mjedise të përshtatshme dhe me të gjitha masat e nevojshme dhe relevante të mbështetjes psikologjike. Megjithatë, Gjykata nuk pranoi, me arsyetimin se çështja në fjalë kishte të bënte me një situatë në zhvillim e sipër dhe ishte ende në pritje para gjykatave vendase.



*Dështimi i autoriteteve për të marrë hapat e nevosjshme për të lehtësuar kontaktin mes babit dhe të birit, të dy me aftësi të kufizuar, përbënin shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KACPER NOWAKOWSKI k. PLONISË**

(Kërkesa nr. 32407/13)

**10 janar 2017**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Kacper Nowakowski, ishte shtetas polak i lindur në 1976 i cili ishte shurdh-memec. Në 2005 ai u martua me A.N., e cila vuante gjithashtu nga një dëmtim në dëgjim dhe ata patën një fëmijë, S.N., i cili lindi në 2006. Fëmija vuante nga një dëmtim në dëgjim.

Në 2007 A.N. kërkoi divorcin. Gjatë procesit u kërkua një vlerësim i ekspertit, i cili deklaroi se midis fëmijës dhe nënës ekzistonin lidhje të forta emocionale, ndërsa ato me kërkuesin i përshkruante si lidhje të dobëta dhe sipërfaqësore. Në nëntor 2007, Gjykata Rajonale e Białystok vendosi që autoriteti prindëror duhej të ndahej mes dy prindërve dhe se fëmija duhet të banonte me nënën. Kërkuesit iu lejua të shihte djalin e tij një herë në javë për dy orë. Vendimi nuk u apeluar dhe u bë përfundimtar.

Në vitin 2011, kërkuesi paraqiti një kërkesë për të pasur një kontakt më të gjatë me të birin, duke kërkuar që takimet të bëheshin jashtë shtëpisë së A.N.-së, dhe pa praninë e saj, pasi ajo më parë penguar takimet e tyre. Qëllimi i kërkuesit ishte të forconte lidhjet e tij me fëmijën, i cili kishte arritur moshën pesë vjeçare. Nga një opinion i mëtëjshëm, i cili theksonte natyrën e vështirë të marrëdhënies baba-fëmijë dhe sesi vështirësitë në komunikim dhe konflikti midis prindërve kishte ndikuar në dobësimin e kësaj lidhje. Z. Nowakoëski i kundërshtoi këto përfundime dhe argumentoi se këto opinione duhet të ishin përgatitur me ndihmën e specialistëve për personat e shurdhër, por kërkesa e tij u rrëzua. Ai pohoi se konstatimet e bërë për shkak të aftësisë së kufizuar të tij përbënin diskriminim.

Në gusht 2012 Gjykata e Rrethit Białystok e hodhi poshtë kërkesën e kërkuesit, duke e bazuar vendimin e saj, *inter alia* mbi vlerësimet dhe konstatimet e ekspertit, varësinë e fëmijës ndaj nënës së tij dhe në fund interesin më të lartë të fëmijës. Ajo konstatoi se përfshirja e nënës ishte e domosdoshme, pasi ajo mund të përdorte gjuhën e shenjave dhe të komunikonte me gojë, ndërsa babai përdorte kryesisht shenjat dhe djali komunikonte vetëm gojarisht. Kërkuesi e apeloj çështjen për ajo ju hodh poshtë.

Në vitin 2011, nga ana e A.N. u iniciuan procese të ndara lidhur me fushëveprimin e autoritetit prindëror të kërkuarit. Në vitin 2012 autoriteti prindëror i kërkuarit ndaj fëmijës së tij u kufizua për çështje që kishin të bënin me arsimimin e tij.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuari ankohej se vendimi në lidhje me të drejtat për të mbajtur kontakt përbënte shkelje të nenit 8 e drejta për respektimin e jetës familjare dhe se rrëzimi i kërkesës së tij për zgjatje kohën e takimit (kontaktit) përbënte shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 8 të Konventës, pasi bazohej vetëm në aftësinë e tij të kufizuar.

### Neni 8

Fillimisht, Gjykata theksoi se gëzimi i shoqërisë së njëri-tjetrit mes një prindi dhe fëmijës përbënin një element themelor të jetës familjare, edhe nëse marrëdhëniet midis prindërve ishin thyer. Ajo më tutje vuri në dukje se autoritetet gëzojnë një hapësirë vlerësimi kur vendosin mbi çështjet e kujdestarisë, megjithatë, kërkohet një shqyrtim më i rreptë për sa i përket kufizimeve të mëtejshme, të tilla si kufizimet e vendosura në lidhje me kontaktet, pasi ato përbëjnë rrezik që marrëdhëniet familjare mes një fëmije të vogël dhe një ose të dy prindërve do të kufizoheshin efektivisht.

Gjykata pranoi se në parim, ishte në interesin më të lartë të fëmijës për të mbajtur kontakte me të dy prindërit, me qëllim që shqyrtimi i saj në rastin në fjalë të analizonte nëse autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë hapat e duhura për të lehtësuar kontaktin midis kërkuarit dhe djalit të tij dhe për rrjedhojë përmbushnin detyrimet pozitive të nenit 8.

Për këtë qëllim, Gjykata analizoi rrëzimin e kërkesës për zgjatjen e kontaktit nga dy këndvështrime të ndryshme: konflikti ekzistues midis prindërve dhe aftësia e kufizuar e z. Nowakoëski.

Përsa i takon konfliktit midis prindërve, Gjykata vuri në dukje se armiqësia ishte e njohur për gjykatat e brendshme dhe se raportet e ekspertëve kishin theksuar se si ky konflikt pengonte bashkëpunimin e plotë midis të dyve në lidhje me fëmijën, duke sugjeruar për të përdorur terapinë e këshillimit për të zgjidhur këtë situatë. Gjykatat e vendit nuk e konsideronin të nevojshëm detyrimin për t'iu nënshtruar terapisë familjare, pasi M.E.-së ju akorduan disa seanca dhe se kërkuari mund të merrte pjesë në të njëjtin grup për prindër. Më tej, Gjykata vuri në dukje se ekzistenca e mekanizmave të ndryshme ligjore mund të ndihmonin në zbutjen e konfliktit midis prindërve, por mundësia e aksesimit të tyre nuk ishte shqyrtuar siç duhet nga

autoritetet kombëtare. Si rezultat, kontakti ndërmjet fëmijës dhe kërkuesit nuk ishte lehtësuar. Gjykata konstatoi vështirësitë e hasura nga gjykatat vendase për shkak të konfliktit të prindërve, por theksoi se ato duhet të merrnin masa për të pajtuar palët në konflikt, duke pasur parasysh prevalimin e interesave të fëmijës.

Përsa i takon, aftësisë së kufizuar të kërkuesit dhe çështjeve pasuese të komunikimit, u vërejt se si tek zgjidhja e gjykatave të brendshme përfshhej nëna e fëmijës. Gjykata theksoi se një masë e tillë nuk e mori në konsideratë siç duhet armiqësinë ekzistuese mes prindërve, as pohimet e bëra nga kërkuesi lidhur me pengimin e takimeve të nënës. Autoritetet vendase duhet të kishin konsideruar masa më të përshtatshme për rrethanat specifike, me qëllim tejkalimin e pengesave të krijuara nga aftësia e kufizuar e kërkuesit. Veçanërisht, Gjykata vuri në dukje se si kërkuesi kishte kërkuar dëshmi të ekspertëve të cilët ishin specialistë që njihnin problemet me të cilat ballafaqohen ata me vështirësi në dëgjim, por kjo kërkuesë i ishte hedhur poshtë.

Gjykata vuri në dukje se nëse do të mbaheshin kontaktet e rregulluara në mënyrë të kufizuar, do të kishte mundësi, që me kalimin e kohës marrëdhënia e kërkuesit me djalin e tij mund të rrezikonte të shkatërrohej. Për këto arsye, Gjykata konstatoi se autoritetet vendase nuk kishin ndërmarrë hapat e duhur për të lehtësuar kontaktin e kërkuesit me të birin, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 8 të Konventës.

#### Neni 14 marrë së bashku me nenin 8

Duke u bazuar në analizën e mësipërme dhe shkeljen e konstatuar, Gjykata konkludoi se nuk ishte e nevojshme marrja në shqyrtim veçmas e kërkesave sipas nenit 14, marrë së bashku me nenin 4.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Polonia duhet ti paguante kërkuesit 16,250 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 698 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Dështimi për t'i garantuar kërkuesit, të cilit i ishte hequr zotësia për të vepruar, një bazë për njohjen e atësisë gjore mbi fëmijën e tij, përbënte mospërmbushje të detyrimeve të shtetit sipas nenit 8*

## VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KRUŠKOVIĆ K. KROACISË

(Kërkesa nr. 46185/08)

**21 qershor 2011**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Branko Krušković, kishte lindur në 1966. Në shkurt 2003 atij ju hoq zotësia për të vepruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Vendimi u bazua në raportin e një psikiatri, i cili rekomandonte se duhej t'i hiqej zotësia juridike për të vepruar për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh për t'ju nënshtruar një trajtimi psikiatrik për e çrregullime të personalitetit organik dhe çrregullime të personalitetit antishoqëror të cilat vinin si rezultat i abuzimit afatgjatë me drogën. Në prill të 2003 qendra lokale për mirëqenien sociale në Opatija caktoi si kujdestar ligjor të tij, nënën e tij. Në shtator 2006, kujdestar ligjor i tij u caktua babai pasi nëna e tij u sëmur. Pak pas kësaj, në një datë të paspecifikuar, një punonjës i qendrës për mirëqenien u emërua si kujdestari i kërkuesit.

Në qershor të 2007 K.S. solli në jetë një vajzë, K., dhe e quajti kërkuesin e fëmijës. Më 17 gusht 2007 kërkuesi, me pëlqimin e nënës së fëmijës, dha një deklaratë në regjistrin e lindjeve në Rijeka se ai ishte babai i fëmijës. Më pas ai u regjistrua në këtë cilësi në certifikatën e lindjes së fëmijës. Në shtator të 2007 kërkuesi bëri të njëjtën deklaratë pranë Qendrës Për Mirëqenie Sociale të Rijekas. Në tetor 2007 Qendra për Mirëqenie Sociale e Rijekës e informoi regjistrin e lindjeve se kërkuesit i ishte hequr zotësia juridike për të vepruar. Për pasojë, regjistri i lindjes apeloi pranë Zyrës së Qarkut të Administratës Shtetërore për të bërë anulimin e përfshirjes së kërkuesit në certifikatën e lindjes. Zyra e qarkut vijoi më tej me anulimin, me arsyetimin se si person që i është hequr zotësia juridike për të vepruar, kërkuesi nuk mund të njihte K., si fëmijën e tij përpara ligjit. Ky vendim nuk iu dha kërkuesit për shkak të pazotësisë së tij për të vepruar. Në mars të vitit 2010, Qendra për Mirëqenie e Opatitit parashtrroi një padi civile në Gjykatën Rrethit Gjyqësor kundër kërkuesit, K.S. dhe K., duke kërkuar që Gjykata e Rrethit Gjyqësor të konstatonte se kërkuesi ishte babai i K.. Përfundimet e kësaj padie ishin lënë pezull në kohën e gjyqimit të rastit në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Bazuar në nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ kërkuesi ankohej se atij i ishte mohuar e drejta tu regjistruar si babai biologjik i fëmijës së tij.

### Pranueshmëria

Qeveria prapësoi se deklaratat e kërkuesit se ai ishte babai i K. nuk kishin pasoja ligjore në ligjin kroat dhe për rrjedhojë mohimi i së drejtës së tij për të bërë deklaratat nuk përbënte shkelje sipas nenit 8, dhe për rrjedhojë nuk mund ishte i aplikueshëm. Gjykata vendosi që, përderisa ky rast ishte ndryshe nga rastet e mëparshme të atësisë, pasi kërkuesi nuk kishte filluar asnjë proces para gjykatave kombëtare për të vendosur atësinë e tij, marrëdhënia juridike midis fëmijës K. të lindur jashtë martesë dhe babait të tij biologjik, kërkuesit, binte në fushën e veprimit të nenit 8.

Gjykata vendosi ti bashkohej argumenteve të Qeverisë se kërkuesi nuk i kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore lidhur me themelin e çështjes.

### Neni 8

Gjykata përsëriti se neni 8 parashikon si detyrime pozitive ashtu dhe negative ndaj Shtetit për të mbrojtur të drejtat e atyre që janë brenda juridiksionit të tij. Shtetet jo vetëm që duhet të shmangin ndërhyrjet arbitrare, por edhe të miratojnë masa që synojnë të garantojnë respektimin e nenit 8. Ndërsa shtetet kanë një hapësirë vlerësimi në zbatimin e masave për përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive, Gjykata është përgjegjëse për të siguruar që këto masa janë në përputhje me Konventën. Në rastin në fjalë, Gjykata pranoi se kufizimi i të drejtave të personave që ju është hequr zotësia juridike për të vepruar në parim nuk përbën shkelje të nenit 8, por kufizime të tilla duhet t'i nënshtrohen masave mbrojtëse procedurale. Për rrjedhojë, në këtë rast roli i Gjykatës ishte shqyrtimi nëse trajtimi i çështjes së atësisë së kërkuesit ishte në kundërshtim me detyrimet pozitive të parashikuara në nenin 8.

Sipas ligjit të brendshëm, kërkuesi nuk kishte asnjë mënyrë për të dhënë ndonjë deklaratë ligjore mbi atësinë e K., përkundrazi ishte plotësisht i varur nga veprimet e qendrës kompetente për mirëqenien. Ky kufizim u justifikua nga nevoja për të parandaluar dhënien e deklaratave ligjore të detyrueshme nga personat që ju ishte hequr zotësia për të vepruar, të cilat mund të ishin në kundërshtim me interesat e tyre. Megjithatë, Gjykata vijoi të konfirmonte se kërkuesi kishte një interes thelbësor, të mbrojtur nga Konventa, në përcaktimin e të faktit biologjik lidhur me jetën e tij

private dhe familjare dhe njohjen e këtij fakti me ligj. Në këtë rast, si kërkuesi ashtu edhe nëna e fëmijës ranë dakord se kërkuesi ishte babai biologjik.

Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se autoritetet përkatëse nuk e ftuan kurrë babanë e kërkuesit, i cili ishte kujdestari i tij ligjor në atë kohë, për të dhënë pëlqimin e tij lidhur me deklaratën e atësisë së kërkuesit. Dhe nëse J.L., punonjësja e qendrës për mirëqenie sociale, e cila u bë kujdestarja ligjore e kërkuesit në atë kohë, ishte detyra e saj të vepronte në interes të kërkuesit, ku përfshihej përcaktimi i atësisë mbi fëmijën e tij. Megjithatë, nga qendra kompetente për mirëqenie sociale nuk u ndërmor asnjë hap për të ndihmuar kërkuesin.

Sipas Qeverisë, mënyra e vetme e mundshme që kërkuesit të mund ti njihej atësia e tij ishte përmes institucionit të procedurave civile, për këtë qëllim nga një qendër kompetente për mirëqenie sociale. Ndërsa kishin nisur proceset për këtë qëllim, kërkuesi ishte i paditur, pavarësisht se kurrë nuk e mohoi atësinë dhe dëshirën e tij të vazhdueshme për t'ju njohur atësia ligjërisht. Gjykata vijoi të theksonte se nuk kishte asnjë detyrim në të drejtën kombëtare që autoritetet përkatëse kombëtare të inicionin procese për të vendosur atësinë e kërkuesit dhe asnjë mënyrë që kërkuesi t'i detyronte këto autoritete që të nisnin një proces të tillë, me diskrecionin e pakufizuar të Shtetit në këtë drejtim duke derivuar në "lënien e një vakumi ligjor" ndaj kërkuesit.

Lidhur me argumentin e Qeverisë se kërkuesi nuk i kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore, Gjykata vuri në dukje se autoritetet kombëtare kishin nisur vetëm proceset gjyqësore për të caktuar kërkuesin si babain e K., dy vjet e gjysmë pasi kërkuesi u kishte kërkuar këtë gjë, duke krijuar kështu një situatë në të cilën kërkesa e kërkuesit nuk ishte marrë parasysh për asnjë arsye të qartë. Për rrjedhojë, Gjykata hodhi poshtë prapësimet lidhur me shterimin e mjeteve të brendshme ligjore.

Gjykata vendosi që një situatë e tillë nuk ishte në interesin më të lartë të kërkuesit ose fëmijës, duke përsëritur se një fëmijë i lindur jashtë martese ka gjithashtu një interes thelbësor për të marrë informacion lidhur me identitetin e prindërve të tij biologjikë, pasi ky është një aspekt i rëndësishëm i identitetit të tij personal. Për rrjedhojë, nuk u arrit një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesit publik për të mbrojtur personat që ju është hequr zotësia për të vepruar dhe interesit të kërkuesit për t'ju njohur atësia ligjërisht. Për rrjedhojë Gjykata konkludoi se Shteti nuk kishte përmbushur detyrimet pozitive të tij për të garantuar të drejtat e kërkuesit, duke shkëlur në këtë mënyrë nenin 8 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se kërkuesit duhej ti akordoheshin 1,800 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 100 euro në lidhje me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Mungesa e qartësisë në rregulloret lidhur me vizitat familjare në paraburgim dhe arbitrariteti në kufizimin e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet kërkuesit dhe të afërmeve të tij përbënte shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KURKOWSKI k. POLONISË**

(Kërkesa nr. 36228/06)

**9 prill 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Mariusz Kurkowski, ishte një shtetas polak i lindur në vitin 1960. Ai ishte anëtar i bordit drejtues të një kompanie prodhuese anijesh. Në vitin 2002 u hap një hetim lidhur me bordin drejtues dhe në dhjetor 2004, z. Kurkowski u arrestua nga Gjykata e Rrethit Gdańsk me argumentin se ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se ai kishte kryer një sërë veprash penale gjatë drejtimit të kompanisë. Vendimi për të vendosur kërkuesin në paraburgim u justifikua duke referuar si shkak rrezikshmërinë e veprave penale dhe rrezikun e pengimit të procesit. Vendimi u mbështet nga Gjykata Rajonale e Gdańsk në janar të vitit 2005.

Paraburgimi i ankuesit u zgjat me vendime të mëvonshme deri në tetor 2006 kohë kur kërkuesi u lirua. Këto vendime u mbështetën në dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer veprat penale; seriozitetin e veprave; kompleksitetin e rastit dhe rrezikun që kërkuesi mund të pengonte procesin duke nxitur dëshmitarët të jepnin dëshmi të rreme. Në gusht të vitit 2005, kërkuesi u akuzua për 11 vepra penale dhe seanca e parë u zhvillua në qershor 2006. Në dhjetor 2005, z. Kurkowski u ankua për kohëzgjatjen e procedurave, por kërkesa u refuzua pasi autoritetet vërejtën se në dritën dhe kompleksitetin e çështjes procesi gjyqësor nuk mund të konsiderohej i gjatë. Procesi penale kundër kërkuesit ishte ende në pritje kur kërkesa po shqyrtohej në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjatë periudhës së paraburgimit, kërkuesi mori disa vizita kryesisht nga mbrojtësi i tij dhe në 32 raste iu lejua të takonte familjen e tij. Më 13 mars 2006, z. Kurkowski kërkoi një vizitë shtesë nga të afërmit e tij, por kjo u refuzua pa asnjë arsye. Në tri raste kontakti mes z. Kurkowski dhe familjes së tij ishte i kufizuar pasi ata ishin ndarë nga një ndarje xhami.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 3 për shkak të kushteve të këqija të paraburgimit të tij dhe shkelje të nenit 5 (3) për shkak të kohëzgjatjes së tij. Për më tepër, për



shkelje të nenit 6 (1) në lidhje me kohëzgjatjen e procesit penal dhe nenit 8 për shkak të kufizimeve të vendosura në lidhje me vizitat e familjarëve të tij.

### Neni 3

Në rastin në fjalë, kërkuesi kaloi 4 ditë në një qeli ku ai kishte në dispozicion rreth 2.1 m<sup>2</sup> hapësirë dhe katër ditë në një qeli ku hapësira në dispozicion ishte rreth 2.6 m<sup>2</sup>. Pavarësisht se kishte gjetur shkelje në rastet e mëparshme në lidhje me kushtet e ngjashme, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e shkurtër të qëndrimit të kërkuesit në këto qeli, kushtet e ndalimit nuk arritën pragun e ashpërsisë të kërkuar në kuptim të nenit 3 të Konventës dhe për këtë arsye nuk u gjet asnjë shkelje në lidhje me këtë nen.

### Neni 5 (3)

Gjykata vuri në dukje se paraburgimi i kërkuesit ishte bazuar në një dyshim të arsyeshëm për kryerjen e veprave të rënda penale, ashpërsinë e dënimit të këtyre veprave, si dhe nevojën për të siguruar zhvillimin e procesit veçanërisht në lidhje me marrjen e provave nga dëshmitarët. Këto baza u konsideruan nga Gjykata si relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin e kërkuesit. Për më tepër, Gjykata gjeti se duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes ajo u trajtua nga autoritetet me kujdesin e duhur. Kështu, nuk u konstatua asnjë shkelje e nenit 5 (3).

### Neni 6 (1)

Ankimi lidhur me kohëzgjatjen e procesit u rrëzua për shkak të mos shterimit të mjeteve të brendshme juridike sipas nenit 35 (1) dhe (4) të Konventës.

### Neni 8

Gjykata iu referua jurisprudencës së saj të mëparshme ku kishte evidentuar se paraburgimi përfshin kufizime të qenësishme në jetën private dhe familjare të një të burgosuri. Sidoqoftë, mundësia e një të paraburgosuri ose kur është e nevojshme ndihma për të takuar familjarët e tij të ngushtë është një pjesë thelbësore e të drejtës së tij/saj për respektimin e jetës familjare. Gjykata përsëriti se çdo ndërhyrje e një autoriteti publik me të drejtën e të paraburgosurit për respektimin e jetës familjare duhet të jetë e parashikuar në ligj, duhet të ndjekë një ose më shumë qëllime legjitime dhe duhet të justifikohet si një masë 'e nevojshme në një shoqëri demokratike'.

Ankimi objekt gjykimi është analizuar si në lidhje me refuzimin e vizitave familjare ashtu edhe kufizimet në kontaktin e drejtpërdrejtë midis kërkuesit dhe familjes së tij. Lidhur me faktin e parë, Gjykata vuri në dukje se të paktën në një rast kërkesa e kërkuesit për të pasur kontakt me familjen e tij ishte hedhur poshtë pa arsyetim dhe kjo përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës familjare. Sa i përket ligjshmërisë së masës, Gjykata vuri në dukje se baza ligjore ishte gjetur në nenin 217 (1) të Kodit të Ekzekutimit të Dënimeve Penale, i cili autorizonte autoritetet për të dhënë leje për vizita familjare në burg. Kjo dispozitë nuk jepte ndonjë udhëzim të mëtejshëm lidhur me kushtet për dhënien e një lejeje të tillë. Për më tepër, nuk është dhënë asnjë mundësi apelimi për refuzimin e këtyre vizitave. Dispozita në fjalë nuk kishte qartësi të arsyeshme në përcaktimin e fushëveprimit të diskrecionit të ushtruar nga autoritetet në lidhje me kufizimin e të drejtës së vizitës dhe për rrjedhojë Gjykata në këtë rast ka konstatuar se refuzimi i paarsyeshëm i vizitave familjare nuk ishte në përputhje me ligjin dhe përbënte shkelje të nenit 8.

Sa i përket kufizimeve për kontakt të drejtpërdrejtë, Gjykata vuri në dukje se në tri raste, kërkuesi u nda nga familja e tij nga një ndarje xhami dhe vërejtë se kjo përbënte një ndërhyrje në të drejtat e tij të nenit 8. Gjykata ishte e bindur se kërkesa e ligjshmërisë u përmbush, pasi kufizimi u zbatua në përputhje me nenin 217 (2) të Kodit të Ekzekutimit të Dënimeve Penale, i cili i jepte diskrecion autoriteteve të përcaktonin mënyrën se si duhet të kryhen vizitat dhe specifikoi se vizitorëve nuk u lejohej të kishin kontakt të drejtpërdrejt fizik me të ndaluarin. Kjo ndërhyrje ndiqte qëllimin legjitim të parandalimit të trazirave dhe krimit.

Gjykatës i mbetej për të përcaktuar nëse ishte mbajtur një balancë e drejtë mes interesave konkurrues. Gjykata vërejtë se mund të vendoseshin kufizime ndaj kontaktit direkt mes të ndaluarve dhe të afërmeve të tyre, por në rastin në fjalë u theksua se autoritetet nuk kishin dhënë ndonjë shpjegim për nevojën e kufizimeve të tilla në krahasim me vizitat e tjera, në të cilat këto nuk u imponuan. Për këto arsye, Gjykata gjeti se këto kufizime kishin qenë arbitrare dhe të rastësishme në kundërshtim me nenin 8.

#### Neni 41

Gjykata u shpreh se Polonia duhej t'ia paguante kërkuesit €1.500 për dëmin jo material.

*Kohëzgjatja e tepërt e e proceseve të kujdestarisë dhe dështimi i shtetit për të hetuar në mënyrë efektive mbi abuzimin e dyshuar ndaj fëmijëve përbën shkelje të neneve 3 dhe 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE M. K. KROACISË**

(Kërkesa nr. 10161/13)

**3 shtator 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkueset, znj. M. dhe M., respektivisht nëna dhe vajza e saj e mitur, ishin shtetase kroate, të cilat kanë lindur në vitin 1976 dhe 2001, dhe kanë jetuar në Zadar, Koraci.

Znj. M. u martua me z. I.M. më 23 qershor 2001, dhe vajza e tyre lindi më 4 shtator të vitit 2001. Marrëdhëniet e çiftit filluan të përkeqësohen dhe ata nisën procesin për divorc. Më 24 gusht 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Zadarit dha vendimin e divorc. Sipas vendimit të gjykatës vendase, vajza u la në kujdestari të babait dhe nënës ju dhe e drejta për të mbajtur kontakte me vajzën si dhe ju caktua pagesa për mjetet e jetesës që duhej të jepte për të.

Sipas deklaratës së dhënë në policinga ana e M., më 1 shkurt të vitit 2011, kishte ndodhur një ngjarje e rëndë e abuzimit në familje: babai i saj e goditi në fytyrë, e kapi për fyti dhe abuzoi psikologjikisht me të. Okulisti e diagnostikoi vajzën me mavijosje dhe dëmtim të indit të syrit të majtë duke treguar se lëndimi ishte shkaktuar nga një goditje me grusht. M. kishte raportuar edhe raste të tjera të dhunës fizike dhe psikologjike nga babai i saj të cilat kishin ndodhur tre vitet e fundit duke pranuar se ajo bkishte frikë nga ai, duke qenë se ishte një njeri i dhunshëm.

Si rrjedhojë, e situatës problematike në familje, një sërë seancash të ndërlidhura me njëra tjetrë nisën përpara gjykatave penale të Kroacisë (për të vendosur mbi pretendimin lidhur me abuzimin e fëmijës), gjykatat civile (për të vendosur mbi kujdestarinë dhe divorcin) dhe autoritetet e mirëqenies sociale.

Pas incidentit të 1 shkurtit, më 30 mars 2011, z. I.M., uakuzua nga Prokurori i Shtetit për kryerjen e veprës penale të lëndimeve trupore. Në tetor 2014, procesi nuk kishte nisur ende pasi gjykata në Zadar priste të merrte një pajisje video-link përmes së cilës M.do të regjistrohej gjatë seancës dëgjimore.

Më 27 prill 2011, znj. M.,depozitoi njëkallzim penale ndaj z. I.M., për abuzim të vajzës së tij, duke cituar incidentin e 1 shkurtit 2001, si dhe pretendimet nga vajza e tyre se

ky nuk kishte qenë rasti i vetem. Kallzimi penal u hodh poshtë në janar 2012, pasi nuk ishin gjetur elemente të mjaftueshme për të vërtetuar abuzimin.

Paralelisht, më 30 mars 2011, znj. M. paraqiti një kërkesëpadi civile për të anuluar urdhrin e kujdestarisë të 24 gushtit 2007, duke kërkuar që të marrë kujdestarinë e përkohshme të vajzës së saj. Megjithatë, kërkesa për kujdestarinë e përkohshme u refuzua dy muaj më vonë për shkak të mungesës së dëshmisë se abuzimi i pretenduar kishte ndodhur vërtet. Proceset lidhur me kujdestarinë ishin ende në pritje në shkallën e parë të gjyqimit në kohën që çështja kishte shkuar për gjykim në GJEDNJ.

Në procesin para autoriteteve të mirëqenies sociale të përfshira në rastin e M., me vendim të datës 7 nëntor 2006, u urdhërua një masë mbrojtëse e fëmijëve për mbikëqyrjen e ushtrimit të autoritetit prindëror me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes. Masa zgjati deri në gusht të 2008. E njëjta masë u vendos më pas nga shtatori 2011 deri në mars 2014 pasi situata familjare nuk kishte pasur ndonjë përmirësim të dukshëm të rastit në fjalë.

Gjatë të gjitha proceseve të mësipërme, M. ishte ekzaminuar nga disa psikiatër dhe psikologë, të cilët kishin konstatuar se fëmija ishte traumatizuar emocionalisht nga ndarja e prindërve dhe nga lidhja e tyre konfliktuale dhe se ajo vazhdimisht kishte shprehur dëshirën për të jetuar me nënën e saj. Megjithatë, nuk ishte vërejtur asnjë rrezik nëse fëmija do të vazhdonte të jetonte me babain e saj, pasi deklaratat e M. se ishte abuzuar nga babai i saj nuk ishin mjaftueshëm bindëse për të justifikuar heqjen e kujdestarisë nga i ati dhe largimin e saj të menjëhershëm.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkeset pretendonin se autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive sipas Konventës pasi autoritetet nuk ndoqën penalisht z. I.M., për veprënpenale të abuzimit të fëmijëve të kryer kundër vajzës së tij, e as për mbrojtjen e saj ndaj veprimeve të tjera të dhunshmeduke vijuar me qëndrimin e saj në shtëpinëe tijdhe duke mos i hequr kujdestarinë përbënintshkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) dhe neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

### Neni 3 dhe 8

Duke pasur parasysh se M. kishte paraqitur një dëshmi për abuzim, ishte e mitur dhe viktimë e dhunës në familje, Gjykata vlerësoi se rasti në fjalë përbënte detyrim pozitiv për shtetin sipas nenit 3 të Konventës për të hetuar rastet e pretenduara të

abuzimit dhe për mbrojtjen e saj nga abuzimi që mund të ndodhte në të ardhmen. Gjatë shqyrtimit të shkeljes së pretenduar sipas nenit 8, Gjykata i shqyrtoi kërkesat e M. duke i marrë në shqyrtim së bashku me nenin 3.

Autoritetet kroate kishin nisur hetime penale vetëm në lidhje me incidentin e 1 shkurtit të 2011, duke mos marrë parasysh të gjitha rastet e mëparshme të abuzimeve të pretenduara që M.-së i ishte dashur të duronte, duke mos e akuzuar z. I.M. lidhur me veprën penale të abuzimit me të mitur dhe në këtë mënyrë duke mbuluar të gjitha rastet e keqtrajtimit të vazhdueshme që ishin bërë më parë. Për rrjedhojë, autoritetet kishin dështuar në marrjen në shqyrtim të çështjes si një e tërë. Për më tepër, kohëzgjatja e proceseve penale ka qenë tepër e gjatë për të pasur në një hetim efektiv, e cila përbën shkelje të kërkesës për marrjen e masave të menjëhershme dhe brenda një afati të arsyeshëm parë në kontekstin e nenit 3. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të këtij neni.

Përsa i përket pretendimeve mbi shkeljen e detyrimeve pozitive të autoriteteve për të parandaluar keqtrajtimin e mundshëm në të ardhmen duke marrë të gjitha masat e nevojshme të arsyeshme, Gjykata vërtetëse autoritetet kombëtare kishin ndër marrë të gjitha hapat e mundshme dhe të nevojshme për të vlerësuar dhe matur rrezikun e keqtrajtimit të mundshëm, si dhe parandalimin e tyre duke marrë parasysh një sërë opinionesh dhe rekomandimesh të ndryshme kontradiktore të lëshuara nga autoritete të ndryshme sociale dhe duke shqyrtuar me kujdes të gjitha materialet relevante. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje në këtë pikë të nenit 3.

### Neni 8

Kërkuueset u ankuan se autoritetet vendase nuk kishin marrë parasysh dëshirën e M.-së për të jetuar me nënën e saj dhe se ajo nuk ishte dëgjuar gjatë proceseve për kujdestarinë, të cilat kishin qenë në pritje për më shumë se katër vjet. Pas tre vjet e gjysmë, M., kishte filluar të shfaqte sjellje vetë lënduese, të cilën ajo e kishte përshkruar si një reagim ndaj frustrimit që kishte ardhur si rezultat i faktit që nuk i ishte lejuar të zgjidhte se me kë dëshironte të jetonte, i ishte mohuar liria e veprimit dhe në këtë mënyrë i ishte kufizuar liria e saj personale. Në bazë të këtyre rethanave kërkuueseve ju lindi e drejta të ngrinin pretendime për respektimin e jetës private dhe familjare të ndryshme nga ato të analizuar në kontekstin e nenit 3 dhe, për rrjedhojë Gjykata konstatoi se për këtë kërkohej një shqyrtim i marrë më vete.

Sipas Gjykatës, rasti i në fjalë bënte thirrje për kujdes më të madh nga gjykatat dhe autoritetet kombëtare për sa i përket një të mitur të traumatizuar, e cila kishte

pësuar një ankth të madh psikologjik që kishte kulmuar në sjellje që çojnë në lëndim të vetes. Megjithatë, gjykatat vendase nuk kishin kuptuar seriozitetin dhe urgjencën e situatës së M. Ajo që ishte më flagrante për Gjykatën ishte se nuk u mor asnjë hap për të përshpejtuar procedurat edhe pasi M. kishte filluar të shfaqte sjellje vetë lënduese.

Ekspertët mjeko-ligjorë të psikologjisë dhe psikiatrisë të përfshirë në rastin në fjalë kishin konstatuar se të dy prindërit ishin po aq të papërshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijën e tyre, qëndrim ky i mbajtur dhe nga qendra lokale e mirëqenies sociale. Ata gjithashtu kishin konstatuar se M. për disa herë më radhë kishte shprehur dëshirën e madhe për të jetuar me nënën e saj. Siç parashikohet në nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët që janë të aftë të kenë pikëpamjet e tyre dhe të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje për çdo çështje që ka të bëjë me ta, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tyre, në çdo proces që ka të bëjë me ta. M., ishte nëntë vjeç e gjysmë në kohën e fillimit të proceseve dhe trembëdhjetë e gjysmë në kohën e vendimit të Gjykatës. Prandaj, do të kishte qenë e vështirë të argumentohej se, duke pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e saj, ajo nuk kishte qenë e aftë të kishte pikëpamjet e veta dhe t'i shprehte ato lirisht.

Gjykata konstatoi se mos respektimi i dëshirave të M., lidhur me çështjen se me cilin prind do të jetonte përbënte shkelje të së drejtës së saj për respektimin e jetës private dhe familjare në kundërshtim me nenin 8 të Konventës. Konkluzionet në lidhje me procedurat e tejkujtura mbi kujdestarinë gjenin të njëjtin zbatim edhe në rastin e znj. M., në lidhje me të drejtën e saj për respektimin e jetës private dhe familjare.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Kroacia duhej t'i paguante fëmijës 19,500 euro dhe mamasë së saj 2,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial, dhe 3,600 euro të dyjave bashkë për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Dëbimi i një çifti afgan me dy fëmijë të mitur përbënte shkelje të së drejtës së tyre për të respektuar jetën familjare garantuar nga neni 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN M. DHE TË TJERËT K. BULLGARISË**

(Kërkesa nr. 41416/08)

**16 korrik 2011**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin z. M, një shtetas i afgan, i lindur në vitin 1974, bashkëshortja e tij, shtetase armene e lindur në 1982 dhe dy fëmijët e tyre të mitur të lindur në vitin 2003 dhe 2005, të gjithë jetonin në Bullgari. Pasi hyri në Bullgari në vitin 1998 dhe u konvertua në të krishterë në vitin 2001, kërkuesit të parë dha statusi refugjatit në mars të vitit 2004 në bazë të rrezikut të persekutimit në Afganistan për shkak të konvertimit të tij fetar.

Në dhjetor 2005, drejtori i Shërbimit të Sigurisë Kombëtare lëshoi një urdhër për tërheqjen e lejes së qëndrimit të z. M., duke urdhëruar dëbimin dhe paraburgimin e tij në pritje të dëbimit. Gjithashtu, ai urdhëroi që z. M. t'i ndalohej hyrja në Bullgari për dhjetë vjet, për arsye se ai ishte një "kërcënim serioz për sigurinë kombëtare". Drejtori i Shërbimit të Sigurisë Kombëtare për këtë vendimmarrje u mbështet në një dokument të brendshëm të 24 nëntorit 2005, i cili theksonte se kërkuesi i parë ishte i përfshirë në trafikimin emigrantëve, i mund të përdorej për kalimin e terroristëve Bullgarinë ndërkombëtarisht. Në tetor 2006 u dha një urdhër tjetër nga Drejtoria e Migracionit pranë policisë kombëtare për ndalimin e z. M. në pritje të dëbimit.

Z. M u arrestua dhe u ndalua më 18 tetor 2006. Në shkurt 2007, shtator 2008 dhe janar 2009, policia bullgare kërkoi nga Ambasada e Afganistanit në Sofje të lëshonte një dokument identiteti për kërkuesin. Ambasada nuk pranoi të pajiste z. M. me pasaportë pasi nuk dëshironte dhe as nuk lejoi që kthehej në Afganistan.

Në tetor 2006, z. M. kundërshtoi urdhrin për tërheqjen e lejes së qëndrimit të dhjetorit 2005, përpara Gjykatës së Sofjes. Në tetor të vitit 2007, Gjykata e Lartë Administrative refuzoi kërkesën e z. M. për të ndaluar ekzekutimin e urdhrin të dëbimit dhe përmes një vendimi të qershorit 2008 rrëzoi ankimin e tij kundër këtij urdhri.

Në tetor 2006, z. M. gjithashtu kundërshtoi urdhrin për paraburgimin e tij lëshuar po atë muaj përpara Gjykatës së Sofjes. Gjykata konstatoi se urdhri ishte nënshkruar nga një zyrtar i paautorizuar dhe e shpalli atë të pavlefshëm, por nuk urdhëroi lirimin e z. M.

Në shtator 2008, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i kërkoi qeverisë bullgare, në përputhje me rregullat e saj mbi vendimet e ndërmjetme, se nuk duhet ta deportonte z. M. në Afganistan deri sa çështja të shqyrtohej në Strasburg. Policia kombëtare urdhëroi z. M. të paraqitej çdo ditë në rajonin lokal të policisë pas lirimimit të tij në korrik 2009.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u bazuar *inter alia* në nenet 5, 8 dhe 13 të Konventës, kërkuesit u ankuan për arrestimin e paligjshëm të M., kërcënimi për ta dëbuar dhe një mjeti juridik efektiv.

### Neni 5 § 1

Gjykata rikujtoi se ndalimi i individëve me qëllim dëbimin e tyre mund të justifikohet vetëm për sa kohë që procesi i dëbimit ose ekstradimit kishte filluar. Nëse procese të tilla nuk do të ndiqen me kujdesin e duhur, paraburgimi do të ishte i papajtueshëm me Konventën.

Z. u mbajt në paraburgim për dy vite dhe tetë muaj e gjysmë. Megjithëse, autoritetet kishin ndërmarrë hapa për ta pajisur atë me një dokument identifikimi dhe u përpoqën ta dërgonin në një vend tjetër të sigurt, ai mbeti në paraburgim gjatë gjithë kësaj kohe. Duke pasur parasysh mungesën e kujdesit nga ana e autoriteteve bullgare, paraburgimi i z. M. nuk mund të konsiderohej i justifikuar për gjithë kohëzgjatjen e tij. Mbi këtë bazë dhe duke vënë në dukje se ekzistenca e dy urdhrave të veçantë të paraburgimit kishte krijuar pasiguri juridike, Gjykata arriti në përfundimin se z. M. ishte ndaluar në kundërshtim me nenin 5 § 1.

### Neni 5 § 4

Z. M. kishte kundërshtuar në dy sete procedurash para gjykatave vendase se ndalimi i tij, i urdhëruar nga dy akte të ndryshme respektivisht në dhjetor 2005 dhe tetor 2006, ishte i paligjshëm. Në setin e parë gjykatat kishin refuzuar të shqyrtonin ankimet tij dhe në të dytin, gjykatat kishin vendosur vetëm dy vjet e gjysmë më vonë se urdhri ishte nënshkruar nga një oficer i paautorizuar. Gjykata vërejti se z. M. ishte gjetur në kushtet e mungesës së sigurisë për të kundërshtuar në mënyrë të shpejtë përpara një gjykate ligjshmërinë e paraburgimit të tij ndërkohë që ishte në pritje të dëbimit, duke shkelur kështu nenin 5 § 4 të Konventës.



## Neni 8

Lidhur me kërcënimin për dëbimin e z. M., Gjykata vuri në dukje se kërkuesit kishin krijuar një jetë të vërtetë familjare në Bullgari dhe se deportimi, nëse do të kryhej, do të përbënte dhe ndërhyrje në këtë të drejtë. Kjo ndërhyrje do të ishte në kundërshtim me nenin 8 të Konventës, përveç nëse mund të justifikohet sipas parashikimeve të paragrafit 2 të kësaj dispozite si e kryer “në përputhje me ligjin”, duke ndjekur një ose më shumë qëllime legjitime dhe duke qenë “e nevojshme në një demokratike” në mënyrë që të arriheshin qëllimet ose synimet në fjalë. Në lidhje me kërkesën që ndërhyrja duhet të jetë në përputhje me ligjin, Gjykata përsëriti se konceptet e ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike kërkojnë, që masat që prekin të drejtat themelore të njeriut duhet të jenë subjekt kundërshtimi përpara një kompetent i cili do të shqyrtojë arsyet e vendimit dhe provat relevante, nëse është e nevojshme sipas rregullimeve të përshtatshme procedurale lidhur me përdorimin e informacionit të klasifikuar. Institucioni në fjalë duhet gjithashtu të jetë kompetent për të shqyrtuar nëse masat e marra ndjekin një qëllim legjitim dhe janë proporcionale. Individui duhet të jetë në gjendje të kundërshtojë vendimin e ekzekutivit se siguria kombëtare është në rrezik. Ndërsa vlerësimi i institucioneve vendase për atë çfarë përbën kërcënim për sigurinë kombëtare natyrisht do të ketë një peshë të konsiderueshme, autoriteti i pavarur duhet të jetë në gjendje të reagojë në rastet kur invokimi i këtij koncepti nuk ka baza të arsyeshme në fakte, ose kur zbulon se “sigurisë kombëtare” është i paligjshëm, ose bie në kundërshtim me kuptimin e përgjithshëm dhe është arbitrar.

Në çështjen në fjalë, Gjykata e Lartë Administrative nuk arriti të sigurojë një shqyrtim të pavarur domethënës të urdhrit të dëbimit kundër z. M. Ajo zbatoi një qasje formale dhe i la një liri të plotë dhe të pakontrolluar një agjencie qeveritare për të “vërtetuar”, duke iu referuar deklaratave të veta të përgjithshme, se një i huaj përbënte një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe duhet të dëbohej. Meqenëse të tilla “certifikime” bazoheshin në informacione të brendshme të pazbuluara dhe ishin mbajtur përtej çdo shqyrtimi gjyqësor, kërkuesi nuk kishte në dispozicion asnjë mjet mbrojtës kundër arbitraritetit. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk gëzuan shkallën minimale të mbrojtjes kundër arbitraritetit të pandarë nga koncepti i ligjshmërisë brenda kuptimit të Konventës. Nëse urdhri i dëbimit i datës 6 dhjetor 2005 do të zbatohet, ndërhyrja që do të rezultonte në jetën familjare të kërkuesve nuk do të ishte “në përputhje me ligjin” siç kërkohet nga neni 8 § 2 të Konventës. Rrjedhimisht, kërkuesit nuk ishin mbrojtur kundër arbitraritetit në kundërshtim me nenin 8 të Konventës.

### Neni 13

Gjykata vërejtë se Gjykata e Lartë Administrative nuk e kishte ekzaminuar siç duhet deklaratën e policisë, e cila pohonte se z. M. përbënte një kërcënim për sigurinë kombëtare. Gjithashtu, nënvizoi se gjykata kombëtare nuk e shqyrtoi me rigorozitetin e kërkuar nga Konventa ankesën e z. M. se ai rrezikonte të keqtrajtohej ose të vdiste nëse dëboheshin drejt Afganistanit. Përveç kësaj, sipas ligjit bullgar, ankesat kundër urdhrave të dëbimit për arsye të sigurisë kombëtare nuk kishin efekt pezullues dhe kërkesa e z. M. për të mos u deportuar ishte lënë praktikisht pa shqyrtim. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ligji dhe praktika bullgare në lidhje me mjetet juridike kundër urdhrave të dëbimit ishte në kundërshtim me nenin 13.

### Neni 46

Duke qenë se Gjykata tashmë kishte gjetur shkelje të ngjashme në një numër çështjesh kundër Bullgarisë të gjykuara në të shkuarën dhe çështje të tjera të ngjashme që ishin ende në pritje për t'u gjykuar, Gjykata gjeti të nevojshme të asistonte qeverinë bullgare në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës.

Në veçanti, Gjykata vendosi që masat për zbatimin e këtij vendimi duhet të përfshijnë ndryshime në Ligjin për të Huajt ose ligje të tjera me qëllim që të sigurojnë që: 1) gjykatat vendase të ushtrjnë shqyrtim të plotë gjyqësor mbi faktet dhe arsyet e parashtruara për dëbimin e të huajve; 2) gjykatat që shqyrtojnë ankesat për dëbim të balancojnë synimin e ndjekur nga autoritetet përballë të drejtave të themelore të individëve të prekur, duke përfshirë të drejtën e tyre për respektimin e jetës familjare; 3) vendi në të cilin do të dëbohen të huajt gjithmonë duhet të parashikohet në një akt ligjërishit detyrues; 4) kërkesat që pretendojnë rrezikut për jetën ose keqtrajtimin në shtetin pritës duhet të shqyrtohen rigorozisht nga gjykatat; dhe 5) pretendime të tilla, të bëra në lidhje me ankesat për deportim, kanë një efekt pezullues automatik në pritje të ekzaminimit të tyre.

### Neni 41

Gjykata vendosi se shteti bullgar duhet t'i paguante z. M. 12,000 euro në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material dhe 3,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

*Refuzimi për të njohur ligjërisht marrëdhëniet prind-fëmijë kur fëmijët lindën si pasojë e surrogacisë në një vend ku ky proces ishte i ligjshëm, përbënte shkelje të nenit 8 lidhur me të drejtën e fëmijëve për respektimin e jetës së tyre private*

## VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MENNESSON K. FRANCËS

(Kërkesa nr. 65192/11)

**26 qershor 2014**

### Faktet kryesore

Dy kërkuesit z. Dominique Mennesson dhe znj. Sylvie Mennesson ishin shtetas francezë të martuar me njëri-tjetrin lindur respektivisht në vitin 1965 dhe 1955. Dy kërkuesit e tjerë znj. Valentina Mennesson dhe znj. Fiorella Mennesson ishin fëmijët e tyre dhe ishin shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të lindur në vitin 2000. Të katër kërkuesit jetonin në Maisons-Alfort, Francë.

Çifti Mennesson nuk ishin në gjendje të kishin një fëmijë të tyre dhe pas një përpjekjes të pasuksesshme për të lindur një fëmijë duke përdorur fekondimin *in vitro* (IVF), ata vendosën të udhëtonin në Kaliforni, ku procesi i lindjes së një fëmije përmes surrogacisë ishte i ligjshëm. Ata hynë në një marrëveshje surrogacie.

Më 1 mars 2000, nëna zëvendësuese u mësua se ishte shtatëzënë me binjakë. Në një vendim të datës 14 korrik 2000, Gjykata Supreme e Kalifornisë, në të cilën dy kërkuesit e parë dhe nëna zëvendësuese me bashkëshortin e saj kishin paraqitur kërkesë, specifikoi të dhënat që duhe të futeshin në certifikatën e lindjes së fëmijëve dhe deklaroi se dy kërkuesit e parë duhet të konsideroheshin respektivisht si “prindërit gjenetik” dhe “nëna ligjore”. Certifikatat u hartuan në përputhje me lindjen e binjakeve më 25 tetor 2000.

Në fillim të nëntorit, kërkuesi i parë shkoi në konsullatën franceze në Los Anxhelos për të marrë gjeneralitetet e certifikatës së lindjes të regjistruar në regjistrin francez të gjendjes civile, si edhe regjistroi emrat e binjakeve në pasaportën e tij me qëllim që ai të mund të kthehej në Francë me ta. Konsullata e refuzoi kërkesën e tij, me arsyetimin se ai nuk mund të provonte që e dytë kishte lindur fëmijët dhe duke dyshuar për një marrëveshje surrogacie dërgoi dosjen në zyrën e prokurorit publik Nantes.

Të katër kërkuesit arritën të ktheheshin në Francë në nëntor të vitit 2000, pasi dy binjaket zotëronin pasaporta amerikane në të cilat dy kërkuesit e parë njiheshin si prindërit e tyre. Me kthimin në Francë hetimet kundër personit ose personave të

panjohur qëtë vepruan si ndërmjetës në marrëveshjen e surrogacisë. Më 30 shtator 2004, gjyqtari hetues konstatoi se meqë veprat në fjalë ishin kryer në territorin e SH.B.A.-së, ku nuk ishin ato nuk klasifikoheshin si kundërvajtje, ato nuk përbënin një vepër të dënueshme në Francë.

Ndërkohë, më 25 nëntor 2002, sipas udhëzimeve të prokurorit publik, u regjistruan të dhënat e lindjes së binjakeve. Megjithatë, më 16 maj 2003 prokurori publik kërkoi t'i anulonte ato duke nisur procedimin në Gjykatën e Créteil *tribunal de grande*, duke argumentuar se marrëveshja e surrogacisë ishte e pavlefshme në përputhje me parimin e politikës publike, që trupi i njeriut dhe statusi civil janë të patjetërsueshme. Gjykata vendase e shpalli ankimin të papranueshëm. Zyra e prokurorisë publike apeloj dhe më 18 mars 2010, Gjykata e Apelit e Parisit anuloi shënimet që me certifikatat e lindjes së fëmijëve.

Ankuesit u ankuan për zbatimin e ligjit, duke pretenduar se neni 3 § 1 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës nuk ishte respektuar dhe se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane më vete dhe marrë sëbashku me nenin 14. Avokati i përgjithshëm rekomandoi shfuqizimin e vendimit por më 6 prill 2011 Gjykata e Kasacionit e rrëzoi ankimin.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan për shkelje të së drejtës për një jetë të qetë private dhe familjare garantuar nga neni 8 i Konventës.

### Neni 8

Nuk u vendos në diskutim që marrëdhënia midis kërkuesve ishte brenda kuptimit të “jetës familjare” sipas nenit 8, ose që refuzimi i autoriteteve franceze për të njohur ligjërisht lidhjet familjare midis tyre përbënte një “ndërhyrje” në të drejtën e kërkuesve për të respektuar jetën e tyre familjare dhe private. Për t'u shqyrtuar në këtë rast ishte fakti nëse ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”, ndiqte një ose më shumë “qëllime legjitime” të renditura në nenin 8 § 2 dhe ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata konsideroi se me qëllim që një masë të jetë në “pajtim me ligjin” nuk duhet të ketë vetëm një bazë ligjore në sistemin juridik të shtetit të paditur, por gjithashtu, duke iu referuar cilësisë së ligjit në fjalë, ai duhet të jetë i aksesueshëm për personin në fjalë dhe efektet e tij të jenë të parashikueshme. Këto kushte janë përmbushur në lidhje me rastin në fjalë. Në kohën materiale Kodi Civil shprehimisht se marrëveshjet

për surrogato ishin të pavlefshme dhe se kjo bazohej në politikën publike. Gjithash-tu, Gjykata franceze e Kasacionit kishte specifikuar më parë, në një rast të ngjashëm se marrëveshjet surrogato parimet e patjetërsueshmërisë së trupit njerëzor dhe gjendjes civile. Prandaj, kërkuesit nuk mund të kishin qenë të pavetëdijshëm se ekzis-tonte të paktën një rrezik thelbësor për një vendim të tillë nga gjykatat franceze në përputhje me rrethanat e ështëjes së tyre. Kështu, ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin” brenda kuptimit të Konventës.

Në lidhje me çështjen nëse kjo ndërhyrje një një qëllim legjitim, Gjykata pranoi që refuzimi për të njohur marrëveshjet surrogato ishte mbrojtja e fëmijëve dhe nënave zëvendësuese, duke plotësuar kështu dy kushtet legjitimuese të renditura në nenin 8 § 2: “mbrojtja e shëndetit” dhe “mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

Duke parë kushtet e ndërhyrjes për të përcaktuar nëse ajo është e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vuri në dukje se nga njëra anë, kur nuk ka një dakordë-sim brenda Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me këtë ështëje, ose në lidhje me rëndësinë relative të interesit që vendoset në rrezik, ose sa i përket mjeteve më të mira hapësira e vlerësimit të Shtetit do të jetë më e gjerë. Nga ana tjetër, kur një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i ekzistencës ose identitetit të një individi është në rrezik, kufiri i lejuar i hapësirës së vlerësimit të shtetit natyrisht do të kufizohet.

Gjykata e Kasacionit kishte konstatuar se pamundësia për të regjistruar marrëdhënien e kërkuesve nuk shkelte të drejtën e tyre për respektimin e jetës private dhe familjare, ose interesin më të lartë të fëmijëve, për aq sa nuk i privonte ata nga marrëdhënia ju-ridike prind-fëmijë njohur sipas ligjit kalifornian dhe nuk i pengonte ata të jetonin në Francë me kërkuesin e parë dhe të dytë. Duke shqyrtuar këtë vendim, Gjykata vëren se duhet të verifikojë nëse Gjykata e Kasacionit mori parasysh në mënyrë të duhur nevojën për të arritur një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesit të komunitetit për të siguruar, që anëtarët e tij të jenë në përputhje me zgjedhjen e bërë në mënyrë demokratike brenda atij komuniteti dhe interesin e kërkuesve - interesit më të lartë të fëmijëve konsideruar si parakusht – për të gëzuar plotësisht të tyre për respek-timin e jetës private dhe familjare. Gjykata konsideroi se në marrjen e një vendimi, në rastin konkret duhej të evidentohej një dallim midis të drejtës së dy kërkuesve të parë për respektimin e jetës së tyre familjare nga njëra anë dhe të drejtës së kërkuesve të tretë dhe të katërt për respektimin e jetës së tyre private nga ana tjetër.

Së pari, Gjykata shqyrtoi të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës së tyre famil-jare dhe “vështirësitë praktike” të njohura nga Gjykata e Apelit në Paris, me të cilat ata u përballën në lidhje me mungesën e njohjes së marrëdhënies së tyre sipas ligjit francez, duke iu referuar këtu ndër të tjera, vështirësive në aksesin e të drejtave ose

shërbimeve, që kërkojnë prova të marrëdhënies ligjore prind-fëmijë, ose udhëtimin si familje. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit nuk pretendonin se kishte qenë e pamundur të kapërceheshin vështirësitë e përmendura dhe nuk tregonin se pamundësia për të përfituar njohjen e marrëdhënies ligjore prind-fëmijë nën ligjin francez i kishte penguar ata të gëzonin në Francë të drejtën për respektimin e jetës së tyre familjare. Prandaj, duke marrë parasysh edhe hapësirën e vlerësimit, vendimi i Gjykatës së Kasacionit ka arritur një balancë të drejtë midis interesave të kërkuesve dhe atyre të shtetit francez duke mos sjellë kështu shkelje të nenit 8 në lidhje me të drejtën e kërkuesve për të jetën e tyre familjare.

Megjithatë, Gjykata shqyrtoi pasojat e këtij kufizimi serioz, mbi identitetin dhe të drejtën për respektimin e jetës private në lidhje me kërkuesin e tretë dhe të katërt. Gjykata evidentoi se duke parandaluar kështu njohjen dhe vendosjen sipas ligjit të brendshëm të marrëdhënieve të tyre ligjore me ato biologjike, shteti i paditur ka tejkaluar kufijtë e lejuar të hapësirës së të vlerësimit. Duke pasur parasysh gjithashtu rëndësinë që duhet t'u jepet interesave të fëmijës gjatë peshimit të interesave konkurrues në një situatë të caktuar. Gjykata arriti në përfundimin se e drejta e fëmijëve për respektimin e jetës së tyre private, që nënkuptonte se të gjithë duhet të jenë në gjendje të vendosin mbi thelbin e tyre të identitetit, duke përfshirë edhe prindërit e tij ose saj, u prek në mënyrë të konsiderueshme. Prandaj, ekzistonte një çështje serioze në lidhje me pajtueshmërinë e situatës me interesin më të lartë të fëmijëve, i cili duhet të udhëheq çdo vendim në lidhje me ta.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me të drejtën e kërkueses së tretë dhe të katërt për respektimin e jetës së tyre private.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi së tretë dhe të katërt 5,500 euro secilës si shpërblim për dëmin jo material dhe gjithë kërkuesve së bashku 15,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Vonesa e tepruar në transferimin e dy fëmijëve nga ish-bashkëshorti tek kërkuesja, pasi asaj i ishte dhënë kujdestaria nga një gjykatë vendase përbënte shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MIJUŠKOVIĆ k. MALIT TË ZI**

(Kërkesa nr. 49337/07)

**21 shtator 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, znj. Svetlana Mijušković, kishte lindur në vitin 1971. Në prill 1998, ajo dhe z. V.K. u martuan dhe në tetor të po atij viti ajo lindi binjakët e tyre A dhe B. Në 2003 kërkuesja dhe fëmijët e saj shkuan tek shtëpia e prindërve të saj për shkak të problemeve martesore. Në janar 2005, V.K. mori A dhe B për pushime dhe më pas refuzoi t'i kthente ata. Në mars të vitit 2005, Qendra për Kujdesin Social në Nikšić (QKSN) urdhëroi që fëmijët t'i ktheheshin kërkueses dhe i ngarkuan ekzekutimin e këtij vendimi Qendrës së Kujdesit Social në Budva (QKSB). Po atë muaj, QKSB u përpoq ta ekzekutonte vendimin me ndihmën e policisë, por u pengua fizikisht nga prindërit e V.K. Midis prillit dhe qershorit 2005, me kërkesë të kërkueses, QKSN-ja nxorri tre vendime të mëtejshme, duke i kërkuar V.K. që t'i kthente fëmijët. V.K. u kërcënua se do të gjobilej dhe do të bëhej ekzekutimi me forcë i vendimit nëse ai refuzonte të kthente fëmijët. Përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk u paraqitën prova se V.K. ishte gjobitur ndonjëherë apo se ishte bërë ndonjë përpjekje nga ana e autoriteteve lidhur me transferimin e kujdestarisë.

Në 2006, Gjykata e Shkallës së Parë zgjidhi martesën dhe i dha kujdestarinë e fëmijëve kërkueses, dhe vendosi se V.K. duhej të paguante detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve. Ky vendim u la në fuqi në të njëjtin vit nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Supreme. Më pas kërkuesja kërkoi ekzekutimin e këtij vendimi, përmes një urdhri ekzekutimi të dhënë nga gjykatat vendase. Ndërsa ky vendim u dha në vitin 2006 thuhej se transferimi i fëmijëve duhej të bëhej brenda tri ditëve, ekzekutimi i tij nuk ishte bërë ende deri në vitin 2009 kur kërkuesja paraqiti një kërkesë për rishqyrtim duke kërkuar që vendimi të ekzekutohej. Më pas në mars 2009, gjyqtari ekzekutiv i akordoi V.K.-së një gjobë prej 500 euro, por përmbarusi nuk mundi të ekzekutonte gjobën për shkak të rezistencës së prindërve të V.K.-së. Si përfundim, gjoba u pagua nga babai i V.K.-së. Po në mars, gjykata vendase lëshoi një tjetër vendim ekzekutimi, duke i kërkuar V.K.-së që t'i kthente fëmijët nënës së tyre brenda tri ditëve ose do të gjobilej me një gjobë tjetër prej 1.000 euro. Pas kësaj, as vendimi dhe as gjoba nuk u ekzekutuan nga autoritetet kombëtare.

Në tetor të vitit 2009 u tentua të bëhej transferimi me forcë i fëmijëve, por ka pasur rezistencë nga ana e V.K. si dhe nga ana A dhe B. Po atë muaj, pak më vonë u tentua sërish ekzekutimi i vendimit për kthimin e fëmijëve, por këtë herë V.K. propozoi që të shtyhej dhe në momentin që u krye kontrolli në shtëpinë e V.K., fëmijët nuk ishin aty. Më pas, kërkuesja u ftua që të paraqesë një kërkesë në gjykatën e brendshme për të sugjeruar se si mund të ekzekutohej vendimi dhe për mundësinë e saj për të siguruar “forcën puntore e nevojshme” për ekzekutimin e tij. Në nëntor 2009, u tentua sërish të kryehej ekzekutimi i vendimit, ku fëmijët refuzonin të shkonin me kërkuesen, duke pretenduar se ajo nuk i kishte trajtuar si duhet. Megjithatë, pas largimit të prindërve të V.K., vendimi u ekzekutua dhe fëmijët i’u kthyen kërkueses. Gjatë periudhës janar 2005 deri në nëntor 2009, kërkuesja pretendonte se kishte pasur vetëm kontakte jo të rregullta dhe të shkurtra me fëmijët e saj, kryesisht gjatë kohës së shkollës dhe vetëm në praninë e V.K.-së ose babait të tij.

Në qershor të 2009 vendase vendosën mbi kujdestarinë e fëmijëve në favor të V.K.-së në një kërkesëpadi civile të ngritur nga ai në një datë të pacaktuar. Ky vendim u bazua pjesërisht në një bisedë joformale që një psikiatër kishte pasur me A dhe B në të cilin psikiatri kishte arritur në përfundimin se fëmijët dëshironin të jetonin me babanë e tyre, por ju ishte “folur negativisht” kundër nënës së tyre nga një i rritur. Kjo gjykatë vendase vuri në dukje se ndërsa fëmijët kishin jetuar me babain e tyre në kundërshtim me vendimin e dhënë në vitin 2006, fëmijët e kishin pëlqyer situatën në të cilën ishin gjendur dhe ishte në interesin e tyre për të “verifikuar situatën”. Në shtator 2009, Gjykata e Lartë në Podgoricë e prishi këtë vendim dhe e ktheu çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në shkurt të vitit 2007, V.K. u shpall fajtor për dhunën në familje ndaj kërkueses dhe u dënua me tre muaj burg të cilat u pezulluan për dy vjet. Megjithatë, ky vendim u hodh poshtë pasi ndjekja penale ishte parashkruar. Gjithashtu, ndaj V.K.-së u ngritën akuzua penale për rrëmbimin e fëmijëve, por u shfajësua në dhjetor të vitit 2007, ku gjykata vendase vuri në dukje se “edhe pse veprimet e sipërpërmendura të të akuzuarit përmbanin të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, vepra e sipërpërmendur përfaqësonte një shkelje të një rëndësie të vogël”. Ky vendim u la në fuqi dhe u bë përfundimtar në maj të vitit 2008.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 8 kërkuesja u ankua në Gjykatë se vonesa në ekzekutimin e vendimit të kujdestarisë në mars të 2006 dhe dështimi i Shtetit në ekzekutimin e vendimit të QKSN në mars 2005, derivoi në pamundësinë e saj për të ushtruar të drejtat e saj prindërore sipas legjislacionit të brendshëm dhe Konventës.



## Neni 8

Gjykata e nisi shqyrtimin e saj duke vënë në dukje se gëzimi reciprok i qëndrimit me njëri midis prindërit dhe fëmijës është një element themelor i jetës familjare sipas nenit 8. Ndërsa ekziston një detyrim pozitiv që shtetet duhet të marrin masa për bashkimin e prindërve me fëmijët e tyre, në rastet e divorcit ky detyrim nuk është absolut. Përkundrazi, Shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme sipas rrethanave të rastit për të sjellë ribashkimin.

Fillimisht, Shteti ndërmori hapa për të bashkuar kërkuesen me fëmijët e saj kur u bënë përpjekje për ekzekutimin e vendimit të QKSN në mars të 2005. Pasi vendimi i NSCC-së u zëvendësua me vendimin e gjykatës vendase të vitit 2006, për t'i dhënë kujdestarinë e A dhe B kërkueses, deri në nëntor 2009 u bënë vetëm tre përpjekje të mëtejshme për të ribashkuar kërkuesen me fëmijët e saj. Gjatë kësaj periudhe V.K. u gjobit vetëm një herë, gati dy vjet e nëntë muaj pasi kërkuesja kërkoi ekzekutimin e vendimit të gjykatës vendase.

Ekzekutimi me forcë i vendimit të kujdestarisë u tentua vetëm pasi çështja i ishte komunikuar Qeverisë së paditur dhe ky vendim u ekzekutua në vetëm më pak se tre muaj përpara se rasti të dëgjohej para Gjykatës. Qeveria nuk dha shpjegime se pse i'u desh kaq shumë kohë për të tentuar të ekzekutonte vendimin e gjykatës vendase. Ndërsa ribashkimi i prindërve dhe i fëmijës në disa raste nuk mund të ndodhte menjëherë dhe pa përgatitjen e nevojshme, nuk ka pasur prova se vonesa në ekzekutimin e këtij vendimi kërkonte ndonjë masë apo paraprake.

Pavarësisht hapësirës së vlerësimit të shtetit dhe faktit se A dhe B u transferuan tek kërkuesja, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet malazeze nuk kishin bërë përpjekjet e duhura dhe efektive për të ekzekutuar vendimin e NCSS-së dhe vendimin përfundimtar të gjykatës vendase në kohën e duhur. Rrjedhimisht ka pasur shkelje të nenit 8

## Neni 41

Gjykata konkludoi se kërkueses duhej ti akordohej shuma prej 10,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe duke qenë se ajo aplikoi për shpenzimet gjyqësore pas afatit përfundimtar asaj nuk ju akordua asnjë shumë nga Gjykata lidhur me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Shteti zgjati periudhën e pasigurisë juridike të kërkuësve në lidhje me identitetin e tyre në shkelje të neneve 6 dhe 8*

## VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MIKULIĆ k. KROACISË

(Kërkesa nr. 53176/99)

**7 shkurt 2002**

### 1. Faktet kryesore

Montana Mikulić është shtetase kroate e lindur jashtë martese në 1996. Më 30 janar 1997, ajo dhe nëna e saj paraqitën padi para Gjykatës Komunale të Zagrebit për njohjen e atësisë nga H.P.. Një sërë seancash u shtynë për shkak se H.P. nuk u paraqit. Gjithashtu, ai nuk iu bind urdhrit të gjykatës për t'iu nënshtruar 6 planifikimeve për kryerjen e testit të ADN-së me qëllim përcaktimin e atësisë. Pas tre vjet e gjysmë, Gjykata e Zagrebit arriti në përfundimin se H.P. ishte babai i kërkuësës. Gjykata e bazoi përfundimin e saj në dëshminë e nënës së kërkuësës dhe në faktin se H.P. kishte shmangur testin e ADN-së.

H.P. apeloj këtë vendim dhe Gjykata e Apelit prishi vendimin e shkallës së parë me argumentin se atësia nuk mund të përcaktohej duke u bazuar kryesisht mbi faktin se testi i ADN-së ishte shmangur. Çështja u kthyer për rishqyrtim në gjykatën më të ulët, duke e urdhëruar atë të dëgjojë dëshmitarët për të cilët H.P. dyshonte se nëna e kërkuësës kishte pasur marrëdhënie intime. Më 19 nëntor 2001, u vendos përsëri se H.P. ishte i ati i vajzës. H.P. apeloj këtë vendim. Në kohën kur çështja shqyrtohej në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, procesi i apelit ishte ende në pritje.

### 2. Vendimi i Gjykatës

U ankua se dështimi i gjykatave vendase për të marrë një vendim në rastin e saj e kishte lënë atë të pasigurt në lidhje me identitetin e saj personal në kuptim të nenit 8. Ajo gjithashtu u ankua, sipas nenit 6 § 1, lidhur me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe në bazë të nenit 13, për mungesën e mjeteve juridike efektive për përshejtimin e proceseve gjyqësore, si dhe mos detyrimin e H.P. vendimin e gjykatës vendase për kryerjen e analizës së ADN-së.

#### Neni 6 § 1

Gjykata theksoi se periudha që mund të shqyrtohej sipas juridiksionit të saj nis nga 6 nëntori 1997, datë në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi në Kroaci. Kështu, kjo periudhë

zgjati katër vjet e dy muaj. Megjithatë, u mor parasysh fakti që në kohën e ratifikimit të Konventës nga Kroacia proceset gjyqësore kishin 9 muaj që kishin nisur.

Gjykata përsëriti se kërkohet një kujdes i veçantë në lidhje me rastet, që kanë të bëjnë me statusin civil. Duke pasur parasysh atë çfarë rrezikohej për kërkuesen në rastin në fjalë, autoritetet kompetente kombëtare duhej të vepronin me kujdes të veçantë në sigurimin e përparësisë së proceseve gjyqësore.

Gjykata Komunale ka caktuar 15 seanca gjyqësore, gjashtë prej të cilave ishin shtyrë për shkak se H.P. nuk ishte paraqitur, ndërkohë që asnjë seancë nuk ishte shtyrë për shkak të mungesës së kërkueses. Qeveria pretendoi se gjykata vendase ishte penguar në ecurinë e procesit sepse i padituri nuk zbatoi urdhrin për të marrë pjesë në seancat gjyqësore dhe kryer e ADN-së.

Gjykata përsëriti se është detyrë e shteteve të organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë, që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e çdo individi të marrë një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme në lidhje me mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet civile. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit, Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore nuk përmbushi kriterin e afatit të arsyeshëm. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

## Neni 8

Në çështjen konkrete rruga e vetme përmes së cilës kërkuesja mund të përcaktonte nëse H.P. ishte apo jo babai i saj biologjik ishte përmes procesit gjyqësor përpara një gjykate civile. Gjykata vërejti se sipas legjislacionit kroat nuk ekzistonte asnjë masë që mund të detyronte H.P. për të zbatuar urdhrin e gjykatës për kryerjen e testeve të ADN-së. Gjithashtu, nuk ekzistonte ndonjë dispozitë e drejtpërdrejtë që rregullonte pasojat e një mos ekzekutimi të tillë. Megjithatë, ishte e vërtetë se gjykatat në proceset civile ishin të lira të arritur përfundime, duke marrë parasysh faktin që një palë ka penguar qartësimin e fakteve. Gjithsesi, kjo dispozitë procedurale ishte e një karakteri të përgjithshëm, duke u dhënë diskrecion gjykatave për të vlerësuar provat dhe nuk përbënte në vetvete një mjet të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për të vendosur atësinë në rastet kur babai i supozuar ishte duke shmangur kryerjen e testeve të ADN-së. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë kishte dështuar në zgjidhjen e çështjes së atësisë nëpërmjet vlerësimit të dëshmimeve të tjera relevante.

Gjykata vlerësoi se individët që ndodhen në gjendjen e kërkueses kanë një interes vital, të mbrojtur nga Konventa, për të marrë informacionin e nevojshëm për të zbuluar të vërtetën për një aspekt të rëndësishëm të identitetit të tyre personal. Nga ana

tjetër, duhej mbajtur parasysh se mbrojtja e personave të tretë mund të përjashtojë detyrimin e tyre për t'u vënë në dispozicion për testet mjekësore të çdo lloji, duke përfshirë testet e ADN-së.

Një sistem si ai kroat, i cili nuk kishte mundësi të detyronte babanë e supozuar të zbatonte një urdhër të gjykatës për t'u nënshtruar testeve të ADN-së, në parim mund të konsiderohet si në përputhje me nenin 8 të Konventës. Gjykata, megjithatë, konsideroi se sipas një sistemi të tillë interesat e individit që kërkon njohjen e atësisë, duhet të garantohen kur atësia nuk mund të njihet me anë të testit të ADN-së. Mungesa e ndonjë mase procedurale për të detyruar babanë e supozuar, që të veprojë në përputhje me urdhrin e gjykatës përputhej vetëm me parimin e proporcionalitetit, nëse do të ofroheshin mjete alternative, që mundësojnë një autoritet të pavarur për të përcaktuar shpejt kërkesën e atësisë. Në çështjen në fjalë asnjë procedurë e tillë nuk ishte në dispozicion të kërkueses.

Për më tepër, në përcaktimin e një kërkesë për vendosjen e atësisë, gjykatave u kërkohet të kishin parasysh parimin themelor të interesave të fëmijës. Gjykata vërejti se procedura në dispozicion nuk krijoi një ekuilibër të drejtë midis të drejtës së për të zgjidhur pasigurinë e identitetit të saj duke shmangur vonesat e panevojshme dhe të drejtës së babait të saj të supozuar për të mos iu nënshtruar testeve të ADN-së. Rrjedhimisht, jo efikasiteti i gjykatave e kishte lënë kërkuesen në një gjendje pasigurie të gjatë që lidhej direkt me identitetin e saj personal dhe kishte shkelje të nenit 8 të Konventës.

### Neni 13

Gjykata vërejti se kërkuësja nuk kishte në dispozicion një mjet juridik efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procesit dhe se për këtë kishte pasur shkelje të nenit 13 marrë sëbashku me nenin 6 § 1 të Konventës. Lidhur me ankimin e saj, nuk kishte asnjë masë që ekzistonte sipas ligjit vendas, e cila të siguronte praninë e të paditurit para gjykatës në procesin e njohjes së atësisë. Gjykata konkludoi se ajo e kishte vendosur tashmë në lidhje me këtë aspekt sipas nenit 8 dhe se për këtë arsye ishte e panevojshme të shqyrtohej e njëjta çështje sipas nenit 13 të Konventës.

### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkueses 7,000 euro si shpërblim për dëmin jo material.

*Dështimi i shtetit për të lehtësuar takimin midis një fëmije me babain e saj dhe gjyshërit nga i ati, si dhe mungesës së mjeteve efektive juridike përbënte shkelje të neneve 8 dhe 13*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MITOVI K. ISH REBUPLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË**

(Kërkesa nr. 53565/13)

**16 prill 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin z. Marjan Mitov (kërkuesi i parë), znj. Cveta Mitova (kërkuesja e dytë) dhe z. Denço Mitov (kërkuesi i tretë) të lindur respektivisht në vitet 1972, 1949 dhe 1950. Ata janë shtetas maqedonas dhe bullgar. Kërkuesi i dytë dhe i tretë janë prindërit e kërkuesit të parë.

Në vitin 2008 kërkuesi i parë u martua me znj. J.S.M. në Shkup dhe më pas çifti për të jetuar në Australi ku edhe një vajzë M.M. Pas prishjes së marrëdhënies mes çiftit znj. J.S.M. dhe fëmija u kthye në Maqedoni në vitin 2011, e më pas u kthyer dhe kërkuesit i parë. Në tetor 2011 znj. J.S.M. paraqiti padi për të zgjidhur martesë me kërkuesin e parë. Me kërkesën e gjykatës vendase, Qendra për Kujdesin Social (Qendra) nisi procedurat për të përcaktuar të drejtat prindërore të kërkuesit dhe znj. J.S.M.

Pas zgjidhjes së martesës së çiftit më 4 korrik 2012 gjykata vendase i la kujdestarinë e M.M. nënës ndërkohë që kërkuesit iu akordua e drejta e takimit. Ish-bashkëshortja e kërkuesit të parë u urdhërua të zbatojë këtë vendim. Në tetor të vitit 2012, kërkuesi i parë i njoftoi Qendrën se ai do të kthehej në Australi, e cila ndryshoi vendimin e parë mbi argumentin se kërkuesi nuk kishte marrë pjesë në asnjë takim të organizuar në zbatim të vendimit të parë. Në fakt ai e takuar vajzën e tij vetëm një herë, që nga kthimi i tij në Maqedoni, në janar 2012.

Në vitin 2013, kërkuesi informoi Qendrën se do të kthehej në Maqedoni për rreth katër muaj dhe kërkoi që Qendra t'a mundësonte atë për të takuar të bijën gjatë kësaj kohe. Qendra mori masat e nevojshme dhe kërkuesi i shkroi Ministrisë për të kërkuar ekzekutimin e këtij urdhri nga policia. Ai gjithashtu i shkroi Qendrës për të kërkuar kujdestarinë e përkohshme të fëmijës. Si Qendra ashtu edhe Ministria pohuan se nuk kishin juridiksion mbi zbatimin e këtyre vendimeve. Në shtator 2013, kërkuesi i parë u kthye përsëri në Australi pa e takuar të bijën.

Qendra informoi kërkuesin e parë se ekzekutimi i vendimit të saj të fundit ishte penguar nga znj. J.S.M dhe se kjo pengesë po shkaktonte tek vajza M. M. 'dëme të riparueshme ... për zhvillimin e saj psikologjik, emocional dhe social'. Megjithatë, kërkesa e z. Mitov për kujdestarinë e përkohshme të M.M. u refuzua pasi Qendra konsideroi se miratimi i kësaj kërkesë nuk do të kishte qenë në interesin më të lartë të fëmijës.

Në prill të vitit 2014, kërkuesi i parë e informoi Qendrën se ai do të mbërrinte në Maqedoni në maj të atij viti dhe kërkoi që të specifikoheshin të drejtat e tij të takimit me M.M. Qendra e mori masat e nevojshme por duke përcaktuar një periudhë të kufizuar nga maji në korrik. Kërkesa e z. Mitov për të specifikuar të drejtat e tij të takimit për muajin gusht u hodh poshtë në shtator, pasi ai ishte kthyer në Australi.

Ndërsa ngjarjet në lidhje me kërkuesin e parë ishin në vazhdim, në vitin 2012 dy kërkuesit e tjerë kërkuan nga Qendra, që të vendosin të drejtën e tyre të takimit me M.M. Pas vendimit pozitiv të Qendrës dy kërkuesit nuk ishin në gjendje të takoheshin me M.M. për shkak të refuzimit të znj. J.S.M. për të bashkëpunuar. Një vendim i ri u dha në janar të vitit 2014 dhe pas kësaj ka pasur një kontakt të kufizuar ndërmjet dy kërkuesve dhe M.M., takime këto të mbikëqyrura nga Qendra. Në prill të vitit 2014, Qendra përsëri dha një vendim të ri mbi takimet mes dy kërkuesve dhe mbesës së tyre. Në kohën kur çështja gjykohej nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ekzistonte asnjë informacion nëse ky vendim ishte zbatuar.

Në gusht dhe tetor 2013, kërkuesi i parë dhe Qendra kishin paraqitur një ankim kundër znj. J.S.M. lidhur me refuzimin e saj për të përmbushur vendimet e Qendrës. Në dhjetor 2014 znj. J.S.M. u gjet fajtorë për rrëmbimin e fëmijës lidhur me refuzimin e saj për të lejuar takimin mes kërkuesit të parë dhe të bijës. Gjykata vendase e dënoi zonjën me kusht.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u bazuar në nenet 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (e drejta për një zgjidhje efektive), kërkuesit u ankuan se autoritetet vendase nuk kishin zbatuar vendimet e Qendrës lidhur me të drejtën e tyre për të takuar M.M. dhe se atyre iu ishte mohuar e drejta për një mjet ligjor efektiv në lidhje me të drejtat e garantuara nga neni 8.

### Neni 8

Së pari, Gjykata theksoi se neni 8 vendos një detyrim ndaj shteteve për të lehtësuar bashkimin midis prindërve dhe fëmijëve të tyre. Ky detyrim nuk është absolut

- autoritetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e të arsyeshme sipas rrethanave specifike të çdo rasti për të lehtësuar kontaktin. Mjaftueshmëria e këtyre hapave pjesërisht vlerësohet duke konsideruar sa shpejt ato zbatohen, pasi kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pariparueshme për marrëdhënien prind-fëmijë.

Marrëdhënia e prindit dhe fëmijës, konkretisht kërkuesit të parë dhe të bijës, u mbajt në vëmendje nga Gjykata si një element thelbësor i 'jetës familjare' sipas nenit 8. Marrëdhënia ndërmjet M.M. dhe gjyshërve të saj u konsiderua nga Gjykata si e një natyre tjetër, e cila ka nevojë për një shkallë më të vogël mbrojtjeje sesa e drejta për të mbajtur një marrëdhënie prind-fëmijë. Sidoqoftë, Gjykata vlerësoi pozitivisht faktin, që Qendra kishte vendosur që gjyshërit kishin të drejtë të krijojnë një marrëdhënie të ngushtë me mbesën e tyre, e drejtë kjo që përfshihet në fushëveprimin e nenit 8.

Gjykata vuri në dukje se Qendra kishte dorëzuar shtatë vendime, që rregullonin të drejtën e takimit të kërkuesve dhe M. M., por kishte pasur vonesa të pashpjegueshme dhe të tepërta midis kërkesave të paraqitura dhe vendimeve. Ky fakt i evidentuar veçanërisht prekte kërkuesin e parë, i cili kalonte vetëm një periudhë kohe të kufizuar në shtetin e paditur. Ndërsa vendimet e Qendrës ishin të detyrueshme dhe të zbatueshme, Gjykata vuri në dukje se autoritetet nuk morën masa për të krijuar kushtet e nevojshme për ekzekutimin e këtyre vendimeve. Si të, vendimet e Qendrës mbetën të pa ekzekutuara dhe kërkuesit nuk ishin në gjendje të takonin M. M. deri më 13 shkurt 2014 kur dy prej kërkuesve kishin vendosur kontakt me vajzën.

Ndërkohë, që Qendra kishte shqyrtuar efektet që ndarja nga babai mund t'i shkaktonte M. M., ajo nuk kishte konsideruar interesin legjitim të kërkuesve për të zhvilluar dhe mbajtur një lidhjeje me M.M. Në të vërtetë, në raste të tilla, mundësia e ribashkimit familjar gradualisht zvogëlohet për sa kohë që është ndaluar kontakti ndërmjet kërkuesve dhe fëmijës. Pavarësisht nga ndjeshmëria e çështjes, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet e vendase nuk kishin bërë përpjekjet e përshtatshme dhe efektive për të zbatuar të drejtat e ankuesve sipas nenit 8 dhe për këtë arsye kishte pasur shkelje të këtij neni.

### Neni 13

Gjykata nisi arsyetimin duke përcaktuar që neni 13 i kërkon shteteve të sigurojnë, ekzistencën e juridike vendase për të siguruar korrigjimin e duhur për ankimet që bëhen në kuadër të Konventës. Ndërkohë që Shteteve iu dha njëfarë lirie në mënyrën se si ata i përmbushën detyrimet e tyre, mjetet juridike që ata ofruan duhej të ishin efektive në praktikë dhe në ligj.

Ankuesit në këtë rast kërkuan tre mjete juridike. I pari ishte që Qendra dhe Ministria e Drejtësisë të zbatonin vendimet e dhëna nga vetë Qendra, i dyti ishte marrja e kujdestarisë së përkohshme të fëmijës dhe i treti ishte akuza penale për rrëmbimin e fëmijës, që ngritën kundër znj. J.S.M. Kërkesa për ekzekutim u refuzua pasi Qendra dhe Ministria e Drejtësisë nuk pranuan juridiksionin për këtë çështje. Prandaj, kërkuesit nuk kishin rrugë ligjore për të vendosur në lëvizje këtë procedurë. Qeveria nuk i ka ofruar Gjykatës informacion se cili organ ka kompetencë në këtë tipologji çështjesh. Për rrjedhojë, Gjykata nuk ishte e bindur se legjislacioni kombëtar në lidhje me përmbarimin zbatohet edhe për vendimet e Qendrës. Kështu, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur një mjet juridik efektiv sipas ligjit të brendshëm për të adresuar ankimin e z. Mitov.

Gjykata gjithashtu nuk ishte e bindur se akuza penale kundër znj. J.S.M. siguroi një mjet juridik efektiv, sidomos pasi asnjë pasojë nuk erdhi për kërkuesin e dytë dhe të tretë. Duke vlerësuar se kërkuesit nuk kishin pasur akses në një mjet juridik efektiv në lidhje me ankimet e tyre sipas nenit 8, Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata vendosi se shteti i paditur duhet të dëm shpërblente kërkuesin e parë në vlerën 13,000 euro dhe dy kërkuesit e tjerë së bashku në vlerën 7,000 euro në lidhje me dëmin jo material. Kërkuesve iu akorduan 850 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.



*Dhënia e dënimit me burg ndaj një nëne për mospërbushje të urdhrin për të drejtën e takimit nuk përbënte shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MITROVA DHE SAVIK k. ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQËDONISË**

(Kërkesa nr. 42534/09)

**11 shkurt 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkueset ishin znj. Spaska Mitrova dhe znj. Suzana Savik, të lindura respektivisht në 1983 dhe 2007 dhe jetonin në Gevgelija. Kërkuesja e parë ishte nëna e kërkueses së dytë.

Kërkuesja e parë u martua me z. V. Savik (babai) në 2006 dhe lindi kërkuesen e dytë në shkurt të 2007. Në 10 maj 2007, Gjykata e Shkallës së Parë të Gevgelija zgjidhi martesën dhe i la kujdestarinë e kërkueses së dytë, kërkueses së parë.

Më 31 maj 2007, Qendra për Mirëqenie Sociale në Gevgelija (Qendra) nxori një urdher duke specifikuar se babait do t'i lejohej të shihte kërkuesen e dytë një herë në javë, për dy orë, në shtëpinë e kërkueses së parë. Refuzimi i kërkueses së parë për të lejuar që babai të kishte kontakt me kërkuesen e dytë në katër takime të planifikuara nga data 8 deri më 29 qershor 2007, çoi në dënimin e saj me gjashtë muaj burg, i zëvendësuar me 1 vit lirim me kusht. Pas refuzimit të vazhdueshëm të kërkueses së parë për të lejuar babanë të takonte fëmijën, asaj ju dha një dënim tjetër me kusht (alternativ) më 17 dhjetor 2007.

Më 21 nëntor 2007 dhe 29 prill 2008, Qendra nxorri urdhra të reja të cilat lejonin babain të takonte fëmijën e tij për pesë dhe shtatë orë respektivisht, pranë Qendrës dhe jo në shtëpinë e kërkueses së parë. Sërisht, kërkuesja e parë ndërmjet nëntorit 2007 dhe prillit 2008, nuk u paraqit në Qendër së bashku me kërkuesen e dytë për gjashtë herë. Si rezultat, Prokurori Publik ngriti akuza penale kundër saj.

Më 10 korrik 2008, Gjykata e Shkallës së Parë e dënoi atë me tre muaj burg. Ankimi-met e saj si në Gjykatën e Apelit të Shkupit dhe më pas në Gjykatën Supreme u hodhën poshtë. Më 30 korrik 2009, kërkuesja e parë filloi të vuante dënimin me burg dhe Qendra i dha kujdestarinë e përkohshme të kërkueses së dytë babait.

Më 6 tetor 2009, dy ditë përpara lirimit të saj dhe më pas më 4 janar 2010, kërkuesja e parë parashtroi dy kërkesa për të vendosur kontakt me Qendrën, të cilat nuk mund të shqyrtoheshin sepse ajo nuk pranoi të merrte pjesë në intervistat me punonjësit e Qendrës. Në bazë të një kërkesë të re të bërë më 29 janar 2010 e cila përmbante detaje të mjaftueshme, Qendra përcaktoi rregullat e kontaktit të saj me fëmijën.

Në një vendim të datës 11 mars 2010, gjykata e shkallës së parë e miratoi kërkesën e babait për kujdestarinë e kërkueses së dytë. Megjithatë, më 20 maj 2010, vendimi i shkallës së parë u hodh poshtë nga Gjykata e Apelit të Shkupit, e cila urdhëroi gjykatën e shkallës së parë të rivlerësonte provat dhe të jepte argumente bindëse se kërkuesja e parë ishte e papërshtatshëm për të pasur kujdestarinë e fëmijës.

Gjatë gjykimit, një grup ekspertësh përcaktoi se të dy prindërit ishin mendërisht të aftë dhe kishin kapacitetin e duhur për t'u kujdesur për fëmijën. Gjykata e shkallës së parë konstatoi se sjellja e keqe në të kaluarën e kërkueses së parë ishte rezultat i mungesës së besimit tek autoritetet dhe marrëdhënies së saj të tensionuar me (ish-bashkëshortin) babanë, por kjo nuk kishte ndikuar në aftësinë e saj për t'u kujdesur për fëmijën. Prandaj, gjykata e shkallës së parë konstatoi se ishte në interesin më të lartë të fëmijës që kujdestaria t'i lihej kërkueses së parë. Më 3 shkurt 2011, Gjykata e Apelit të Shkupit la në fuqi këtë vendim.

Më 1 mars 2012, Gjykata Supreme hodhi poshtë vendimin e Gjykatës së Apelit të 3 shkurtit 2011 dhe e kaloi kujdestarinë e kërkueses të dytë tek babai. Sipas Gjykatës Supreme, kjo ishte në interesin më të lartë të fëmijës, duke pasur parasysh se kur kërkuesja e parë kishte kujdestarinë e fëmijës, rezultoi shpesh në pamundësinë e babit për të parë kërkuesen e dytë ndërsa sjellja e tij kishte provuar të ishte konstruktive dhe bashkëpunuese.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja e parë u ankua se dënimi për heqjen e lirisë së saj me vendim të 10 korrikut 2008, dështimi i Qendrës për të përcaktuar të drejtën e kërkueses së parë për të pasur kontakt me kërkuesen e dytë për disa muaj gjatë dhe menjëherë pas burgimit dhe vendimit të Gjykatës Supreme që revokonte kujdestarinë e saj ndaj fëmijës, përbënte shkelje të së drejtës së tyre për jetë familjare të mbrojtur sipas nenit 8 të Konventës.

### Neni 8

Gjykata pranoi se gëzimi reciprok i shoqërisë së prindit dhe fëmijës me njëri-tjetrin përbën një element themelor të "jetës familjare" brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës.

Më pas, Gjykata theksoi se sipas nenit 8, shteti ka detyrimin pozitiv për të marrë masat e duhura me qëllim që të mundësojë bashkimin e prindit që nuk ka kujdestarinë me fëmijën, duke përfshirë edhe rastet e konfliktit midis prindërve. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se ky detyrim nuk është absolut dhe varet nga rrethanat e secilit rast. Për më tepër, megjithëse përdorimi i sanksioneve shtrënguese në këtë fushë të ndjeshme nuk është i dëshirueshëm, nuk duhet të përjashtohet në rastet e “sjelljes haptazi të paligjshme të prindit me të cilin jeton fëmija”.

Gjykata theksoi se çështja vendimtare që shtrohet është nëse është arritur një ekuilibër i drejtë midis interesave konkurruese në rrezik - ato të fëmijës, të dy prindërve dhe të rendit publik - brenda hapësirës së vlerësimit që ju është dhënë Shteteve për çështje të tilla, duke pasur parasysh se interesi më i lartë i fëmijës duhet të ketë vëmendjen kryesore. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se interesi më i lartë i fëmijës mund, në rrethana të caktuara, të anashkalojë ato të prindërve.

Në vlerësimin nëse dënimi me heqje lirie ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”, Gjykata vuri në dukje se ndërkohë që heqja e lirisë kishte efekt afatshkurtër mbi të drejtat e kërkueseve, ai kishte në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës, respektivisht të përfitonte nga shoqëria e të dy prindërve. Prandaj, Gjykata konstatoi se ndërhyrja e Shtetit në të drejtat e kërkueses së parë nuk mund të konsiderohej si joproporcionale sipas nenit 8, duke pasur parasysh rastin në tërësi dhe mospërmbushjen e urdhrave të Qendrës nga ana e kërkueses së parë, duke ndaluar në këtë mënyrë moslejimin e babait dhe fëmijës për të parë njëri-tjetrin. Gjykata theksoi se në rrethana të tilla, kur një prind i pengon tjetrit të shikojë fëmijën, “mundësitë e bashkimit familjar do të zvogëlohen gradualisht dhe do të shkatërrohen përfundimisht”.

Ndërsa Gjykata pranoi se është pjesë thelbësore e të drejtës së të burgosurit për respektimin e jetës familjare që autoritetet i mundësojnë dhe i ndihmojnë ata të mbajnë kontakte me familjen e ngushtë, Gjykata konstatoi se, nisur nga fakti se kërkuësja e parë nuk paraqiti kërkesën e duhur pranë autoriteteve, duke përfshirë këtu dhe Qendrën, për t'i lejuar asaj kontaktin me fëmijën e saj, Qendra nuk kishte kompetencën për të caktuar me mocion të saj për të përcaktuar të drejtën e kërkueseve për jetë private dhe familjare.

Fakti që kërkuëset nuk e shihnin njëra pas liritimit të kërkueses së parë nga burgu për gati gjashtë muaj, nuk ishte faj i Qendrës për sa kohë që kërkuësja kishte refuzuar të merrte pjesë në intervistat me punonjësit e Qendrës.

Në dhënien e kujdestarisë së babait të fëmijës, Gjykata vërejti se Gjykata Supreme kishte marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, që kur kërkuesja e parë kishte pasur në kujdestari fëmijën ajo vazhdimisht nuk e kishte lejuar babain për të parë fëmijën e tij.

Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të nenit 8 të Konventës.

*Ndalimi i paligjshëm i të miturit azilkërkues, përbënte shkelje të nenit 3 dhe 5*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MUSKHADZHIYEVA DHE TË TJERËT k. BELGJIKËS**

(Kërkesa nr. 41442/07)

**19 janar 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Aina Muskhadzhijeva, e lindur 1966, dhe katër fëmijët e saj, Alik, Liana, Khadzha dhe Louisa, (lindur më 2006, 2003, 2001 dhe 2000, respektivisht të moshës 7 muajshe, tre vjeç e gjysëm, pesë dhe shtatë vjeç në kohën e gjykimit të çështjes në shtetas rusë me origjinë çeçene jetonin në një kamp refugjatësh në Poloni.

Më 11 tetor 2006, kërkuesit fluturuan nga Grozni në Çeçeni dhe mbërritën në Belgjikë ku kërkuan azil ditën e nesërme. Znj. Mushhadzhijeva, kërkuesja e parë, nuk posedonte dokumente identifikimi dhe pretendonte se ajo nuk kishte aplikuar kurrë për azil në Belgjikë apo në ndonjë vend tjetër, se nuk e dinte kush ishte vendi i parë në të cilin kishte hyrë në BE dhe se nuk kishte jetuar në asnjë vend tjetër të BE-së, përpara Belgjikës.

Gjurmët e gishtave të saj zbulonin se ajo kishte qenë e regjistruar në Poloni disa herë midis viteve 2004 dhe 2006. Më pas ajo dha informacione kontradiktore pa qenë në gjendje të siguronte prova, duke pranuar se e kishte kaluar Poloninë në rrugën e saj drejt Belgjikës dhe se kishte jetuar për disa muaj në të shkuarën në Poloni para se të kthehej në Rusi. Ajo shtoi se në fillim të tetorit të 2006 ishte larguar sërish nga Rusia, për të shkuar drejt Belgjikës për të kërkuar azil.

Në nëntor 2006, u deklarua se Polonia ishte shteti përgjegjës për marrjen në shqyrtim të kërkesës së saj për azil.<sup>157</sup> Autoritetet belge lëshuan një deklaratë që refuzonte lejen e kërkuesve për të qëndruar në Belgjikë dhe urdhëronte transferimin e tyre në Poloni. Më 22 dhjetor 2006, në pritje të transferimit të tyre, kërkuesit u vendosën në një qendër të mbyllur tranziti pranë aeroportit të Brukselit, e njohur si “Qendra e Tranzitit 127 bis”.

---

<sup>157</sup> Në bazë të nenit 16 (d) të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 343/2003 u vendosën kritere dhe mekanizma për përcaktimin e shtetit të BE-së që do të ishte përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë azili të paraqitur në një Shtet Anëtar nga shtetas të një vendi të tretë.

Më 29 dhjetor 2006, kërkuesit parashtruan një kërkesë për lirimin e tyre, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Brukselit. Më 5 janar 2007, kjo gjykatë konstatoi se refuzimi i lejes për të qëndruar ishte në përputhje me ligjin, pasi marrja në shqyrtim e kërkesave për azil në rastin në fjalë i takonte autoriteteve polake. Kërkuesit e ankimuan këtë vendim.

Më 23 janar 2007, Gjykata e Apelit e shpalli vendimin e dëbimit të ligjshëm dhe në 24 janar 2007, kërkuesit e ankimuan vendimin e Gjykatës së Apelit përpara Gjykatës së Kasacionit. Në të njëjtën ditë, kërkuesit u dërguan në Poloni, ku u vendosën në një qendër për refugjatët, në pritje të marrjes në shqyrtim të kërkesave të tyre për azil. Më 21 mars 2007, Gjykata e Kasacionit e shpalli ankesën e tyre të papranueshme, pasi ata tashmë ishin dërguar në Poloni.

Ndërsa kërkuesit ishin akoma në Belgjikë, OJF “Médecins sans frontières” konstatoi se fëmijët, veçanërisht Khadzha, kishin simptoma psikologjike dhe psikotraumatike dhe për këtë duhet të lireshin të lirë për të minimizuar dëmin. Më 27 mars 2007, një raport tjetër i hartuar nga një psikolog në Poloni konfirmoi gjendjen psikologjike mjaft kritike të Khadzhas dhe u shpreh se përkeqësimi mund të ishte shkaktuar si pasojë e ndalimit në Belgjikë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan për shkelje të neneve 3 dhe 5 të Konventës. Në mënyrë të veçantë, ata u ankuan për kushtet e ndalimit për më tepër se një muaj në “Qendrën Transitore 127 bis” dhe deklaruan se ndalimi i tyre kishte qenë i paligjshëm dhe mjeti juridik i përdorur para Gjykatës së Kasacionit nuk kishte qenë efektiv, pasi ata ishin larguar nga vendi përpara se gjykata të merrte një vendim.

### Neni 3

Së pari, duke marrë në shqyrtim gjendjen e katër fëmijëve, Gjykata rikujtoi jurisprudencën e saj tek *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*<sup>158</sup>, ndalimi i një të mituri të pashoqëruar në “Qendrën Tranzitore 127 bis” vinte në kundërshtim me nenin 3 dhe se vulnerabiliteti ekstrem i një fëmije prevalonte dhe mernte përparësi ndaj statusit të tij si i paligjshëm. Gjykata dallimin ndërmjet rastit në fjalë me rastin e *Mubilanzila*, pasi në këtë çështje fëmijët nuk u ndanë nga kërkuesi i parë, nëna e tyre, por në të dy rastet solli në vëmendje paralelisht vulnerabilitetin ekstrem të fëmijëve. Kushtet e paraburgimit në qendrën “127 bis” nuk ishin të projektuara për të strehuar fëmijët, siç konfirmohet nga disa raporte të cituara nga Gjykata. Gjithashtu, Gjykata i

---

<sup>158</sup> *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 2006, nr. 13178/03.

referohej problemeve të evidentuara nga mjekët e pavarur lidhur me gjendjen shëndetësore të fëmijëve.

Duke pasur në vëmendje moshën e fëmijëve, kohëzgjatjen e ndalimit të tyre dhe gjendjen e shëndetit të tyre, Gjykata konstatoi se kushtet në të cilat kishin qëndruar fëmijët në qendrën e ndalimit “127 bis” kishin arritur pragun e ashpërsisë për t’u konsideruar si trajtim çnjerëzor dhe për rrjedhojë u konstatua shkelje sipas nenit 3.

Më tej, Gjykata vijoi të shqyrtojë rastin e nënës, duke u përpjekur të vlerësonte nëse kërkuesi i parë mund të konsiderohej si një viktimë e tërthortë e keqtrajtimit që ju ishte shkaktuar fëmijëve të saj. Për sa kohë që kërkuesja e parë nuk ishte ndarë në asnjë fazë nga fëmijët e saj, ajo nuk kishte vuajtur nga ankthi i të mos qenit në gjendje t’i mbronte ata dhe se prania e tyre e vazhdueshme duhej t’ja kishte zbutur disi shqetësimin dhe mërzitjen e ndalimit të tyre. Për rrjedhojë, ndalimi nuk kishte arritur e ashpërsisë për tu konsideruar si trajtim çnjerëzor dhe poshtërues dhe për këtë në rastin e nënës nuk u konstatua asnjë shkelje sipas nenit 3.

#### Neni 5 § 1

Duke ju referuar vendimit të saj tek *Mubilanzila*, Gjykata konstatoi se edhe pse familja nuk ishte ndarë, fakti që fëmijët mbaheshin në një qendër të mbyllur të projektuar për rritur dhe të pa përshtatshme për vulnerabilitetin e tyre, përbënte shkelje të nenit 5 § 1 në lidhje me fëmijët.

Duke u rikthyer tek rasti i ndalimit të nënës, Gjykata nuk vërejti elemente që vinin në kundërshtim me Konventën. Ajo ishte ndaluar në mënyrë të ligjshme me qëllim dëbimin të saj nga Belgjika, dhe për rrjedhojë nuk kishte pasur shkelje e nenit 5 § 1 në lidhje me rastin e saj.

#### Neni 5 § 4

Gjykata shqyrtoi nëse mosdhënia e vendimit nga Gjykata e Kasacionit lidhur me kërkesën e kërkuesve për lirim përpara se ata të ktheheshin në Poloni përbënte shkelje të nenit 5 § 4. Ndërsa, Gjykata e Kasacionit e kishte dhënë vendimin e saj pas transferimit të kërkuesve, përpara se dy gjykatat që kishin juridiksion *de facto* dhe *de jure* ta kishin shqyrtuar kërkesën pa vonesa, ndërkohë që kërkuesit vijonin të ishin ende në Belgjikë. Më 29 dhjetor 2007, kërkuesit kishin paraqitur një ankesë në gjykatën e shkallës së parë, dhe kjo gjykatë kishte vendosur mbi këtë çështje brenda një afati të shkurtër, gjashtë ditë më vonë. Në mënyrë të ngjashme, kërkuesit patën mundësinë të apelojnë vendimin e Dhomës së Këshillit ndërsa vijonin të ishin ende në territorin belg.

Gjykata përsëriti se neni 5 § 4 nuk garanton asnjë të drejtë, të tillë si, në rastin e një apeli kundër vendimeve që caktojnë ose zgjasin periudhën e ndalimit. Në parim, sipas neni 5 § 4 është e mjaftueshme që ankesa të shqyrtohet nga një gjykatë e vetme, me kusht që procedura e ndjekur të jetë e ligjshme dhe t'i sigurojë individit garancitë e përshtatshme lidhur me thelbin e heqjes së lirisë së tyre. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të neni 5 § 4.

#### Neni 41

Gjykata akordoi 17,000 euro në total për të katër fëmijët lidhur me dëmin jomaterial që erdhi si pasojë e ndalimit të tyre. Për sa kohë që kërkuesit nuk paraqitën një kërkesë lidhur me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore, Gjykata nuk akordoi asnjë shumë për këtë.



*Vendimet e gjykatave vendase për rikthimin e tre fëmijeve tek babi i tyre kundër vullnetit të tyre dhe pa bërë ularsimin e duhur mbi interesin e tyre më të lartë përbënte shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN N.TS. DHE TË TJERËT K. GJEORGJISË**

(Kërkesa nr. 71776/12)

**2 shkurt 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkesuesja, znj. N.TS., ishte shtetase gjeorgjiane e lindur në 1976, e cila jetonte në Tbilisi. Tre e saj – N.B., dhe dy djem binjakë, S.B. dhe L.B. - kishin lindur respektivisht në 2002 dhe 2006 dhe ishin të mitur në kohën e procesit.

Motra e N.T.– nëna e djemve – vdiq në nëntor 2009 dhe fëmijët e saj shkuan të jetonin me tezen e tyre dhe gjyshërit nga ana e nënës. Në fund të dhjetorit të 2009, z. G.B. – djemtë e babait – kërkuan kthimin e djalit të tij, por gjyshërit nga ana e nënës refuzuan. Ky refuzim vinte kryesisht si pasojë e abuzimit të tij me drogën (megjithëse në 2008 ai kishte filluar të trajtohej me substancën e metadonit) disa dënime të mëparshme lidhur me abuzimin me drogën dhe faktit që në vitin 2008 ai u diagnostikua me çrregullime në sjellje dhe çrregullime psikiatrike. Megjithatë, referuar dosjes mjekësore, në shkurt 2010 diagnoza e tij tregonte se varësia e tij ndaj drogës ishte ulur, dhe ai nuk paraqiste ndonjë kërcënim as ndaj vetes së tij dhe as ndaj personave që e rrethonin. Më tej, referuar një certifikate tjetër mjekësore, ai nuk vuante nga asnjë patologji psikiatrike.

Më 5 janar 2010, z. G.B. i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tbilisit kthimin e djalit të tij. Pavarësisht vendimit të gjykatës për të përfshirë në këtë rast Agjencinë e Shërbimit Social (ASHS) duke i kërkuar asaj të emëronte një përfaqësues për të mbrojtur interesat e djemve dhe për të kryer një vlerësim të kushteve të jetesës së babait dhe gjyshërve nga ana e nënës, përfaqësuesit e ASHS nuk u përfshinë në këtë fazë të procesit. Ata morën pjesë vetëm në procesin e mëvonshëm në apel të sjellë nga familja e nënës, në statusin e “palës së interesuar”.

Në maj 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tbilisit vendosi që të tre djemtë të ktheheshin tek babai i tyre, duke e konsideruar këtë kthim të dobishëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e tyre fizik dhe intelektual. Gjykata i njohti z. G.B aftësinë për përgjegjësitë e tij prindërore, pavarësisht se një raport i ekspertëve rekomandonte se djemtë nuk duhej të ndryshonin mjedisin jetësor pasi ata kishin vuajtur nga çrregullime të ankthit nga ndarja dhe kishin shfaqur një qëndrim negativ ndaj babait të tyre.

Familja nga ana e nënës apeloj në Gjykatën e Apelit të Tbilisit duke u ankuar lidhur me vendim e gjykatës së shkallës së parë, e cila i kishte dhënë përparësi të drejtave të babit në vend që të udhëhiqej nga interesi më i lartë i fëmijëve. Në shkurt 2011, Gjykata e Apelit e prishi vendimin e ankimuar dhe vendosi që tre djemtë duhet të qëndrojnë me familjen e prindërve nga nëna. Megjithatë, në tetor 2011, Gjykata Supreme e Gjeorgjisë e ktheu çështjen për rishqyrtim. Më 2 shkurtit 2012, Gjykata e Apelit e Tbilisit, e hodhi poshtë vendimin e mëparshëm, duke konkluduar se fëmijët duhet të jetojnë me z. G.B. Ankimi i bërë nga tezet dhe gjyshërit nga nëna në Gjykatën Supreme të Gjeorgjisë u hodhën poshtë në maj të vitit 2012.

Me qëllim ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tbilisit u bënë dy përpjekje lidhur me kthimin e djemve tek babai pasi fëmijët refuzonin të shkonin me z. G.B. Në kohën e procesit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, djemtë po jetonin me gjyshërit nga ana e nënës dhe tezet.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendoi se e drejta e të saj për respektimin e jetës private dhe familjare të sanksionuar në nenin 8 të Konventës ishte shkelur për shkak të vendimit të gjykatave të brendshme për t'i kthyer fëmijët tek babai i tyre. Ajo parashtrroi në veçanti se autoritetet kombëtare nuk kishin arritur të vlerësonin tërësisht interesat më të larta të djemve dhe se proceset kishin pasur të meta procedurale.

### Qëllimi i kërkesës dhe pranueshmëria

Kërkuesja e bëri të qartë se ajo paraqiti një kërkesë në Gjykatë vetëm në emër të të saj dhe nuk ishte duke ndjekur ndonjë kërkesë të mundshme në emër të saj. Në prapësimet e saj, Qeveria deklaroi se tezja nuk kishte *locus standi* për të bërë kërkesë në emër të të saj.

Gjykata u shpreh se do të kufizonte shqyrtimin e çështjes në dy pyetjet e mëposhtme: nëse znj. N.Ts. kishte *locus standi* për t'u ankuar në emër të nipave të saj dhe, nëse po, a ishte shkelur e drejta e të miturve për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare për shkak të vendimit të gjykatave vendase për kthimin e tyre tek babai.

Qeveria argumentoi se kërkuesja nuk kishte tagrin e nevojshëm për të vepruar në emër të të saj, pasi babait të djemve nuk i ishte privuar e drejta e tij prindërore dhe se ai ishte kujdestari i tyre i vetëm ligjor pas vdekjes së nënës së tyre dhe se djemtë asnjëherë nuk ishin vënë nën kujdestarinë e tezeve të tyre. Këtu Gjykata theksoi se të tre djemtë haptazi ishin në pozita vulnerable. Ata ishin të mitur që kishin

humbur nënën e tyre dhe kishin një marrëdhënie të komplikuar, madje armiqësore me babanë e tyre. Në rrethanat e aktuale, nuk kishte dyshim se tezza kishte një lidhje mjaft të ngushtë me nipat e saj për t'u ankuar në emër të tyre, duke pasur parasysh faktin se që nga vdekja e nënës së tyre, ajo ishte kujdesur dhe kishte siguruar një banesë të qëndrueshme për ta.

Më tej, Gjykata shqyrtoi çështjen për të përcaktuar nëse plotësonte dy kritere shtesë: së pari, rreziku që pa kërkesën e tezes, djemtë do të ishin privuar nga një mbrojtje efektive e të drejtave të tyre; dhe se nuk kishte konflikt interesi mes tyre dhe tezes. Përsa i takon kriterit të parë, duke pasur parasysh situatën e familjes së djemve, haptazi nuk kishte asnjë të afërm tjetër që mund të ishte ankuar në emër të tyre. Rrjedhimisht, nuk kishte burim alternativ të përfaqësimit që do të ngrinte dyshimin se roli i hallave të tyre ishte i papërshtatshme ose i panevojshëm. Sa i përket kriterit të dytë, thelbi i kërkesës ishte dyshimi nëse autoritetet vendase kishin respektuar aspektin procedural sipas parashikimeve të Konventës dhe nëse kishin vepruar në interesin më të lartë të fëmijëve. Për rrjedhojë, Gjykata, nuk vërejti ndonjë konflikt interesi midis hallës dhe nipërve të saj në këtë pikë, duke marrë parasysh faktin se ajo nuk u ankua në emër të saj. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata konsideroi se tezza kishte tagër për të paraqitur një kërkesë në emër të nipërve të saj.

## Neni 8

Gjykata konstatoi se thelbi i çështjes të paraqitur në parashtrimet e tezes lidhur me të drejtat e të saj sipas nenit 8 ishte shkelur, sepse gjykatat vendase nuk kishin arritur të vlerësonin tërësisht gjendjen e tyre dhe të merrnin në konsideratë interesin e tyre më të lartë. Këtu ekzistojnë dy aspekte themelore për të shqyrtuar: nëse djemtë ishin përfshirë në mënyrë të rregullt në proces dhe nëse vendimet e marra nga gjykatat vendase u diktuan nga interesat e tyre më të larta.

Edhe pse gjykata e shkallës së parë kishte kërkuar emërimin e një përfaqësuesi të ASHS për djemtë, Gjykata kishte rezerva lidhur me rolin specifik që kishte luajtur përfaqësuesi gjatë itinerarit të proceseve të brendshme. ASHS ishte përfshirë formalisht në proces që nga apeli dhe vetëm në statusin e “palës së interesuar”, për të cilën Kodi i Procedurës Civile nuk kishte parashikuar asnjë dispozitë. Prandaj, ishte e paqartë se si ASHS mund të kishte përfaqësuar në mënyrë efektive interesat e fëmijëve, për shkak se ajo nuk kishte tagër përfaqësimi. Përveç kësaj, mbetet e paqartë se çfarë nënkuptonte saktësisht një përfaqësim i tillë nga ana e ASHS, pasi legjislacioni përkatës nuk përcaktonte funksionet dhe kompetencat e përfaqësuesit të caktuar sipas skemës së sipërpërmendur. Gjatë periudhës së procesit, si cili zgjati më shumë se dy vjetësh përfaqësuesit e ASHS-së takuan djemtë vetëm disa herë me qëllimin e

vetëm të hartimit të disa raporteve mbi kushtet e tyre të jetesës dhe gjendjen e tyre emocionale. Megjithatë, nuk ishte mbajtur ndonjë kontakt i rregullt për monitorimin e djemve dhe krijimin e një marrëdhënie të besueshme me ta.

Në këtë kontekst, Gjykata ju referua instrumenteve të disa organeve ndërkombëtare ku në rastet kur ekzistojnë interesa konfliktuale ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, kërkohet sigurimi i një kujdestari *ad litem* ose emërimi i një përfaqësuesi tjetër të pavarur me qëllim përfaqësimitin e pikëpamjeve e fëmijës dhe për ta mbajtur atë të informuar në lidhje me procesin.

Gjykata vërjeti sesi hartimi i raporteve të ASHS dhe ndjekja e seancave gjyqësore pa pasur tagër mund të konsiderohej si një përfaqësim adekuat i këtyre standardeve. Për më tepër, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare përkatëse, gjykatat kombëtare nuk kishin shqyrtuar mundësinë e përfshirjes direkte, së paku të djalit më të madh gjatë proceseve që preknin të drejtat e tyre.

Vendimi i gjykatave vendase për kthimin e djemve tek babai i tyre ishte kryesisht i bazuar në dy arsye: interesi më i lartë i djemve që të ribashkohen me babanë e tyre dhe ndikimi negativ i familjes së nënës tek djemtë. Ndërsa Gjykata e pranoi këtë arsyetim, ajo nënvizoi se gjykatat vendase nuk arritën të merrnin në konsideratë faktin se djemtë nuk donin të ribashkoheshin me babanë e tyre. Çfarëdo manipulimi që mund të këtë bërë familja e nënës në armiqësimin e djemve ndaj babait të tyre, provat në lidhje me qëndrimin armiqësor të djemve ndaj tij ishin të paqarta. Për më tepër, disa raporte të psikologëve kishin paralajmëruar për rreziqet e mundshme mbi shëndetin psikologjik të djemve në rast të kthimit të detyruar tek babai i tyre. Në këto rrethana, një masë e tillë rrënjësore pa marrë parasysh kalimin e duhur dhe masat përgatitore që synonin të ndihmonin djemtë dhe babain e tyre në rindërtimin e marrëdhënieve, vinte në kundërshtim me interesat e djemve.

Gjykata arriti në përfundimin, se përfaqësimi me të meta dhe dështimi pasues për të paraqitur dhe dëgjuar në mënyrë të rregullt pikëpamjet e djemve, si dhe për të marrë në konsideratë interesat e tyre më të larta dhe gjendjen emocionale, kishin minuar procesin e rregullt të vendimmarrjes, duke shkelur për rrjedhojë të drejtat e garantuara në nenin 8.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Gjeorgjia duhej t'u paguante të dy djemve së bashku 10,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 900 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Urdhri i dhënë nga gjykatat zvicerane për kthimin në Izrael të një fëmije, i cili ishte rrëmbyer nga nëna e tij nuk ishte në interesin e tij më të lartë dhe për rrjedhojë cenonte nenin 8*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE ÇËSHTJEN NEULINGER DHE SHURUK k. ZVICRËS**

(Kërkesa nr. 41615/07)

**6 korrik 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Isabelle Neulinger dhe djali i saj Noam Shuruk, ishin shtetas zviceranë që jetonin në Luzanë, Zvicër. Kërkuesja e parë, znj. Neulinger vendosi të zhvendoset në Izrael më 1999 dhe u martua me një shtetas izraelit, Shai Shuruk. Djali i tyre, Noam, lindi në Tel Aviv në vitin 2003 dhe kishte shtetësi izraelite dhe zvicerane.

Sipas kërkuesve, në vjeshtën e vitit 2003 babai i fëmijës iu bashkua lëvizjes hebreje “Lubavitch”, të cilën e përshkruan si ultra-ortodokse dhe radikale të njohur. Pas vështirësive martesore, duke u frikësuar se burri i saj do të merrte djalin e tyre në një komunitet “Chabad-Lubavitch” jashtë vendit për indoktrinimin fetar. Znj. Neulinger aplikoi në Gjykatën Familjare të Tel Avivit për një urdhër *ne exeat* me qëllim që të parandalonte largimin e Noamit nga Izraeli. Më 20 qershor 2004, Gjykata e Familjare ia akordoi kërkueses një urdhër të tillë, i cili skadonte kur fëmija të mbushte moshën madhore, si edhe përmes një vendimi të ndërmjetëm i akordoi asaj “kujdestarinë se përkohshme” të djalit.

Në një vendim të 17 nëntorit 2004, Gjykata Familjare konfirmoi kujdestarinë e kërkueses së parë dhe i akordoi babait të drejtën e vizitës.

Pas një kërkese urgjente të paraqitur nga kërkuesja e parë, më 12 janar 2005, Gjykata e Familjare e Tel Avivit e ndaloi babanë të hyjë në kopshtin e fëmijëve ose në banesën e kërkueses. Kufizime u vendosën gjithashtu mbi të drejtën e të atit për të takuar fëmijën.

Zgjidhja e martesës së çiftit u shpall më 10 shkurt 2005 dhe vendimi nuk ndryshoi aspektet e kujdestarisë.

Më 27 mars 2005, Gjykata Familjare e Tel Avivit rrëzoi një kërkesë të paraqitur nga kërkuesja e parë për anulimin e urdhrit *ne exeat*, që pengonte largimin e kërkuesit të dytë nga Izraeli. Kështu, më 24 qershor 2005, kërkuesja e parë u largua fshehurazi së bashku me të birin nga Izraeli për në.

Më 30 maj 2006, Gjykata Familjare Tel Avivit pas kërkesës së paraqitur nga babai i kërkuesit të dytë, vërejtë se fëmija ishte rezident i përhershëm në Tel Aviv dhe se, prej 24 2005, prindërit kishin qenë kujdestarë të përbashkët të djalit të tyre. Ajo pohoi se largimi i djalit nga Izraeli pa pëlqimin e të atit cenonte nenin 3 të Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve të 25 tetorit 1980 (Konventa e Hagës).

Babai i fëmijës paraqiti një kërkesë autoritetet vendase në Lozanë duke kërkuar një urdhër për kthimin e djalit në Izrael, por kërkesa e tij u refuzua. Gjykata vendase konsideroi se ndërsa largimi në mënyrë të fshehtë i fëmijës shkelte nenin 3 të Konventës së Hagës, ajo ishte e detyruar të zbatonte nenin 13, nën paragrafi (b), të së njëjtës Konventë, pasi ekzistonte rreziku që fëmija t'i ekspozohej një dëmi fizik ose psikologjik gjatë kthimit, ose do ta vendoste atë në një situatë të pa tolerueshme.

Më 25 shtator 2006 babai apeloj kundër këtij vendimi përpara Gjykatës së Kantonit Vaud, e cila urdhëroi kryerjen e një raporti ekspertize. Raporti, i hartuar nga një peditër dhe psikiatër për fëmijëve, konstatoi se kthimi i fëmijës në Izrael së bashku me nënën e tij do ta ekspozonte atë ndaj një dëmi psikologjik, intensiteti i të cilit nuk mund të vlerësohej pa konstatuar kushtet e atij kthimi, në veçanti kushtet që presin nënës dhe pasojat e tyre të mundshme për fëmijën. Gjithashtu, raporti paraqiti se kthimi i fëmijës pa nënën e tij do ta ekspozonte kundrejt një dëmi akoma më të madh psikologjik. Ekspertët u shprehën se edhe ruajtja e status quo-s do të përbënte edhe për fëmijën një rrezik real për dëmtime të mëdha psikologjike me pasoja afatgjata.

Në një letër të datës 30 prill 2007, në pyetjen nëse kërkuesja e parë do të ndiqej penalisht ose do të nëse ajo do të kthehej në Izrael, autoritetet izraelite deklaruan se do ta konsideronin pozitivisht udhëzimin e policisë vendase për të mbyllur dosjen penale për mungesë interesi publik, me kusht që znj. Neulinger të mos kryejë veprime të mëtejshme për të larguar fëmijën, si edhe të përmbushë disa kushte të caktuara.

Në vendimin e datës 22 maj 2007, Gjykata Kantonale e Vaudit rrëzoi ankimin e babait, duke konfirmuar se ky rast ishte një përjashtim nga parimi i kthimit të shpejtë të fëmijës, në përputhje me nenin 13, nën paragrafi (b) të Konventës së Hagës .

Babai paraqiti një ankim civil në Gjykatën Federale dhe më 16 gusht 2007, kjo gjykatë pranoi ankimin e tij duke argumentuar se neni 13 i Konventës së Hagës ishte zbatuar gabim dhe urdhëroi znj. Neulinger të kthente të birin në Izrael.

Më 27 shtator 2007, Dhoma vendosi të jap një vendim të ndërmjetëm në bazë të Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës, duke u shprehur se në interes të palëve dhe

për zhvillimin e duhur të procesit gjyqësor iniciuar përpara Zvicra. të mos kthente kërkuesen në Izrael deri sa çështja të përfundonte së shqyrtuari në Strasburg.

Një vendim i ndërmjetëm u dha më 29 qershor 2009, nga Gjykata e Qarkut në Lozanës, me kërkesë të znj. Neulinger, ku u vendos se djali do të jetonte me të ëmën në Luzanë, si edhe i ndaloi të atit kontaktin me kërkuesin e dytë, duke i kaluar kështu kujdestarinë e plotë kërkueses së parë me qëllim që ajo të kishte mundësi të rinovonte dokumentet e identifikimit të kërkuesit të dytë.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Në referim të nenit 8 të Konventës, kërkuesit u ankuan se kthimi i Noamit në Izrael do të përbënte një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e tyre për respektimin e jetës familjare.

Në vendimin e datës 8 janar 2009, Dhoma e Gjykatës konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8. çështja iu referua Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43 të Konventës me kërkesë të kërkuesve.

### Neni 8

Dhoma e Madhe vërejti se urdhri i Gjykatës Federale zvicerane për kthimin e fëmijës në Izrael përbënte një “ndërhyrje” të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës familjare brenda kuptimit të nenit 8. Për rrjedhojë, Gjykata ndaloi të shqyrtonte nëse ndërhyrja e kundërshtuar përmbushte kërkesat në nenin 8, domethënë, nëse ajo ishte “në përputhje me ligjin”, kishte një ose më shumë qëllime legjitime, si edhe nëse ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Së pari, Gjykata përsëriti gjetjet e Dhomës duke nënvizuar se largimi i kërkuesit të dytë nga Izraeli nga nëna e tij ishte i gabuar, pasi babai gëzonte të drejta për kujdestarinë e përbashkët të djalit dhe largimi i këtij të fundit nga vendi e shndërroi të drejtën e babait iluzore në praktikë.

Gjykata vërejti se në kuadër të legjislacionit izraelit i kujdestarisë, i cili përfshinte të drejtën për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës, ishte i krahasueshëm me të drejtat e kujdestarisë sipas nenit 5 të Konventës së Hagës, i cili përkufizon të drejtën e “përcaktimit të vendbanimit të fëmijës”. Sipas Gjykatës, kjo e drejtë ishte shkelur, pasi ajo duhej të ushtrohej bashkërisht me marrëveshje nga të dy prindërit. Për më tepër, nëna e mori fëmijën në Zvicër duke shkelur një urdhër të dhënë nga gjykatat vendase që ndalonte pikërisht largimin e tij nga Izraeli. Ky urdhër ishte lëshuar pas kërkesës së bërë nga vetë nëna.

Kështu, Dhoma e Madhe në të njëjtën linjë me Dhomën, konstatoi se kërkuesja e parë e largoi fëmijën e saj nga Izraeli drejt Zvicrës “në shkelje”, të nenit 3 të Konventës së Hagës, duke kryer kështu një rrëmbim për qëllimet e asaj Konvente. Për rrjedhojë, urdhri për kthimin e fëmijës sipas nenit 12 të Konventës së Hagës, kishte një bazë të mjaftueshme ligjore.

Dhoma e Madhe mbajti të njëjtin qëndrim sikurse dhe Dhoma në lidhje me faktin se vendimi i dhënë nga Gjykata Federale ndiqte një qëllim legjitim, e konkretisht mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të Noamit dhe babait të tij, qëndrim ky i cili nuk u kundërshtua nga palët përpara Dhomës së Madhe.

Në lidhje me pyetjen nëse ishte mbajtur një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesave konkurrues – atyre të fëmijës, të dy prindërve dhe të rendit publik - Gjykata u shpreh se interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore në këtë rast. Interesi më i lartë i fëmijës mund të varet nga natyra dhe serioziteti i çështjeve dhe mund të prevalojë mbi interesat e prindërve. Interesi i fëmijës përbëhet nga dy shtylla: mbajtja e lidhjeve të fëmijës me familjen dhe zhvillimi i tij / saj në një mjedis të shëndoshë. Këto parime parashikohen gjithashtu nga Konventa e Hagës, e cila kërkon rikthimin e shpejtë të fëmijës së rrëmbyer, përveç rasteve nëse ekziston një rrezik i madh që kthimi i fëmijës do ta ekspozonte atë përballë dëmtimeve fizike ose psikologjike, ose do ta vendoste në një situatë të papërballueshme në kuadër të nenit 13.

Nuk ishte detyrë e Gjykatës që të zëvendësonte autoritetet vendase në lidhje me ekzaminimin e faktit nëse ekzistonte rreziku, që fëmija të ekspozohej ndaj dëmtimit psikologjik, në kuptim të nenit 13 të Konventës së Hagës, në rast ai do të kthehej në Izrael. Megjithatë, Gjykata ishte kompetente për të konstatuar nëse gjykatat e vendase, në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të Konventës së Hagës, siguruan garancitë e përcaktuara në nenin 8 të Konventës, veçanërisht duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase që kishin shqyrtuar çështjen nuk kishin mbajtur një qëndrim unanim. Një sërë ekspertësh përmes raporteve që hartuan arritën në përfundimin se ekzistonte një rrezik real për fëmijën në rast të kthimit të tij në Izrael. Gjithashtu, në çdo rast, gjykatat vendase dhe ekspertët, u shprehën se kthimi i fëmijës mund të bëhej vetëm i shoqëruar nga nëna tij me qëllim shmangien e traumave.

Për të përcaktuar nëse kthimi i detyruar i fëmijës së shoqëruar nga nëna e tij, megjithëse ajo e kishte përjashtuar këtë mundësi, do të përfaqësonte një ndërhyrje proporcionale me të drejtën e secilit kërkues për respektimin e jetës së tij familjare, Gjykata



mori parasysh zhvillimet që kishin ndodhur nga koha kur ishte dhënë vendimi i Gjykatës Federale zvicerane. Kërkuesi i dytë tashmë kishte shtetësinë zvicerane dhe kishte ardhur në vend në moshën dy vjeçare. Sipas deklaratave të bëra nga vetë kërkuesit ai ishte përshtatur shumë mirë në Zvicër dhe ndiqte një çerdhe shtetërore sekulare gjatë ditës dhe një çerdhe private hebreje. Ai ndiqte shkollën në Zvicër dhe fliste frëngjisht. Edhe pse gjendej ishte në një moshë (7 vjeçare) ku ai ende kishte një kapacitet të caktuar për përshtatje, zhvendosja e tij përsëri do të kishte pasoja të rënda për të.

Për sa i përket problemeve që kthimi i nënës do të shkaktonte, ajo mund të ndaj rrezikut të sanksioneve penale, pasojat e të cilave mbeteshin për tu përcaktuar.

Gjykata vërejti se mundësia që kërkuesja e parë të mos ndiqej penalisht varej nga një sërë kushtesh që lidheshin me sjelljen e saj, të cilat megjithatë nuk e përjashtonin tërësisht mundësinë që ajo të ndiqej penalisht. Një skenar të tillë, nuk do të ishte në interesin më të lartë të fëmijës, duke pasur parasysh se kërkuesja e parë ishte ndoshta i vetmi person me të cilin ai kishte lidhje. Në rast të burgosjes së znj. Neulinger, nuk ishte e qartë nëse babai do të kishte aftësinë për t'u kujdesur për fëmijën, duke pasur parasysh sjelljen e tij në të kaluarën dhe burimet e kufizuara financiare. Sipas Gjykatës, nuk mund të cilësohej se znj. Neulinger ishte krejtësisht e pajustificuar kur refuzonte për t'u kthyer në Izrael.

Në dritën e konsideratave të sipërpërmendura, veçanërisht të zhvillimeve më të fundit në situatën e kërkuesve, Gjykata nuk ishte e bindur se kthimi i në Izrael do të ishte në interesin më të lartë të fëmijës. Sa i përket nënës, ajo do të hasej me një ndërhyrje jo proporcionale në të drejtën e saj për respektimin e jetës së qetë familjare në rast se detyrohej të kthehej në Izrael. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se do të kishte shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me të dy kërkuesit nëse do të ekzekutohej vendimi i gjykatës zvicerane, që urdhëronte kthimin e kërkuesit të dytë në Izrael.

#### Neni 6

Dhoma e Madhe konfirmoi qëndrimin e Dhomës në lidhje me pretendimet për nenin 6 § 1 përbënin një nga elementet thelbësore të shqyrtimit të ankimit në kuadër të nenit 8 dhe nuk ishte nevoja të shqyrtoheshin më vete.

#### Neni 41

Gjykata iu akordoi të dy kërkuesve së bashku 15,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Dështimi i autoriteteve polake për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive dhe për të ekzekutuar një urdhër gjykate pas një rrëmbimi ndërkombëtar të një fëmije, rezultoi në shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN OLLER KAMINSKA k. POLONISË**

(kërkesa nr. 28481/12)

**18 janar 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, znj. Oller Kaminska, ishte një shtetase polake. Në 27 mars 2000, ajo lindi një fëmijë, një vajzë të quajtur A. Në atë kohë, kërkuesja ishte e martuar me babanë e fëmijës, M.K. dhe jetonte në Poloni. Ajo kishte dhe një djalë nga një marrëdhënie e mëparshme, të lindur në vitin 1993. Në vitin 2006 familja u shpërngul në Irlandë. Ata jetuan atje deri në vitin 2009 kur çifti u nda dhe M.K. u rikthye në Poloni.

Në qershor të vitit 2009 M.K. u kthye në Irlandë për pushime dhe u shpreh se don-te të merrte A. me vete në Poloni për pushimet verore. Kërkuesja shqetësohej se ndoshta M.K. nuk do ta kthente vajzën e tyre A. në Irlandë pas pushimeve në Poloni, prandaj në 29 qershor 2009 ajo nisi procedurat para Gjykatës së Rrethit të Ennis, sipas ligjit të vitit 1964 për kujdestarinë e të miturve, duke deklaruar se rezidenca e fëmijës ishte në Irlandë dhe se fëmija duhet të kthehej në Irlandë në 15 gusht 2009. Në 2 korrik 2009, Gjykata lëshoi një urdhër pëlqimi si masë të përkohshme. Sipas këtij urdhëri pëlqimi, prindërit binin dakord që fëmija të kalonte kohë me të atin në Poloni nga 7 korriku 2009 deri më 15 gusht 2009. Gjithashtu, urdhëri theksoi faktin se rezidenca e përhershme e fëmijës ishte Irlanda. Megjithatë, në mes të procedurave, babai nuk e ktheu fëmijën tek kërkuesja në Irlandë në gusht 2009.

Në 15 shtator 2009, Gjykata e Rrethit Ennis i njohe kujdestari të plotë kërkueses dhe nxorri urdhërin e parë për kthimin e fëmijës. Kërkuesja më pas kërkoi pranë Ministrisë polake të Drejtësisë – të caktuar si Autoriteti Qendror nga Konventa e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës 1980 (Konventa e Hagës) – ndihmë për rikthimin e fëmijës.

Në 4 dhjetor 2009, Gjykata Rajonale e Gdansk vendosi të ekzekutojë urdhërin e parë irlandez të kthimit. Në procedurat e njëkohshme, Gjykata e Rrethit të Malbork në Poloni rrëzoi kërkesën e kërkueses për kthimin e fëmijës. Në 22 qershor 2010, Gjykata e Apelit e Gdansk anulloi vendimin e Gjykatës Rajonale, duke pretenduar se urdhëri irlandez i kthimit nuk pajtohej me vendimin e Gjykatës së Rrethit të Malbork.

Pas kësaj, kërkuesja vazhdoi ankimin e saj në Gjykatën e Lartë Polake, e cila anuloi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe çoi çështjen për rishqyrtim. Lidhur me rishqyrtimin, kërkuesja rifilloi procedurat në Irlandë. Në 9 shtator 2011, Gjykata e Lartë e Irlandës ndryshoi vendimin e tyre të vitit 2009 dhe dha kujdestari të përbashkët. Gjykata përsëri urdhëroi kthimin e fëmijës në Irlandë deri më 2 nëntor 2011.

Më pas kërkoi që urdhëri i ri irlandez të ekzekutohej në Poloni. Në një seancë në 9 maj 2012, babai u shpreh se refuzonte të binte dakord me urdhërat e mëparshëm të Gjykatës Irlandeze, duke pretenduar se fëmija ishte në një “gjendje të keqe psikologjike”. Pas kësaj, fëmija dhe babai u zhdukën nga Polonia dhe përpjekjet për të ekzekutuar urdhërin e dytë irlandez të kthimit nga Policia e Shtetit dështuan. Çështja më në fund u soll para Gjykatës së Rrethit të Malbork në 7 shtator 2012, e cila vendosi se procedurat për njohjen dhe ekzekutimin e urdhërit të dytë irlandez nuk duhet të vazhdonin, duke qenë urdhërit i kishte kaluar afati.

Kërkuesja siguroi kthimin e vajzës në mënyrë të njëanshme. Në 26 shtator 2012, kërkuesja e takoi vajzën jashtë shkollës dhe udhëtoi me të drejt Irlandës.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja u ankua se gjykatat polake kishin shkelur të drejtën e saj për respektimin e jetës familjare, sepse ato kishin dështuar të siguronin ribashkimin e saj me të bijën, siç ishte urdhëruar nga dy gjykatat irlandeze. Ajo u mbështet në nenin 6 dhe nenin 8 të Konventës.

### Neni 8

Gjykata vlerësoi se marrëdhënia midis kërkueses dhe të bijës përbënte “jetë familjare” sipas nenit 8 (1) të Konventës. Gjykata më tej u shpreh se, në lidhje me detyrimet pozitive të Shtetit, neni 8 përfshin të drejtën e një prindi për të kërkuar marrjen e masave në mënyrë që të ribashkohet me fëmijën e tij/saj dhe një detyrim të autoriteteve vendase për ndërmarrjen e masave të tilla. Në kontekstin e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, detyrimi pozitiv që neni 8 i Konventës sjell për Shtetin Palë, duhet të interpretohet nën dritën e Konventës së Hagës.

Rrjedhimisht, pika kryesore që duhet të vlerësohej nga Gjykata ishte fakti nëse autoritetet polake kishin marrë të gjitha masat që duhet të kishin marrë në mënyrë të arsyeshme, për të siguruar të drejtat familjare të kërkueses. Në lidhje me këtë, Gjykata theksoi se nuk kishte pasur zbatim të vendimit të 9 shtatorit 2011 në 7 muajt e parë dhe se efektivisht, iu desh autoriteteve polake mbi një vit për të vendosur se urdhëri

irlandez i ekzekutimit ishte i vlefshëm dhe i zbatueshëm. Për më tepër, kërkuesja nuk kishte pasur asnjë kontakt me të bijën gjatë asaj periudhe kohore.

Më tej, Gjykata u shpreh se në fushën e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, përshatshmëria e një mase duhet të vlerësohet nga shpejtësia e zbatimit të saj; këto masa kërkojnë një ekzekutim të shpejtë, duke qenë se kalimi i kohës dhe ndryshimi i rrethanave mund të çojnë në pasoja të pakthyeshme për marrëdhënien midis fëmijëve dhe prindërve që nuk bashkëjetojnë me ta.

Gjykata u shpreh se kërkuesja kishte bërë çdo gjë që në mënyrë të arsyeshme mund të pritej prej saj, duke shteruar të gjitha mjetet e brendshme të ankimit. Autoritetet polake kishin refuzuar zbatimin e urdhërave të Gjykatës Irlandeze dhe kishin vendosur për çështjen e kujdestarisë në kundërshtim me Gjykatën irlandeze.

Në përgjithësi, autoritetet polake nuk kishin vepruar në mënyrë të shpejtë për të siguruar zbatimin e vendimit irlandez, siç kërkohet sipas të drejtës së Bashkimit Evropian (p.sh. parashikimet e Rregulloreve të Këshillit lidhur me njohjen dhe zbatimin e gjykimeve në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe martesore). Argumenti i qeverisë polake se kohëzgjatja e procedurave kishte ardhur vetëm si pasojë e kompleksitetit të çështjes, nuk u pranua. Më tej, u vu re se gjykatat vendase kishin marrë vendime kontraktore. Si rezultat i kësaj, e drejta e kërkueses për respektim të jetës së saj familjare nuk mori mbrojtje efektive.

Rrjedhimisht, u gjet shkelje e nenit 8. Gjykata nuk e pa të nevojshme të shqyrtonte çështjen në lidhje me nenin 6.

#### Neni 41

Kërkueses iu akordua 15,000 euro për dëmin material dhe 10,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

*Segregimi i fëmijëve Rom në një shkollë fillore kroate përbënte diskriminim dhe shkelte nenin 14 marrë së bashku me nenin 2 të Protokollit nr. 1*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN ORSUS DHE TË TJERËT k. KROACISË**

(Kërkesa nr. 15766/03)

**16 mars 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin 15 shtetas kroat me origjinë Rome. Ata kishin lindur ndërmjet viteve 1988 dhe 1994 dhe jetonin të gjithë në Kroacinë e veriut. Në prill 2002 kërkuesit nisën një proces gjyqësor kundër shkollave të tyre fillore. Ata pretenduan se kurrikula e tyre mësimore kishte 30% më pak përmbajtje se kurrikulat zyrtare kombëtare. Ata pretenduan se kjo ishte një situatë e pastër e diskriminimit racor dhe cenonte të drejtën e tyre për arsim, si dhe të drejtën e tyre për tu mbrojtur nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Gjithashtu, kërkuesit paraqitën një studim psikologjik të fëmijëve romë që kishin ndjekur klasat që përbëheshin vetëm nga fëmijë Rom në rajonin e tyre. Ky raport u shpreh se fëmijët që kishin ndjekur këtë edukim të segreguar kishin pësuar dëm emocional dhe psikologjik, si në aspektin e vetëvlerësimit ashtu edhe zhvillimit të identitetit të tyre.

Në shtator të vitit 2002, Gjykata Komunale rrëzoi padinë e kërkuesve. Ajo vërejti se arsyeja pse pjesa më e madhe e nxënësve rom ishin vendosur në klasa të veçanta ishte për shkak se ata kishin nevojë për tutorim shtesë në gjuhën kroate. Për më tepër, kurrikula në shkollat fillore Podturen dhe Macinec ishte e njëjtë me atë të përdorur në klasat e tjera paralele të këtyre shkollave. Rrjedhimisht, kërkuesit nuk kishin arritur të vërtetonin pretendimet e tyre lidhur me diskriminimin racial. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Gjykata e Apelit. Ankimi kushtetues i kërkuesve paraqitur në nëntor 2003 u rrëzua mbi bazë të të njëjtave argumente në shkurt të vitit 2007.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit pretenduan se segregimi i tyre në klasa që përbëheshin vetëm nga nxënës rom i kishte cenuar atyre të drejtën e edukimit në mjedis multikulturor duke i kishte diskriminuar. Ky trajtim i kishte sjellë dëme të rënda edukuese, psikologjike dhe emocionale, veçanërisht në lidhje me faktin që ndiheshin të huaj dhe mungesën e vetëvlerësimit. Ata gjithashtu u ankuan për kohëzgjatjen e tepërt të proceseve gjyqësore vendase. Ata u mbështetën në veçanti në nenin 3, nenin 6 § 1, nenin 2 të Protokollit nr. 1 dhe nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në vendimin e 17 korrikut 2008, Dhoma e Gjykatës vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1 marrë më vete ose së bashku me nenin 14 të Konventës, në lidhje me vendosjen e kërkuesve në klasa të përbëra vetëm nga nxënës rom; si edhe gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore jashtë një afati të arsyeshëm veçanërisht përpara Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të nenit 43 të Konventës çështja iu referua për shqyrtim Dhomës së Madhe.

#### Neni 6§1

Gjykata vërejti se kohëzgjatja e procesit gjyqësor për më shumë se katër vjet përpara Gjykatës Kushtetuese për një çështje të kësaj rëndësie kishte qenë e tepërt. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti shkelje të së drejtës së kërkuesve për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur kështu nenin 6 §1 të Konventës.

#### Neni 14 marrë së bashku me nenin 2 të Protokollit Nr. 1

Gjykata vërejti se ky rast ngrinte kryesisht një çështje diskriminimi. Ajo risolli në vëmendje gjetjet e evidentuara në jurisprudencën e saj të mëparshme, ku është vërejtur që si rezultat i historisë së tyre, romët janë bërë një lloj i veçantë minoriteti i pa favorizuar dhe i pambrojtur. Për rrjedhojë, atyre u duhet siguruar një mbrojtje e veçantë, duke përfshirë edhe sferën e arsimit.

Gjykata mori në shqyrtim argumentin e paraqitur nga qeveria kroate, për vendosjen e kërkuesve në klasa që përbëheshin vetëm nga rom, për shkak të problemeve në zotërimin e gjuhës kroate dhe vërejti se ky veprim nuk vinte domosdoshmërisht në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Megjithatë, kur kjo masë ndikon vetëm mbi anëtarë të një grupi të caktuar autoritetet duhet të marrin masa mbrojtëse specifike.

Ligji kroat i kohës nuk ofronte klasa të veçanta për fëmijët që nuk kishin njohuri të mira të gjuhës kroate. Përveç kësaj, testet që përcaktonin nëse fëmijët do të regjistroheshin në klasa të përbëra vetëm nga rom nuk ishte hartuar në mënyrë specifike për të vlerësuar zotërimin e gjuhës kroate, por kishin një karakter për përcaktimin e gjendjes së përgjithshme psiko-fizike.

Për sa i përket kurrikulës, pasi u regjistruan në klasa të përbëra vetëm nga nxënës rom kërkuesve nuk iu ishte ofruar një program i hartuar posaçërisht për të adresuar mungesat e pretenduara gjuhësore. Ndërkohë, që kërkuesve iu ofruan klasa shtesë të gjuhës kroate, ato nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe kjo mundësi ekzistoi vetëm në disa faza të arsimit.

Të gjithë kërkuesit kishin kaluar një periudhë të konsiderueshme të arsimimit të tyre në klasa që bëheshin vetëm nga nxënës rom. Megjithatë, nuk kishte ekzistuar asnjë procedurë e veçantë monitorimi dhe ndonëse disa nga kërkuesit ndonjëherë kishin ndjekur klasa të përziera, qeveria nuk kishte arritur të tregonte se çdo raport individual ishte hartuar në lidhje me secilin kërkues dhe përparimin e bërë në lidhje me zotërimin e gjuhës kroate. Mungesa e një procedure monitoruese të përcaktuar dhe transparente kishte lënë shumë hapësirë për arbitraritet.

Për më tepër, statistika e paraqitura nga kërkuesit për rajonin në të cilin ata kishin jetuar, statistika këto që nuk u kundërshtuan nga qeveria, treguan një trend braktisjesh së shkollës nga nxënësit rom në masën 84%.

Për sa i përket pasivitetit të prindërve dhe mungesës së kundërshtimeve në lidhje me vendosjen e fëmijëve të tyre në klasa të veçanta, Gjykata u shpreh se prindërit, vetë anëtarë të një komuniteti të pa favorizuar dhe shpesh të dobët, nuk kishin qenë në gjendje të peshonin të gjitha aspektet të situatës dhe pasojat e dhënies së pëlqimit nga ana e tyre. Përveç kësaj, nuk mund të pranohet asnjë heqje dorë nga e drejta për të mos iu nënshtruar diskriminimit racor, pasi ajo do të ishte në kundërshtim me një interes të rëndësishëm publik.

Për rrjedhojë, duke njohur përpjekjet e autoriteteve kroate për të siguruar që fëmijët rom të përfitojnë shkollim, Gjykata u shpreh se në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet nuk ishin marrë masat e duhura për të siguruar kujdes të mjaftueshëm për nevojat e veçanta të kërkuesve si anëtarë të një grupi të pa favorizuar. Kështu, vendosja e tyre në klasa që përbëheshin vetëm nga nxënës nuk ishte e justifikuar dhe binte në kundërshtim me nenin 14 të marrë së bashku me nenin 2 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi secilit kërkues 4,500 euro në lidhje me dëmin jo material dhe të gjithëve së bashku 10,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Plagosja e rëndë e një studenti nga mësuesi të tij derivoi krijimin e detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën sipas nenit 2*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN OSMAN K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(kërkesa nr. 23452/94)

**28 tetor 1998**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi i parë, Mulkiye Osman, ishte nëna e kërkuesit të dytë, Ahmet Osman, i cili ishte një ish-nxënës i mësuesit Paul Paget-Lewis në shkollën House School.

Në vitin 1986 drejtori i shkollës, z. Prince, vuri re se një nga anëtarët e stafi i tij pedagogjik, Paul Paget-Lewis, kishte krijuar një lidhje të veçantë ndaj Ahmet Osmanit. Në janar të vitit 1987 znj. Green, nëna e Leslie Green, një nxënësi në të njëjtën shkollë, i bëri një ankesë z. Prince se Paget-Lewis kishte ndjekur djalin e saj deri në shtëpi pas shkollës dhe e kishte ngacmuar atë. Pasi u intervistua nga z. Perkins, Paul Paget-Lewis paraqiti edhe një deklaratë me shkrim, e cila u konsiderua “shqetësuese” nga z. Perkins pasi tregonte qartë se ishte “shumë xheloz” ndaj miqësisë midis Ahmet Osman dhe Leslie Green. Z. Perkins e sugjeroi z. Paget-Lewis që të kërkonte ndihmë psikiatrike.

Ndërkohë, stafi drejtues i shkollës zhvilloi disa intervista të tjera me individët përkatës. Sipas ditarit të z. Prince, midis 3 marsit 1987 dhe 17 marsit 1987, ai u takua me policinë katër herë për të diskutuar çështjen.

Ndërsa po përpiqej të organizonte një transferim të Ahmet Osmanit në një shkollë tjetër, u zbulua se dosjet në lidhje me Ahmet dhe Leslie Green ishin vjedhur nga zyra e shkollës. Paget-Lewis mohoi çdo përfshirje në vjedhje.

Më 14 prill 1987, Paget-Lewis e ndryshoi emrin në Paul Ahmet Yildirim Osman. Z. Prince informoi policinë dhe shkroi për këtë tek Autoriteti i Arsimit të Brendshëm të Londrës (ILEA), ai gjithashtu i informoi ata se ishte i shqetësuar se çrregullimet psikologjike të Paget-Lewis mund të paraqisnin kërcënim për sigurinë e Ahmet Osmanit. Paget-Lewis u vizitua nga doktor Ferguson, një psikiatër më 19 maj 1987. Dr. Ferguson rekomandoi që Paget-Lewis të vazhdonte të jepte mësim në shkollë, por të merrte konsulencë dhe psikoterapi.

Në ditët në vijim, një tullë u hodh në drejtim të dritares së shtëpisë së kërkuesve. Në vendngjarje erdhi policia dhe u hartua një procesverbal. Në qershor 1987, gomat



e makinës së z. Ali Osman (burri i parë i kërkueses dhe babai i kërkuesit të dytë) u shpërthyen dy herë me dashje. Të dy incidentet u raportuan në polici.

Pas një ekzaminimi tjetër të Paget-Lewis, doktor Ferguson arriti në përfundimin se ai duhet të largohet nga shkolla dhe e diagnostikoi si përkohësisht të papërshtatshëm për të punuar. Paget-Lewis u pezullua përkohësisht nga mësimi, megjithatë ky pezullim u hoq dhe ai filloi të punonte si mësues zëvendësues në dy shkolla të tjera lokale.

Në gusht ose shtator 1987, ndaj pronave të familjes Osman u bën një sërë sulmesh, duke përfshirë derdhjen e vajit të motorit dhe parafinës në shtëpi, thyerjen e xhamit të makinës së Z. Osman, bllokimin e derës me ngjitës dhe lyerjen e derës së jashtme të shtëpisë me jashtëqitje qeni.

Policia vizitoi shtëpinë e Osmanëve dhe pastaj foli me Paget-Lewis në lidhje me aktet e vandalizmit. Në një deklaratë të mëvonshme për policinë, Paget-Lewis pretendoi se u tha policëve se humbja e punës së tij ishte aq shqetësuese sa që mendonte se ai ishte në rrezik të bënte diçka kriminale dhe të çmendur, megjithatë qeveria mohoi se kjo ishte thënë.

Më 7 dhjetor 1987 një makinë e drejtuar nga Paget-Lewis u përplas me një furgon në të cilin Leslie Green ishte pasagjer.

Më 15 dhjetor 1987 Paget-Lewis kërkoi të merrej në pyetje nga oficerët e policisë. Një procesverbal i policisë i datuar në të njëjtën ditë, konstatonte se Paget-Lewis ndihej në një gjendje vetë shkatërruese dhe se fajësonte z. Perkins për të gjitha problemet e tij.

Më 17 dhjetor 1987, oficerët e policisë arritën në shtëpinë e Paget-Lewis për ta arrestuar por ai nuk gjendej në shtëpi. Në fillim të janarit 1988, policia inicioi procedim penal ndaj Paget-Lewis për shkak të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Përveç kësaj, emri i Paget-Lewis u regjistrua në sistemin kompjuterik kombëtar të policisë si i kërkuar në lidhje me incidentin me makinë dhe si i dyshuar për kryerjen e veprave penale.

Më 7 mars 1988 Paget-Lewis u pa nga një grup njerëzish pranë shtëpisë së kërkuesve. Rreth orës 11:00 Paget-Lewis qëlloi dhe vrau z. Osman dhe plagosi rëndë Ahmet Osmanin. Më pas ai u fut në shtëpinë e Z. Perkins dhe plagosi atë dhe vrau të birin. Herët në mëngjes Paget-Lewis u arrestua.

Më 28 tetor 1988, Paget-Lewis u dënua për dy akuza për vrasje, duke u deklaruar fajtor dhe u shpall me përgjegjësi të reduktuar. Gjykata vendosi se ai duhet të vendosej për një periudhë të pacaktuar pranë një spitali mendor të sigurt.

Më 28 shtator 1989, kërkuesit filluan procedime kundër, inter alias, Komisionerit të Policisë duke pretenduar neglizhencë ndonëse policia ishte në dijeni të veprimtarive të Paget-Lewis që prej majit 1987. Sipas kërkuesve ata nuk arritën ta kapnin, merrnin në pyetje ose t'i drejtonin një akuzë përpara marsit 1988.

Më 19 gusht 1991, Komisioneri i Policisë lëshoi një kërkesë kundër padisë së kërkuesve për shkak se ajo ishte e pabazuar. Gjykata e Apelit më pas konstatoi se, sipas rregullave përjashtuese të vendimit të Dhomës së Lordëve të vitit 1989 në çështjen *Hill v Chief Constable of West Yorkshire* nuk mund të drejtohej akuzë për neglizhencë ndaj policisë për arsye se policia publike gëzonte imunitet ndaj padive.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Bazuar në nenet 2, 6, 8 dhe 13, kërkuesit u ankuan se shteti kishte dështuar të mbronte jetën e Aliut dhe Ahmet Osmanit si dhe të parandalonte incidentet që i ishin shkaktuar familjes së tyre dhe se ata nuk kishin mundësi për të aksesuar gjykatën dhe as një mjet ligjor efektiv për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

### Neni 2

Kërkuesi pohoi se duke mos ndërmarrë hapa adekuate dhe të përshtatshme për të mbrojtur jetën e kërkuesit të dytë dhe të atit të tij, Ali Osman, nga rreziku i vërtetë dhe i njohur i shkaktuar nga Paget-Lewis, autoritetet nuk kishin arritur të përmbushnin detyrimin e tyre pozitiv sipas nenit 2.

Gjykata fillimisht deklaroi se, kur ka një pretendim se autoritetet shtetërore kanë shkelur detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën për jetë, ndonëse kanë pasur detyrim ta mbrojnë atë, duhet të vërtetohet që autoritetet kanë qenë në dijeni ose duhet të kishin qenë në dijeni gjatë kohës së zhvillimit të ngjarjeve të ekzistencës së një rreziku të vërtetë dhe të menjëhershëm të jetës së një individi nga veprat penale të një pale të tretë dhe se autoritetet nuk arritën të marrin masa brenda kompetencave të tyre, që sipas një gjykimi të arsyeshëm, mund të shmangnin rrezikun.

Megjithëse policia ishte informuar për të gjitha çështjet relevante, përfshirë një incident grafitesh, vjedhjen e dosjeve të shkollës dhe ndryshimin e emrit të Paget-Lewis, Gjykata nuk ishte e bindur se dështimi i policisë për ta investiguar më tej këtë çështje

mund të konsiderohet shkelje në pikëpamje të nenit 2 duke pasur parasysh nivelin e informacionit që ata dispononin në atë kohë. Sipas Gjykatës, ndonëse lidhja e Paget-Lewis me Ahmet Osmanin mund të gjykohej nga oficerët e policisë që vizituan shkollën si një sjellje jo profesionale nga ana e Paget-Lewis, kurrsesi nuk kishte asnjë sugjerim se Ahmet Osman ishte në rrezik seksualisht aq më pak se jeta e tij të ishte në rrezik prej mësuesit.

Duke qenë se Paget-Lewis kishte mohuar të gjithë përfshirjen gjatë intervistës me z. Perkins dhe nuk kishte asgjë për ta lidhur atë me incidentet, Gjykata konsideroi se vlerësimi i policisë për situatën dhe vendimi i tyre për ta trajtuar atë si çështje brenda shkollës nuk mund të konsiderohen të paarsyeshme.

Në lidhje me aktet e vandalizmit kundër shtëpisë dhe pronës së familjes Osman dhe pohimin se policia nuk mbajti shënime për incidentet e raportuara, Gjykata deklaroi se kjo mungesë nuk mund të konsiderohet si pengesë për të kuptuar rrezikun serioz që po i kanosej familjes Osman dhe se sjelljet e Paget-Lewis fshinin një prirje vrasëse. Gjykata gjithashtu theksoi se vendimi për të arrestuar Paget-Lewis nuk ishte bazuar në ndonjë rrezik të perceptuar ndaj jetës së familjes Osman, por në dyshimin se ai ishte përfshirë në kryerjen e disa veprave penale të lehta.

Në lidhje me faktin se Paget-Lewis në tri raste i kishte komunikuar policisë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, qëllimet e tij vrasëse, Gjykata konsideroi se këto deklarata nuk mund të konsideroheshin si të arsyeshme dhe mjaftueshme për të nënkuptuar se familja Osman ishte objekt i kërcënimeve të tij.

Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi se kërkuesit nuk arritën të provojnë se policia ishte ose duhet të ishte në dijeni se jeta e familjes Osman ishte në rrezik real dhe të menjëhershëm nga Paget-Lewis. Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje të nenit 2.

## Neni 8

Gjykata ritheksoi se nuk e kishte konstatuar se policia e dinte ose duhet të kishte ditur gjatë kohës së zhvillimit të ngjarjeve që Paget-Lewis përfaqësonte një rrezik të vërtetë dhe të menjëhershëm për jetën e Ahmet Osmanit dhe se veprimet e tyre ndaj ngjarjeve ishin të papajtueshme me detyrën e autoriteteve sipas nenit 2. Ky përfundim konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të ndonjë detyrimi pozitiv të parashikuar nga Neni 8.

Sa i përket pretendimit të ankuesve se policia dështoi të hetojë sulmet e përsëritura në shtëpinë e tyre, Gjykata theksoi se policia kishte konstatuar se nuk kishte prova për të implikuar Pagetin-Lewis. Gjithashtu, Gjykata shtoi se nën dritën e zhvillimeve të reja në këtë rast, ishte bërë një përpjekje për të arrestuar dhe marrë në pyetje Paget-Lewis për dyshimin për dëmtime kriminale. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur asnjë shkelje nga autoritetet për ndonjë detyrim pozitiv sipas nenit 8.

#### Neni 6 § 1

Kërkuesit pretenduan se shkarkimi i policisë nga akuza për neglizhencë për shkak se policia nuk mund të paditej nga Gjykata e Apelit, përbënte një kufizim të së drejtës së tyre për akses në një gjykatë në kundërshtim me nenin 6 § 1.

Për sa i përket argumentit të Qeverisë për zbatueshmërinë e nenit 6 se kërkuesi nuk kishte të drejtë në ligjin vendas të padisë policinë për neglizhencë, Gjykata nuk pajtohej dhe konsideroi se kërkuesit kishin të drejtë të kërkojnë një gjykim mbi pranueshmërinë e kërkesës së tyre.

Gjykata pastaj vuri në dukje se arsyet që çuan në Shtëpinë e Lordëve në çështjen *Hill* për të vendosur një rregull për të përjashtuar policinë publike nga paditë u bazua në pikëpamjen se interesat e komunitetit në tërësi plotësoheshin më mirë nga një policë efikas dhe efektiv në betejën kundër krimit, dhe që nuk ishte i ekspozuar nga rreziku i vazhdueshëm ndaj përgjegjësisë për veprimet operacionale.

Megjithëse qëllimi i një rregulli të tillë mund të pranohet si legjitim në terma të Konventës, duke pasur si qëllim ruajtjen e efektivitetit të shërbimit policor dhe rrjedhimisht parandalimin e trazirave apo krimit, Gjykata theksoi çështjen e proporcionalitetit.

Zbatimi i rregullave pa kryerjen e hetimeve të mëtejshme mbi ekzistencën e interesit publik, që vetëm i jep një imunitet "*blanket*" policëve në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë hetimit dhe zbardhje së krimit, përbën një kufizim të pajustificueshëm të së drejtës së kërkuesit për të pasur një vendim mbi themelin e padisë së tij/saj kundër policisë.

Gjykata arriti në përfundimin se zbatimi i rregullit përjashtues në çështjen objekt gjykimi derivoi një kufizim jo proporcional në lidhje me të drejtën e kërkuesit për të aksesuar gjykatën dhe shkeli kështu nenin 6 § 1.

### Neni 13

Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të kryente një shqyrtim më vete të nenit 13, pasi kishte evidentuar shkelje të nenit 6 § 1.

### Neni 51<sup>159</sup>

Gjykata i akordoi secilit kërkues 10,000<sup>160</sup> GBP shpërblim për dëmet dhe 30,000 GBP për shpenzimet gjyqësore.

---

<sup>159</sup> Aktualisht neni 41.

<sup>160</sup> Vlera e përafërt £1 = €1.60.

*Ndalimi administrativ i të miturve së bashku me familjen e tyre në një qendër ndalimi të papajisur për nevojat e fëmijëve në veçanti përbënte shkelje të neneve, 3, 5 dhe 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN POPOV K. FRANCËS**

(Kërkesat nr. 39472/07 dhe 39474/07)

**19 janar 2012**

### **2. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin znj. Yakaterina Popov dhe z. Vladimir Popov së bashku me dy fëmijët e tyre, të lindur respektivisht në 2004 dhe 2007.

Në lidhje me dy kërkuesit e parë, ndërkohë që jetonin në Kazakistan ata u sulmuan dhe u ngacmuan nga lokale për origjinën e tyre ruse dhe besimin ortodoks rus. Në një sërë rastesh, znj. Popov u mor nga policia dhe u godit dhe për këtë ajo vendosi të largohet nga vendi në dhjetor të 2002 dhe të hynte në Francë me një vizë dy javore. Bashkëshorti i saj shkoi në Francë në qershor të 2003.

Të dy kërkuesit aplikuan për azil në Francë, por kërkesa e tyre u refuzua dhe më vonë ata humbën të drejtën për të ankmuar për refuzimin e kërkesës për azil. Ata kërkuan kryerjen e një shqyrtimi të ri të rastit të tyre dhe aplikuan për njohjen e mungesës së pashtetësisë, kërkesa të cilat gjithashtu ju hodhën poshtë. Në qershor 2005, prefektura e Ardennes i informoi kërkuesit lidhur me refuzimin e rastit të tyre duke ju dhënë një leje qëndrimi dhe udhëzimin se ata duhet ta linin vendin brenda një muaji.

Më 27 gusht 2007 prindërit dhe fëmijët e tyre, të cilët ishin nën moshën 3 vjeç dhe 6 muaju kapën dhe u arrestuan nga policia. Një ditë më vonë prefektura e Maine-et-Loire urdhëroi ndalimin e tyre administrativ në një hotel në Angers. Më 28 gusht familja u transferua në aeroportin Charles-de-Gaulle më qëllim për t'i nisur për në Kazakistan. Megjithatë, fluturimi i tyre u anulua dhe për këtë ata transferuan në qendrën e ndalimit administrativ të Rouen-Oissel.

Qendra e ndalimit të Rouen-Oissel nuk kishte kushte për qëndrimin e fëmijëve. Nuk kishte orar për ajrim ose vend për të mësuar, si dhe nuk kishte as shtretër në dispozicion për fëmijë. Fëmija më i rritur shfaqte shenja ankthi në kohën që ata ishin të ndaluar në qendër dhe refuzonte që të hante. Ndalimi administrativ i kërkuesve u zgjat edhe për pesëmbëdhjetë ditë.

Më 11 shtator 2011 kërkuesit u transferuan sërish në aeroportin e Charles-de-Gaulle, por largimi i tyre dështoi sërish për të dytën herë. Më 12 shtator 2011 një gjyqtar

konstatoi se kërkuesit nuk mund të fajësosheshin për dështimin e përpjekjeve të bëra për largimin e tyre duke lirim të tyre.

Përpara arrestimit dhe ndalimit, kërkuesit nuk mundën të bënin një kërkesë të re për azil dhe më 16 korrik 2009, Gjykata Kombëtare e Azilit ju dha atyre statusin e refugjantit, bazuar në hetimet që ju ishin bërë autoriteteve të Kazakistanit lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të kërkesave për azil, kthimi i tyre në vendin e tyre të origjinës i vendoste ata përpara rrezikut.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se kushtet dhe kohëzgjatja e ndalimit të tyre në qendrën e Rouen-Oisseldetention shkelte nenet 3 dhe 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si për prindërit ashtudhe për fëmijët. Më tej kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 8 në lidhje me ndërhyrjen në jetën e tyre familjare si pasojë e paraburgimit të tyre.

### Neni 3

Fillimisht, Gjykata e shqyrtoi kërkesën lidhur me kushtet e ndalimit të fëmijëve. Fakti që fëmijët u vendosën së bashku me prindërit e tyre nuk e përjashtondetyrimin e shtetit për të mbrojtur interesat e fëmijëve sipas parashikimeve të nenit 3, duke përsëritur rëndësinë e prevalimit që duhet të kenë fëmijët të cilët janë mjaft vulnerabël krahasuar me vlerësimin lidhur me statusin e tyre si emigrantë të paligjshëm.

Përsa i takon kushteve të ndalimit, Gjykata vuri në dukje se megjithëse sipas ligjit francez qendra ishte e autorizuar për të marrë familje, kjo thjesht kërkoi që qendra të kishte dhoma gjumi të përshtatshme posaçërisht për fëmijë, pa përmendur shprehimisht pajisjet e nevojshme për strehimin e fëmijëve bashkë me prindërit e tyre. Gjykata përmendi gjetjet e raporteve të ndryshme përfshirë ato të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Komisionerin për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave qendra e ndalimit nuk ishte e pajisur me pajisje të tilla. Për shembull nuk kishte shtretër për fëmijë apo zona të përshtatshme për të luajtur, dhe dyert automatike të dhomave përbënin rrezik për ta. Gjithashtu, në këtë drejtim u theksua se si imoraliteti, stresi, pasiguria dhe atmosfera armiqësore në këto qendra kishte ndikim negativ tek fëmijët e vegjël, në kundërshtim me parimet ndërkombëtare sipas të cilave duhet të shmanget ndalimi i fëmijëve për periudha të gjata. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kushtet në të cilat ishin mbajtur fëmijët nuk ishin të përshtatshme për moshën e tyre.

Duke ju kthyer kohëzgjatjes së ndalimit, Gjykata vuri në dukje se megjithëse periudha prej pesëmbëdhjetë ditësh nuk ishte e tepruar në vetvete, ajo mund të perceptohej si e pafundme nga ana e fëmijëve, duke marrë parasysh kushtet në të cilat ata ishin mbajtur dhe moshën e tyre të re. Për këtë qëllim, Gjykata vlerësoi një ndalim i tillë kishte shkaktuar ankth dhe stres psikologjik tek fëmijët dhe arriti në përfundimin se shteti nuk kishte marrë në konsideratë pasojat e pashmangshme të ndalimit ndaj kërkuesve të tretë dhe të katërt. Duke pasur parasysh moshën e re të fëmijëve, kohëzgjatjen e ndalimit të tyre dhe kushtet e izolimit, kishte konkluduar se në rastin e fëmijëve kishte pasur shkelje të nenit 3.

Në lidhje me ndalimin e prindërve, Gjykata pranoi shqetësimin dhe frustrimin që mund t'ju ishte shkaktuar atyre për shkak të paraburgimit, por fakti që ata nuk ishin ndarë nga fëmijët e tyre lehtësonte gjendjen e tyre emocionale. Për këtë arsye, sipas parashikimeve të nenit 3, pragu minimal i ashpërsisë dhe për rrjedhojë nuk u gjet asnjë shkelje në këtë drejtim.

#### Neni 5 (1) (f)

Për rastin në fjalë, Gjykata përsëriti se si neni 5 (1) (f) parashikon një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i përcaktuar në nenin 5 (1), duke u lejuar Shteteve të kontrollojnë lirinë e personave të huaj në kontekstin e emigracionit.

Përsa i takon rastit të fëmijëve, Gjykata konstatoi se pavarësisht faktit se ata ishin bashkë me prindërit e tyre dhe se qendra e paraburgimit kishte një ambient të dedikuar për familjet, duke marrë parasysh kushtet e ndalimit të përmendura më sipër, autoritetet nuk kishin mbrojtur të drejtën e lirisë së fëmijëve.

Situata e veçantë e fëmijëve nuk u vlerësua siç duhet nga autoritetet, të cilat nuk verifikuan nëse vendosja në qendrën e ndalimit ishte mjeti i fundit i përdorur pasi nuk kishte një alternativë tjetër. Për këtë arsye u konstatua shkelje e së drejtës së fëmijëve sipas nenit 5 (1) (f), megjithatë nuk u gjet asnjë shkelje lidhur me prindërit.

#### Neni 5 (4)

Gjykata vuri në dukje se prindërit kishin mundësi të bënin ankim në gjykatë lidhur me ligjshmërinë e burgimit, por një mjet i tillë nuk ishte i aksesueshëm nga ana e fëmijëve. Meqenëse, legjislacioni francez nuk parashikon mundësinë e vendosjes së të miturve në burgim administrativ, asnjë urdhër nuk u lëshua për largim e fëmijëve dhe as nuk kishte vendim për t'i ndaluar ata, kështu që asnjë prej këtyre masave nuk ishte e mundur para gjykatave. Fëmijët e gjetën veten përpara një vakumi ligjor, pa



pasur akses të mjeteve ligjore për tu ankuar për ligjshmërinë e burgimit të tyre në kundërshtim me nenin 5 (4) të Konventës.

### Neni 8

Gjykata vuri në dukje se ndërkohë që gëzimi reciprok i qëndrimit bashkë mes prindërit dhe fëmijës përfaqëson një aspekt themelor të jetës familjare, kjo nuk do të thotë që respekti për jetën familjare është e garantuar thjesht duke e mbajtur familjen së bashku, veçanërisht kur familja është nën burgim. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se periudha e paraburgimit prej pesëmbëdhjetë ditësh mund të konsiderohej si një ndërhyrje në jetën familjare të kërkuarve.

Një ndërhyrje do të përbënte shkelje, nëse nuk është në përputhje me ligjin, ndjek një qëllim legjitim dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata vuri në dukje, se baza ligjore për burgim parashikohej në legjislationin francez dhe se qëllimi legjitim në rastin në fjalë do të ishte parandalimi i emigracionit të paligjshëm dhe kontrolli i hyrjes dhe qëndrimit të huajve. Për rrjedhojë, gjykata vijoi më tej për të vlerësuar proporcionalitetin e ndalimit të familjes. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë i është dhënë parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Gjykata theksoi se kërkuarët nuk paraqisnin rrezik për tu arratisur, dhe duke pasur parasysh efektivitetin e qëndrimit të mëparshëm të detyrueshëm në një hotel, izolimi i tyre në një qendër ndalimi nuk justifikonte një nevojë sociale të ngutshme. Për më tepër, nga faktet e rastit për Gjykatën ishte e qartë se nuk ishin vlerësuar alternativa të tjera për ndalimin e tyre dhe as mundësia që autoritetet të kishin rishqyrtuar rastet e burgimit në një vend të ndryshëm nga qendra e burgimit dhe së fundmi nuk ishin ndërmarrë hapa për të hequr sa më shpejt të ishte e mundur largimin e tyre. Gjykata vuri në dukje se kishte hedhur poshtë një kërkesë<sup>161</sup> për një çështje të ngjashme, por në rastin në fjalë ajo i dha peshë të veçantë zhvillimeve të fundit në lidhje me interesin më të lartë të fëmijëve në kontekstin e burgimit duke vendosur se ky parim nuk mund të interpretohet duke u kufizuar vetëm në mbajtjen e familjes së bashku, por duhet të udhëzojë punën e autoriteteve ndaj burgimit, duke kërkuar që ata të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të kufizuar, sa të jetë e mundur, ndalimin e familjeve të shoqëruara me fëmijë dhe në mënyrë efektive të mbrojtë të drejtën për jetë familjare.

---

<sup>161</sup> *Muskhadzhuyevadhe Të Tjerët k. Belgjikës*, vendimi 19 janarit 2010, nr. 41442/07 (gjithashtu e përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

Për rrjedhojë, u konstatua shkelje e nenit 8, pasi në mungesë të ndonjë faktori që tregonte rrezikun e arratisjes, ndalimi i familjes në një qendër sigurie për pesëmbëdhjetë ditë nuk ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Franca duhej t'i paguante kërkuarve 10,000 euro për dëmin jomaterial dhe 3,000 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Kujdesi i pamjaftueshëm dhe ndalim i paligjshëm i një azilkërkuessi të mitur të pashoqëruar përbënte shkelje të nenëve 3, 5 dhe 13*

## **RAHIMI k. GREQISË**

(Kërkesa nr. 8687/08)

**5 korrik 2011**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuessi, Eivas Rahimi, i lindur në vitin 1992, ishte 15 vjeç kur mbërriti në Greqi si një i mitur i pashoqëruar. Ai ishte larguar nga Afganistani në vitin 2007, pas vdekjes së prindërve të tij, për shkak të konfliktit të armatosur. Sipas kërkuessit, jeta e tij ishte në rrezik, pasi ishte i pambrojtur për shkak të moshës së tij të re, ishte jetim dhe shteti afgan nuk mund të ofronte asnjë mbrojtje.

Pas mbërriti në ishullin e Lesbos, ai u arrestua dhe u dërgua në një kamp për refugjatët. Atje qëndroi nga 19-21 korriku 2007, në pritje të një urdhri për dëbimin e tij. Ndërkohë që mbahej i ndaluar, ai nuk u informua mbi mundësinë për të kërkuar azil apo për të drejtat e tij të tjera ligjore në një gjuhë që ai mund ta kuptonte. Ai mbahej së bashku me persona të tjerë madhorë dhe në kushte jo higjienike.

Më 20 korrik u lëshua një urdhër dëbimi për kërkuessin, ku përmendej fakti se do të shoqërohej nga kushëriri i tij, N.M. Kërkuessit nuk iu ofrua asnjë ndihmë nga autoritetet për lirim e tij. Atij nuk iu caktua kujdestar ligjor dhe jetonte në rrugët e Athinës, derisa mori ndihmë nga një OJQ lokale.

Në shtator 2007 autoritetet refuzuan kërkesën e tij për azil politik ndërkohë që kërkesa e tij në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut ishte ende në pritje për t'u shqyrtuar.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u bazuar në nenet 3 dhe 13, kërkuessi u ankua për mungesën e mbështetjes së duhur për statusin e tij si i mitur i pashoqëruar. Gjithashtu, ai u ankua në lidhje me kushtet në qendrën e ndalimit. Më tej, në bazë të nenit 5(1), (2) dhe (4), ai pretendoi se gjendja e tij si rezident i paligjshëm i mitur ishte shpërfillur vazhdimisht dhe ai nuk ishte informuar për arsyet e arrestimit apo të mjeteve ankimore që kishte në dispozicion.

### Nenet 3 dhe 13

#### *Nëse kërkuesi ishte i shoqëruar*

Pyetja nëse Eivas ishte i shoqëruar, për të cilët palët nuk pajtoheshin, ishte vendimtare për sa i përket detyrimeve që Shteti kishte ndaj tij. Duke i bazuar konstatimet në regjistrimin e kërkesës për azil politik dhe raportit të shkruar nga një OJQ lokale (Arsis), Gjykata vlerësoi se që prej 27 korrikut 2007 kërkuesi nuk kishte qenë i shoqëruar nga një i afërm i ngushtë.

Në periudhën nga 19 deri 27 korrik 2007, autoritetet, në bazë të një procedure të paqartë, i kishin caktuar kërkuetit një person të rritur për ta shoqëruar, me inicialet N.M. Gjykata vuri në dukje impaktin e rëndësishëm që kishte, në rrethanat personale të kërkuetit, vendimi i autoriteteve për t'i caktuar një person të rritur si kujdestarin e tij dhe që do e përfaqësonte para autoriteteve. Dokumentet zyrtare nuk përmbanin informacione që të tregonin për një lidhje familjare ndërmjet kërkuetit dhe N.M. Për këto arsye, Gjykata konstatoi në mënyrë të qartë se kërkuesi ishte një i mitur i pashoqëruar.

#### *Shterimi i mjeteve të brendshme ligjore*

Në broshurën informuese që autoritetet i kishin dhënë, ku përshkruheshin disa nga mjetet ligjore në dispozicion, përmendej mundësia për të bërë një ankesë tek shefi i policisë, por nuk jepeshin detaje rreth kësaj procedure. Gjykata vuri në dukje se i mituri nuk kishte pasur një përfaqësues ligjor gjatë ndalimit të tij. Përveç kësaj, broshura informuese ishte e shkruar në arabisht, ndërkohë që gjuha amtare e kërkuetit ishte Farsi. Për këtë arsye, Gjykata nuk mund ta konsideronte broshurën informuese në lidhje me mjetet ligjore në dispozicion të kuptueshme.

Më tej, Gjykata vlerësoi nëse shefi i policisë ishte një autoritet i cili plotësonte kërkesat e paanshmërisë dhe objektivitetit, të nevojshme për ta bërë një mjet ligjor efektiv. Sa i përket legjislacionit në fuqi, ai nuk i njihte gjykatave të drejtën për të shqyrtuar kushtet e jetesës në qendrat e ndalimit për të huajt ilegalë dhe të urdhëronte lirimin e tyre mbi këtë bazë. Prandaj, Gjykata hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mos-shterimin e mjeteve të brendshme ligjore.

#### *Kushtet e ndalimit në Qendrën Pagani*

Gjykata vuri në dukje se në raportet e disa organizatave të mirë-respektuara ndërkombëtare tregoheshin kushtet e tmerrshme në Qendrën Pagani, e cila përbëhej nga

pesë magazina të mëdha, ku mbaheshin shtatëqind e njëzet emigrantë ndërkohë që kishte një kapacitet strehimi për treqind njerëz. Qendra nuk kishte ambiente të mjaftueshme për të miturit. Në lidhje me kushtet e jetesës të qendrës, raportoheshin kushte të tmerrshme. Mbi njëqind persona kishin dy tualete të përbashkëta dhe të ndaluarit ndanin dyshekët ose flinin në dysheme. Gjykata vërejti në veçanti tualetet e përmbytura, ventilimin e dobët dhe një mjedis të përgjithshëm jo të shëndetshëm.

Gjykata konstatoi se kushtet e ndalimit në Qendrën Pagani, përbënin trajtim poshtërues. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

Për më tepër, duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme në lidhje me çështjen e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore, Gjykata arriti në përfundimin se shteti kishte dështuar gjithashtu të përmbushte edhe detyrimet e tij sipas nenit 13 të Konventës.

#### *Periodha pas lirit të kërkuesit*

Gjykata vërejti se sjellja e autoriteteve, të cilët ishin treguar indiferentë për mirëqenien e kërkuesit, i kishte shkaktuar atij një ankth dhe shqetësim të thellë, deri në momentin që i kishte ardhur në ndihmë OJQ-ja lokale. Duke qenë se kërkuesi bënte pjesë në kategorinë më vulnerabël të shoqërisë, si i mitur, autoritetet duhet të merrenin masat e duhura për ta mbrojtur dhe për t'u kujdesur, veçanërisht duke i caktuar një kujdestar. Gjykata iu referua vendimit *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>62</sup>, në të cilën kishte vënë në pah "gjendjen e veçantë të pasigurisë dhe cenueshmërisë të azilkërkuesve që jetonin në Greqi" dhe i gjeti autoritetet përgjegjëse "për shkak të mosveprimit të tyre". Pragu i ashpërsisë që kërkohet të arrihet sipas nenit 3, këtë rast ishte arritur dhe Gjykata u shpreh se Shteti nuk i kishte vepruar në pajtim me detyrimet e tij sipas nenit 3.

Duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme ligjore, Gjykata u shpreh se Shteti kishte dështuar gjithashtu të plotësonte edhe detyrimet e tij sipas nenit 13.

#### Neni 5 (1)

Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për liri dhe siguri sipas nenit 5, pasi ndalimi i kërkuesit ishte rezultat i zbatimit në mënyrë automatike të legjislacionit kombëtar,

---

<sup>162</sup> *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, [Dhoma e Madhe] vendim i 21 janarit 2011, nr. 20696/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

pa marrë parasysh rrethanat e veçanta të kërkuarit si një i mitur i pashoqëruar. Autoritetet nuk kanë marrë parasysh interesin më të mirë të kërkuarit, si i mitur, dhe as kanë shqyrtuar mundësinë e zëvendësimit të masës së ndalimit me një masë më pak drastike.

Gjykata dyshonte nëse autoritetet kishin vepruar në mirëbesim në vendosjen e masës së ndalimit, prandaj ndalimi i kërkuarit nuk ka qenë “i ligjshëm” sipas kuptimit të nenit 5 (1) (f).

Kërkuari e kishte pasur të pamundur në praktikë për të kontaktuar një avokat. Duke qenë se broshura informuese ishte në një gjuhë të pakuptueshme për të dhe nuk kishte asnjë kujdestar që mund ta përfaqësonte ligjërisht, Gjykata vëren se kërkuari nuk kishte pasur mundësi të shfrytëzonte mjetet ligjore në dispozicion.

Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 5 (4).

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuarit 15,000 euro në lidhje me dëmin jo material që ai kishte pësuar dhe 1,000 euro për kostot dhe shpenzimet.

*Dështimi i autoriteteve për të hetuar me shpejtësi dhe efektivitet vdekjen ose zhdukje e një grup Romësh, varka e të cilëve u mbyt në bregdetin malazes përbënte shkëlqje të nenit 2 të Konventës*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RANDELOVIC DHE TË TJERËT k. MALIT TË ZI**

(Kërkesa nr. 66641/10)

**19 shtator 2017**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin shtetas serb dhe një prej tyre ishte shtetas i Maqedonisë së Veriut.

Të afërmit e tyre ishin në mes një grupi prej rreth 70 romësh që hipën në barkën “Miss Pat” në bregdetin malazet më 15 gusht 1999, me synimin për të shkuar në Itali. Për shkak të mbipopullimit barka u mbyt vetëm disa orë pasi u largua nga bregu dhe prej kësaj ngjarjeje mbijetoi vetëm një person. Më 30 gusht 1999, i mbijetuari i vetëm u gjet i gjallë në bregun malazet. Ndërkohë, 35 trupa u gjetën në det, 13 prej të cilëve u identifikuan nga të afërmit e tyre. Specialistët e mjekësisë ligjore nuk ishin në gjendje të përcaktonin me siguri shkaqet e vdekjes, megjithatë, deklaruan se ekzistonte mundësia që udhëtarët të kishin humbur jetën për shkak të mbytjes.

Më 1 shtator 1999, Gjykata e Shkallës së Parë në Bar nisi një hetim zyrtar ndaj shtatë individëve, me dyshimin se kishin kryer veprën penale “kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror në kushte të rrezikshmërisë së lartë”. Në tre vitet e ardhshme, deri në fund të 2002, u vendos që dy të pandehurit do të gjykoreshin në mungesë dhe do të përfaqësoheshin nga avokatë të caktuar kryesisht. Ndërmjet 25 dhjetorit 2002 dhe 14 prillit 2004 u zhvilluan 11 seanca gjyqësore dhe 8 të tjera u shtynë për arsye procedurale. Çështja u transferua në Gjykatën e Lartë në prill 2004. Në vitin 2008 kjo gjykatë hodhi poshtë padinë në lidhje me një nga të pandehurit dhe vendosi që dy të pandehurit e tjerë që jetonin jashtë Malit të Zi do të gjykoreshin në mungesë. Ndërmjet 28 shtatorit 2009 dhe 9 korrikut 2014 u zhvilluan edhe 15 seanca gjyqësore, dëgjimore, 22 prej të cilave u shtynë për shkaqe procedurale.

Pas një sërë shtyrjesh në korrik 2014, Gjykata e Lartë liroi të gjithë të pandehurit për shkak të mungesës së provave. Prokurori paraqiti një ankim kundër këtij vendimi.

Kërkuesja Begija Gaši, vëllai dhe kunata e së cilës ishte zhdukur prej aksidentit ishte marrë në pyetje si dëshmitare në proces. Në lidhje me këtë ngjarje në dhjetor 2009

Avokati i Popullit prezantoi një raport ku vërejti se kohëzgjatja e procesit gjyqësor për më shumë se 10 vjet ishte një veprim i pajustificuar.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur kryesisht në nenin 2 të Konventës, kërkuesit u ankuan se autoritetet malazeze nuk kishin zbatuar detyrimin e tyre për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv për vdekjen dhe zhdukjen e familjarëve tyre, si edhe për të ndjekur penalisht personat përgjegjës.

Gjykata vendosi të vazhdojë shqyrtimin e çështjes vetëm në lidhje me një nga kërkueset, Begija Gaši, e cili kishte parashtruar pretendimet e saj brenda afatit të kërkuar, ndërsa i rrëzoi pretendimet e të gjithë kërkuesve të tjerë, që nuk iu përgjigjën në kohë kërkesës së Gjykatës.

### Pranueshmëria

Gjykata rrëzoi kundërshtimet e qeverisë malazeze lidhur me pranueshmërinë e kërkesës. Për sa i takon gëzimit të “statusit të viktimës” nga kërkuesja, znj. Gaši gëzonte të drejtën të paraqiste kërkesën për vëllain e saj dhe kunatën, pavarësisht se trupat e tyre nuk ishin identifikuar. Gjykata në mënyrë specifike vuri në dukje se ajo kishte qenë konsistente gjatë gjithë proceseve gjyqësore në pretendimin se të afërmit e saj ishin në barkë. Ndërkohë, asnjë analizë e ADN-je nuk ishte kryer nga autoritetet. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e pranueshme.

### Neni 2

Gjykata vërejti se detyrimi për të mbrojtur të drejtën e jetës në kuadër të nenit 2 vendos një detyrim procedural ndaj shtetit për të hetuar vdekjet kur ato ndodhin në duart e agjentëve shtetërorë, si dhe kur shkaktohen nga individë privatë ose të panjohur. Me qëllim që një hetim të jetë efektiv, ai duhet të jetë në gjendje të çojë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës. Megjithatë, ky nuk është një detyrim mbi rezultatin por mbi mjetet dhe çdo mangësi në hetim, që minon këtë aftësi do të rrezikojë të bjerë poshtë standardit të kërkuar të efektivitetit.

Kur një hetim pas sjell nisjen e një procesi gjyqësor në gjykatat kombëtare, ky proces, duke përfshirë fazën e gjykimit, duhet të përmbush standardet e kërkuara të detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën e individëve përmes ligjit. Duke pasur parasysh se mund të ketë pengesa ose vështirësi që pengojnë përparimin e një hetimi, autoriteteve u kërkohet që hetojnë menjëherë një shkelje të pretenduar të së drejtës



për jetën. Në çështjen në fjalë, Gjykata vërejti se procesi penal ishte ende në pritje në nivelin e dytë të gjykimit për më shumë se dhjetë vjet dhe shtatë muaj pas ngritjes së aktakuzës së re dhe më shumë se shtatëmbëdhjetë vjet e nëntë muaj pas ngjarjes.

Gjithashtu, Gjykata gjeti se shkelje kishin ndodhur kur gjykimi vazhdonte në mënyrë të padrejtë dhe se kalimi i kohës në mënyrë të pashmangshme ndikonte në sasinë dhe cilësinë e dëshmive. Mungesa e shpejtësisë së hetimit hedh dyshime në faktin nëse autoritetet kishin vepruar në mirë besim.

Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e panevojshme e hetimit në rrethanat e vdekjes së një individi ishin një tregues i fortë se proceset ishin të mangëta dhe mund të tregonin për një shkelje të mundshme të detyrimit procedural të shtetit sipas nenit 2 të Konventës. Në çështjen në fjalë Gjykata vendosi se qeveria nuk kishte arritur të justifikonte kohëzgjatjen e proceseve penale jashtë afatit të arsyeshëm. Si rezultat, vonesat nuk ishin në përputhje me obligimin e shtetit sipas nenit 2, si edhe hetimi dhe procedimet penale nuk kishin respektuar kërkesat e shpejtësisë dhe efikasitetit. Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi znj. Gaši €12,000 në lidhje me dëmin jo material dhe €500 për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore.

*Vdejkja e një personi i cili ishte trafikuar në Qipro, përfshinte përgjegjësinë e autoriteteve për të mbrojtur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, duke derivuar në shkelje të neneve 2, 4 dhe 5*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RANTSEV K. QIPROS DHE RUSISË**

(Kërkesa nr. 25965/04)

**7 janar 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte një shtetas rus dhe babai i znj. Oxana Rantseva, e cila vdiq në Qipro në mars të vitit 2001. Ajo kishte mbërritur në Qipro në fillim të marsit të atij viti me një vizë si “artiste” dhe filloi punën në një kabare. Tre ditë më vonë braktisi vendin e punës duke lënë një shënim se po kthehej në Rusi. Pasi e gjeti atë në një klub nate në Limasol rreth orës 4:28 të mëngjesit të datës 28 mars, drejtuesi i kabaresë ku ajo kishte punuar e denoncoi atë në polici, duke kërkuar që policia ta deklaronte një emigrante të pa rregullt dhe ta arrestonte e dëbonte nga Qipro. Pas kontrollit të bazës së saj të të dhënave Policia arriti në përfundimin se znj. Rantseva nuk u ishte një emigrante e pa rregullt dhe refuzoi ta arrestonte. Ata i kërkuan menaxherit të kabaresë, që ta merrte nga rajoni i policisë dhe të kthehej me të në mëngjes për të bërë kërkime të mëtejshme mbi statusin e saj të imigracionit. Menaxheri e mori vajzën e kërkuesit në orën 5:20 të mëngjesit.

Znj. Rantseva u shoqërua nga menaxheri i kabaresë në shtëpinë e një punonjëseje tjetër, ku u çua në një dhomë në katin e gjashtë të bllokut të apartamenteve, ndërsa menaxheri mbeti në banesë. Rreth orës 6:30 të atij mëngjesi znj. Rantseva u gjet e vdekur në rrugën poshtë banesës. Një kuvertë u gjet e varur në kangjellat e ballkonit.

Pas vdekjes së znj. Rantseva u morën në pyetje të gjithë personat që kishin qenë prezent në banesë. Gjithashtu, u intervistua një fqinj që kishte parë trupin e zonjës të binte në tokë nga të njëjtët oficerë që kishin qenë në detyrë në rajon ku vajza e kërkuesit ishte shoqëruar. Autopsia e kryer përcaktoi si shkak të humbjes së jetës së vajzës rënien nga ballkoni. Pak kohë më vonë u vendos që znj. Rantseva humbi jetën në rrethana të dyshimta, që ngjanin me një aksident në një përpjekje për të shpëtuar nga banesa në të cilën ajo ishte akomoduar, por nuk ekzistonin prova për të sugjeruar përgjegjësi penale për vdekjen e saj.

Një tjetër autopsi u krye në Rusi, me kërkesë të kërkuesit, e cila arriti në përfundimin se ishte e nevojshme kryerja e një hetimi plotësues për ngjarjen dhe këto gjetje iu

përcollën autoriteteve qipriote në formën e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike sipas traktateve në të cilat Qipro dhe Rusia ishin palë. Në raportin e përgatitur nga Avokati i Popullit qipriot u vu në dukje në lidhje me rastin e znj. Rantseva se fjala “artiste” kishte në Qipro sinonim me fjalën “prostitutë”.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur *inter alia* në nenet 2, 3, 4, dhe 5 të Konventës z. Rantsev u ankua për hetimin mbi vdekjen dhe dështimin e autoriteteve qipriote dhe ruse për të mbrojtur vajzën e tij nga trafikimi i qenieve njerëzore.

### Neni 2

Në lidhje me Qipron, Gjykata vlerësoi se zinxhiri i ngjarjeve që çuan në vdekjen e znj. Rantseva nuk mund të ishte parashikuar nga autoritetet qipriote dhe në këto kushte ata nuk kishin detyrim, që të merrnin masa praktike për të parandaluar rrezikun për jetën e saj.

Megjithatë, një numër mangësish kishin ndodhur në hetimin e kryer nga autoritetet qipriote: kishte pasur dëshmi kontradiktore të cilat nuk ishin sqaruar; pas vendimit të gjykatës vendase për të mbyllur hetimet nuk ishte bërë asnjë përpjekje për të sqaruar rrethanat e çuditshme të vdekjes së znj. Rantseva; kërkuesi nuk ishte pyetur për datën e seancës dhe për rrjedhojë ai kishte qenë në mungesë kur ishte dhënë vendimi i pushimit; megjithëse ngjarja kishte ndodhur në vitin 2001 nuk kishte ende një shpjegim të qartë mbi të. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kishte pasur një shkelje të nenit 2 të Konventës, si rezultat i dështimit të autoriteteve qipriote për të hetuar në mënyrë efektive vdekjen e znj. Rantseva.

Në lidhje me Rusinë, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet ruse nuk kishin shkelur nenin 2 të Konventës pasi ato nuk ishin të detyruara të hetonin mbi një ngjarje që kishte ndodhur jashtë juridiksionit të tyre.

### Neni 3

Gjykata vendosi se çdo keqtrajtim që mund t'i ketë ndodhur znj. Rantseva përpara se të humbiste jetën ka qenë i lidhur me mundësinë e trafikimit dhe shfrytëzimit të saj dhe do të trajtohet në kuadër të ankimit për nenin 4.

#### Neni 4

Gjykata vërejtë se, si skllavëria, trafikimi i qenieve njerëzore, për shkak të natyrës dhe qëllimit të këtij shfrytëzimi, mbështetet në ushtrimin e kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë. Qeniet njerëzore trajtohen si mallra për t'u blerë dhe shitur dhe për t'i vënë në punë të detyruar, duke nënkuptuar këtu mbikëqyrje të ngushtë të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilave shpesh janë të kufizuara; duke përfshirë dhe përdorimin e dhunës dhe kërcënimeve ndaj këtyre viktimave. Prandaj, Gjykata u shpreh se trafikimi në vetvete ishte i ndaluar në kuptim të nenit 4. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje nga ana e Qipros në lidhje me detyrimet e saj pozitive, që rrjedhin nga ky nen në dy pika: së pari, dështimi për të vendosur një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe administrativ për të luftuar trafikim e qenieve njerëzore si rezultat i regjimit ekzistues të vizave "artistike"; si dhe së dyti, dështimi i policisë për të marrë masa operacionale për të mbrojtur znj. Rantseva nga trafikimi, pavarësisht nga rrethanat që derivonin ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se ajo mund të kishte qenë viktimë trafikimi.

Gjithashtu, ka pasur një shkelje të këtij neni edhe nga Rusia për shkak të dështimit të saj për të hetuar se si dhe ku ishte rekrutuar znj. Rantseva. Veçanërisht për shkak të mungesës së ndërmarrjes së hapave për të identifikuar individët, që ishin të përfshirë në rekrutimin e znj. Rantseva ose metodat e përdorura për rekrutim.

#### Neni 5 § 1

Gjykata konstatoi se paraburgimi i vajzës për rreth një orë në rajonin e policë dhe mbyllja e saj e mëpasshme në apartamentin privat, pas sillte përgjegjësi të autoriteteve qipriote në kundërshtim me nenin 5 § 1 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata vendosi se Qipro duhet t'i paguante kërkuarit €40,000 në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material dhe 3,150 për shpenzimet gjyqësore. Ndërkohë, Rusia duhet t'i paguante €2,000 në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Vonesat dhe mungesa e përpjekjeve në proceset e brendshme në lidhje me një sulm fizik ndaj një fëmije i cili derivoi në pamundësinë për të shqyrtuar çështjen, përbënte shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit sipas nenit 8*

## VENDIMI PËR ÇËSHTJEN REMETIN K. KROACISË

(Kërkesa nr. 29525/10)

11 dhjetor 2012

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Tomislav Remetin, ishte shtetas kroat i lindur në 1989. Në prill 2003 kërkuesi, i cili ishte 13 vjeç në atë kohë, u sulmua fizikisht nga babi i një djali me të cilin ai kishte pasur një zënkë në sheshin e lojrave të shkollës. Raportet mjekësore tregonin se kërkuesi kishte marrë plagë në faqen e majtë, në zonën e majtë të mesit dhe rreth shprehkës. Kërkuesi njoftoi policinë për incidentin dhe burri u identifikua si I.Š.

Me kalimin e kohës, tre grupe procesesh u ngritën kundër I.Š.: proceset kundërvajtëse për shkak të prishjes së qetësisë publike, si dhe proceset penale dhe civile.

Në maj të vitit 2003, proceset kundërvajtëse u ngritën nga Gjykata e Kundërvajtjeve të Dubrovnikut, me kërkesë të policisë. Seancat u mbajtën në qershor të vitit 2004 dhe në prill 2005, megjithatë proceset u ndërpreën pasi ndjekja penale ishte parashkuar.

Në qershor 2003, babai i kërkuesit paraqiti një ankesë në Zyrën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut kundër I.Š. Policisë së Dubrovnikut iu kërkua të hetonte mbi akuzat, e cila mori në pyetje babanë e kërkuesit, I.Š., dhe dëshmitarët e tjerë si dhe dëshmi mjekësore. Në dhjetor 2003, I.Š. u padit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut. Kërkuesi dhe I.Š. u dëgjuan nga gjykata, por gjyqtari që drejtonte procesin i hodhi poshtë kërkesat për të thirrur dëshmitarë të tjerë. Zëvendës Prokurori i Shtetit hoqi dorë nga ndjekja penale ndaj I.Š. për shkak të provave të pamjaftueshme dhe babai i kërkuesit mori rolin e “*prokurorit subsidar*”.

Në shtator 2006, një padi e mëtejshme u parashtrua nga babai i kërkuesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut kundër I.Š, me akuza për sjellje të dhunshme, të cilat kishin shkaktuar lëndime trupore, adresimi i kërcënimeve serioze dhe fyerjeve verbale. Ajo u ndryshua më vonë duke i shtuar objektit të padisë edhe keqtrajtimin e një fëmije. Ai gjithashtu paraqiti një kërkesë për dëmet. Edhe në këto procese, babai i kërkuesit kërkoi që dëshmitarët të dëgjoheshin, por gjyqtari e hodhi poshtë kërkesën e tij dhe konkludoi mbi procesin. Më 12 janar 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut e

shkarkoi I.Š. nga akuzat për sjellje të dhunshme dhe pushoi proceset lidhur me shkaktimin e lëndimeve trupore dhe kërcënimet serioze, për shkak se ndjekja penale ishte parashkruar. Në janar 2007 para Gjykatës së Qarkut të Dubrovnikut u parashtrua një ankesë, e cila la në fuqi shkarkimin nga akuzat për sjellje të dhunshme dhe prishi pjesën e vendimit për pushimin e proceseve lidhur me akuzat për shkaktimin e lëndimeve trupore dhe kërcënimeve serioze. Për këtë u vendos rigjykimi lidhur me akuzat e sipërpërmendura.

Në prill 2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut ngriti akuza para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut lidhur me kërcënimet serioze të bëra nga I.Š. Në dhjetor të vitit 2008 procesi u ndërpre pasi i akuzuari ishte liruar me vendim të formës së prerë për të njëjtat fakte nën një kualifikim të ri ligjor. Ajo gjithashtu e udhëzoi kërkuesin se ai mund të ndiqte kërkesën e tij civile në një proces civil të veçantë.

Në janar 2009, çështja u apelua në Gjykatën e Qarkut të Dubrovnikut e cila prishi vendimin e gjykatës më të ulët dhe për këtë u vendos që çështja të rigjykohej. Për këtë, rasti u parashtrua para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut, e cila në prill të 2009 e pushoi sërisht procesin pasi i akuzuari ishte shkarkuar nga akuzat me vendim të formës së prerë për të njëjtat fakte nën një kualifikim të ri ligjor. Një tjetër apel u parashtrua përpara Gjykatës së Qarkut të Dubrovnikut, i cili u pushua pasi ndjekja penale ishte parashkruar. Në korrik të 2009 kërkuesi paraqiti një kërkesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimit të Gjykatës së e Shkallës më të Lartë të Dubrovnikut, por ajo ju rrëzua. Krahas këtyre proceseve, në janar 2009, kërkuesi paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila iu dërgua Gjykatës së Lartë lidhur me kohëzgjatjen e proceseve, por kjo u hodh poshtë si e pabazuar.

Përsa i takon proceseve civile, në shkurt të vitit 2009, kërkuesi paraqiti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut kundër I.Š., duke kërkuar kompensim për dëmin jomaterial, kërkesë që ju hodh poshtë pasi ishte parashkruar. Një ankimim u parashtrua, por vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor u la në fuqi.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 8, për shkak të moskryerjes së një hetimi efektiv nga ana e autoriteteve lidhur me kërkesat e tij, dhe për nenin 6 për shkak të tejgjatjes së procesit.

### Neni 8

Fillimisht, Gjykata kujtoi se ndërsa qëllimi thelbësor i nenit 8 ishte mbrojtja e individit

kundër veprimeve arbitrare të autoriteteve publike, ky nen përfshinte gjithashtu edhe detyrime pozitive që përfshinin miratimin e masave në sferën e marrëdhënieve ndërmjet individëve privatë. Për këtë qëllim, Gjykata theksoi se Shtetet, me qëllim që të përmbushin detyrën e tyre për të mbrojtur integritetin fizik dhe moral të një individi sipas nenit 8, duhet të vendosin dhe të zbatojnë një kuadër të përshtatshëm ligjor që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga individët privatë.

Gjykata vuri në dukje se si sulmi në rastin në fjalë u krye kundër një djali trembëdhjetëvjeçar nga një i rritur për shkak të një mosmarrëveshje të parëndësishme dhe i kushtoi rëndësi të veçantë moshës së kërkuesit, duke e konsideruar atë si një “person vulnerabël”.

Gjykata vuri në dukje se në rastin e një sulmi ndaj integritetit fizik të një personi nga një individ tjetër privat, Konventa nuk kërkonte domosdoshmërisht ndjekje penale të asistuar nga shteti kundër sulmuesit. Megjithatë, nëse një ndjekje penale e tillë vihej në dispozicion dhe individi e shfrytëzonte këtë mundësi, Gjykata do ta bazonte shqyrtimin në efektivitetin dhe mënyrën në të cilën ajo u zbatua. Për këtë qëllim, Gjykata theksoi se sigurimi i një kuadri të përshtatshëm ligjor për mbrojtjen e individëve nga sulmet e dhunshme nuk ishte i mjaftueshëm, pasi shkelje e nenit 8 mund të konsiderohej edhe nëse kuadri ligjor dhe praktikat kishin mangësi në zbatimin e tyre, dhe për rrjedhojë shteti nuk kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive.

Gjykata vuri në dukje se ndërkohë që reagimi i parë i autoriteteve vendase ishte të hapte një hetim në të njëjtën ditë, të fillonte proceset për kundërvajtje, të mblidhte dëshmitarë dhe prova mjekësore dhe në fund të paraqiste një padi kundër I.Š., asnjë nga hapat e ndërmarrë më tej nga autoritetet kroate nuk mund të cilësohej si e efektshme ose mjaftueshmërisht e përshtatshme.

Ashtu si proceset për kundërvajtje të ngritura nga policia, edhe proceset penale të ngritura nga Prokuroria e Shtetit u pushuan për shkak parashkrimit të ndjekjes penale. Gjykata u shpreh se në rastin e parashkrimit të ndjekjes penale, nëse shteti nuk ishte në gjendje të ofronte arsye bindëse dhe të besueshme për të justifikuar këtë gjë, kjo do të ishte një tregues i rëndësishëm se procesi kishte të meta deri në masën që përbënte shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit sipas Konventës.

Për të vlerësuar këtë, Gjykata vuri në dukje se në proceset penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dubrovnikut mbajti seancën e parë dy vjet e gjashtë muaj pas ngritjes së akuzës dhe gjatë kësaj kohe nga ana e autoriteteve vendase nuk u morën hapa të mëtejshme. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se si dëshmitarët në kohën e ngjarjes nuk u thirrën për të dëshmuar. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, vonesat e tejzgjatura

në caktimin e seancës së parë dhe mungesa e përpjekjeve nga ana e autoriteteve të akuzës rezultuan në parashkrimin e ndjekjes penale. Babai i kërkuesit u përpoq ta korrigjonte këtë mungesë përpjekjesh duke marrë rolin e “*prokurorit subsidiar*”, por kërkesa e tij për ofrimin e ndihmës ligjore falas pasi nuk kishte njohuri të mjaftueshme ligjore u hodh poshtë.

Në lidhje me proceset për kundërvajtje, Gjykata vuri në dukje se gjatë harkut kohor të dy viteve Gjykata e Kundërvajtjes së Dubrovnikut dëgjoi vetëm I.Š. dhe nuk dëgjoi asnjë prej dëshmitarëve të tjerë. Sipas mendimit të Gjykatës, nuk mund të ketë asnjë arsye të posaçme për të justifikuar një proces aq të ngadaltë.

Si përfundim këto praktika derivuan në pamundësinë e shqyrtimit të çështjes, duke treguar një dështim nga shteti për të përmbushur detyrimet e tij pozitive sipas nenit 8 të Konventës.

#### Neni 6

Gjykata konsideroi se kërkesat në lidhje me tejzgjatjen e proceseve të konsiderohen si haptazi të pabazuara dhe u hodhën poshtë në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

#### Neni 41

Kroacia duhej t'i paguante kërkuesit 7,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial.



*Hetimi i autoriteteve kroate përsa i përket ankimit të kërkuësës se ajo ishte detyruar të prostituonte nuk ishte i përshtatshëm dhe shkelte aspektin e detyrimeve procedurale të shtetit sipas nenit 4*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN S.M. k. KROACISË<sup>163</sup>**

(Kërkesa nr. 60561/14)

**19 korrik 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja znj. S. M., ka lindur në vitin 1990 dhe gjatë periudhës 2000-2004 ka jetuar në një familje kujdestare. Më pas ajo u zhvendos në një shtëpi shtetërore për fëmijët dhe të rinjtë ku qëndroi deri sa mbaroi trajnimin profesional si kamarriere.

Më 27 shtator 2012, kërkuesja paraqiti një padi në polici kundër T.M., një ish-police, duke pretenduar se ndërmjet verës 2011 dhe shtatorit të të njëjtit vit ai e kishte detyruar të prostituonte duke përdorur presion fizik dhe psikologjik. Kërkuesja paraqiti se kishte takuar T.M. në vitin 2011 nëpërmjet një rrjeti social dhe se ai i ishte ofruar për t'i gjetur asaj një punë si kamarriere. Më pas T.M., kishte filluar të kërkonte që S.M. të kryente shërbime seksuale për meshkuj të tjerë duke e kërcënuar se do ta rrihte nëse ajo nuk bindej. Ai i dha kërkueses një telefon celular me qëllim, që klientët të mund ta kontaktonin. Kërkuesja deklaroi se ajo kishte qenë shumë e frikësuar nga T.M. dhe nuk mundi t'i bënte rezistenë. Më pas T.M. mori me qira një banesë ku të jetonte së bashku me kërkuesen, vend të cilin e shfrytëzoi si vend ku S.M. të ofronte shërbimet seksuale. Kur kërkuesja refuzoi ai kërcënoi se do ta dhunonte, gjë të cilën e bëri çdo dy ditë. Meqenëse ata jetonin në të njëjtën banesë T.M. kontrollonte çdo veprim të kërkueses.

Më tej kërkuesja deklaroi se kur kishte qenë një herë e vetme në banesë kishte kërkuar ndihmë tek mikja e saj M.I. tek e cila kishte qëndruar më pas për një periudhë rreth 10 ditore.

M.I. deklaroi në polici se në fund të verës 2011 kërkuesja u rikthye papritur në banesën e saj ku ajo jetonte me të ëmën. Vetëm pasi ajo erdhi dhe vendosi të jetonte në apartamentin e M.I., kjo e fundit mësoi se kërkuesja kish qenë e përfshirë në prostitucion.

Më 6 nëntor 2012, Zyra e Prokurorit të Qarkut e paditi T.M. me akuzën për shfrytëzim prostitucioni në mënyrë të organizuar. Më 21 dhjetor 2012, kërkueses iu dha zyrtarisht

---

<sup>163</sup> Kjo çështje është referuar në Dhomën e Madhe dhe pritet të gjykohet prej saj.

statusi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore nga Zyra Kroate për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicat. Policia kroate kontaktoi Kryqin e Kuq, i cili nga ana e tij organizoi këshillim individual për kërkuesen. Gjithashtu, S.M. iu dha ndihmë juridike nga një organizatë joqeveritare brenda skemës së ndihmës ligjore të mbështetur nga shteti.

Gjatë dëshmisë së kërkueses në gjykatë ajo elaboroi më tej deklaratën e saj të parë bërë në polici. Megjithatë, T.M. mohoi versionin e ngjarjeve dhe deklaroi se kërkuesja ishte vetë prostituuar me qëllim që të shlyente borxhet dhe të fitonte para. Ai deklaroi se kishte jetuar në të njëjtin apartament me kërkuesen, vend në të cilin ajo ushtronte prostitucionin por nuk e kishte kuptuar këtë fakt. Më 15 shkurt 2013 gjykata vendase liroi T.M. me arsyetimin se edhe pse ishte vërtetuar se ai kishte organizuar një rrjet prostitucioni, nuk ishte vërtetuar se kërkuesja ishte detyruar të prostituonte. Meqë ai ishte akuzuar për veprë të rëndë, ai nuk mund të dënohej për akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit. Dëshmisë së kërkueses iu dha më pak peshë në argumentin e gjykatës, pasi sipas kësaj të fundit deklarata e kërkueses kishte qenë jo koherente, e pasigurtë dhe kërkuesja kishte ndaluar rrëfimin dhe hezitur ta vazhdonte.

Prokurori i çështjes apeloj kundër vendimit, duke argumentuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar në vendimmarrjen e saj duke mos pranuar si provë dëshminë e kërkueses. Gjykata e Apelit e rrëzoi ankimin, duke mbajtur të njëjtin qëndrim në arsyetimin e vendimit si gjykata e shkallës së parë. Më 31 mars 2014, kërkuesja paraqiti një ankim në Gjykatën Kushtetuese. Më 10 qershor 2014, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankimin si të papranueshëm, duke vërejtur se kërkuesja nuk kishte të drejtë të paraqiste ankim kushtetues lidhur me akuzat penale.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në nenet 3, 4 dhe 8 të Konventës kërkuesja u ankuar se papërshtatshmëria e kuadrit ligjor kombëtar dhe përgjigjia procedurale e autoriteteve vendase mbi ankimet e saj kundër T.M. kishin shkelur të drejtat e saj. Veçanërisht ajo pretendoi se autoritetet kroate kishin dështuar të zbardhnin gjithë rrethanat e ngjardjes, nuk i kishin siguruar asaj një pjesëmarrje të duhur gjatë procesit dhe nuk kishin kualifikuar drejtë akuzën.

### Neni 4

Gjykata vlerësoi se ankimi duhet të analizohet në kuadër të nenit 4 të Konventës (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar). Ajo deklaroi se vetë trafikimi, si dhe shfrytëzimi i prostitucionit ishin brenda objektit të kësaj dispozite.

Gjykata vërejt se nuk kishte rëndësi fakti se çështja nuk përfshinte elementë ndër-kombëtarë pasi neni 2 i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit përfshin “të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, qoftë kombëtare apo ndër-kombëtare” dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve i referohet shfrytëzimit të prostitucionit në përgjithësi.

Neni 4 i Konventës përmban një detyrim pozitiv ndaj shteteve anëtare për të ndëshkuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive çdo veprim, që synon mbajtjen e një personi në një pozitë skllavërie, servitutit ose pune të detyruar ose të detyrueshme. Prandaj, shtetet kanë detyrimin pozitiv për të krijuar një kornizë ligjore dhe administrative për të ndaluar dhe ndëshkuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Gjykata ishte e bindur se në kohën e ngjarjeve kishte një kornizë ligjore të përshtatshme në Kroaci për shqyrtimin e saj në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore, prostitucionit të detyruar dhe shfrytëzimit të prostitucionit. Gjykata gjithashtu vërejt se kërkueses iu siguroa ndihmë nga ana e Qeverisë. Kjo përfshinte njohjen e statusit të saj si viktimë e trafikut të qenieve njerëzore dhe dhënien e ndihmës juridike falas, përmes programeve të financuara nga shteti dhe të mbështetura nga OJF-të. Rrjedhimisht, kishte një kuadër ligjor të përshtatshëm për të mbështetur kërkuesen.

Megjithatë, ndërkohë që hetimi fillestar ishte i shpejtë, Gjykata deklaroi se më shumë individë duhet të ishin marrë në pyetje nga policia, sidomos nëna dhe i dashuri i M.I. Ky element solli që Gjykata të vërente se autoritetet kroate nuk e hetuan rastin në thellësi dhe nuk u përpoqën të mbledhin të gjitha provat e disponueshme.

Për më tepër, autoritetet kurrë nuk kishin bërë një përpjekje serioze për të hetuar presionin psikologjik të ushtruar nga T.M. ndaj kërkueses, si një faktor relevant në vlerësimin nëse T.M. e detyroi kërkuesen të prostituonte. Gjithashtu, autoritetet nuk morën në konsideratë praninë e pjesëve të një arme në banesën e T.M. dhe varësinë ekonomike të kërkueses nga T.M.

Gjykata vazhdoi më tej duke evidentuar se sipas ligjit kroat, Konventës për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të Tjerëve dhe Konventës Kundër Trafikimit, pëlqimi i viktimës është i parëndësishëm.

Autoritetet kombëtare nuk e konsideruan ndikimin e mundshëm të traumës psikologjike në aftësinë e kërkueses për të lidhur në mënyrë koherente rrethanat e ngjarjeve mbi shfrytëzimin e saj. Gjithashtu, Gjykata nënvizoi se prania e T.M. në sallën e gjyqit mund të ketë pasur një efekt të dëmshëm ndaj kërkueses edhe pse ai më pas u largua.

Gjykata vlerësoi se në këtë rast autoritetet kroate nuk përmbushën detyrimet e tyre procedurale sipas nenit 4 dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të këtij neni.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkueses 5,000 euro në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material.

*Trajtimi i ndryshëm midis babait fëmija i të cilit kishte lindur gjatë martesës dhe një baba fëmija i të cilit kishte lindur jashtë martese përbënte shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 8*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN SAHIN k. GJERMANISË**

(kërkesa nr. 30943/96)

**8 korrik 2003**

### **1. Faktet kryesore**

Asim Sahin, i lindur më 1950, ishte një shtetas turk në kohën e ngjarjeve, por më vonë fitoi shtetësinë gjermane. Ai ishte babai i një fëmije, G., të lindur jashtë martese në korrik 1988. Ai njohu atësinë e fëmijës, ra dakort të paguante kuotat për shpenzimet dhe e vizitonte rregullisht vajzën e tij deri në tetor 1990, kur nëna e saj i ndaloi kontaktin e mëtejshëm. Në dhjetor 1990 ai aplikoi pa sukses në gjykatat vendase për të drejtën e aksesit. Apeli i mëpasshëm u pushua mbi bazat e një raporti psikologjik, sipas të cilit, dhënia e aksesit kërkuesit për të vizituar vajzën e tij pa i rregulluar më parë gjerat të dy prindërit e vajzës, nuk do të ishte në interesin më të lartë të fëmijës. Në ekzaminimin e vajzës nga një ekspert psikolog, vajza nuk u pyet në asnjë moment për babanë e saj, as për faktin nëse dëshironte ta takonte. Gjykata vendase gjithashtu u shpreh se nuk ishte e nevojshme të dëgjohej fëmija si pjesë e procedurave, pasi sipas psikologut, pyetja e saj mbi marrëdhënien me babanë do t'a cenonte atë psikologjikisht. Ankesa e kërkuesit në Gjykatën e Apelit gjithashtu u rrëzua.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Në vendimin e Dhomës mbi këtë çështje, të dhënë më 11 tetor 2001, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 dhe 14 të Konventës. Çështja iu referua Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43.

Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) se rrëzimi i kërkesës së tij për të pasur kontakt me të bijën lindur jashtë martese, nga gjykatat gjermane, shkelte Konventën. Kërkuesi gjithashtu u ankua për trajtim diskriminues sipas nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) lidhur me nenin 8.

#### Neni 8

Palët ranë dakort se refuzimi i bërë ndaj kërkesës së kërkuesit për të vizituar fëmijën e tij, përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për jetë private dhe familjarë, sipas nenit

8 § 1. Gjykata përsëriti se, çdo ndërhyrje në nenin 8 do të përbënte shkelje të Konventës, përveçse kur ndërhyrja bëhet në përputhje me ligjin, ndiqte një qëllim legjitim dhe ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Ndërhyrja në nenin 8 ishte në përputhje me një pikë të ligjit vendas dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së 'shëndetit ose moralit' dhe 'të drejtave dhe lirive' të fëmijës. Për të vendosur nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, autoritetet vendase duhet të vendosnin një balancë mes interesit të fëmijës dhe interesit të prindërve. Në këtë rast, gjykatat gjermane e kishin arsyetuar mjaftueshëm vendimin e tyre për të mos lejuar aksesin, konkretisht, tensionet serioze mes prindërve të fëmijëve dhe rreziku se vizitat e kërkuarit me fëmijën e tij do të ndikonin për keq në zhvillimin e fëmijës.

Në vendosjen nëse arsyetimet ishin të mjaftueshme, Gjykata konsideroi nëse procesi i vendimmarrjes kishte mbrojtur interesin e kërkuarit. Ajo theksoi se ai kishte pasur mundësinë të paraqiste të gjithë argumentet e tij në favor të fitimit të të drejtës së vizitave dhe kishte pasur mundësinë e aksesit në të gjithë informacionet relevante në të cilat u mbështetën gjykatat kombëtare. Gjykata theksoi se, do të ishte e tepërt të pretendonte se gjykatat vendase duhet të degjojnë dëshmi orale të fëmijëve, në lidhje me të drejtën e vizitës së prindit. Duke qenë se fëmija kishte qenë vetëm 5 vjeç në atë kohë, gjykata vendase mund të mbështetej vetëm në gjetjet e ekspertit psikolog. Gjykata ishte e bindur se procedura e gjykatave gjermane kishte qenë e arsyeshme në rrethanat e dhëna dhe kishte ofruar material të mjaftueshëm për të marrë një vendim të arsyeshëm nga ana e gjykatës vendase në lidhje me të drejtën e vizitës. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 8 ishin respektuar.

#### Neni 14 në lidhje me nenin 8

Gjykata nisi duke shqyrtuar faktin se, në kohën e dhënë, prindërit meshkuj të divorcuar, të fëmijëve të lindur nga martesë ishin ligjërisht të lidhur me të drejtën e vizitës me fëmijët e tyre dhe se ky akses mundej, nëse ishte e nevojshme, të kufizohej ose pezullohej në favor të interesit të fëmijës. Megjithatë, prindërit meshkuj të fëmijëve të lindur jashtë martesë mund të kishin akses ndaj fëmijëve të tyre nëse nëna e fëmijës binte dakort, ose do t'i duhej të siguronin një vendim gjykatë se një kontakt i tillë ishte në interes të fëmijës.

Pyetja para Gjykatës ishte nëse aplikimi i këtij ligji do të rezultonte në një trajtim të diferencuar të pajustificuar midis kërkuarit, baba i një fëmije të lindur jashtë martesë dhe prindërve meshkuj të divorcuar. Në zbatimin e seksionit të dhur të Kodit Civil, gjykatat gjermane kishin gjetur se vetëm rrethana speciale mund të justifikonin pretendimin se kontakti personal me babanë mund të jepte efekte të përhershme

në shëndetin e fëmijës. Duke qenë se këto rrethana speciale nuk ekzistonin në këtë rast, pavarësisht se gjykatat vendase ishin të bindura për qëllimet e arsyeshme të kërkuesit, afërsinë me të bijën dhe dashamirësinë ndaj saj, një pengesë ishte vënë ndaj kërkuesit, e cila ishte më e rëndë se ajo e vendosur për prindërit meshkuj të divorcuar.

Gjykata u shpreh se, vetëm arsye shumë të rënda mund të justifikonin trajtimin e prindërve meshkuj të fëmijëve jashtë martesë, ndryshe nga prindërit meshkuj të fëmijëve të lindur nga martesë. Arsye të tilla nuk ishin dhënë në këtë çështje. Kështu, kishte pasur shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 8.

#### Neni 41

Gjykata vendosi për dëmshpërblim 20,000 euro për dëmin jomaterial dhe 4,500 euro për shpenzimet gjyqësore.

*Vendosja e fëmijëve të kërkueses së parë në komunitetin "Il Forteto" dhe mungesa e kontaktit përbënin shkelje të nenit 8, ku kërkuesja që kishte mundësi të vepronte në emër të fëmijëve nuk kishte më përgjegjësi prindërore*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN SCOZZARI DHE GIUNTA k. ITALISË**

(Kërkesat nr. 39221/98 dhe 41963/98)

**13 korrik 2000**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja e parë, Dolorata Scozzari, ishte shtetase belge dhe italiane, e lindur në 1960 dhe jetonte në Itali. Ajo gjithashtu vepronte në emër të fëmijëve të saj, G., trembëdhjetë vjeç dhe M., gjashtë vjeç në kohën e gjyqimit të rastit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kërkuesja e dytë, Carmela Giunta, ishte shtetase italiane dhe nëna e kërkueses së parë.

Më 9 shtator 1997, duke pasur parasysh situatën dramatike në shtëpinë e kërkueses së parë, e cila ishte shkaktuar kryesisht nga dhuna e bashkëshortit të kërkueses së parë si ndaj saj ashtu dhe fëmijëve dhe faktit që fëmija më i madh kishte qenë viktimë e abuzimit seksual nga një punonjës social, Gjykata për të Rinjtë i hoqi përgjegjësinë prindërore kërkueses së parë dhe urdhëroi vendosjen e fëmijëve në komunitetin "Il Forteto". Dy nga drejtuesit kryesorë të këtij komuniteti ishin dënuar në vitin 1985 për keqtrajtimin e tre personave me aftësi të kufizuara (një vajzë dhe dy djem) që kishin qëndruar atje. Njëri prej tyre ishte gjithashtu i dënuar për abuzim seksual. Të dy burrat vazhdonin të mbanin pozicione drejtuese brenda komunitetit dhe ishin të përfshirë aktivisht me proceset dhe kujdesin lidhur me fëmijët e kërkueses së parë.

Më 9 shtator 1997, Gjykata për të Rinjtë vendosi se kërkuesja e parë duhej të kishte kontakt vetëm me fëmijën e saj më të vogël, por ajo u pengua që ta bënte këtë gjë në praktikë. Më pas, gjykata urdhëroi se ajo duhej të merrte këshillime për t'u përgatitur për të pasur kontakt më fëmijën e saj të vogël. Vizitat që sapo i ishin rregulluar u pezulluan në korrik të 1998. Më pas, më 22 dhjetorit 1998 pas vendimit të Gjykatës për të Rinjtë për të pasur kontakt me të dy fëmijët, kërkuesja e parë u lejua t'i vizitojë ata për herë të parë më 29 prill 1999. Një vizitë e dytë u mbajt më 9 shtator 1999, por shërbimet sociale vendosën që të pezullojnë të gjitha vizitat në vijim.



## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja e parë, e cila gjithashtu pretendonte të vepronte në emër të fëmijëve të saj, u ankua për shkelje të nenit 8 të Konventës për faktin se asaj i ishte hequr përgjegjësia prindërore, fëmijët e saj ishin marrë në kujdes, autoritetet kishin shkaktuar vonesa në lejimin e saj për të parë fëmijët, ishin organizuar shumë pak vizita kontakti dhe autoritetet i kishin vendosur fëmijët tek “Il Forteto”.

Kërkuesja e dytë u ankua gjithashtu për shkelje të nenit 8, pasi autoritetet kishin pakësuar mundësitë e saj për t’u kujdesur për nipërit e saj.

### Pranueshmëria

Qeveria italiane e kundërshtoi qëndrimin e kërkueses së parë për të vepruar në emër të fëmijëve të saj. Gjykata deklaroi se të miturit mund të aplikonin në Gjykatë madje, ose veçanërisht, në qoftë se ata përfaqësoheshin nga një prind që ishte në konflikt me autoritetet. Ajo konsideroi se në rast të një konflikti mbi interesat e një të mituri midis prindit biologjik dhe personit të caktuar nga autoritetet për të vepruar si kujdestar i fëmijës, ekzistonte rreziku se disa nga ato interesa nuk do të sillleshin kurrë në vëmendjen e Gjykatës dhe se të miturit do humbisnin mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre sipas Konventës. Rrjedhimisht, edhe pse nëna në këtë rast ishte privuar nga përgjegjësia prindërore - faktikisht, ky ishte një nga shkaqet e mosmarrëveshjes që ajo i ishte drejtuar Gjykatës – ku pozita e saj si prind biologjik ishte e mjaftueshme për t’i dhënë asaj tagrin e nevojshëm për të aplikuar në Gjykatë në emër të fëmijëve, dhe gjithashtu për të mbrojtur interesat e tyre.

### Neni 8

Në këtë rast u konstatua se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueseve për respektimin e jetës familjare, se kjo ishte në përputhje me ligjin dhe se ndërhyrjet ishin bërë për “mbrojtjen e shëndetit ose moralit” dhe “mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”, pasi ato kishin për qëllim të mbronin mirëqenien e fëmijëve të kërkueses së parë. Prandaj gjykata duhej të merrte parasysh nëse ato ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike.

### *Pezullimi i autoritetit prindëror të kërkueses së parë dhe largimi i fëmijëve*

Gjykata vuri në dukje se rrethanat e faktit të kërkueses së parë u përkeqësuan seriozisht në vitin 1994. Ajo ishte veçanërisht e prekur nga roli negativ i ish-bashkëshortit të saj. Megjithatë, duhej të theksohej gjithashtu se edhe pas ndarjes nga bashkëshorti

i saj, kërkuesja e parë e kishte pasur të vështirë të kujdesej për fëmijët e saj (një raport i një neuropsikiatri të punësuar nga autoriteti lokal shëndetësor tregonte se kërkuesja e parë vuante nga një çrregullim i personalitetit dhe nuk ishte e aftë të menaxhonte situatën komplekse të familjes dhe fëmijëve të saj). Problemi ishte kompleks nisur nga trauma e rëndë që kishtë pësuar fëmija më i madh si rezultat i abuzimit nga një pedofil, punonjës social i cili kishte arritur të mashtronte familjen. Gjykata vlerësoi se, në lidhje me këtë, ndërhyrja e autoriteteve u bazua në arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe u justifikua nga nevoja për të mbrojtur interesat e fëmijëve. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në këtë drejtim.

#### *Kontakti mes kërkueses së parë dhe fëmijëve të saj*

Së pari, Gjykata, konsideroi se vendimi i 9 shtatorit 1997 për të ndaluar çdo kontakt midis kërkueses së parë dhe djalit të saj të madh nuk ishte bazuar në arsye të mjaftueshme. Ndërsa rrethanat komplekse të cilat ishin të dëmshme për jetën familjare dhe zhvillimin e fëmijëve kishin justifikuar plotësisht marrjen e tyre të përkohshme nën kujdes, por nga ana tjetër gjendja e rëndë brenda familjes së kërkueses së parë nuk e justifikonte në vetvete ndërprerjen e kontaktit me fëmijën më të madh.

Gjykata më tej vuri në dukje se megjithëse vendimi i 9 shtatorit 1997 kishte parashikuar organizimin e vizitave me djalin e vogël, deri më 6 mars 1998 nuk ishte bërë asgjë, datë kur Gjykata për të Rinjtë vendosi të kërkonte përfundimisht që vizitat të parapriheshin nga një program përgatitor për nënën.

Megjithatë, asgjë nuk kishte nisur kur, vetëm dy ditë para se të bëhej vizita e parë, më 8 korrik 1998, Gjykata për të Rinjtë kishte vendosur me kërkesë të zëvendës prokurorit publik, i cili sapo kishte filluar një hetim lidhur me babain e fëmijëve, të pozullonte vizitat që tashmë ishin planifikuar. Më pas, përkundrejt vendimit të Gjykatës për të Rinjtë të datës 22 dhjetor 1998, për rifillimin e vizitave nga 15 mars 1999, vizita e parë nuk u bë deri më 29 prill 1999.

Nga dosja e çështjes rezultonte se që nga vizita e parë, shërbimet sociale kishin luajtur një rol të jashtëzakonshëm në zbatimin e vendimeve të Gjykatës për të Rinjtë dhe kishin mbajtur një qëndrim negativ ndaj kërkueses së parë, fakt të cilin Gjykata nuk e gjeti të bazuar objektivisht. Faktikisht, mënyra sesi shërbimet sociale e kishin trajtuar situatën deri më tani, kishte ndihmuar në shpëputjen e lidhjes ndërmjet kërkueses së parë dhe fëmijëve, duke rrezikuar në mënyrë të përhershme marrëdhënien e tyre. Fakti që ka pasur vetëm dy vizita (pas ndarjes një vit e gjysmë) që nga vendimi i saj i 22 dhjetorit 1998, duhet të kishtë shtyrë Gjykatën e të Rinjve të hetonte arsyet lidhur me vonesat në program, megjithatë ajo thjesht pranoi konkluzionet negative

të shërbimeve sociale, pa analizuar faktet në mënyrë kritike. Rrjedhimisht, në këtë aspekt ka pasur shkelje të nenit 8.

#### *Vendimi për të vendosur fëmijët në komunitetin "Forteto"*

Gjykata vuri në dukje se dy nga drejtuesit kryesorë dhe bashkë-themeluesit e "Il Forteto" ishin dënuar në vitin 1985 për keqtrajtimin dhe abuzimin seksual të tre personave me aftësi të kufizuar të cilët qëndronin në këtë komunitet. Në kundërshtim me deklaratat e Qeverisë së paditur, provat në dosjen e çështjes treguan se dy drejtuesit në fjalë kanë luajtur një rol shumë aktiv në rritjen e fëmijëve të kërkueses së parë. Vërejtjet e Gjykatës u përforcuan akoma më shumë nga fakti se Gjykata për të Rinjtë ishte në dijeni të dënimeve kur mori vendimet lidhur me fëmijët e kërkueses së parë. Një faktor i mëtejshëm kontribues ishte abuzimi seksual me të cilin fëmija i madh kishte pësuar në të kaluarën. Kombinimi i këtyre dy faktorëve e shqetësuan kërkuesen e parë në lidhje me vendosjen e fëmijëve të saj në "Il Forteto" çka është e kuptueshme nga pikëpamja objektive.

Situata ishte përforcuar nga fakti se disa nga drejtuesit e "Il Forteto" kishin kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në shtyrjen ose pengimin e zbatimit të vendimeve për të lejuar kontaktin midis kërkueses së parë dhe fëmijëve të saj dhe se kishte prova që tregonin fëmijët e kërkueses së parë janë ndikuar me qëllim distancimin e djemve, veçanërisht djalit të madh, nga nëna e tyre.

Mungesa e një afati kohor për vendimin e kujdesit ndaj fëmijëve, ndikimi negativ i personave përgjegjës për fëmijët tek "Il Forteto", e shoqëruar me qëndrimin dhe sjelljen e shërbimeve sociale, integrimi afatgjatë brenda "Il Forteto", i shtyu fëmijët e kërkueses së parë drejt një ndarje të pakthyeshme nga nëna. Rrjedhimisht, vendosja e pandërprerë e fëmijëve tek "Il Forteto" në kohën e gjykimit të rastit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk i përmbushte kërkesat e nenit 8 të Konventës.

#### *Pozita e kërkueses të dytë*

Prova në dosjen e çështjes tregonte se kërkuesja e dytë do të kishte vështirësi të konsiderueshme për t'u kujdesur siç duhet për fëmijët. Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi se vendimi i autoriteteve për të mos i besuar kujdesin e fëmijëve kërkueses së dytë ishte i bazuar në arsye mjaft të rëndësishme ku edhe pas vendosjes së saj në Itali, kërkuesja e dytë herë pas herë udhëtonte drejt Belgjikës. Për këtë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 përsa i takon kërkueses së dytë.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se kërkuesja e parë padyshim kishte pësuar dëme jomateriale dhe i akordoi asaj shumën prej 100,000,000 ITL<sup>164</sup>. Gjithashtu, konsideroi se edhe fëmijët kishin pësuar dëm jomaterial dhe secilit prej tyre ju akordua shuma prej 50,000,000 ITL. Së fundmi, lidhur me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore u akorduan 17,685,000 ITL.

---

<sup>164</sup> Vlera e përafërt 1 ITL = 0.00052 €

*Pretendimi i kërkuesit për shkelje të së drejtës garantuar nga neni 8 i Konventës në lidhje me refuzimin e autoriteteve për ta transferuar atë më pranë familjes u deklarua i papranueshëm, ndërkohë kushtet në të cilat ai mbahej në paraburgim u gjetën në shkelje të nenit 3*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SERCE k. RUMANISË**

(Kërkesa nr. 35049/08)

**30 qershor 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Ali Serce ishte shtetas turk i lindur në 1966. Ai ishte i martuar dhe kishte katër fëmijë të cilët jetonin në Turqi.

Në qershor 2005 ai u dënua nga Gjykata e Qarkut të Bukureshtit për veprën penale të vrasjes dhe u dënua me tetëmbëdhjetë vjet burgim. Ai kreu dënimin e tij në dy burgje të ndryshme në Rumani, konkretisht në Rahova dhe Giurgiu, ku qëndronte në kohën kur paraqiti kërkesën përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në vitin 2007, kërkuesi paraqiti një kërkesë përpara Ministrisë rumune të Drejtësisë për t'u transferuar në Turqi, në mënyrë që të vuante dënimin pranë familjes së tij, e cila nuk ishte në gjendje të udhëtojë për në Rumani pasi nuk kishin të ardhura të mjaftueshme. Kjo kërkesë u bazua në Konventën midis Rumanisë dhe Turqisë mbi transferimin e personave të dënuar. Ministria e Drejtësisë filloi procedurat e transferimit dhe në qershor 2007 Gjykata e Rrethit të Ankarasë vendosi që kërkuesi mund ta kryente pjesën tjetër të dënimit në Turqi. Në shkurt të vitit 2008 kërkesa e z. Serce u paraqiti para Gjykatës së Apelit të Bukureshtit, e cila në prill 2008 e hodhi poshtë transferimin, për shkak të ndryshimeve në legjislacionin penal turk sa i përket limirit me kusht, ndryshim nga përfitimi i të cilit kërkuesi mund të lirohej për një kohë më të shkurtër.

Kërkuesi paraqiti një kërkesë të mëvonshme transferimi, e cila u refuzua gjithashtu nga Gjykata e Apelit e Bukureshtit në dhjetor 2011.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u anku për shkelje të nenit 3 për shkak të kushteve çnjerëzore të paraburgimit të tij, si dhe shkelje të nenit 8 për shkak të pamundësisë së mbajtjes së kontaktit me familjen e tij, si pasojë e refuzimit të autoriteteve rumune për ta transferuar atë në Turqi.

### Neni 3

Gjykata fillimisht përsëriti edhe një herë se neni 3 i Konventës kërkon që shtetet të sigurojnë që kushtet e paraburgimit janë në përputhje me dinjitetin njerëzor, për të parandaluar që metoda e ekzekutimit të këtyre masave të shkaktojë shqetësime ose vështirësi për individin në një intensitet të tillë që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim, si edhe të mbrojë shëndetin dhe mirëqenien e individit.

Gjykata ka vërejtur edhe më parë se përveç mbipopullimit, çështje të tilla si mungesa e mobiljeve të përshtatshme në qeli, kushtet sanitare të tilla si numëri i kufizuar i tualeteve dhe lavamanëve për një numër të madh të paraburgosurish, një gamë e gjerë e nevojave dhe prania e insekteve ishin element të rëndësishëm për të vlerësuar nëse kushtet e paraburgimit përputheshin me nenin 3.

Në rastin objekt gjykimi, kërkuesi u ankua për mungesën e higjienës dhe praninë e insekteve në qeli, të cilat e pengonin të flinte natën. Gjithashtu, ai u ankua për mungesë të aktiviteteve dhe mundësive për të punuar. Për këtë qëllim, Gjykata shqyrtoi raportet e prodhuara nga një OJQ-të rumune që monitoronin burgjet, si dhe jurisprudencën e mëparshme mbi kushtet e papërshtatshme të burgjeve të Rahovës dhe Giurgiut. Gjykata arriti në përfundimin se kushtet sanitare ishin të pakënaqshme. Këto kushte të marra së bashku me gjendjen shëndetësore të kërkuesit dhe mbipopullimin e burgut përbënin shkelje të nenit 3.

### Neni 8

Gjykata vuri në dukje se çështja qendrore e rastit objekt shqyrtimi ishte të përcaktonin nëse refuzimi i autoriteteve rumune për të lejuar transferimin e kërkuesit në Turqi përfshihej brenda fushëveprimit të Konventës.

Së pari, Gjykata vuri në dukje se në legjislacionin rumun nuk ekzistonte asnjë dispozitë e posaçme që garantonte të drejtën për t'u transferuar në Turqi. Për më tepër, një e drejtë e tillë thelbësore nuk u garantua nga marrëveshja midis Rumanisë dhe Turqisë lidhur me transferimin e personave të dënuar, pasi ajo nuk i detyron autoritetet rumune që të miratonin kërkesën për transferim në favor të kërkuesit.

Më tej, Gjykata theksoi se Konventa nuk i lejon personave të ndaluar të drejtën për të zgjedhur vendin e tyre të paraburgimit dhe ndarja nga familja ishte një pasojë e pashmangshme e ushtrimit të prerogativave të shteteve për urdhërimin e

paraburgimit në kontekstin e ndëshkimit penal. Për rrjedhojë kërkesa u konstatua si e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitën e nenit 35 (3) të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që shteti rumun duhet t'i paguante kërkuesi 5,000 euro si shpërblim i dëmit jomaterial.

*Vendimi i gjykatës për të kthyer fëmijën tek i ati i cili jetonte në një tjetër shtet përbënte shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠNEERSONE DHE KAMPANELLA K. ITALISË**

(Kërkesa nr. 14737/09)

**12 tetor 2011**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, znj. Jeljazaveta Šneersone dhe i biri Marko Kampanella, ishin të dy shtetas letonez, të lindur respektivisht në 1973 dhe 2002 dhe jetonin në Riga.

Marko ka lindur në Itali në kohën kur kërkuesja e parë dhe i ati i tij jetonin së bashku. Në vitin 2003, kur Marko ishte një vjeç, prindërit e tij u ndanë dhe kërkuesit u transferuan në një banesë tjetër.

Më 20 shtator 2004, me kërkesën e znj. Šneersone, Gjykata për të Rinjtë në Romë i dha asaj kujdestarinë e Marko-s, pasi konflikti i vazhdueshëm ndërmjet prindërve e bëri kujdestarinë e përbashkët të pamundur. Ndërsa babait iu dha e drejta e takimit me Markon sipas një kalendari javor të caktuar. Ai e apeloj vendimin, duke kërkuar dhënien e kujdestarisë së përbashkët ose kujdestarisë së vetme, pasi ai nuk donte që kërkuesja e parë të transferonte fëmijën jashtë vendit pa miratimin e tij. Seksioni për të Rinjtë pranë Gjykatës së Apelit të Romës rrëzoi kërkesën e tij për kujdestari të pavarur dhe gjeti shqetësimin e babait në lidhje me mundësinë e transferimit të kërkueses së parë dhe djalit në Letoni të pabazuar, pasi kërkuesja e parë e kishte lënë Markon në kujdesin e të atit kur udhëtoi për në Letoni dhe djali nuk kishte një pasaportë.

Më 24 qershor 2005, gjyqtari i kujdestarisë dha një autorizim për të lëshuar një pasaportë për Markon. Pas këtij vendimi më 11 korrik babai i djalit apeloj kundër vendimit, por apeli i tij u refuzua.

Më 3 shkurt 2006, Gjykata e Civitavecchia vendosi që babai i Marko-s duhej të paguante detyrim ushqimor për të birin, vendim ky që mbeti i pa zbatuar. Për këtë arsye, në prill të vitit 2006, kërkuesit pretenduan se nuk kishin zgjidhje tjetër përveçse të ktheheshin në Letoni, pasi nuk kishin asnjë mbështetje tjetër financiare.

Më 7 shkurt 2006 Markos iu dha shtetësia letoneze. Në një datë të paspecifikuar, me



kërkesë të babait të djalit, Gjykata për të Rinjtë e Romës i dha të atit kujdestarinë e përkohshme të kërkuesit të dytë dhe pohoi që fëmija duhet të jetonte me të atin.

Në përputhje me Konventën e Hagës lidhur me Rrëmbimin Ndërkombëtar të Fëmijëve, Ministria e Drejtësisë italiane kërkoi nga autoritetet letoneze të kthenin kërkuesin e dytë në Itali. Gjykatat e letoneze vendosën në vitin 2007 se kthimi i Markos në Itali nuk do të ishte në interesin e tij më të lartë. Ky vendim u mbështet në raportin e një psikologu, i cili arriti në përfundimin se ndarja e djalit nga e ëma do të ndikonte në mënyrë të pashmangshme negativisht për të. Më 4 qershor 2007 me kërkesë të znj. Šneersonë paraqiti një kërkesë për kujdestari të vetme në Gjykatën e Qarkut të Rigës.

Në prill 2008, me kërkesë të babait të Markos, Gjykata për të Rinjtë në Romë.s urdhëroi kthimin e djalit në Itali në bazë të Rregullores së Këshillit Evropian të vitit 2003 nr. 2201/2003 lidhur me juridiksionin në çështjet e përgjegjesisë prindërore. Në gusht të atij viti, autoritetet italiane i kërkuan Letonisë, që të vepronte mbi vendimin e Gjykatës së Romës dhe të transferonte djalin në Itali. Apeli i kërkueses së parë u refuzua nga Gjykata e Apelit e Romës, e cila dha vendimin e saj përmes procedurës me shkrim pa dëgjuar palët, por pas marrjes në shqyrtim të parashtrimeve të tyre me shkrim.

Më 10 korrik 2009, përmbaruesi i Gjykatës Rajonale të Rigës iu afrua babait të Marko-s duke e ftuar atë që të rivendoste kontakte me të birin, megjithatë babai nuk u përgjigj.

Në tetor 2008, Letonia ngriti një padi kundër Italisë përpara Komisionit Evropian në lidhje me procedurat e kthimit. Në veçanti Letonia pretendoi se Italia nuk kishte respektuar as rregulloret, as vendimet e gjykatave letoneze lidhur me kërkuesin e dytë. Komisioni lëshoi një mendim të arsyetuar, duke gjetur se Italia nuk kishte shkelur Rregulloret ose ndonjë parim të përgjithshëm të së drejtës komunitare.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

### Neni 8

Për sa i përket pranueshmërisë së çështjes, Gjykata vuri në dukje se duhet të shmanget qasja kufizuese ose thjesht teknike lidhur me përfaqësimin e fëmijëve përpara Gjykatës. Prandaj, ajo refuzoi argumentin e qeverisë lidhur me papajtueshmërinë *rationae personae*, duke vlerësuar se të miturit mund të aplikojnë në Gjykatë veçanërisht, nëse përfaqësohen nga njëri prej prindërve, i cili është në konflikt me autoritetet dhe kritikon vendimet e tyre. Në raste të tilla, fakti i të qenit prindi biologjik i fëmijës

është i mjaftueshëm për t'i dhënë atij/asaj fuqinë juridike të nevojshme për të aplikuar përpara GJEDNJ edhe në emër të fëmijës, për të mbrojtur interesat e këtij të fundit.

Gjykata vërejti se nuk kishte kundërshtime në lidhje me faktin se marrëdhënia midis kërkuessve përfshihet në kuptimin e «jetës familjare» në kuadër të nenit 8. Në lidhje me marrjen e vendimit nëse kthimi i kërkuessit të dytë do të përbënte shkelje të nenit 8 për shkak të vendimit të dhënë nga gjykatat italiane, Gjykata vuri në dukje se as qeveria italiane as vetë kërkuessit nuk kontestuan se transferimi i djalit ishte i gabuar sipas parashikimeve të Konventës së Hagës mbi Rrëmbimin Ndërkombëtar të Fëmijëve, si edhe faktin se vendimet e gjykatave italiane për ta kthyer djalin në Itali kishin qëllim legjitim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të Markos dhe babait të tij.

Megjithatë, Gjykata konsideroi se gjykatat italiane, në vendimin e tyre për kthimin e kërkuessit të dytë në Itali, nuk kishin parasysh në mënyrë të arsyeshme interesin më të lartë të fëmijës. Gjykatat italiane nuk iu referuan dy raporteve të psikologëve të hartuara në Letoni sipas kërkesave të përfaqësuesit të kërkuessve dhe më pas të mbështetura nga gjykatat letoneze. Gjithashtu, gjykatat italiane nuk iu referuan rreziqeve të mundshme që mund të pësonte shëndeti psikologjik i kërkuessit të dytë në rast kthimi, rreziqe këto të identifikuara në raportet në fjalë.

Për sa i përket vendit ku do të akomodohej djali në Itali pas kthimit asnjë autoritet italian nuk u bëri asnjë përpjekje për të vlerësuar nëse ky vend ishte i përshtatshëm për të akomoduar një fëmijë të vogël. Gjykata nuk ishte e bindur se gjykatat italiane e vlerësuan mjaft seriozitetin e vështirësive, të cilat kërkuessi i dytë mund të haste pas kthimit në Itali.

Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e kërkuessve për respektimin e jetës së tyre familjare nuk ishte «e nevojshme në një shoqëri demokratike» brenda kuptimit të nenit 8 § 2 të Konventës. Prandaj, Gjykata vlerësoi se në rastin objekt gjykimi kishte shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me urdhrin e gjykatave italiane për kthimin e kërkuessit të dytë në Itali.

Gjithashtu, Gjykata shqyrtoi rregullsinë e procedurës në vendimmarrjen e Gjykatës për të Rinjtë në Romë për të vendosur nëse kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të mungesës së kërkuesses së parë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore në atë gjykatë. Duke marrë parasysh se babai i kërkuessit të dytë dhe kërkuessa e parë paraqitën me ndihmën e avokatit deklarata të detajuara me shkrim në dy nivele të gjykatave italiane, Gjykata ishte e bindur se kërkesa e respektimit të një procesi të rregullt sipas kërkesave të nenit 8 ishte respektuar. Rrjedhimisht, nuk kishte

pasur shkelje të nenit 8 për shkak të mungesës së kërkeses së parë nga seancën e zhvilluar nga gjykata italiane.

#### Neni 6

Në shqyrtim të pretendimeve për nenin 6 të Konventës, Gjykata vlerësoi se procedurat e zhvilluara përpara gjykatave italiane nuk paraqitën asnjë dyshim për shkelje dhe kështu kjo pjesë e ankimit të kërkesve u deklarua si haptazi e pa pranueshme.

#### Neni 41

Gjykata vendosi se Italia duhet t'i paguante të dy kërkesve së bashku 10,000 euro në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material dhe 5,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

*Dështimi i autoriteteve vendase në marrjen e të gjitha masave të arsyeshme për të lehtësuar bashkimin mes kërkueses dhe të birit pavarësisht vendimeve gjyqësore që ekzistonin në favor të saj sollën shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠOBOTA-GAJIĆ k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS**

(Kërkesa nr. 27966/06)

**6 shkurt 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja znj. Verica Šobota-Gajić, lindi në vitin 1964 dhe jetonte në afërsi të Gradiska. Ajo u martua me Z.G, me të cilin kishte dy fëmijë, një vajzë të lindur në vitin 1992 («A») dhe një djalë të lindur në vitin 1994 («B»). Pas një episodi të pretenduar dhune në familje, kërkuesja e la bashkëshortin duke marrë A. ndërkohë që Z.G mbajti B.

Më 30 maj 2002, kërkuesja filloi procedurat e divorcit dhe kujdestarisë para Gjykatës së Shkallës së Parë të Gradiškës. Më 19 shkurt 2003, Gjykata e Shkallës së Parë Gradiška i dha kërkueses divorcin dhe i dha asaj kujdestarinë e të dy fëmijëve. Më 28 shkurt 2003, Qendra e Punëve Sociale i dha kërkueses kujdestarinë e përkohshme të A dhe B në pritje që vendimi i dhënë nga gjykata të mernte formë të prerë.

Më 28 prill 2003, kërkuesja u ankua pranë Seksionit të të Drejtave të Njeriut, një organ vendas në mbrojtje të të drejtave të njeriut, që procedurat e deritanishme nuk kishin arritur të përmbushnin standardin e shpejtësisë dhe efikasitetit të kërkuar sipas nenit 8 të Konventës, për të siguruar respektimin e të drejtës së saj për një jetë të qetë familjare.

Më 30 korrik 2003, Departamenti i Administrimit të Përgjithshëm pranoi të ekzekutoonte vendimin e 28 shkurtit 2003. Më 18 gusht dhe 26 shtator ky institucion kreu dy përpjekje të pasuksesshme për të ekzekutuar vendimin në fjalë.

Më 6 nëntor 2003, Seksioni i të Drejtave të Njeriut gjeti një shkelje të nenit 8 të Konventës dhe i akordoi kërkueses dëmshpërblim, duke urdhëruar Republikën Serbska «të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të ekzekutuar menjëherë vendimin e Qendrës së Punëve Sociale, jo më vonë se data 5 janar 2004» dhe «t'i paguante kërkueses brenda të njëjtit afat 2,500 marka boshnjake [ekuivalente me 1,280 euro] si shpërblim për dëmin jo material».

Më 18 dhjetor 2003 Departamenti për Administrimin e Përgjithshëm i dorëzoi kërkueses djalin e saj B. Të nesërmen e ngjarjes Z.G. rrëmbeu djalin.

Më 23 prill 2004 prokurori kompetent, duke qenë i bindur se kishte prova të mjaftueshme se Z.G. ka kryer rrëmbimin e fëmijës, ngriti aktakuzë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Gradiška.

Më 14 janar 2006 Z.G. ndërroi jetë dhe procesi penal kundër tij u ndërpre. B. mbeti me D.B., gjyshen nga ana e babait. Më 1 shkurt B. kundërshtoi të kthehej të jetonte me të ëmën dhe Qendra e Punëve Sociale vendosi të mos e detyronte.

Më 2 mars 2006, Qendra e Punëve Sociale u përpoq pa sukses për të bindur D.B. për të lehtësuar kthimin e B. pranë së ëmës. Sipas procesverbalit të takimit, D.B. kishte shprehur në praninë të nipit B., neverinë e saj për kërkuesen. D.B. u përshkrua si një person manipulues, poseduese, autoritare dhe agresive.

Më 31 mars 2006 Gjykata për Kundërvajtjet Penale e Gradiškës dënoi D.B. për dhunën psikologjike ushtruar ndaj B. dhe e urdhëroi Qendrën e Punëve Sociale, që të siguron-te kthimin e shpejtë të B. pranë të ëmës po të ishte e nevojshme edhe me ndihmën e policisë.

Pas një periudhe midis viteve 2006 dhe 2007, gjatë së cilës autoritetet kombëtare ishin vazhdimisht të paafta për të zbatuar vendimin, Qendra e Punëve Sociale ktheu B. pranë kërkueses më 22 janar 2007.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja në referim të nenit 8 të Konventës u ankua se autoritetet vendase kishin dështuar në marrjen e të gjitha masave të arsyeshme për të lehtësuar bashkimin mes saj dhe të birit, pavarësisht ekzistencës së vendimeve në favor të saj.

### Neni 8

Për sa i përket pranueshmërisë së çështjes, qeveria pohoi se duke marrë parasysh kthimin e B. më 22 janar 2007 dhe vendimin e Seksionit për të Drejtat e Njeriut, kërkuesja nuk mund të pretendonte më se ishte viktimë e shkeljes së supozuar. Megjithatë, Gjykata iu referua jurisprudencës së saj të mëparshme duke konsideruar se një vendim ose masë e favorshme për kërkuesen nuk është në parim e mjaftueshme për ta privuar nga statusi i saj si «viktimë» përveç rastit nëse autoritetet kombëtare kanë pranuar dhe më pas kanë ofruar dëmshpërblim për shkeljen e Konventës.

Gjykata konstatoi se në këtë situatë, shuma e dhënë (1,280 €) për kërkuesen nuk përbënte kompensim të mjaftueshëm, sidomos në lidhje me faktin se situata e konstatuar vazhdoi për më shumë se tre vjet pas dhënies së dëmshpërblimit.

Marrëdhënia në mes kërkueses dhe djalit të saj ishte e qartë se përfshihej brenda kuptimit të «jetës familjare» sipas nenit 8 të Konventës; duke qenë kështu, pyetja në këtë rast ishte nëse kishte pasur një mosrespektim të së drejtës së kërkueses për të gëzuar një jetë të qetë familjare.

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, Gjykata shqyrtoi nëse autoritetet kombëtare kishin respektuar detyrimet pozitive dhe kishin ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të lehtësuar ribashkimin, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme prej tyre në referim të rrethanave të veçanta të rastit, si edhe nëse ata kishin arritur një ekuilibër të drejtë midis interesave të gjithë personave të përfshirë dhe interesit të përgjithshëm për të siguruar respektimin e shtetit të së drejtës. Në një rast si ky objekt gjykimi, përshtatshmëria e një mase duhej të gjykohej nga shpejtësia e zbatimit të saj pasi kalimi i kohës mund të kishte pasojë të pariparueshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit që nuk jetonte me të.

Gjykata vërejti se ribashkimi i një prindi me një fëmijë, që ka jetuar për një kohë me prindin tjetër mund të mos ndodh menjëherë dhe pa përgatitjet e nevojshme. Megjithatë, në rastin në fjalë, nuk kishte dëshmi se ishin marrë masa përgatitore, që mund të shpjegonin vonesat e lartpërmendura nga ana e autoriteteve.

Për të përcaktuar nëse autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të lehtësuar ribashkimin, Gjykata shqyrtoi mosmarrëveshjet ndër sektoriale mbi përgjegjësitë administrative ndërmjet departamenteve të ndryshme kombëtare të përfshira, të cilat kanë ndodhur në periudhën ndërmjet paraqitjes së kërkesës së parë nga kërkuesja më 15 maj 2001 dhe ribashkimit me djalin e saj më 22 janar 2007. Nuk kishte asnjë indicie se kërkuesja kishte kontribuar në zvarritjen e çështjes.

Duke iu referuar urdhrit të bërë më 31 mars 2006, për të siguruar kthimin e shpejtë të B. pranë nënës së tij, qoftë edhe me ndihmën e policisë, Gjykata vuri në dukje se megjithëse ky urdhër ishte menjëherë i ekzekutueshëm, ai nuk u zbatua deri më 22 janar 2007 për shkak të konfuzionit në lidhje me përgjegjësinë për ekzekutim ndërmjet Qendrës së Punëve Sociale, Gjykatës së Shkallës së Parë dhe policisë lokale, duke shmangur të gjitha përgjegjësitë dhe duke mos bashkëpunuar.

Si rezultat i dështimit të përsëritur i autoriteteve vendase për të ndërmarrë veprime dhe për të zbatuar vendimet në favor të kërkuases, duke rezultuar në vonesa të tepruara solli sipas gjykatës një shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuases 8,800 euro dëmshpërblim në lidhje me dëmin jo material dhe 4,700 euro për shpenzimet gjyqësore.

*Gjykimi dhe dënimi i dy kërkuesve të mitur, të dënuar për vrasje nga një gjykatë për të rritur, përbënte shkelje të nenit 5 dhe 6*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJET T. k. MBRETËRISË SË BASHKUAR dhe V. k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat nr. 24724/94 dhe 24888/94)

**16 dhjetor 1999**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, ishin qytetarë britanikë të dy të lindur në 1982, të cilët u dënuan në nëntor 1993 për rrëmbimin dhe vrasjen e një djali dy vjeçar. Ata ishin dhjetë vjeç në kohën kur kryen veprën penale dhe njëmbëdhjetë në kohën e gjykimit të tyre, i cili u mbajt në seancë me dyer të hapura në Gjykatën e Kurorës dhe tërhoqi intensivisht vëmendjen e shtypit dhe interesit publik. Pas dhënies së vendimit kërkuesit u dënuan me heqje lirie për një periudhë minimale të pacaktuar “sipas pëlqimit të Mbretëreshës”. Sipas ligjit dhe praktikës angleze, fëmijët dhe të rinjtë e dënuar me burgim “sipas pëlqimit të Mbretëreshës”, së pari duhej të vuanin dënimin për një periudhë minimale të pacaktuar deri në lirimin e tyre me kusht e cila sipas legjislacionit britanik quhej “*tarifë*”, e dhënë nga Sekretari i Brendshëm, për të përmbushur kriteret me efekt ndëshkues dhe parandalues. Pas përfundimit të afatit minimal “të tarifuar”, të ndaluarit u lanë të lirë, pavarësisht se sipas këndvështrimit të Bordit të Lirimeve me Kusht, ata vazhdonin të përbënin rrezik për publikun. Sekretari i Brendshëm vendosi si dënim një “*tarifë*” prej pesëmbëdhjetë vjetësh në lidhje me secilin kërkues. Ky vendim u prish nga Dhoma e Lordëve në procesin gjyqësor të 12 qershorit 1997, pasi opinioni publik për rastin në fjalë kishte ndikuar në vendimmarrjen e Sekretarit të Brendshëm. Deri në datën kur rasti u shqyrtua nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk u përcaktua asnjë “*tarifë*” e re.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan në bazë të nenit 3 (ndalimi i torturës), pasi ata ju nënështruan një gjykimi të plotë për të rritur dhe kohëzgjatja e dënimit me burg të tyre përbënte shkelje të Konventës. Ata gjithashtu u ankuan se nuk kishin pasur një proces të rregullt dhe se vendimi mbi periudhën e tyre minimale të pacaktuar “*tarifore*” nga Sekretari i Brendshëm, dhe jo nga një gjykatë, përbënte shkelje të nenit 6 (e drejta për proces të rregullt). Së fundmi, kërkuesit u ankuan gjithashtu sipas nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri) se sistemi i dënimit të fëmijëve në shtetin e paditur ishte arbitrar dhe ata nuk kishin mundësi të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre të vazhdueshëm pasi vendimi u mor nga një trup gjyqësor.



### Neni 3

#### *Gjykimi*

Gjykata e nisi gjykimin e saj duke shqyrtuar nëse përgjegjësia penale ndaj dy kërkuesve ishte e mjaftueshme për të përbërë shkelje të të drejtave të tyre sipas nenit 3. Gjykata vuri në dukje se midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nuk kishte një standard të qartë të përbashkët në lidhje me moshën minimale për përgjegjësi penale, ku faktikisht moshë 10-vjeçare në Mbretërinë e Bashkuar nuk ishte as më e ulta mes shteteve anëtare dhe as nuk ndryshonte në mënyrë joproportionale nga kufijtë e përgjithshëm që kishin vendosur shtetet e tjera për moshën. Për rrjedhojë, ngarkimi me përgjegjësi penale ndaj dy kërkuesve nuk përbënte shkelje të nenit 3.

Gjykata më pas shqyrtoi nëse, mbajtja e proceseve penale për tre javë në Gjykatën e Kurorës për seksionin e të rriturve, zbatimi i procedurës gjatë gjykimit dhe pas dhënies së dënimit si në rastin e të rriturve, bërja publike e emrave të kërkuesve T dhe V, përbënin shkelje të nenit 3. Në këtë drejtim, Gjykata njohu se e drejta ndërkombëtare i kushtoi më shumë rëndësi mbrojtjes së të pandehurve të mitur sesa publikimit dhe nevojës për të gjykuar të miturit në gjykatat e të rriturve. Megjithatë, Gjykata gjithashtu konsideroi se në këtë rast nuk kishte prova që mbajtja me dyer të hapura e gjykimin të kërkuesve arrinte pragun minimal të ashpërsisë për t'u konsideruar keqtrajtim sipas nenit 3. Më tej, Gjykata arriti në përfundimin se proceset penale kundër kërkuesve nuk kishin ndonjë qëllim nga ana e shtetit për të turpëruar kërkuesit apo për t'ju shkaktuar atyre vuajtje, madje për këtë arsye ishin ndërmarrë masa të posaçme për të ndryshuar procedurën e gjykatave vendase për të marrë parasysh moshën e kërkuesve. Çdo proces ose hetim në lidhje me ngjarjet e kryera nga T dhe V do t'i kishte shkaktuar kërkuesve "ndjenjën e fajit, stresit, ankthit dhe frikës", ndaj aspektet specifike të procesit gjyqësor të cilat ishin shkaktare të vuajtjes së kërkuesve nuk do të kishin qenë të tilla nëse autoritetet vendase do të kishin trajtuar procesin penal kundër kërkuesve në një mënyrë tjetër duke përdorur të gjithë mjetet, që kishin në dispozicion. Për rrjedhojë gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 3 në lidhje me gjykimin e kërkuesve.

#### *Dënimi*

Duke qenë të dënuar me heqje lirie "sipas pëlqimit të Mbretëreshës" i cili përbënte një periudhë minimale ndalimi të pacaktuar, e quajtur "*tarifa*", para kryerjes së të cilës kërkuesit nuk mund të liroheshin. Gjykata nuk konsideroi nëse elementi ndëshkues i zbatuar nga ana e shtetit përbënte dënim në vetvete, duke derivuar kështu në shkelje të nenit 3 apo që Konventa i pengonte shtetet për dënimin e fëmijëve me

një periudhë të pacaktuar e cila lejonte që heqja e lirisë të të pandehurve të bazohej në nevojën për të mbrojtur rendin publik. Për sa kohë që “tarifa” përfundimtare nuk ishte vendosur ende deri në datën e gjykimit të rastit në Gjykatën Evropiane, nuk mund të nxirrej ndonjë përfundim lidhur me kohëzgjatjen e burgimit ndëshkues që do të kryhej nga kërkuesit. Kryerja e gjashtë viteve burg nga kërkuesit nuk u konsiderua si trajtim çnjerëzor ose poshtëruës, për rrjedhojë nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 në lidhje me dënimin e kërkuesve.

## Neni 6

### *Gjykimi*

Për të përcaktuar nëse natyra e gjykimit të kërkuesve kishte shkelur nenin 6, Gjykata filloi duke përcaktuar se ky nen në tërësi garantonte të drejtën e personave të akuzuar për të marrë pjesë në mënyrë efektive në gjykimin e tyre penal. Në lidhje me fëmijët, Gjykata ishte e mendimit se ishte thelbësore që ata të trajtoheshin në një mënyrë që merrte plotësisht në konsideratë moshën e tyre, nivelin e pjekurisë dhe kapacitetin intelektual dhe emocional dhe se ishin ndërmarrë hapa përgatitore për pasur aftësinë për të kuptuar dhe marrë pjesë në procese. Nisur nga kjo pikënisje, Gjykata vazhdoi të theksojë se në lidhje me procedurat penale që përfshijnë fëmijë të vegjël, do të ishte e nevojshme që seancat të zhvilloheshin në një mënyrë të tillë që të zvogëlonin sa të ishte e mundur ndjenjën e tyre të frikës dhe heqjes së lirisë. Ndërsa qeveria argumentoi në këtë rast se interesi i përgjithshëm i një sistemi drejtësie transparent kërkon gjykimin me dyer të hapura. Gjykata vuri në dukje se autoritetet ishin ende në kohë për të bërë ndryshime në procedurën gjyqësore duke përcaktuar përzgjedhjen e publikut dhe shtypit për të marrë pjesë në këto gjykime.

Ndërsa ishin marrë masat e posaçme për të ndihmuar dhe përgatitur kërkuesit për të kuptuar proceset gjyqësore tri javore me dyer të hapura për publikun, Gjykata vuri në dukje se procesi gjyqësor ndonjëherë duhet të kishte qenë i pakuptueshëm dhe frikësues për një fëmijë njëmbëdhjetë vjeçar dhe se marrja e disa masave nga ana e autoriteteve për të modifikuar sallën e gjyqit, të tilla si ngritja e nivelit të bankës së të pandehurit për të ndihmuar kërkuesit të shikonin, kishte ndikuar në rritjen e shqetësimit të kërkuesve gjatë gjykimit.

Raportet psikiatrike të nxjerra në lidhje me dy kërkuesit tregonin se çrregullimi i stresit post-traumatik kishte kufizuar aftësinë e tyre për të udhëzuar avokatët si dhe për të dëshmuar në mbrojtjen e tyre. Në fakt, provat e paraqitura në gjykatë sugjerorin se asnjëri nga kërkuesit nuk ishte në gjendje të ndiqte siç duhet rrjedhën e procesit. Ndërkohë që të dy kërkuesit përfaqësoheshin nga avokatë të kualifikuar, Gjykata

e konsideronte se kërkuesit e kishin pasur shumë të vështirë dhe se nuk duhej të ishte ndërë të qetë për t'u konsultuar apo për të ndihmuar siç duhet përfaqësuesit e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se lidhur me gjykimin e kërkuesve, kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

#### *Dënimi*

Gjykata miratoi argumentin e kërkuesve se “tarifa” ishte caktuar nga Sekretari i Brendshëm, dhe jo nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, siç parashikohet në nenin 6, dhe për këtë kishte pasur shkelje të këtij neni në lidhje me dënimin e tyre.

#### Neni 5 § 1

Gjykata vërejti se kërkuesit u dënuan me burgim nga një gjykatë kompetente dhe për këtë arsye heqja e lirisë së tyre binte në fushëveprimin e nenit 5 § 1. Megjithatë, dënimi me heqje lirie “sipas pëlqimit të Mbretëreshës” ishte i ligjshëm sipas ligjit anglez, i vendosur sipas procedurës të parashikuar në ligj dhe nuk mund të thuhet se ishte arbitrar, pasi ajo ishte në përputhje me qëllimet për heqjen e lirisë sipas parashikimeve të nenit 5 § 1. Për rrjedhojë, Gjykata konkludoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1.

#### Neni 5 § 4

Kërkesa e kërkuesve në lidhje me nenin 5 § 4 ishte se ndërsa neni parashikonte mundësinë e lirit të një personi në rastet kur burgimi i tyre ishte konstatuar i paligjshëm, kërkuesit nuk kishin pasur mundësinë të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre të vazhdueshëm të dhënë nga një trup gjyqësor. Në kushtet kur një gjykatë kombëtare dha një dënim të caktuar me burgim ndaj një personi me qëllim ndëshkimin, Gjykata kishte vendosur që masat mbrojtëse të parashikuara nga neni 5 § 4 duhej të inkorporoheshin në vendimmarrjen e gjykatës kombëtare. Pasi ishte vërtetuar se “tarifa” e kërkuesve ishte vendosur nga Sekretari i Brendshëm dhe jo nga një gjykatë e pavarur, nuk mund të thuhet se masat mbrojtëse të kërkuara sipas nenit 5 § 4 ishin inkorporuar në dënimin e kërkuesve. Për më tepër, pasi u prish “tarifa” fillestare e Sekretarit të Brendshëm, nuk u vendos asnjë “tarifë” tjetër. Kjo do të thoshte që kërkuesit nuk ishin në gjendje të kundërshtonin ligjshmërinë e paraburgimit të tyre, pasi në atë kohë nuk kishte një kuadër të plotë ligjor për dënimin e tyre me burgim. Për rrjedhojë, që nga koha e dënimit kërkuesit nuk kishin pasur mundësi të kundërshtonin ligjshmërinë e burgimit të tyre dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 5 § 4.

#### Neni 41

Kërkuesit nuk bënë kërkesa lidhur me dëmin material ose jomaterial dhe për këtë nuk ju akordua asnjë shumë. Gjykata i akordoi T. shumën prej 18,000 paund sterlina (GBP) dhe 32,000 paund sterlina (GBP) për shpenzimet gjyqësore.<sup>165</sup>

---

<sup>165</sup> Vlera e përafërt 1£ = 1.59 €

*Kthimi i një familje afgane azilkërkuessish në Itali sipas Rregullores së "Dublin" pa garanci individuale në lidhje me kujdesin ndaj tyre përbënte shkelje të nenit 3*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN TARAKHEL K. ZVICRËS**

(Kërkesa nr. 29217/12)

**4 nëntor 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Golajan Tarakhel, i lindur në vitin 1971, gruaja e tij Meryam Habibi, e lindur në vitin 1981 dhe gjashtë fëmijët e tyre të mitur, të lindur mes viteve 1999 dhe 2012, ishin shtetas afganë të cilët jetonin në Lozanë, në Zvicër.

Z. Tarakhel dhe Znj. Habibi ishin njohur dhe martuar në Pakistan para se të jetonin në Iran për 15 vjet. Më pas ata u larguan nga Irani për në Turqi, nga ku morën një anije për në Itali. Çifti dhe pesë fëmijët e tyre më të mëdhenj, zbarkuan në bregdetin italian në korrik të vitit 2011, para se t'i nënshtroheshin procedurës së identifikimit EURODAC dhe të dërgoheshin në institucionin e pritjes. Kërkuesit, pasi u përcaktua identiteti i tyre, u transferuan në Qendrën e Pritjes të Azilkërkuessve (CARA) në Bari.

Në fund të korrikut të vitit 2011, kërkuesit u larguan nga CARA pa leje dhe udhëtuan për në Austri, ku kërkuan azil por pa sukses. Më pas udhëtuan për në Zvicër dhe paraqitën atje një kërkesë për azil në nëntor të vitit 2011. Në janar të 2012, Zyra Federale e Migracionit (ZFM) në Zvicër vendosi të mos shqyrtojë kërkesën për azil pasi bazuar në Rregulloren e Dublinit të Bashkimit Evropian, shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës ishte Italia.

Më pas, ZFM-ja urdhëroi kthimin e kërkuesve në Itali. Kërkuesit apeluan në Gjykatën Administrative Federale, e cila e hodhi poshtë ankesën në shkurt të vitit 2012. Pas kësaj, kërkuesit i kërkuan ZFM-së që rihapte procedurat e për dhënien e azilit në Zvicër, por kjo u hodh poshtë nga Gjykatat Federale Administrative në mars të vitit 2012 me arsyetimin se kërkuesit nuk kishin paraqitur argumente të reja.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se, në qoftë se ktheheshin në Itali, "në mungesë të garancive të veçanta në lidhje me kujdesin e tyre", do t'i nënshtroheshin trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, si rezultat i "mangësive sistemike" në kushtet e pritjes për azilkërkuessit

në Itali, në shkelje të nenit 3. Më tej, ata pretenduan shkelje të nenit 13 pasi autoritetet zvicerane nuk i kishin konsideruar siç duhej rrethanat e tyre personale dhe nuk e kishin marrë parasysh situatën e tyre si një familje në procedurat për kthimin e tyre në Itali, të cilat ishin tepër formale, automatike dhe arbitrare.

### Neni 3

Gjykata ritheksoi parimin e përgjithshëm se dëbimi i azilkërkuesve nga një Shtet Kontraktues, mund të lindë përgjegjësinë e atij Shtetit sipas nenit 3, nëse ka argumente thelbësore për të besuar se personi në fjalë do të përballlet me rrezikun real të torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtërues në vendin pranues. Përveç kësaj, Gjykata nënvizoi faktin se një azilkërkues është “një anëtar i një grupi të veçantë, të diskriminuar dhe vulnerabël të popullsisë që ka nevojë për mbrojtje të veçantë”.

Gjykata iu referua Rekomandimeve të ZKLKBR-së dhe raportit të vitit 2012, të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, të cilët i referohen një numri mangësish në kushtet e pritjes së azilkërkuesve në Itali. Kishte një mungesë të hapësirave në qendrat e pritjes, çka do të thoshte se një numër i madh i azilkërkuesve kishin mbetur pa strehim. Në vitin 2013, ZKLKBR-ja kishte identifikuar një sërë problemesh që lidhen me cilësinë e shërbimeve të ofruara, që ndryshonin në varësi të madhësisë së objekteve dhe të mungesës së koordinimit në nivel kombëtar. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, në raportin e tij të vitit 2012, kishte vërejtur ekzistencën e problemeve në lidhje me ndihmën ligjore, kujdesin dhe ndihmën psikologjike në qendrat e pritjes emergjente, kohën e marrë për të identifikuar personat në nevojë dhe ruajtjen e unitetit të familjes gjatë transferimeve.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se struktura dhe situata e përgjithshme e pritjes së azilkërkuesve në Itali, ngrite dyshime serioze për kapacitetet e sistemit. Si rrjedhojë, mundësia që një numër i konsiderueshëm i azilkërkuesve mund të mbeteshin pa strehim, ose të qëndronin në objektet e mbipopulluara pa asnjë intimitet, apo edhe në kushte jo të shëndetshme e të dhunshme, nuk mund të hidhej poshtë si e pabazë. Prandaj, ishte e nevojshme të shqyrtohej situata individuale e kërkuesve në dritën e situatës së përgjithshme që mbizotëronte në Itali në kohën përkatëse në lidhje me kushtet e pritjes.

Duke pasur parasysh se ambientet e pritjes në Itali ishin të papërshtatshme, Shteti zviceran ishte përgjegjës për të marrë garancitë e mjaftueshme nga autoritetet italiane, që kërkuesve do t'u viheshin në dispozicion ambiente me kushte të përshatshme për moshën e fëmijëve të tyre dhe se familja do të qëndronte së bashku,

nëse ktheheshin në Itali. Edhe pse ZFM-ja ishte kontaktuar nga autoritetet italiane në lidhje me strehimin e familjes, autoritetet zvicerane nuk kishin marrë informacion mjaftueshëm të detajuar që të mund të ishin të sigurt se kërkuesit do të trajtoheshin në mënyrë të përshtatshme.

Në mungesë të garancive të tilla individuale, Gjykata konstatoi se do të kishte shkelje të nenit 3 të Konventës nëse kërkuesit do të ktheheshin në Itali pa u marrë më parë garanci të tilla individuale specifike në raport me situatën e tyre individuale dhe familjare.

#### Neni 13 i shqyrtuar së bashku me nenin 3

Duke iu referuar intervistës së kërkuesve përpara ZFM-së dhe mundësisë për të apeluar në Gjykatën Federale Administrative, Gjykata konsideroi se kërkuesit kishin në dispozicion një mjet ankimor efektiv në lidhje me pretendimet e tyre sipas nenit 3. Prandaj, pretendimet e tyre sipas nenit 13 u refuzuan si të pabazuara.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që Zvicra t'i paguante kërkuesve 7,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

*Kohëzgjatja e panevojshme e procesit gjyqësor familjar dhe mungesa e ekzekutimit të vendimit të së drejtës së takimit përbën shkelje të neneve 6 dhe 8*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN V.A.M. k. SERBIË**

(Kërkesa nr. 39177/05)

**13 mars 2007**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja V.A.M, në shkurt të vitit 1999 ngriti një padi civile në të cilën kërkoi zgjidhje martese me bashkëshortin D.M., kujdestarinë e vajzës së saj S.M dhe detyrimin ushqimor për rritjen e saj. Zgjidhja e martesës së zonjës V.A.M dhe mohimi i çdo kontakti të saj me vajzën, dukej si rezultat i faktit se ajo ishte me HIV.

Pas nisjes së procesit gjyqësor, Gjykata e Katërt Komonale në Beograd shtyu 15 sene. Cjatë kësaj kohe, megjithëse kryesisht në përgjigje të kërkesave të shumta të kërkueses, Gjykata Komonale u përpoq të merrte informacion në lidhje me adresën e saktë të të paditurit nga organet e ndryshme shtetërore, duke përfshirë autoritetet tatimore, komnat, Ministrinë e Arsimit dhe Gjykatën Tregtare.

Thirrjet u dërguan në një numër adresash, por çdo herë që i padituri nuk mori dijeni, gjë që më 17 prill 2003 e detyroi gjykatën të arrinte në përfundimin se ai ishte “duke shmangur në mënyrë të qartë drejtësisë”. Procesi gjyqësor nuk kishte përfunduar ende kur çështja po shqyrtohej nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Më 23 korrik 1999 Gjykata Komonale e urdhëroi të paditurin të lehtësonte aksesin e kërkueses me S.M., dy herë në muaj, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar mbi themelin e çështjes. Përkundër kësaj, në kohën e gjykimit të këtij rasti në Gjykatën e Strasburgut, zonja V.A.M. nuk kishte qenë në gjendje ta shihte vajzën e saj për rreth tetë vjet, vendimi për të drejtën takimit nuk ishte zbatuar asnjë herë zyrtarisht.

Më 15 qershor 2006, Gjykata Komonale i dha kujdestari të përkohshme të S.M. kërkueses dhe urdhëroi të paditurin ta dorëzojë fëmijën, në pritje të një vendimi përfundimtar mbi themelin e çështjes. Në arsyetimin e saj, ajo gjeti *inter alia* se: i) i padituri e kishte bërë të qartë që nga fillimi se ai nuk do të lejonte që kërkuesja të kishte kontakt me S.M. për shkak të frikës së tij se fëmija mund të “infektohej” me HIV; ii) kërkuesja përkundër pretendimeve të të paditurit, ishte një prind i përgjegjshëm dhe i motivuar, gjendja shëndetësore e së cilës ishte e qëndrueshme, vazhdimisht nën kontroll dhe nuk paraqiste rrezik për S.M. ; dhe iii) i padituri jo vetëm që nuk kishte



respektuar detyrimin e tij për ta informuar gjykatën për adresën e tij të saktë, por gjithashtu, për shumë vite, kishte shmangur me qëllim drejtësinë, që nga ana e tjetër kishte rezultuar në mohimin e së drejtës së kërkueses për tu takuar me S.M., duke treguar kështu një shpërfillje të madhe ndaj interesave të S.M. nga ana e tij.

Më 13 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut pranoi ankesën e të paditurit ndaj vendimit të Gjykatës Komunale, e anuloi urdhrin e kundërshtuar dhe e udhëzoi Gjykatën Komunale që të rishqyrtojë çështjen e kujdestarisë së përkohshme së kërkueses.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Zonja V.A.M. u ankua në bazë të neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës lidhur me kohëzgjatjen dhe rregullsinë e procesit civil, si edhe mungesën e mjeteve juridike efektive. Ajo gjithashtu u ankua për diskriminim, në kuadër të nenit 14, për shkak të faktit se ajo ishte me HIV-it.

### Neni 6 § 1

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse. Gjithashtu, një konsideratë të rëndësishme kërkon e drejta që rrezikohet për kërkuesin, duke mbajtur në vëmendje pasojat e mundshme, që mund të sjellë kohëzgjatja e procesit, veçanërisht në gëzimin e së drejtës për respektimin e jetës familjare. Numri i lartë i çështjeve përpara një gjykate nuk është një shpjegim i vlefshëm për vonesat e tepërta pasi shtetet kanë për detyrë të organizojnë sistemet e tyre juridike në mënyrë të tillë, që gjykatat vendase të mund të përmbushin detyrimin për të dëgjuar rastet brenda një kohe të arsyeshme.

Në çështjen objekt gjykimi procesi gjyqësor në nivel të brendshëm ka zgjatur 8 vjet, nga të cilat 2 vjet e 11 muaj do të shqyrtohen nga Gjykata (pas datës kur Konventa kishte hyrë në fuqi në lidhje me Serbinë). Duke pasur parasysh atë që rrezikohej për zonjën V.A.M. sidomos në lidhje me gjendjen shëndetësore të saj, Gjykata konstatoi se autoritetet vendase, në vend që të tregonin kujdes të jashtëzakonshëm në përshejtimin e procedurës, në mënyrë të vazhdueshme dështuan të përdorin mjetet procedurale në dispozicion për të detyruar D.M. të ishte prezent gjatë seancave gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procesit civil.

### Neni 8

Së pari, Gjykata vërejt se gëzimi i ndërsjellë nga prindërit dhe fëmija i shoqërisë së njëri-tjetrit përbën një element thelbësor të “jetës familjare” brenda kuptimit të nenit 8. Më tej, edhe pse objekti kryesor i nenit 8 është mbrojtja e individit kundër veprimeve arbitrare nga autoritetet publike, ky nen sjell gjithashtu detyrime pozitive të qenësishme për shtetet në garantim të “respektimit” efektiv të jetës familjare. Në rastet, që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve në sferën e të drejtës familjare, Gjykata ka vërejtur në mënyrë të përsëritur se e rëndësishme është të vlerësohet nëse autoritetet kombëtare kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme dhe të arsyeshme në varësi të rrethanave specifike të çdo rasti, për të lehtësuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Mjaftueshmëria e një mase duhet të gjykohet me shpejtësinë e zbatimit të saj, pasi kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pariparueshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit, i cili nuk bashkëjeton me të. Megjithëse masat shtrënguese kundër fëmijëve nuk janë të dëshirueshme në këtë fushë të ndjeshme, përdorimi i sanksioneve nuk duhet të përjashtohet në rast të sjelljes së paligjshme të prindit i cili jeton me fëmijën.

Duke pasur parasysh faktet e çështjes konkrete, përfshirë kalimin e kohës dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të S.M., Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet serbe kishin dështuar të bënin përpjekje adekuate dhe efektive për të ekzekutuar vendimin e ndërmjetëm të 23 korrikut 1999. Për rrjedhojë në këtë rast ka pasur një shkelje të së drejtës së kërkueses për respektimin e jetës së saj familjare garantuar nga neni 8 i Konventës.

Gjithashtu, duke pasur parasysh rrethanat bindëse të rastit, në veçanti atë kërkuesja rrezikonte, sjelljen e autoriteteve serbe dhe, në të vërtetë, dallimin në natyrën e interesave të mbrojtura nga nenet 6 dhe 8 të Konventës, Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e procesit gjyqësor civil.

### Neni 13

Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 13 marrë së bashku me nenin 6 të Konventës, në lidhje me mungesën e mjetit ligjor efektiv në legjislationin vendas për të adresuar ankimin e kërkueses sa i takon kohëzgjatjes së procesit.

#### Neni 14

Gjykata gjeti se provat në dispozicion ishin të pamjaftueshme për të konstatuar nëse kërkuesja ishte diskriminuar vërtet për shkak të shëndetit të saj. Kështu, Gjykata e deklaroi këtë ankim haptazi të pabazuar.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkueses 15,000 euro në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material dhe 4,350 uro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Heqja e të drejtës së aksesit të babait ndaj fëmijës për shkak të besimit fetar ishte diskriminuese dhe përbënte shkelje të nenit 14 marrë së bashku me nenin 8*

## VENDIMI PËR ÇËSHTJEN VOJNITY K. HUNGARISË

(Kërkesa nr. 29617/07)

**12 shkurt 2013**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Péro Vojnity, ishte shtetas hungarez i lindur në 1948, dhe i përkiste besimit fetar të *Hit Gyülekezete* (Kongregacioni i Besimit). Kërkuesi i dytë kishte një djalë, i lindur në 1994, i cili pas divorcit të prindërve të tij qëndroi me nënën. Z. Vojnity i ishte garantuar e drejta për të pasur akses me të birin.

Z. Vojnity parashtroi një kërkesë për të kërkuar kujdestarinë e fëmijës ose për të rirregulluar kushtet e të drejtave për të pasur akses me të birin. Pavarësisht sugjerimit të bërë nga një psikiatër për të lejuar kontakt më të lirshëm me fëmijën, Gjykata e Rrethit të Szeged e hodhi poshtë kërkesën e tij. Më tej, një kërkesë tjetër e z. Vojnity, e parashtruar në vitin 2004 u hodh sërish poshtë, pasi e njëjta gjykatë konstatoi se rrethanat e kërkuesit nuk ishin të pranueshme për edukimin e një fëmije.

Në 2006 nënës ju hoq kujdestaria nga Autoriteti i Mbikqyrjes së Szegedit dhe fëmija ju la vëllait të tij më të madh. Kërkuesi nuk u konsiderua për dhënien e kujdestarisë, për shkak të prozelitizmit të tij të tepruar dhe kushteve të papërshtatshme të banimit, por ju dha e drejta për akses.

Vëllai i më të madh paraqiti kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor kundër z. Vojnity për ta privuar atë nga të drejtat e tij të aksesit ndaj djalit. Eksperti psikolog vërejti se pjesëmarrja e kërkuesit në jetën e fëmijës së tij ishte e dëmshme, veçanërisht për shkak të insistimit të tij në prozelitizëm dhe gjykata procedoi me heqjen e të drejtave të aksesit të kërkuesit. Më 4 shkurt 2008, Gjykata Rajonale e Qarkut të Csongrád e la në fuqi këtë vendim.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se heqja e plotë e të drejtave të tij të aksesit përbënte ndërhyrje të pajustificuar dhe joproporcionale në të drejtën e tij për jetë familjare, në kundërshtim me nenin 8 të Konventës, të marrë më vete dhe së bashku me nenet 14 dhe 9, ku ai u ankua se mohimi i të drejtës së tij nga ana e autoriteteve përbënte një trajtim

të diferencuar për shkak të besimit të tij fetar. Ai gjithashtu u ankua për shkelje të nenit 6.

#### Neni 14 marrë së bashku me nenin 8

Gjykata përsëriti se prindi dhe fëmija duhet të gëzojnë shoqërinë e njëri-tjetrit si një aspekt themelor i jetës familjare. Në rastin në fjalë, kërkuesi kishte kontakt të rregullt me fëmijën deri me vendimin e heqjes së të drejtës së tij për akses, kështu që ishte e qartë se ky vendim përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës familjare.

Fillimisht, Gjykata vuri në dukje se gjykatat e brendshme kishin mbajtur parasysh prevalimin e interesit të fëmijës kur i hoqën të drejtën për të pasur akses kërkuesit. Megjithatë, Gjykata konstatoi se bindja fetare e kërkuesit ishte fakti vendimtar lidhur me vlerësimet e bëra nga autoritetet kombëtare, të cilat i kishin trajtuar ndryshe raste të tjera në lidhje me prindërit e tjerë të gjendur në një situatë të ngjashme, por që nuk kishin ndonjë besim të tepruar fetar. Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, një trajtim i tillë i ndryshëm duhet të ketë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, ose duhet të konsiderohet diskriminues. Në rastin në fjalë, mbrojtja e shëndetit dhe të drejtave të fëmijës përbënte një qëllim ligjshëm.

Nisur nga rrethanat e rastit, Gjykata pranoi se autoritetet kombëtare treguan një interes të ligjshëm lidhur me zhvillimin e fëmijës, por vunë në dukje se lidhur me fënë e kërkuesit nuk kishte asnjë dëshmi bindëse që mund të përbënte rrezik për dëmtimin e fëmijës në rastin në fjalë.

Për më tepër, Gjykata përsëriti se në kontekstin e kufizimeve mbi të drejtat e aksesit prindëror kërkohet një shqyrtim i rreptë dhe masa radikale si heqja e plotë e kontaktit, e cila mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, pasi fëmijët kanë të drejtë të mbajnë lidhje familjare. Sipas pikëpamjes së Gjykatës ekzistenca e rrethanave të tilla të jashtëzakonshme nuk është provuar në rastin në fjalë, pasi autoritetet nuk arritën të përcaktojnë se çfarë dëmi real do të shkaktonte besimi fetar i kërkuesit tek fëmija.

Gjykata vuri në dukje se masa e dhënë nga autoritetet kombëtare, e bënte të pamundur kontaktin mes kërkuesit dhe të birit duke mos marrë në konsideratë masat alternative më pak të ashpra, ishte joproporcionale dhe nuk ndiqte një qëllim legjitim, respektivisht mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Për rrjedhojë, u konstatua se kërkuesi ishte diskriminuar në bazë të besimit të tij fetar

në ushtrimin e së drejtës së tij për respektimin e jetës familjare, në kundërshtim me nenin 14 të marrë së bashku me nenin 8.

#### Nene të tjera

Gjykata konstatoi se nuk u paraqit asnjë kërkesë e veçantë në lidhje me nenin 6, në lidhje me nenin 8 të marra më vete ose së bashku me nenin 9 i marrë më vete ose së bashku me nenin 14, përsa kohë që rrethanat faktike në të cilat mbështeten janë të njëjta me ato për kërkesën e marrë në shqyrtim më sipër.

#### Neni 41

Gjykata konkludoi se Hungaria duhej ti paguante kërkuetit 12,500 euro lidhur me dëmin jomaterial dhe 3,000 euro lidhur me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

*Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve – dështim i autoriteteve për të shqyrtuar ankimin mbi “rrezikun e” ndaj një fëmije*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN X k. LETONISË**

(Kërkesa nr. 27853/09)

**26 nëntor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja znj. X, ishte shtetase letoneze e lindur në 1974. Në një datë të papërcaktuar, ajo u shpërngul në Australi ku u martua me një z. R.L. Në vitin 2004, ndërsa ishte ende e martuar me R.L., kërkuesja u takua me z. T. me të cilin më pas vendosi të bashkëjetonte në fund të vitit. Në shkurt të vitit 2005, kërkuesja lindi një vajzë, E., dhe në nëntor 2005, ajo u divorcua zyrtarisht nga R.L. Atësia e fëmijës nuk ishte përcaktuar në këtë fazë. Kërkuesja vazhdoi të jetonte me T-në, në banesën të cilën ky i fundit e kishte marrë me qira, si edhe përfitonte asistencë si prind i vetëm. Kërkuesja mori shtetësinë australiane në vitin 2007. Marrëdhëniet mes kërkueses dhe T. u përkeqësuan dhe në vitin 2008 ajo u largua nga Australia për në Letoni duke marrë me vete vajzën e saj e cila ishte tre vjeç e pesë muaj.

Menjëherë, T. paraqiti një padi në Gjykatën Australiane të Familjes për të vendosur të drejtat prindërore në lidhje me E., duke kërkuar kthimin e fëmijës në Australi sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Gjykata australiane u shpreh për atësinë e tij, si edhe për faktin që kërkuesja dhe T. kishin pasur përgjegjësi të përbashkët prindërore për fëmijën e tyre, që nga lindja. Kërkuesja ishte ftuar të merrte pjesë në seancë gjyqësore personalisht, ose ta ndiqte atë përmes telefonit por nuk e kishte bërë këtë. Kërkuesja nuk e apeloj vendimin.

Në shtator 2008, Autoriteti Qendror i Letonisë mori një kërkesë nga institucioni homolog australian me objekt kthimin e fëmijës. Kërkuesja u dëgjua në Letoni nga dy gjykata vendase dhe T. ishte i pranishëm në këto procese. Gjatë këtyre proceseve kërkuesja argumentoi se T. nuk kishte arsye për t’u njohur si babai i E., pasi në kohën e lindjes së saj, ajo kishte qenë e martuar me një burrë tjetër. Për më tepër, T. nuk kishte shprehur kurrë një dëshirë për të njohur atësinë e tij përpara kohës se ajo të kthehej në Letoni. Gjithashtu, kërkuesja argumentoi se T. kishte abuzuar ndaj saj dhe se fëmija kishte zhvilluar një lidhje me Letoninë. Gjatë procesit në apel kërkuesja gjithashtu paraqiti një raport nga një psikolog, që deklaronte se fëmija do të vuante trauma nëse do të ndahej nga nëna. Gjykatat e Letonisë urdhëruan kthimin e fëmijës

në Australi duke vërejtur se largimi ishte i paligjshëm dhe u krye pa pëlqimin e T. Gjykata e Apelit vendosi se nuk mund të merrte në konsideratë raportin e psikologut për vajzën pasi themeli i çështjes së kujdestarisë duhet të vlerësohej nga gjykatat australiane.

Kërkuesja refuzoi të zbatonte vendimin e gjykatës vendase për ta kthyer fëmijën pranë T. dhe kërkoi një pezullim të urdhrit të ekzekutimit. Gjykata vendase urdhëroi zhvillimin e një seance tjetër në prill të vitit 2009. Në mars të vitit 2009 T. takoi papritmas kërkuesen dhe vajzën ndërsa ishte në Letoni dhe arriti ta merrte me vete fëmijën në Australi. Sapo arriti në Australi, gjykatat vendase vendosën që T. kishte përgjegjësinë e vetme prindërore mbi fëmijën dhe se kërkueses i lejohej vetëm të vizitonte vajzën e saj në prani të një punonjësi social. Ajo gjithashtu ishte e ndaluar të fliste me vajzën e saj në letonisht.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të vendimit të gjykatave letoneze për të urdhëruar kthimin e vajzës së saj në Australi. Dhoma në vendimin e saj të datës 15 nëntor 2011, konkludoi me shumicë se kishte pasur shkelje të nenit 8. Rasti iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 me kërkesë të qeverisë.

### Neni 8

Gjykata vërejtë se vendimi për kthimin e fëmijës në Australi kishte përbërë një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private dhe familjare. Kjo ndërhyrje ishte në përputhje me ligjin dhe kishte ndjekur një qëllim legjitim, përkatësisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të babait të saj.

Sa i përket domosdoshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata vuri në dukje se ekzistonte një konsensus i gjerë në mbështetje të idesë se në të gjitha vendimet lidhur me fëmijët duhet të mbahen në vëmendje interesat e tyre më të larta. Këto interesa mund të mos jenë të njëjta me ato të prindërve dhe në kontekstin e një kërkesë për kthim të bërë në bazë të Konventës së Hagës - e cila është e ndryshme nga procedurat e kujdestarisë - ato vlerësimi duhet bërë në dritën e përjashtimeve të parashikuara nga kjo Konventë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kohën e kaluar në një vend (neni 12) dhe ekzistencën e një "rreziku të lart" (neni 13 (b)). Në këtë rast roli i Gjykatës Evropiane ka të bëjë me verifikimin nëse procesi i vendimmarrjes në gjykatat e brendshme, që çoi në vendimin për ta kthyer fëmijën në Australi kishte qenë i drejtë dhe se ishin mbrojtur interesat më të lartë të fëmijës.



Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vuri në dukje se kërkuesja kishte paraqitur në Gjykatën Rajonale të Rigës një raport të hartuar nga një psikolog pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke argumentuar, *inter alia*, se një ndarje e menjëhershme mes fëmijës dhe nënës duhej të përjashtohej për shkak të traumave psikologjike, që fëmija mund të pësonte. Gjykata nënvizoi se ishte e papranueshme, që gjykatat e brendshme nuk e kishin marrë në konsideratë këtë raport të hartuar nga një ekspert i fushës me argumentin se çështja e trajtuar në të kishte të bënte me themelin e çështjes së kujdestarisë. Në fakt, raporti psikologjik tërhoqi vëmendjen për ekzistencën e një rreziku psikologjik, i lidhur drejtpërdrejt me interesat më të larta të fëmijës, duke paraqitur një dyshim të qenësishëm të një “rreziku të lartë”, i cili duhet të ishte ekzaminuar në dritën e nenit 13 (b) të Konventës së Hagës, sikurse duhet të ishte shqyrtuar edhe çështja nëse ishte e mundur, që nëna të ndiqte vajzën e saj në Australi dhe të mbante kontakt me të. Nevoja për të respektuar afate ligjore, pa dyshim të parashikuara edhe nga Konventa e Hagës, nuk mund t’i liroje autoritetet letoneze nga përgjegjësia për të shqyrtuar një pretendim të tillë.

Në përfundim, Gjykata u shpreh se refuzimi për të shqyrtuar një raport të përgatitur nga një ekspert, i cili nënvizonte ekzistencën e mundësisë së një “rreziku të lartë” për fëmijën në kuptim të nenit 13 (b) të Konventës së Hagës, e detyronte të arrinte në përfundimin se autoritetet letoneze kishin dështuar për të përmbushur detyrimet e tyre procedurale në kuadër të nenit 8 të Konventës duke shkelur kështu të drejtën e garantuar nga ky nen.

#### Neni 41

Gjykata vendosi se Letonia duhet t’i paguante kërkueses 2,000 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

*Dështimi i autoriteteve shtetërore për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga neglizhenca duke shkeli kështu nenin 3*

## **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN Z. DHE TË TJERËT K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 29392/95)

**10 maj 2001**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkesit ishin të gjithë vëllezër dhe motra mes tyre të lindur respektivisht ndërmjet viteve 1982–1988. Në tetor 1987 familja e kërkesve iu referua shërbimeve sociale nga *kujdestari shëndetësor* për shkak të shqetësimeve rreth fëmijëve, duke përfshirë këtu edhe raportet që paraqisnin se njëri prej tyre Z. kishte vjedhur ushqim. Pas këtij referimi shërbimet sociale monitoruan familjen dhe ofruan forma të ndryshme të mbështetjes për prindërit për katër vite e gjysëm. Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe problemet vazhduan. Në tetor të vitit 1989, kur ishin duke hetuar një vjedhje, policia evidentoi se dhomat e fëmijëve ishin në një gjendje shumë të keqe sanitare, duke përfshirë dyshekët e ndotur me urinë. Në mars 1990, u raportua se Z. dhe A. po vidhnin ushqim nga kazanët e mbeturinave në shkollë. Më pas në shtator 1990, u raportua se dy fëmijët e tjerë A. dhe B. kishin plagë në fytyrat e tyre. Në disa raste, u raportua se fëmijët ishin mbyllur në dhomat e tyre dhe gjatë kësaj kohe copëtonin jashtëqitje në dritare. Më 10 qershor 1992, fëmijët u vendosën në një familje kujdestare emergjente pas kërkesës së nënës së tyre, e cila kishte deklaruar se nëse ata nuk do të largoheshin nga kujdesi i saj, ajo do t'i qëllonte. Psikologjia që ekzaminoi fëmijët zbuloi se tre të rriturit tregonin shenja të shqetësimeve të rënda psikologjike dhe theksoi se ky ishte rasti më i keq i shpërfilljes dhe abuzimit emocional që kishte parë.

Avokati i caktuar kryesisht për të vepruar për llogari të kërkesve, nisi procedimin kundër autoriteteve lokale duke pretenduar shpërblimin e demit të ardhur si pasojë e neglizhencës së këtyre autoriteteve ndaj marrjes së masave për të garantuar mirëqenien dhe mbrojtjen efektive të fëmijëve. Ky proces përfundoi në Dhomën e Lordëve dhe pretendimet e kërkesve u rrëzuan. Në vendimin e dhënë më 29 qershor 1995, u vërejt se konsideratat e politikave publike ishin të tilla që autoritetet lokale nuk duhet të mbajnë përgjegjësi për rastet e neglizhencës në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre statutores, që mbrojnë mirëqenien e fëmijëve.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se autoritetet lokale nuk kishin marrë masat e përshtatshme për t'i mbrojtur ata nga neglizhenca dhe abuzimi i rëndë, ndaj të cilit kishin qenë subjekt për shkak të keqtrajtimit nga prindërit e tyre, si edhe u ankuan për faktin se u ishte shkëlur e drejta për të aksesuar gjykatën, ose një mjet ligjor efektiv për ta rivedosur në vend këtë të drejtë. Kërkuesit inkovuan nenet 3, 6, 8 dhe 13 të Konventës.

### Neni 3

Neni 3 i Konventës garanton një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike, duke ndaluar në terma absolutë torturën ose trajtimin ose ndëshkimin çnjerëzor ose poshtëruës. Shtetet duhet të marrin masa për të siguruar, që çdo individ brenda juridiksionit të tyre nuk i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose degradues, duke përfshirë edhe keqtrajtimin e kryer nga individë privatë. Këto masa duhet të sigurojnë mbrojtje efektive veçanërisht të fëmijëve dhe personave të tjerë vulnerabel, duke përfshirë këtu hapa të arsyeshëm për të parandaluar një keqtrajtim për të cilin autoritetet kishin, ose duhet të kishin dijeni.

Gjykata vërejti se nuk kishte asnjë kundërshtim se neglizhenca dhe abuzimi, që kishin pësuar të katër fëmijët kishte arritur pragun e trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Qeveria britanike nuk e kundërshtoi faktin, që shteti kishte dështuar në përbushjen e detyrimit të tij pozitiv sipas nenit 3 për t'u dhënë kërkuesve mbrojtje të përshtatshme ndaj trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Trajtimi i pësuar nga kërkuesit u soll në vëmendjen e autoritetit lokal, në tetor 1987, që kishin një detyrë ligjore për të mbrojtur fëmijët dhe kishte një sërë kompetencash në dispozicion, duke përfshirë këtu largimin e tyre nga shtëpia. Megjithatë, fëmijët u morën në kujdestari emergjente vetëm pas insistimit të nënës së tyre më 30 prill 1992.

Sipas raportit të psikiatrit gjatë periudhës së ndërhyrjes prej katër vjet e gjysmë, kërkuesit iu ishin nënshtruar përvojave të tmerrshme. Gjithashtu, Bordi i Kompenimit të Dëmtimeve Penale kishte vërejtur se fëmijët kishin qenë subjekt i një neglizhimi të tmerrshëm gjatë një periudhe të zgjatur dhe kishin pësuar lëndime fizike e psikologjike, që klasifikoheshin si vepra penale dhune. Gjykata vërejti se ishte e ndërjegjshme për vështirësinë e vendimeve me të cilat ballafaqohen shërbimet sociale, si edhe parimin e rëndësishëm kundërveprues të respektimit dhe ruajtjes së jetës familjare. Megjithatë, çështja objekt gjykimi nuk la asnjë dyshim për të konstatuar dështimin e sistemit për të mbrojtur kërkuesit nga neglizhenca abuzimi serioz dhe afatgjatë. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 3.

### Neni 8

Pasi evidentoi se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme, që ankimi në lidhje me nenin 8 të shqyrtohej më vete.

### Neni 6

Gjykata vërejti se prej fillimit të procesit në gjykatat vendase kishte pasur një mosmarrëveshje serioze rreth ekzistencës të së drejtës së parashtruar nga kërkuesit sipas legjislacionit të brendshëm. Prandaj, neni 6 ishte i zbatueshëm për procesin e nisur nga kërkuesit, që pretendonin neglizhencë nga ana e autoriteteve lokale.

Në lidhje me pajtueshmërinë me nenin 6, Gjykata vërejti se rezultati i proceseve të brendshme ishte se kërkuesit dhe çdo fëmijë tjetër, që ankohej për shkelje të njëjta nuk mund të padisnin një autoritet lokal për neglizhencë dhe shpërblim dëmi, megjithëse kjo situatë kishte qenë e parashikueshme, rëndë dhe kishte shkaktuar vuajtje. Megjithatë, kjo e drejtë nuk derivonte nga asnjë klauzolë procedurale ose imunitet, që kufizonte të drejtën e kërkuesve për t'iu drejtuar gjykatës. Rrëzimi i pretendimit të kërkuesve rezultoi nga zbatimi i parimeve të së drejtës materiale nga gjykatat e brendshme. Për rrjedhojë, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë mbi përmbajtjen e duhur të së drejtës kombëtare. Megjithatë, kërkuesit ishin të saktë në pretendimet tyre se vakumi ligjor, që ata kishin identifikuar ishte ai që ngrii një çështje në bazë të Konventës. Gjykata vlerësoi se ky pretendim i takonte nenit 13 dhe jo nenit 6 (1), duke mos gjetur kështu asnjë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

### Neni 13

Gjatë shqyrtimit nëse kishte pasur shkelje të nenit 13, Gjykata vërejti se kërkuesit pretenduan se autoritetet dështuan për të mbrojtur qytetarët nga veprimet e individëve të tjerë privatë. Duhet të ekzistonin mekanizma ligjore në dispozicion të viktimave ose familjarëve të tyre për të vendosur përpara përgjegjësisë zyrtarët ose organet shtetërore, për kryerjen veprime apo mosveprime, që përfshijnë shkeljen e të drejtave të individëve sipas Konventës. Për më tepër, në rastin e një shkelje të neneve 2 dhe 3, të cilat renditen si dispozitat më themelore të Konventës, kompensimi për dëmin jomaterial që rrjedh nga këto shkelje duhet në parim të ekzistojë si pjesë e gamës së rivendosjes të së drejtës.

Gjykata vlerësoi se kërkuesit nuk kishin pasur në dispozicion të tyre një mjet të përshatshëm për të marrë një përcaktim të pretendimeve të tyre se autoritetet lokale nuk i kishte mbrojtur nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues, ose nga mundësia e

marrjes së një kompensimi të detyrueshëm për dëmin e pësuar. Rrjedhimisht, atyre nuk u është dhënë një mjet efektiv në lidhje me shkeljen e nenit 3 duke shkelur kështu nenin 13 të Konventës.

#### Neni 41

Në lidhje me dëmin material Gjykata i akordoi kërkuetit Z. 8,000 GBP, kërkuetit A. 100,000 GBP, kërkuetit B. 80,000 GBP dhe kërkuetit C. 4,000 GBP. Gjithashtu, Gjykata i akordoi secilit kërkuet 32,000 GBP në lidhje me shpërblimin e dëmit jo material dhe shpenzimet gjyqësore.

*Foshnjat e humbura në spitale: Serbia duhet të japë shpjegime të besueshme në lidhje me fatin e secilit prej fëmijëve dhe të vërë në vend të drejtat e shkelura të prindërve*

## **ZORICA JOVANOVIĆ k. SERBIË**

(kërkesa nr. 21794/08)

**26 mars 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkesja, Zorica Jovanović, është shtetase serbe, e cila ka lindur në vitin 1953 dhe jeton në Batočina (Serbi).

Më 28 tetor 1983 Znj. Jovanović lindi një djalë të shëndetshëm në Qendrën Mjekësore Čuprija, një spital shtetëror. Tre ditë më vonë, kur ajo dhe foshnja ishin gati për tu larguar, ajo u informua se, foshnja e saj kishte vdekur. Ajo u përpoq të hynte në dhomën e spitalit ku djali i saj kishte kaluar natën, por u ndalua nga dy sanitare të spitalit. Një infermiere u përpoq t'i injektonte një qetësues, të cilën ajo arriti ta shmangë. Në një gjendje shoku dhe duke mos pasur asnjë mundësi tjetër, ajo u largua nga spitali. Trupi i foshnjës nuk iu dorëzua kurrë znj. Jovanović apo familjes së saj. Asaj kurrë nuk iu dha ndonjë raport autopsie apo ndonjë informacion se, kur dhe ku ishte varrosur foshnja. Spitali thjesht e informoi atë se, djali i saj kishte vdekur më 31 tetor 1983 dhe se, nuk kishte asnjë informacion për sa i përket shkakut të vdekjes.

Në nëntor të vitit 2002 komuna lokale e informoi znj. Jovanović se, lindja e të birit, por jo vdekja, ishte regjistruar në regjistrat komunal. Kjo u konfirmua përsëri në shtator të vitit 2007.

Një padi penale e ngritur nga bashkëshorti i znj. Jovanović kundër stafit të spitalit - pas raportimeve në media për rastet e tjera të ngjashme - u hodh poshtë në tetor 2003 si e pabazuar. Nuk u dhanë shpjegime të mëtejshme dhe nuk ishte e qartë nëse ishte kryer apo jo një hetim paraprak.

Midis vitit 2003 dhe 2010 u ndërmorën disa hapa për përmirësimin e procedurave në spitale në rastet e vdekjes së të porsalindurve dhe për të hetuar pretendimet në vitin 2005 nga prindërit e qindra foshnjave të porsalindura të cilat, ishin zhdukur pasi ishin deklaruar se kishin vdekur në repartet spitalore, kryesisht që nga vitet 1970 deri në vitet 1990. Raportet zyrtare konstatuan mangësi serioze në legjislacionin në fuqi në vitet 1980, si dhe në procedurat dhe rregullimet normative për trajtimin e rasteve kur një i porsalindur vdes në spital dhe se dyshimet e prindërve për çfarë u

kishte ndodhur në të vërtetë fëmijëve të tyre, ishin të justifikuara. Gjithashtu raportet kishin konstatuar se, përgjigja e organeve shtetërore për situatën kishte qenë e pamjaftueshme në vetvete. Në dhjetor 2010, një grup pune i ngritur nga Parlamenti serb arriti në përfundimin se, nuk kishte nevojë për ndryshime të legjisllacionit, i cili ndërkohë ishte amenduar, me përjashtim të mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave mjekësore. Grupi gjithashtu vuri në dukje se, Kushtetuta nuk e lejonte zgjatjen e periudhës së parashkrimit të ndjekjes penale të veprave të kryera në të kaluarën, ose për të parashikuar veprat penale të reja, më të rënda, dhe/ose dënime më të ashpra.

Znj. Jovanović ishte trajtuar në mënyrë të përsëritur për depresion ndërmjet viteve 2009-2011.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në veçanti në nenin 8 dhe nenit 13, znj. Jovanović pretendoi se, autoritet serbe kishin dështuar në mënyrë të vazhdueshme për t'i dhënë asaj informacion në lidhje me fatin e djalit të saj të porsalindur dhe për t'i dhënë asaj mundësinë për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

### Neni 8

Gjykata vërejti se, Znj. Jovanović kishte mbetur ende sot e kësaj dite pa një përgjigje të besueshme mbi çfarë kishte ndodhur me djalin e saj në vitin 1983. Ajo kurrë nuk e kishte parë trupin e pajetë të djalit të saj, shkaku i vdekjes së tij kurrë nuk ishte përcaktuar dhe vdekja e tij kurrë nuk ishte regjistruar zyrtarisht. As padia penale e ngritur nga bashkëshorti i saj në lidhje me këtë nuk ishte vlerësuar siç duhej. Në të vërtetë, vetë autoritetet serbe kishin pohuar në një sërë raportesh, se kishte probleme dhe mangësi në legjisllacionin në fuqi në atë kohë, në procedurat dhe rregullimet normative në rastet e vdekjeve në spital të të sapolindurve si dhe në reagimin e shtetit ndaj akuzave për zhdukjen e foshnjave në spitale.

Pavarësisht nga disa nisma zyrtare, në dukje premtuese, ndërmjet viteve 2003 dhe 2010, raporti i grupit të punës i dhjetorit 2010 arriti në përfundimin se, nuk ishin të nevojshme ndryshime të mëtejshme në legjisllacionin tashmë të ndryshuar. Megjithatë, kjo në mënyrë të qartë vetëm përmirësonte situatat në të ardhmen por, në fakt, nuk bëri asgjë për prindërit, përfshirë këtu edhe kërkuesen, të cilët kishin kaluar një eksperiencë të tillë në të kaluarën.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se, kishte pasur shkelje të vazhdueshme të së drejtës së Znj. Jovanović për respektimin e jetës familjare për shkak të dështimit të

vazhdueshëm të autoriteteve serbe për t'i siguruar asaj informacion të besueshëm në lidhje me atë që kishte ndodhur me djalin e saj. Kështu, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8.

Gjykata konstatoi se nuk kishte nevojë të shqyrtohej më vete ankesa sipas nenit 13.

#### Neni 46

Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të kërkuessve potencialë, Gjykata u shpreh më tej se Serbia duhej që - brenda një viti nga momenti që vendimi merrte formë të prerë – të merrte masat e duhura për të siguruar vendosjen në vend të të drejtave të të gjithë prindërve në situatë të ngjashme me kërkuessin. Ky proces duhet të mbikëqyret nga një organ i pavarur, me kompetencat e duhura, në mënyrë që tu jepej një përgjigje e besueshme prindërve në lidhje me çfarë u kishte ndodhur fëmijëve të zhdukur dhe të merrnin dëmshpërblimin e duhur.

Ndërkohë, Gjykata vendosi ta shtyjë për një datë të mëvonshme shqyrtimin e të gjitha kërkesave të ngjashme, tashmë pezull para saj.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesses 10,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 1,800 euro për kostot dhe shpenzimet.